

**PARTITË KONSERVATORE DHE LINDJA E DEMOKRACISË NË KONTEKSTIN
SHQIPTAR: NJË LEXIM KRITIK I MODELIT TË DANIEL ZIBLATT**

Dok Fitimtar Zekthi

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në “Shkenca Sociale dhe të Sjelljes” Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Ervis Iljazaj

Numri i fjalëve 57404

Tiranë, gusht, 2025

DEKLARATA E AUTORËSISË

Dëshmoj se përmbajtja e këtij punimi është vetëm krijimi im dhe nuk është dorëzuar më parë për vlerësim nga asnjë institucion tjetër akademik. Për më tepër, ajo nuk është botuar në tërësi, diku tjetër. Të gjitha kontributet e bëra nga individë të tjerë njihen siç duhet përmes citimit dhe referencës së duhur.

Me respekt

Fitimtar Zekthi

Abstrakt

Ky studim shqyrton rolin e partive konservatore në procesin e lindjes dhe konsolidimit të demokracisë në Shqipëri, përmes një analize kritike të modelit teorik të Daniel Ziblatt. Duke u bazuar në tezën se partitë konservatore mund të shërbejnë si agjentë të institucionalizimit dhe stabilitetit demokratik, kërkimi eksploron nëse dhe në çfarë mase Partia Demokratike e Shqipërisë – si forca kryesore e së djathtës pas rënies së komunizmit – ka përmbushur këtë funksion. Nëpërmjet një qasjeje të kombinuar historike, diskursive dhe institucionale, studimi analizon evolucionin organizativ, qëndrimet në momente kritike, raportin me institucionet dhe kapacitetin për të ofruar alternativë qeverisëse. Gjetjet sugjerojnë se, ndonëse Partia Demokratike ka luajtur një rol thelbësor në tranzicionin nga autoritarizmi, ajo ka dështuar të ndërtojë një kulturë të qëndrueshme institucionale dhe të promovojë konsolidim demokratik të vërtetë. Mungesa e një orientimi të qartë ideologjik, drejtimi personalist, dhe raporti i tensionuar me institucionet e pavarura e kanë penguar këtë forcë politike të veprojë si “parti e së djathtës e kontrolluar dhe përfshirëse” në kuptimin ziblattian. Studimi përpiqet të sjellë një kënd kritik në debatet mbi transplantimin e modeleve teorike në kontekste postkomuniste me tradita të dobëta institucionale.

Fjalë kyçe:

Partitë konservatore; konsolidimi demokratik; Daniel Ziblatt; Shqipëria postkomuniste; Partia Demokratike; institucionalizimi i partive; tranzicioni politik; opozita; demokracia e brishtë; elitat politike.

Abstract

This study examines the role of conservative parties in the process of the birth and consolidation of democracy in Albania through a critical analysis of Daniel Ziblatt's theoretical model. Building on the thesis that conservative parties can serve as agents of institutionalization and democratic stability, the research explores whether, and to what extent, the Democratic Party of Albania—as the main force of the right after the fall of communism—has fulfilled this function. Through a combined historical, discursive, and institutional approach, the study analyzes organizational evolution, behavior in critical moments, relations with institutions, and the capacity to offer a governing alternative. The findings suggest that, although the Democratic Party played a crucial role in the transition from authoritarianism, it has failed to build a sustainable institutional culture and to promote genuine democratic consolidation. The lack of a clear ideological orientation, personalistic leadership, and a tense relationship with independent institutions have prevented this political force from acting as a “controlled and inclusive right-wing party” in the Ziblattian sense. The study seeks to bring a critical perspective to the debates on the transplantation of theoretical models in post-communist contexts with weak institutional traditions.

Keywords:

Conservative parties; democratic consolidation; Daniel Ziblatt; post-communist Albania; Democratic Party; party institutionalization; political transition; opposition; fragile democracy; political elites.

LISTA E TABELAVE

Nr.	Titulli i Tabelës
1	Vlerësimi i Performancës së PD-së sipas Modelit të Ziblatt (1992–1997)
2	Vlerësimi i Performancës së PD-së sipas Modelit të Ziblatt (1997–2005)
3	Vlerësimi i Performancës së PD-së sipas Modelit të Ziblatt (2005–2013)
4	Vlerësimi i Performancës së PD-së sipas Modelit të Ziblatt (2013–2025)
5	Krahasimi i Performancës së PD-së në periudha të ndryshme (1992–2025) sipas variablit të varur ziblattian
6	Tabela e indikatorëve institucionalë të Shqipërisë: Freedom House, V-Dem Parti, V-Dem Opozitë (1992–1997)
7	Tabela e indikatorëve institucionalë të Shqipërisë: Freedom House, V-Dem Parti, V-Dem Opozitë (1997–2005)
8	Roli i opozitës në Shqipëri (1992–2005) sipas kodimit ordinal (rendor) (0–2)
9	Vlerësimi krahasues i kapaciteteve organizative të PD-së (Intervistat me funksionarë)
10	Krahasimi i sjelljes në krizë, qëndrimi, diskursi, pjesëmarrja në marrëveshje (1997, 2017, 2019)

LISTA E SHKURTIMEVE

PD – Partia Demokratike

PS – Partia Socialiste

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

KE – Këshilli i Europës

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

BE – Bashkimi European

NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

ODIHR – Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE)

TPE – Tregu i Përbashkët European

PE – Parlamenti European

PPSh – Partia e Punës së Shqipërisë

PKSh – Partia Komuniste e Shqipërisë

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË
ABSTRAKT
ABSTRACT
DEDIKIM
LISTA E SHKURTIMEVE
LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

KAPITULLI I: HYRJJE

1.1 Dobësitë Strukturore të Demokracisë Shqiptare. Mungesa e institucioneve të forta dhe të pavarura
1.2 Partitë politike si struktura të mbyllura dhe jo-demokratike dhe dështimi i sundimit të ligjit
1.3 Llogaridhënia politike formale, por jo efektive
1.4 Efikasiteti i administratës publike me dobësi të qëndrueshme dhe të thella
1.5 Shteti i së drejtës i paqenë, drejtësia e politizuar dhe e vonuar
1.6 Probleme strukturore të dështimit të demokracisë në Shqipëri
1.7 Llogaridhënia politike: formale, por jo efektive
1.8 Efikasiteti i administratës publike: një zhgënjim kohëgjatë
1.9 Sundimi i ligjit: thuajse i paqenë
1.10 Një demokraci që “ka ecuar” për tre dekada në vend ose është bërë më keq

KAPITULLI II – METODOLOGJIA E STUDIMIT

2.1 Objektivi i studimit
2.2 Pyetjet kërkimore
2.3 Analizë (e gjuhës) diskursive
2.4 Studim rasti historik: Shqipëria 1990–2025
2.5 Intervista me funksionarë dhe analizë e tyre
2.6 Analizë e tipareve bazë të PD-së nëpërmjet analizës së intervistave me protagonistë, drejtues dhe themelues të PD-së
2.7 Burimet dhe të dhënat
2.8 Kufizimet metodologjike
2.9 Hipoteza kërkimore
2.10 Variablat e pavarura dhe operacionalizimi i tyre
2.11 Variablat e varura dhe operacionalizimi i tyre
2.12 Burimet empirike të të dhënave për studimin

KAPITULLI III – KUADRI TEORIK DHE RISHIKIMI I LITERATURËS

- 3.1 Lindja e demokracisë në Europë: Vala e parë e demokratizimit (1828–1926)
- 3.2 Vala e dytë e demokratizimit (1945–1962)
- 3.3 Vala e tretë e demokratizimit (1974–deri sot)
- 3.4 Këndvështrimi teorik i Daniel Ziblatt
- 3.5 Dy kornizat e demokratizimit sipas Daniel Ziblatt
- 3.6 Dilema e konservatorëve: bashkëjetesë me masat apo përjashtim autoritar
- 3.7 Partitë konservatore si kanale institucionale të interesave të elitës ose parisë – një këndvështrim teorik mbi Ziblatt dhe zbatueshmërinë në rastin shqiptar
- 3.8 Rastet ziblatiane kur partitë konservatore patën sukses: Britania e Madhe, Gjermania, Suedia
- 3.9 Rastet ziblatiane kur partitë konservatore dështuan: Spanja, Austria, Italia

KAPITULLI IV – KONTEKSTI HISTORIK, SHQIPËRIA DHE E DJATHTA NË PERIUdhËN POSTKOMUNISTE

- 4.1 Shkatërrimi i strukturës së mëparshme shoqërore dhe politike gjatë komunizmit
- 4.2 Formimi i Partisë Demokratike: një lëvizje popullore, jo një parti e djathtë klasike
- 4.3 Antikomunizmi si zëvendësues i konservatorizmit: e djathta shqiptare pa traditë ideologjike
- 4.4 Mungesa e traditës së shtresës së mesme, aristokracisë apo pronarëve të mëdhenj ...

KAPITULLI V – STRUKTURA SOCIALE DHE POLITIKE E SHQIPËRISË NË VITET 1945–1990: ANALIZË TEORIKE DHE KRAHASIME NGA KËNDVËSHTRIMI I ZIBLATT

- 5.1 Shqipëria nën këndvështrimin e modelit të Daniel Ziblatt
- 5.2 Shqipëria para Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj
- 5.3 Shqipëria në momentin e rënies së komunizmit
- 5.4 Kompromisi i munguar konservator në Shqipëri
- 5.5 Raste krahasimore me Shqipërinë: Rumania
- 5.6 Rast krahasimor me Shqipërinë: Bullgaria
- 5.7 Rast krahasimor me Shqipërinë: Vendet Baltike

KAPITULLI VI – SJELLJA POLITIKE E TË DJATHTËS NË SHQIPËRI: ANALIZË E PERIUdhAVE KRYESORE

- 6.1 Vitet 1992–1997: shenja të ndërtimit të një pushteti autoritar nga e djathta dhe largim nga parimet e së djathtës

6.2 Sjellja e PD-së në vitet 1997–2005: opozitë e vështirë dhe me dy pamje	
6.3 Qeverisja 2005–2013: konsolidimi institucional shoqëruar me tensione të brendshme	
6.4 Gjendja dhe sjellja e PD-së pas vitit 2013: dobësim, bojkot dhe delegjitimim i proceseve	
6.5 Rastet e sabotimit institucional: bojkoti i parlamentit, djegia e mandateve dhe mospranimi i zgjedhjeve	

KAPITULLI VII – ANALIZË DISKURSIVE E GJUHËS SË BERISHËS DHE E PROGRAMEVE TË PD-SË

7.1 Analizë diskursive e gjuhës së Berishës në vitet 1990–1991	
7.2 Analizë diskursive e gjuhës së Berishës në vitet 1992–1997	
7.3 Analizë diskursive e gjuhës së Berishës dhe e ligjërimit të PD-së në vitet 1997–2005 ..	
7.4 Analizë diskursive e ligjërimit të PD-së në vitet 2005–2013	
7.5 Analizë diskursive e gjuhës dhe ligjërimit të PD-së, kryetarit të saj Lulzim Basha dhe ish-kryetarit Berisha për periudhën 2013–2015	
7.6 Analizë e Intervistave të diuara funksionarëve dhe ish funksionarëve të PD-së	

KAPITULLI VIII – GJETJET KRYESORE DHE DISKUTIM

8.1 Gjetjet, Ndërlidhje e të dhënave empirike me modelin teorik	
8.2 Diskutim, Roli i së djathtës në konsolidimin (apo jo) të demokracisë në Shqipëri	
Ndikimi i diskursit, strukturës dhe veprimeve institucionale	

KAPITULLI IX – KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

SHTOJCA	
----------------------	--

Kapitulli I : Hyrje

1.1 Dobësitë strukturore të demokracisë shqiptare. Mungesa e institucioneve të forta dhe të pavarura

Pas 45 vitesh diktaturë të ashpër komuniste, shoqëria shqiptare nisi të përjetojë përmbysjen më të madhe politike, shoqërore dhe institucionale të historisë së saj moderne. Deri në fundin e viteve '80, Shqipëria njihej si një nga regjimet më të izoluar dhe represive të Evropës, ku shteti kishte ushtruar kontroll pothuaj total mbi jetën publike dhe private të qytetarëve (Dani, 2024). Çdo formë opozite ideologjike, politike apo kulturore ishte shtypur sistematikisht, dhe Partia e Punës e Shqipërisë kishte instaluar një regjim njëpartiak të bazuar mbi kultin e individit dhe dhunën strukturore. Megjithatë, gjatë viteve 1989–1990, nën ndikimin e ngjarjeve në Evropën Lindore dhe presionit të brendshëm ekonomik e shoqëror, filloi të përvijohet një pakënaqësi në rritje ndaj regjimit. Kjo pakënaqësi, fillimisht e përhapur në formë bisedash të kujdesshme dhe mosbindjeje pasive, u shndërrua në veprim të drejtpërdrejtë në dhjetor të vitit 1990, madje që në tetor, kur protestat e studentëve në Tiranë u bënë katalizator i kërkesave për pluralizëm dhe ndryshim politik (Zogaj, 2014).

Në këtë kontekst, më 11 dhjetor 1990, u themelua Partia Demokratike e Shqipërisë – forca e parë opozitare që sfidonte hapur monopolin e Partisë së Punës. Ky ishte një moment historik, pasi për herë të parë pas vitit 1944, në Shqipëri po artikulohej publikisht një alternativë politike. Reagimi i regjimit komunist ishte fillimisht i kontrolluar. Sekretari i parë i PPSH-së, Ramiz Alia, u përpoq të ruante qetësinë politike përmes një diskursi më fleksibël, duke u përpjekur të orientohej drejt një tranzicioni të kontrolluar. Megjithatë, brenda vetë strukturës së Partisë së Punës kishte tensione të mëdha, sidomos në nivelet e dyta drejtuese, të cilat u treguan armiqësore ndaj çdo forme pluralizmi.

Ngjarja që tronditi rëndë strukturën e regjimit ndodhi në verën e vitit 1990, kur qindra qytetarë shqiptarë u futën në ambasadat e huaja në Tiranë për të kërkuar azil politik. Ky ishte një akt simbolik dhe praktik i mohimit të legjitimitetit të shtetit totalitar dhe dëshmoi publikisht se frika ndaj sistemit kishte nisur të thyhej. Ngjarja u interpretua si një pikë pa kthim për rendin politik ekzistues.

Zhvillimet politike kulmuan me mbajtjen e zgjedhjeve të para pluraliste në mars të vitit 1991. Megjithatë Partia Demokratike kishte fituar një mbështetje të gjerë në zonat urbane dhe në shtresat e arsimuara, ajo nuk arriti të fitojë zgjedhjet. Partia e Punës doli forcë shumicë dhe formoi qeverinë, por qeverisja e saj u përball me krizë të menjëhershme legjitimiteti. Kryeministri Fatos Nano u detyrua të japë dorëheqjen pas vetëm pak muajsh, ndërsa qeveritë pasuese nuk arritën të stabilizonin situatën. Në mars të vitit 1992, Shqipëria shkoi në zgjedhje të parakoshhme, të cilat u fituan në mënyrë plebishitare nga Partia Demokratike.

Fitorja e opozitës shënoi fillimin e një tranzicioni të gjatë dhe kompleks drejt ndërtimit të një sistemi demokratik. Megjithatë, mbi tre dekada më pas, është e qartë se ky rrugëtim ka qenë i mbushur me pengesa strukturore, tensione politike dhe dështime serioze në konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve demokratike funksionale.

Parimisht demokracia përfaqësuese funksionon përmes disa mekanizmave thelbësorë: zgjedhje të lira dhe të ndershme, institucione të pavarura, sundim të ligjit, llogaridhënie publike dhe ndarje të pushteteve. Këto janë jo vetëm standarde normative, por edhe kritere funksionale për të matur konsolidimin demokratik. Në rastin e Shqipërisë, analiza e këtyre elementeve tregon një dështim të thellë dhe të përsëritur në të gjitha dimensionet kryesore të funksionimit të një regjimi demokratik. Pas fitores plebishitare të Partisë Demokratike në mars të vitit 1992 dhe kalimit paqësor të pushtetit nga Partia e Punës, Shqipëria dukej se kishte hyrë në një fazë të re të historisë së saj politike: ndërtimin e një shteti demokratik funksional. Megjithatë, përkundër ndërrimeve formale të regjimit dhe përpjekjeve fillestare për reformë, procesi i konsolidimit demokratik në Shqipëri është karakterizuar nga një vazdhimësi krizash, tensionesh dhe dështimesh në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe funksionale. Në kete punim ne perpiqemi te analizojme faktorët kryesorë që kanë penguar këtë proces në më shumë se tri dekadat e fundit dhe rolin e partive te djatha, veccanërisht të PD-së ne gjithë keto vite.

Në çdo rend demokratik të mirëfilltë, institucionet nuk janë thjesht mekanizma formalë; ato janë trupëzime konkrete të vlerave politike dhe morale të një shoqërie që i ka braktisur format e sundimit arbitrar dhe ka zgjedhur, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, qeverisjen përmes ligjit, ndarjes së pushteteve dhe llogaridhënies. Por në Shqipëri, ajo që u ndërtua pas vitit 1990 nuk ishte një rend i tillë. U ngrit një shtet pa themele te forta, pa frymë dhe pa nerv demokratik, një skelet institucional që u mbush me klientelizëm, oportunizëm dhe moral provincial.

Në vend që të kishte një revolucion institucional, u bë një transplantim pa ndërgjegje. Strukturat e vjetra të regjimit komunist në të cilat bindja politike ishte normë, ndërsa liria përjashtim u lyen me një bojë të zbehtë pluralizmi. Shteti nuk u ringrit si një trupë neutrale mes shoqërisë dhe partisë, por mbeti një instrument pushteti për partinë që e kap atë. E majta dhe e djathta, sa herë kanë ardhur në pushtet, nuk kanë ndryshuar strukturën, por kanë ndërruar klientët.

Kjo është arsyeja pse Parlamenti nuk është vend përfaqësimi, por skenë aktrimi politik dhe marrëveshesh të mbyllura. Kjo është arsyeja pse drejtësia nuk është entitet i të drejtës, por aparat ekzekutiv i vullnetit të partisë. Kjo është arsyeja pse administrata publike nuk është shërbim, por zgjatim i partisë në çdo zyrë. Kjo është arsyeja pse media, në shumicën dërrmuese, nuk është degë ose kolone e katërt e pushtetit, por një zë i zbutur ose një kor i korruptuar.

Në një situatë të tillë, nuk është e tepruar të thuhet se Shqipëria ndodhet në një regjim që më shumë i ngjan asaj që Guillermo O'Donnell e quan “demokraci deleguese” (O'Donnell, 2010), pra një rend ku qytetarët votojnë, por nuk qeverisin, ku ka institucione, por ato nuk kontrollojnë, ku ka Kushtetutë, por ajo lexohet si një tekst i tejkaluar në logjikën e interesit politik. Demokracia, në vend që të forcohej si një rend i kufizimit të pushtetit, është deformuar në një mjet për ta betonuar pushtetin dhe jo për ta kufizuar atë.

Dhe kur një shoqëri e pranon këtë pa rezistencë, pa zë, pa ndëshkim moral, ajo nuk është thjesht viktimë. Ajo bëhet bashkëfajtores. E kjo është drama e vërtetë. Pra jo thjesht dështimi i institucioneve, por dështimi i vetëdijes për ta ndërtuar lirinë si rend e jo si ankth.

1.2. Partitë Politike si struktura të mbyllura dhe jo demokratike dhe dështimi i sundimit të ligjit

Në vend që të funksionojnë si ndërmjetës mes shoqërisë dhe shtetit, partitë politike në Shqipëri janë kthyer në mjete të personalizuar të pushtetit. Demokracia e brendshme në parti pothuajse mungon, dhe vendimmarrja është e përqendruar në duart e pak individëve. Kjo ka prodhuar modele partish autoritare dhe të përqendruara te lideri, duke bllokuar rinovimin e brendshëm dhe pluralizmin politik.

Sistemi partiak shqiptar gjithnjë e më shumë i ngjan asaj që Katz dhe Mair (Katz and Mair, 1995) e përkufizojnë si një sistem partish kartel ku partitë janë të shkëputura nga elektorati dhe nuk konkurrojnë për alternativa politike, por për qasje te burimet shtetërore. Kjo dinamikë ka prodhuar një sistem formal shumëpartiak pa konkurrencë reale politike, duke e shtyrë Shqipërinë drejt një modeli me pluralizëm të kufizuar.

Një nga dështimet më të thella të tranzicionit demokratik në Shqipëri është paaftësia për të ndërtuar një shtet të së drejtës. Pavarësisht disa përpjekjeve për reforma, përfshirë reformën e madhe në drejtësi të nisur në vitin 2016 me mbështetje ndërkombëtare, sistemi i drejtësisë vazhdon të perceptohet si i korruptuar, i politizuar dhe joefektiv (BTI, 2024).

Mungesa e pavarësisë së gjyqësorit ka dëmtuar trajtimin e barabartë përpara ligjit dhe ka minuar vetë themelet e legjitimitetit demokratik. Edhe pse reforma ka sjellë disa suksese, sidomos me krijimin e institucioneve kundër korrupsionit si SPAK, ajo është përdorur gjithashtu për qëllime politike, duke riprodhuar dhe jo shkatërruar kapjen institucionale.

Demokracia nuk mbahet vetëm me ligje dhe institucione, por edhe me një kulturë politike që promovon pjesëmarrje, tolerancë dhe respekt për rregullat e lojës. Tranzicioni shqiptar është zhvilluar mbi trashëgiminë e një kulture të thellë autoritare dhe mbi mungesën e një tradite demokratike.

Qytetaria karakterizohet nga apatia politike, mungesa e besimit te institucionet dhe një pranueshmëri fatale ndaj korrupsionit. Këto tipare kanë penguar zhvillimin e një shoqërie civile të fortë dhe i kanë lejuar elitat politike të veprojnë në një ambient me llogaridhënie të ulët dhe me mbikëqyrje minimale nga shoqëria (Howard, 2003).

Aktorët ndërkombëtarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e reformave në Shqipëri, sidomos në fushën e reformës në drejtësi dhe integritetit në BE. Megjithatë, kjo përfshirje ka sjellë edhe pasoja të paqëllimshme.

Përgjegjësia politike është deleguar pjesërisht tek institucionet ndërkombëtare, duke dobësuar lidhjen mes votuesve dhe elitave vendase. Siç argumenton Bickerton (2012), ndërkombëtarizimi i politikës shpesh çon në një hapësirë të depolitizuar vendore, ku qytetarët shndërrohen në spektatorë dhe jo pjesëmarrës në procesin demokratik.

Demokracia shqiptare pas komunizmit nuk ka vuajtur nga mungesa e institucioneve formale, por nga mungesa e substancës së vërtetë kushtetuese. Pavarësisht më shumë se tri dekadave tranzicion, dështimi për të ndërtuar institucione të pavarura, një sistem drejtësie funksional, parti demokratike dhe një kulturë politike pjesëmarrëse tregon se problemi kryesor nuk është mungesa e pluralizmit, por mungesa e llogaridhënies efektive politike, e kapacitetit shtetëror dhe sundimit të ligjit që janë në fakt vetë shtyllat e rendit modern politik (Fukuyama, 2014).

Në pjesën më poshtë do të shqyrtojmë se si këto dobësi përkeqësohen më tej nga një sistem elektoral dhe partiak që, në vend që të mundësojë llogaridhënie dhe rotacion pushteti, i ka shndërruar zgjedhjet në rituale legjitimimi pa konkurrencë reale demokratike. Pra tërë pema institucionale e vendit tonë, tërë sistemi ynë politik, tërë mënyra e funksionimit të demokracisë është në një masë dërmuese jo substanciale, është në një masë dërmuese thjesht formë.

1.3 Llogaridhënia politike formale, por jo efektive

Llogaridhënia politike nënkupton përgjegjësinë që një qeveri ka ndaj qytetarëve, institucioneve kontrolluese dhe shoqërisë civile. Në Shqipëri, kjo llogaridhënie ka qenë shpesh e fragmentuar, e instrumentalizuar ose thjesht formale.

Së pari, liria e medias, një komponent thelbësor për ndërtimin e një mjedisi kritik dhe transparent, ka qenë në rënie të vazdheshme. Sipas “World Press Freedom Index” (2025), Shqipëria renditet në vendin e 96-të, me një indeks 58.18 nga 100, duke e vendosur atë mes vendeve me liri të kufizuar të shtypit. Mediat janë shpesh të kapura nga interesat e grupeve të pushtetit, dhe shumë gazetarë përballen me presion, vetëcensurë apo kërcënime të drejtpërdrejta.

Së dyti, kontrolli parlamentar ndaj qeverisë ka qenë i dobët dhe në raste të caktuara i sabotuar apo shkatërruar. Qeveritë shqiptare, pavarësisht ngjyrës politike, kanë përdorur shumicën në Kuvend jo për të garantuar llogaridhënie, por për të mbyllur hetimet, bllokuar interpelancat dhe shmangur transparencën. Komisionet hetimore parlamentare janë shpesh penguar ose janë bërë vegla politike të mazhorancës, ndërsa opozitat, në disa raste, kanë bojkotuar Kuvendin, duke dëmtuar më tej procesin demokratik.

Së treti, llogaridhënia përpara gjyqësorit ka qenë e kufizuar për shkak të korrupsionit dhe varësisë politike të sistemit gjyqësor. Ndërhyrja në drejtësi ka qenë një ndër kritikën më të përsëritura në raportet ndërkombëtare, përfshirë ato të Komisionit Evropian dhe Departamentit Amerikan të Shtetit. Vetëm pas nisjes së reformës në drejtësi në vitin 2016, u ndërmorën hapa për pastrimin e sistemit përmes vettingut, i cili largoi qindra gjyqtarë dhe prokurorë për shkak të korrupsionit dhe paaftësisë profesionale.

1.4 Efikasiteti i administratës publike me dobësi të qëndrueshme dhe të thella

Një administratë publike funksionale është thelbësore për zbatimin e ligjit, për ofrimin e shërbimeve dhe për stabilitetin politik. Në Shqipëri, administrata publike është karakterizuar nga politizimi ekstrem i emërimeve, ku vendet kyçe në administratë i janë dhënë militantëve dhe klientëve politikë, shpesh jashtë kriterëve profesionale. Ajo është karakterizuar nga korrupsioni i përhapur, veçanërisht në sektorët si tatimet, doganat, hipoteka, arsimi, shëndetësia dhe drejtësia. Është karakterizuar gjithashtu edhe nga mungesa e kapaciteteve menaxheriale, që ndikon negativisht në formulimin dhe zbatimin e politikave publike.

Të gjitha këto janë dokumentuar në mënyrë të përsëritur në raportet e Bankës Botërore, OECD dhe institucionet evropiane. Kjo mungesë e kapacitetit dhe integritetit të administratës ka

kontribuar drejtpërdrejt në dështimin e shtetit për të përmbushur pritshmëritë bazë të qytetarëve, duke ulur besimin publik dhe duke rritur tendencën për emigrim masiv.

1.5 Shteti i së drejtës i paqenë, drejtësia e politizuar dhe e vonuar

Sundimi i ligjit ka qenë segmenti më problematik i zhvillimit demokratik shqiptar. Për dekada me radhë, drejtësia nuk ka funksionuar si një pushtet i pavarur, por si instrument në duart e grupeve politike dhe interesave të veçanta. Kjo ka ndikuar në disa drejtime. Së pari kemi patur të bëjmë me mungesë e hetimeve të paanshme ndaj zyrtarëve të lartë. Së dyti kemi patur të bëjmë me vendime gjyqësore të motivuara politikisht dhe së treti kemi patur amnisti të heshtura ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Reforma në drejtësi e nisur në vitin 2016 synoi të ndryshonte këtë realitet, por procesi ka qenë i ngadaltë dhe i vështirë. Edhe pse janë krijuar institucione të reja si KLP, KLGJ, SPAK dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, niveli i besimit publik ndaj sistemit mbetet i ulët.

Dështimi i demokracisë në Shqipëri nuk ka ardhur thjesht si pasojë e kushteve objektive, por është produkte i sjelljes dhe qëllimeve të elitave politike. Në mungesë të një klase politike me vizion institucional, partitë kanë funksionuar si struktura klienteliste dhe autoritare. Ato kanë ndërtuar lidhje të forta me interesa kriminale dhe ekonomike, duke e kthyer shtetin në një mjet për përfitim personal dhe kontroll politik. Në këtë kuptim, Shqipëria përkon me diagnozën e Colin Crouch mbi “post-demokracinë”, ku zgjedhjet zhvillohen rregullisht, por vendimmarrja reale ndodh në rrathë të mbyllur dhe jo-transparentë (Crouch, 2004). Siç do të diskutohet në kapitullin vijues, në këtë dështim të demokracisë shqiptare mungon pikërisht ajo që Daniel Ziblatt e konsideron si faktor kyç për suksesin demokratik: një klasë politike konservatore e gatshme të pranojë rregullat e lojës dhe të mbrojë institucionet. Në vend të kësaj, Shqipëria ka prodhuar elita politike që kanë vepruar jashtë logjikës së përfaqësimit demokratik dhe kanë trajtuar shtetin si pronë partiake.

1.6. Probleme strukturore të dështimit të demokracisë në Shqipëri

Në teori, demokracia funksionale mbështetet mbi disa shtylla thelbësore si zgjedhje të lira dhe të ndershme, institucione të pavarura, sundim të ligjit, ndarje të pushteteve dhe llogaridhënie efektive. Në rastin e Shqipërisë, e cila që prej vitit 1991 ka zhvilluar rregullisht zgjedhje dhe ka miratuar një sërë reformash institucionale, këto komponentë kanë mbetur në mënyrë të vazhdueshme të dobëta ose të shkatërruara.

Dështimi për të konsoliduar një rend demokratik funksional është analizuar në mënyrë të mrekullueshme nga Francis Fukuyama, i cili identifikon tre tregues kryesorë të cilësisë së qeverisjes që janë llogaridhënia (accountability), kapaciteti i administratës (state capacity) dhe sundimi i ligjit (rule of law) (Fukuyama, 2014). Shqipëria, pas më shumë se tre dekadash tranzicion, vazhdon të shfaqë probleme serioze në të tre këta tregues.

1.7 Llogaridhënia politike formale, por jo efektive

Llogaridhënia, pra, përbën një element themelor për funksionimin e demokracisë. Ajo nënkupton që qeveria dhe pushteti publik duhet t'u përgjigjen qytetarëve përmes një sistemi të ndërlidhur institucionesh mbikëqyrëse dhe mekanizmesh demokratikë si media e lirë, parlamenti funksional, gjykatat e pavarura dhe zgjedhjet konkurruese. Në Shqipëri, ky mekanizëm është në mënyrë kronike i dobët dhe i cenuar, duke prodhuar një model qeverisjeje me përgjegjshmëri të ulët dhe transparencë të kufizuar.

Sipas raportit të fundit të *World Press Freedom Index* (2025), Shqipëria renditet në vendin e 96-të nga 180 vende, me një indeks prej 58.18, duke u klasifikuar si vend me liri të kufizuar të shtypit (Reporters Without Borders [RSF], 2025). Kjo renditje reflekton një klimë jo të favorshme për median e lirë, e cila shpesh varet nga interesat ekonomike dhe politike të grupeve në pushtet. Si pasojë, vetëdijesimi publik dhe transparencia institucionale dëmtohen që në rrënjë. Gjatë qeverisjes së tij nga viti 2013 deri më 2025, kryeministri Edi Rama ka pasur një qëndrim shpeshherë konfrontues ndaj medias, duke përdorur gjuhë denigruese ndaj gazetarëve, të cilët i ka quajtur publikisht sherbertore, injorantë dhe madje “kadrinj” (Balla, 2023). Ai është përpjekur të ushtrojë kontroll institucional mbi median përmes strukturave të varura nga ekzekutivi dhe ka mbështetur krijimin e mediave proqeveritare.

Kjo sjellje nuk është e re. Gjatë mandatit të tij (2005–2013), edhe ish-kryeministri Sali Berisha synoi të ndikonte narrativën mediatike përmes shpërndarjes selektive të reklamave shtetërore, veçanërisht në favor të televizioneve të mëdha. Një raport i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë në vitin 2008 e cilësonte këtë praktikë si një përpjekje për “blerje të medias” (Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, 2008). Në periudhën 1992–1997, liria e shtypit ishte edhe më e kufizuar, shpesh e rrezikuar nga dhuna. Rasti më ekstrem ishte djegia e redaksisë së gazetës *Koha Jonë*, një akt simbolik jo thjesht i intimidimit politik ndaj medias së pavarur por i dhunës së drejtpërdrejtë ndaj saj (Shkullaku, 2012).

Një tjetër hallkë e dëmtuar e zinxhirit të llogaridhënies është Kuvendi i Shqipërisë. Në vend që të funksionojë si një organ efektiv kontrolli ndaj ekzekutivit, ai është shndërruar në një institucion formal, shpesh nën dominimin total të shumicës parlamentare. Komisionet hetimore parlamentare janë bllokuar rregullisht nga mazhoranca, ndërsa interpelancat janë përdorur më shumë si mjete propagandistike sesa si instrumente reale përgjegjshmërie. Në anën tjetër, opozitat kanë përdorur shpesh bojkotin si strategji politike, duke dëmtuar më tej ekuilibrin institucional dhe rolin përfaqësues të parlamentit (Krasniqi, 2021). Parlamentiu në thelb ka qenë krejtësisht i nxjerre nga funksionet kontrolluese.

Sistemi gjyqësor, i cili në një demokraci duhet të veprojë si garant i llogaridhënies ligjore, është përballur me probleme të thella politizimi dhe korrupsioni. Sipas raporteve të Komisionit Evropian (2023) dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit (2023), pavarësia e gjyqësorit në Shqipëri mbetet e brishtë dhe e ekspozuar ndaj ndërhyrjeve të pushtetit politik. Megjithatë reforma në drejtësi, e nisur në vitin 2016 me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, solli një spastrim të sistemit përmes procesit të vetting-ut, duke larguar rreth gjysmën e gjyqtarëve dhe prokurorëve ekzistues, ajo ende nuk ka prodhuar një sistem gjyqësor tërësisht të pavarur dhe funksional (European Commission, 2023).

Në tërësi, përbërësit kyç të llogaridhënies demokratike – media, parlamenti dhe gjyqësori – janë në krizë në Shqipëri, duke përforcuar një model qeverisjeje ku fuqia politike është e pakontrolluar dhe llogaridhënia bëhet më tepër përmes presionit ndërkombëtar sesa përmes mekanizmave të brendshëm demokratikë.

1.8 Efikasiteti i administratës publike një zhgënjim kohëgjatë

Një nga parakushtet themelore për zbatimin efektiv të politikave publike dhe për realizimin e mirëqeverisjes është ekzistenca e një administrate publike profesionale, meritokratike dhe të depolitizuar. Në vendet me demokraci të konsoliduar, shërbimi civil përfaqëson një trupë teknike të qëndrueshme, që funksionon në mënyrë autonome ndaj cikleve politike, duke siguruar vazhdimësi dhe cilësi në ofrimin e shërbimeve publike. Në Shqipëri, megjithatë, ky standard është larg realitetit. Politizimi i thellë i administratës publike mbetet një nga problemet më kronike dhe destabilizuese të sistemit shtetëror.

Raportet e Bankës Botërore (2022) dhe të OECD (2023) theksojnë se proceset e rekrutimit dhe ngritjes në detyrë në sektorin publik shpesh nuk bazohen në meritë apo në kritere profesionale, por në lidhje politike dhe patronazh. Kjo ka çuar në një administratë të kapur nga pushteti ekzekutiv dhe partiak, ku besnikëria politike zëvendëson kompetencën dhe integritetin profesional. Si rrjedhojë, çdo ndryshim politik në nivel qendror shoqërohet me rotacione të gjera në administratë, duke e dëmtuar qëndrueshmërinë institucionale dhe kapacitetin për të ndërtuar një administratë funksionale dhe të qëndrueshme.

Sektorë kyç të shtetit si administrata tatimore, doganore, sistemi shëndetësor, arsimi dhe administrimi i pronës karakterizohen nga mungesa e kapaciteteve, efikasiteti i ulët, dhe prani e konsiderueshme e korrupsionit në nivele të larta. Këto mangësi nuk janë vetëm teknike, por përfaqësojnë dështime sistematike të qeverisjes publike. Shkurt sic thuhet rëndom “nuk mbaron dot punë”. Siç e tregon sondazhi i IDRA Research (2024), niveli i besimit të qytetarëve ndaj administratës publike është në rënie, duke reflektuar perceptimin e përhapur se administrata nuk i shërben interesit të përgjithshëm, por interesave politike dhe klienteliste.

Ndërtimi i një administrate publike të pavarur, të mbrojtur nga ndërhyrjet politike dhe të udhëhequr nga parimet e meritokracisë dhe transparencës, është një domosdoshmëri për funksionimin demokratik të shtetit dhe për rivendosjen e besimit qytetar në institucionet publike (OECD, 2023; World Bank, 2022; IDRA, 2024). Pra edhe komponentja që përmend Fukuyama, ajo e efikasitetit të administratës është thuajse e shkatërruar.

1.9 Sundimi i ligjit thuajse i paqenë

Për dekada me radhë, sistemi gjyqësor shqiptar ka vuajtur nga ndërhyrjet politike, mungesa e pavarësisë dhe një nivel i lartë korrupsioni të brendshëm. Gjykatës dhe prokurorë shpesh kanë vepruar jo mbi bazën e ligjit, por në funksion të interesave politike apo personale, duke shitur

drejtësinë për përfitime materiale ose mbrojtje politike (Transparency International, 2023). Një pjesë e konsiderueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë akuzuar për pasuri të pajustificuara, lidhje me grupe kriminale apo për vendimmarrje të manipuluar përmes mitmarrjes (BIRN, 2022). Ky fenomen ka prodhuar një kulturë pandëshkueshmërie të thellë, ku qytetarët ndihen të pambrojtur përballë sistemit dhe ku drejtësia perceptohet si një mall që blihet dhe shitet.

Kjo situatë alarmante ishte një ndër shtysat kryesore për nisjen e reformës në drejtësi në vitin 2016. Reforma u mbështet fuqishëm nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, dhe synonte pastrimin e sistemit përmes vetting-ut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ngritjen e strukturave të reja, si SPAK dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH). Deri më sot, me qindra gjyqtarë dhe prokurorë janë larguar nga sistemi për shkak të pasurisë së pajustificuar apo lidhjeve me palë të treta (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 2023).

Përkundër këtyre arritjeve, sfidat mbeten serioze. SPAK ka ndërmarrë hetime ndaj disa figurave të larta, por kritikën për selektivitet dhe për fokusim të tepërt në figura të opozitës janë të pranishme. Po ashtu, ritmi i hetimeve është i ngadaltë, dhe pak raste përfundojnë me vendime përfundimtare në gjykatë (European Commission, 2024). Ndërkohë, pavarësia reale e institucioneve të reja është ende në pikëpyetje, për shkak të varësisë së tyre nga mbështetja teknike dhe politike e aktorëve ndërkombëtarë. Në mungesë të një kulture të brendshme ligjore të konsoliduar, ekziston rreziku që këto struktura të mos jenë të qëndrueshme në planin afatgjatë.

Në këtë kontekst, sfida kryesore nuk është më vetëm ndarja formale e pushteteve, por ndërtimi i një drejtësie funksionale që gëzon integritet, besueshmëri dhe kapacitet për të ndëshkuar korrupsionin në të gjitha nivelet përfshirë vetë brendësinë e sistemit gjyqësor. Pra Shqipëria në mbi tre dekada nuk mundi të kete sundim të ligjit dhe drejtësi të pavarur.

2.0 Një demokraci që “ka ecur” për tre dekada në vend ose është bërë më keq

Në përfundim të kësaj analize del qartë se dështimi i demokracisë shqiptare nuk është vetëm institucional, por gjithashtu strukturor, kulturor dhe elitist. Pas më shumë se tri dekadash pluralizëm formal, Shqipëria nuk ka arritur të konsolidojë një sistem funksional të ndarjes së pushteteve, të përfaqësimit politik të vërtetë dhe të një shoqërie civile të fuqizuar. Demokracia shqiptare ka mbetur kryesisht elektorale dhe procedurale, pa u kthyer, sic thote Wolfgang Merkel për vende të tilla, në një regjim ku qytetarët kanë ndikim real mbi politikën publike (Merkel, 2004).

Një nga arsyet themelore për këtë gjendje është dështimi i klasës politike për të funksionuar si një elitë përgjegjëse demokratike. Siç thekson Daniel Ziblatt (Ziblat, 2017), në vendet ku demokracia ka funksionuar dhe është institucionalizuar, veçanërisht në Evropën Perëndimore, partitë konservatore dhe elitat tradicionale kanë luajtur një rol kritik në ruajtjen e rendit kushtetues dhe në legjitimimin e procesit demokratik, shpesh për të shmangur destabilitetin dhe për të mbrojtur interesat e tyre afatgjata përmes rregullave të përbashkëta. Në Shqipëri, përkundrazi, elitat politike pavarësisht kahjes ideologjike të pretenduar kanë ndjekur një logjikë të dominimit personalist dhe klientelist. Demokracia është shndërruar në një instrument për

kapjen e shtetit dhe përjashtimin e kundërshtarëve, ku rotacioni politik nuk sjell ndryshim substancial, por vetëm zhvendosje të grupeve përfituese.

Ky model e afron Shqipërinë me atë që Colin Crouch (Crouch, 2004) përshkruan si *post-demokraci*, një gjendje ku institucionet demokratike ekzistojnë nominalisht (zgjedhje, parlament, media), por përmbajtja e tyre është zbrazur. Vendimmarrja reale ndodh përmes kanalesh informale, në duar të një elite të vogël që kontrollon burimet ekonomike dhe institucionale, ndërsa pjesëmarrja qytetare kufizohet në ritualin e votimit pa alternativë të besueshme. Diskursi publik, në vend që të jetë një arenë për debat dhe ndërtim konsensusi, është reduktuar në propagandë partizane dhe polarizim.

Kjo krizë e thellë e përfaqësimit dhe e përgjegjshmërisë e çon demokracinë shqiptare drejt një modeli hibrid: formalisht pluralist, por thellësisht i kapur dhe i mbyllur. Në mungesë të reformës reale të partive politike, të rritjes së transparencës dhe të rivendosjes së llogaridhënies publike, demokracia shqiptare rrezikon të mbetet e ngecur në një gjendje *interregnum*-i të përhershëm midis tranzicionit të papërfunduar dhe autokracisë elektorale (Levitsky & Way, 2010). Kësisoj ne do të perpiqemi të shohim ose të gjejmë pse është kjo gjendje dhe cili është roli i të dhatës në këtë dështim.

Kapitulli II: Metodologjia e studimit

2.1 Objektivi i studimit

Ky studim ndërton një qasje metodologjike të shumëfishtë me qëllim testimin e teorisë së Daniel Ziblatt mbi rolin themelor të partive konservatore në lindjen dhe konsolidimin e demokracisë, duke e aplikuar atë në kontekstin post-komunist shqiptar, konkretisht në periudhën 1990–2025. Metodologjia ndërthur analizën krahasuese, analizën diskursive dhe studimin e rastit historik për të krijuar një pasqyrë të shumëanshme të zhvillimit (ose dështimit) të një të dhatë institucionale në Shqipëri. Kjo qasje është e nevojshme për të kapur kompleksitetin ideologjik, institucional dhe kulturor të tranzicionit demokratik në një vend ku tradita konservatore ka qenë e ndërprerë ose e pamunguar.

Ky studim synon të vlerësojë aplikueshmërinë e modelit teorik të Daniel Ziblatt mbi rolin e partive konservatore në lindjen dhe konsolidimin e demokracisë, duke e testuar atë në kontekstin shqiptar pas vitit 1990 – një vend pa një traditë të mirëfilltë të së dhatës konservatore. Qëllimi është të shqyrtohet nëse dhe në çfarë mënyre mungesa e një të dhatë të institucionalizuar ka ndikuar në dështimin e konsolidimit demokratik në Shqipëri, duke e vendosur analizën në kuadrin e teorisë të institucionalizmit historik dhe të zhvillimit demokratik.

Ziblatt argumenton se në shumë vende të Evropës Perëndimore, përfshirë Gjermaninë dhe Britaninë e Madhe, partitë konservatore luajtën një rol kyç në tranzicionin drejt demokracisë, duke siguruar rendin dhe duke kufizuar forcat destabilizuese përmes integritetit institucional. Aplikimi i këtij modeli në Shqipëri, ku mungesa e një të dhatë tradicionale u zëvendësua nga elita të reja me orientim jo konsistent ideologjik, ngre pikëpyetje mbi kapacitetin e strukturave

politike për të përmbushur funksionet stabilizuese që Ziblatt i atribuon konservatorizmit institucional.

Studimi ka rëndësi teorike pasi teston kufijtë e një modeli të krijuar në kontekste të konsoliduara historikisht dhe e aplikon atë në një rast post-komunist me zhvillime të ndërprera dhe elite fluide. Në të njëjtën kohë, ai ka rëndësi empirike për të kuptuar më mirë mekanizmat që kanë çuar në dështimin demokratik të Shqipërisë, duke kontribuar në debatin më të gjerë mbi tranzicionet e dështuara demokratike dhe rolin e partive në këto procese.

2.2 Pyetjet kërkimore

1. A ka ekzistuar një e djathtë konservatore institucionale në Shqipëri pas vitit 1990? Si është formësuar diskursi i së djathtës pas rënies së komunizmit?

A janë përpjekur partitë të krijojnë një identitet konservator sipas parametrave të Ziblatt (moderim, institucionalizim, elitizëm funksional)?

2. Cili ka qenë roli i saj në procesin demokratik shqiptar?

A ka funksionuar si faktor stabilizues apo polarizues?

A ka pasur një ndikim pengues ose nxitës në ndërtimin e institucioneve demokratike?

2.3. Analizë (e gjuhës) diskursive

Kjo pjesë synon të hetojë nëse në Shqipëri ka ekzistuar një diskurs i mirëfillt konservator, apo nëse ai ka qenë i improvizuar dhe i instrumentalizuar për qëllime elektorale dhe përballje me të kaluarën komuniste. Duke përdorur metodat e Analizës Kritike të Diskursit, do të analizohen përmbajtja dhe format e artikullimit të së djathtës në hapësirën publike. Kjo analizë do të mbështetet mbi kornizën teorike të Daniel Ziblatt mbi diskursin e forcave konservatore dhe mbi qasjen për analizën diskursive të Chantal Mouffe.

- Objekt analizash:
 - a) Fjalimet politike të liderëve të PD-së (Sali Berisha, Lulzim Basha, Jozefina Topalli, Bamir Topi etj.),
 - b) Programet zgjedhore të PD-së në zgjedhje të ndryshme (1992, 1996, 2005, 2013, 2021, 2025),
 - c) Artikuj, intervista dhe deklaratat publike që shprehin identitetin ideologjik të partisë.
- Fjalë kyçe dhe tematike: autoriteti, rendi, feja, familja, prona private, kombi, sovraniteti, anti-komunizmi.
- Qëllimi i analizës:
 - a) Zbulimi i koherencës së diskursit politik konservator në Shqipëri.
 - b) Matja e distancës midis retorikës dhe praktikës politike.

- c) Analiza e mënyrës si Partia Demokratike ka përvetësuar, shtrembëruar apo shmangur vlerat klasike të konservatorizmit.

Kjo analizë synon të vërtetojë nëse në Shqipëri kemi të bëjmë me një konservatorizëm ideologjik të institucionalizuar apo me një konservatorizëm elektoral të improvizuar, pa lidhje me parimet e një të djathtë klasike. Në analizë janë marrë fjalime ose konferenca shtyop i të Sal i Berishës dhe Lulzim Bashës në raste vendimtare. Rast i të tilla për punimin tonë janë konsideruar rast i I paraqitjes së asaj se cfarë përfaqësonte PD-ja pak ditë pas themelimit kur Berisha mbajti një fjalim të rëndësishëm, i zgjedhjeve të vitit 1991 ku PD-ja humbi, rast i i ngjarjeve të 2 prillit në Shkodër, rast i i zgjedhjeve të vitit 1992 ku PD-ja fitoi, rast i i referendumit mb i kushtetutën në vitin 1994, rast i i lirimit të burgosurve politikë, rats i I rrëzimit të shtatores së Enver Hoxhës, rast i I ligjit antigjenocid të vitit 1996, fjalim në fushatën e vitit 1996, fjalim pas zgjedhjeve të vitit 1996. Janë marrë në analizë fjalime të Berishës në rastin e vrasjes së Azem Hajdarit, deklaratë në rastin e arrestimit të tij në vitin 2000, fjalim me rarsin e rizgjedhjes kryetar i PD pas largimit nga detyra e presidentit. Janë marrë në analizë fjalime dhe deklarata në kuvend në rastin e largimit të kryeministrit Nano, të votëbesimit të qeverisë Majko dhe Meta. Janë marrë në analzië deklaratat dhe fjalime të fushatës së vitit 2005, fjalim i fitores në datën 4 korrik, fjalim i I votëbesimit të qeverisë, deklaratë pas ngjarjes së Gërdecit, fjalime të fushatës së vitit 2009, deklaratë pas marrëveshjes me Ilir Metën për koalicion qeveritar, deklaratë për ngjarjet e 21 janarit, deklaratë për zgjedhjet lokale të vitit 2011, fjalim përmbyllës në fushatën e vitin 2013, deklaratë për dorëheqje nga kryetar i PD-së. Janë marrë në analizë fjalime të berishës gjatë lëvizjes së Foltos (fjalim i n Berat, në lezhë, në Korccë), fjalime të Berishës në kuven din e dhjetorit të 2021, fjalime në Kuvendin e prillit të 2022, fjalime në zgjedhjet vendore të 2023, deklarata pas nisjes së cështjes penale ndaj tij, fjalime në protestat e korrikut të 2022. Janë marrë në analizë fjalime të Lulzim Bashës pas zgjedhjes kryetar i PD në gusht 2013, deklaratë pas votëbesimit të qeverisë Rama në shtator 2013, deklaratë në protestën e vitit 2014 kur u dogji bunkeri, fjalim i hapës dhe mbyllës i fushatës së zgjedhjeve vendore 2015. Janë marrë në analizë deklarata mb i reformën në drejtës i në vitin 2016. Janë marrë në analzië fjalime në atë që u quajt “ccadra e lirisë”, fjalime në protestat e vitit 2018, fjalim i pas djegies së mandative, fjalim i për mospjehesëmarrjen në zgjedhjet lokale të 2019, fjalime të fushatës së 2021, fjalim i për pezullimin e Berishës nga grup i PD-së, fjalim i në kuvendin e dhjetorit të vitit 2021. Janë marrë në analzië edhe dy deklarata të Bamir Topit në kohën e garës për president në vitin 2008, të Jozefina Topallit gjatë fushatës së vitit 2009 të cilat shkaktuan shuyme debat në atë kohë. Është marrë në analizë program i vitit 1992, a i “Vizion 2000” të vitit 1996, ai i vitit 2001 me “Fillimin e ri”, ai i vitit 2005, i vitit 2009, i vitit 2013.

2.4 Studim rasti historik, Shqipëria 1990–2025

Shqipëria do të analizohet si një rast unik i një tranzicioni të gjatë dhe të paqëndrueshëm demokratik. Kjo qasje do të lejojë një analizë të thelluar të zhvillimeve politike dhe institucionale në periudha kyçe, me qëllim gjurmimin e kapaciteteve konservatore për të ndërtuar rend dhe demokraci funksionale.

Faza të përzgjedhura për analizë:

Vitet 1990–1992: Themelimi i Partisë Demokratike dhe adoptimi i një narrative anti-komuniste me nuanca konservatore.

Viti 1997: Kriza e shtetit dhe roli i PD-së në rënien e institucioneve.

Vitet 2005–2013: Rikthimi në pushtet, përpjekjet për modernizim dhe tensionet mes konservatorizmit dhe teknokracisë.

Viti 2019: Bojkoti i Kuvendit dhe zgjedhjeve lokale – akt i delegjitimitetit institucional.

Viti 2025: Pozicionimi aktual i PD-së – përçarja e brendshme, mungesa e platformës ideologjike dhe degradimi i rolit institucional.

Këto janë konsideruar si faza të natyrshme që kanë dallim mes tyre jo thjesht nga rendi kohor por në një kuptrim të substancës dhe mënyrës së ndryshme se si PD-ja nia qas, veprimi dhe u sill politikist të paktën në aspektin formal. Sigurisht këto perfaqesojnë gati të gjithë periudhen e tranzicionit shqiptar.

Objekti: Të analizojmë nëse PD ka pasur kapacitet për të ndërtuar një kulturë politike të qëndrueshme, me rrënjë në vlera konservatore dhe besueshmëri institucionale, apo ka vepruar në mënyrë ad hoc, duke favorizuar krizat dhe delegjitimitetin institucional.

Në këtë analizë të ngjarjeve dhe në përgjithësi të veprimit dhe sjelljes së PD-së do të shohim se si kanë ecur dhe se si janë sjellje variablat e pavarur dhe raportin e tyre me variablat e varur. Do të shohim me fjalë të tjera se si ato kanë prodhuar efektin, pasojën pra si e kanë ndikuar ato ecurinë demokratike të vendit. Variablat e pavarur që do të marrim në nisur nga modeli Ziblat janë forca dhe organizmi i i partive të djathta, institucionalizmi i partive të djathta, sjellja në momente krizash dhe roli në ruajtjen e institucioneve demokratike. Variabla të varur do të jenë “Pjesëmarrja dhe Pluralizmi politik” një indeks i Freedom House i cili nxjerr raporte periodike për gjendjen e demokracisë (përfshirë edhe Shqipërinë), Indeksi i Institucionalizmit të partive që ka për burim projektin V-Dem, Indeksi i rolit të opozitës që ka për burim V-Dem dhe shkallën e zgjedhjeve të lira matur nga treguesit e ODSB-ODIHR-it.

2.5. Intervista me funksionarë dhe analizë e tyre.

Intervista me dhjetë funksionarë dhe ish funksionarë të PD-së. Do të bëhet një analizë e gjuhës së tyre, e pikëpamjeve të tyre, e qasjeve të tyre për të marrë të dhëna mbi variablat baza të cilët siç Daniel Ziblat janë kyç për një parti të djathtë në mënyrë që ajo të ketë rol të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë. Dhjetë funksionarët dhe ish funksionarët janë katër kryetarë të degëve të mëdha të vendit si Fieri, Shkodra, Elbasani dhe Tirana që janë qytetet më të mëdha dhe degët e PD-së më të mëdha në shkallë vendi. Katër ish kryetarët janë gjithashtu ish kryetarë të degëve të mëdha por jo të katër degëve të para. Ish kryetarët janë të degëve që janë degë të rëndësishme por pak më të vogla si Lezha, Lushnja, Gjirokastra, dhe Dibra. Ata janë gjithashtu edhe që kanë garuar një herë të paktën për deputetët ose kryetarë bashkie. Dy të tjerët janë

drejtuesi i tanisëm i sekretariatit të organizmit dhe ish drejtuesi i këtij sekretariati. Që të dhjetë të intervistuarit janë anëtarë të Këshillit Kombëtar. Dy drejtuesit e sekretariatit janë anëtarë të Kryesisë së PD. Të intervistuaritb janë zgjedhur në mënyr të tillë që të përfaqësojnë Këshillin Kombëtar, Kryesinë, Kolegjin e Kryetarëve të degëve që janë tre organe të rëndësishme vednmarrëse dhe mblidhen shpesh për të konsultuar apo marrë vendime për veprimin politik. Janë zgjedhur degët e mëdha dhe degët e mesme sespe ato mnbajnë peshën kryesore në zgjedhje, në protesta dhe kanë numrin më të lartë të përfaqësuesve ne grupin parlamentar dhe në Këshillin Kombëtar. Intervistat janë gjysëm të strukturuar dhe tentojnë të marrin përgjigje për katër variablat ziblattianë si Forca dhe organzimi i partisë, instutucionalimi i saj, qëndrimi në moment kyçe të vendit dhe qëndrimi ndaj institucioneve si Prokuroria, gjykatat etj. Analiza e tyre do të bëhet për të matur, për të parë saktësisht vlerat ose projeksionet e këtyre variablave.

2.6 Analizë e tipareve bazë të PD-së nëpërmjet analizës së intervistave me protagonsitë, drejtues dhe themelues të PD-së.

Do të analizohet përmes këtyre intervistave se cfarë ishte, cfarë përfaqësonte në themelim dhe më pas PD në kuptimin e modleit të Ziblat. Konkretisht do të shikohet se cila ishte forca e PD-së, cili ishte organizmi, në cfarë mase ajo ishte e institucionalizuar. Do të analizohet se në cfarë thonë protagonistët për strukturat partiake (degë, anëtarësi, kontrollin mbi kandidaturat)? Si flasin për rekrutimin e elitave dhe përzgjedhjen e drejtuesve?

Do të shihet nëse mbështesin ata norma procedurale dhe mekanizma demokratikë brenda partisë? Si flasin për statutin, rotacionin e lidshipit, mbajtjen e kuvendeve dhe zgjedhjeve të brendshme? Do të shieht përmes këtyre intervistave se cila ishte sjellja e PD-së në në momente krize në ato që Ziblat i quan "Hinge of History". Si e justifikojnë vendimmarrjen në raste si: 1997, 2008, 2019, 2021? A mbështesin rrugë institucionale apo strategji që e shmangin sistemin demokratik? Do të përpiqemi të kuptojmë se cili ishte raporti me rregullat e lojës. A shfaqin respekt për institucionet si gjykatat, KQZ, parlamenti? A e legjitimojnë procesin zgjedhor kur janë në opozitë? Për këtë gjë kemi marrë disa intervista drejtues të PD-së si ish sekretari organizativ, ish nënkryatri i PD-së, ish deputetë dhe kryetarë degësh. Nëpërmjet intervistave do të shohim fjalët kycc, peshën e lidshipit, tendencën për respect të parimeve të djathta etj.

2.7 Burimet dhe të dhënat

- a) Burimet parësore janë fjalime, dokumente partiake, programet zgjedhore, transkripte të intervistave, arkiva parlamentare.
- b) Burimet dytësore janë literaturë shkencore për rastet krahasuese, studime mbi tranzicionin politik në Shqipëri, vepra të Ziblat dhe teoricienëve të tjerë të demokratizimit (Dahl, Linz & Stepan, Przeworski).
- c) Përkufizimet analitike janë konceptet e “partive të qëndrueshme konservatore” (Ziblat, 2017), “institucionalizimit të partive” (Mainwaring & Scully, 1995), dhe “post-demokracisë” (Crouch, 2004).

- d) Intervista me ish drejtues te PD-së dhe personalitete politike te viteve 1990-2025
- e) Raportet e Freedom house,
- f) Raportet për demokracinë të Institutit dhe projektit V-Dem

2.8 Kufizimet metodologjike

- a) Kufizime në qasjen krahasuese. Shqipëria nuk ka pasur një traditë të mirëfilltë konservatore para vitit 1990, duke e bërë krahasimin historik të pjesshëm.
- b) Probleme të aksesit në të dhëna: dokumentacion i mangët për vitet 1990–1997 dhe mungesë transparence në partitë politike.
- c) Rreziku i subjektivitetit në analizën diskursive, i cili do të minimizohet përmes triangulimit të burimeve dhe analizës së shumëfishtë.

Kontributi i pritur nga ky studim ose pritshmeritë nga ky studim janë

- a) Testojë kufijtë e teorisë së Ziblat në kontekste pa trashëgimi konservatore historike.
- b) Ofrojë një lexim alternativ të tranzicionit shqiptar, që nuk e sheh vetëm si dështim të institucioneve, por edhe si mungesë të një force të djathtë të përgjegjshme dhe të institucionalizuar.
- c) Shtrojë pyetje mbi raportin midis ideologjisë politike dhe stabilitetit demokratik në shoqëritë post-autoritare.

2.9. Hipoteza kërkimore

Bazuar në teorinë e Daniel Ziblat (2017), i cili argumenton se konsolidimi i suksesshëm i demokracisë varet në mënyrë të veçantë nga sjellja dhe struktura e partive konservatore në momentet e tranzicionit, ky studim formulon hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza Kryesore (H1):

Mungesa e një partie konservatore të institucionalizuar dhe të moderuar në Shqipëri ka ndikuar negativisht në konsolidimin e demokracisë pas vitit 1990.

Kjo hipotezë sugjeron se, ndryshe nga rastet perëndimore ku partitë konservatore vepruan si aktorë stabilizues dhe bashkëpunues në ndërtimin e rendit demokratik, në Shqipëri mungesa e një të djathtë të tillë ka krijuar një vakuum institucional dhe ka favorizuar polarizimin, radikalizimin politik dhe delegjitimimin e institucioneve.

Hipoteza Dytësore:

- a) H2: Partia Demokratike në Shqipëri nuk ka zhvilluar një identitet ideologjik konservator koherent dhe të qëndrueshëm, por ka funksionuar kryesisht mbi baza reaktive, populiste dhe anti-komuniste.
- b) H3: Sjellja politike e së djathtës shqiptare në momente kyçe të krizës (si në vitin 1997, 2019 dhe 2025) ka minuar institucionet demokratike për shkak të mungesës së përkushtimit ndaj rregullave të lojës demokratike.
- c) H4: Në mungesë të një të djathtë konservatore të moderuar, procesi i konkurrencës politike në Shqipëri është karakterizuar nga cikle të delegjitimitit reciprok, bojkoteve elektorale dhe polarizimit ekstrem, duke penguar ndërtimin e një demokracie funksionale.

3. Variablat e pavarura dhe operacionalizimi i tyre

a) Forca dhe organizimi i partive të djathta

Me forcë dhe organizim të partive të djathta kuptojmë kapacitetin organizativ dhe elektoral të partisë për të funksionuar si aktor efektiv demokratik.

Indikatorë të matshëm janë

- m) Numri i anëtarëve të regjistruar në parti gjatë periudhave të ndryshme.
- n) Shtrirja territoriale e partisë (numri i degëve aktive në rrethe/komuna).
- o) Performanca në zgjedhje (përqindjet në zgjedhje parlamentare dhe vendore).
- p) Niveli i centralizimit në përzgjedhjen e kandidatëve (statutet dhe praktikat konkrete).
- q) Sasia e burimeve financiare zyrtare (raportet financiare në KQZ ose të publikuara në media/institucione monitoruese).

b) Institucionalizimi i partive të djathta

Ky ka të bëjë me stabilitetin organizativ dhe autonominë e partisë si institucion përballë individëve.

Indikatorë të matshëm janë

- m) Numri i ndryshimeve në lidërsip (rotacioni i brendshëm vs dominimi i një lideri).
- n) Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave statutore (këshilla kombëtar, kuvende, forume rinore dhe grash).
- o) Rregullsia dhe transparenca e proceseve zgjedhore të brendshme (zgjedhje me më shumë se një kandidat; mbajtja e kongreseve).
- p) Niveli i varësisë nga figura karizmatike (analiza diskursive + qasje e centralizuar e vendimmarrjes).

q) Përcaktimi i qartë i orientimit ideologjik në dokumentet programore.

c) Sjellja në momente krizash ("Hinge of History")

Ky ka të bëjë me qëndrimi e partisë në momente kritike që testojnë angazhimin ndaj lojës demokratike.

Indikatorë të matshëm janë

- m) Vendimmarrjet që sfidojnë institucionet (bojkoti i zgjedhjeve, djegia e mandateve, thirrje për protesta masive).
- n) Deklaratat publike në krizat madhore (1997, 2001, 2008, 2019, 2021) që mbështesin/hedhin poshtë kompromisin institucional.
- o) Pjesëmarrja në marrëveshje politike ndërpartiake (p.sh. marrëveshja e 17 majit 2017).
- p) Raportimet e organizatave ndërkombëtare mbi rolin e partisë në ruajtjen e rendit demokratik gjatë krizave.

d. Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike

Teorikisht ky tregues ka të bëjë me angazhimin e partisë në mbështetje të funksionimit normal të institucioneve të pavarura.

Indikatorë të matshëm janë:

- m) Qëndrimi ndaj vendimeve të institucioneve kushtetuese (KQZ, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria, ODIHR).
- n) Pjesëmarrja apo jo në reforma sistemike (p.sh. reforma në drejtësi, reforma zgjedhore).
- o) Diskursi politik lidhur me integrimin euroatlantik dhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare.
- p) Frekuenca e akteve të mosbindjes institucionale (mosnjohja e zgjedhjeve; thirrje për rrëzim të institucioneve përmes protestave).

3.1 Variablat e varura dhe operacionalizimi i tyre

Me stabilizim demokratik nënkuptojmë një gjendje në të cilën institucionet demokratike janë të konsoliduara dhe funksionojnë sipas rregullave të vendosura, ku alternimi i pushtetit ndodh në mënyrë paqësore dhe pjesëmarrja politike përfaqësuese garantohet përmes një opozite të fuqishme dhe partish konkurruese. Sipas Ziblatt (2017), një sistem demokratik i stabilizuar

mbështetet në aktorë politikë, veçanërisht konservatorët, që pranojnë rregullat e lojës dhe i binden rezultatit të proceseve demokratike.

Për të operacionalizuar variablat e varura do të shohim mënyrën se si mund të maten disa tregues të mbështetur në buriem të sakta ose të mirëpranuara si të besueshme.

Stabilizimi demokratik si variabël mund të matet përmes disa treguesve të mbështetur në burime të besueshme vendase dhe ndërkombëtare.

a) Freedom House – “Political Pluralism and Participation” (nën-indeks i Democracy Score)

- m)** Shkallë matjeje: 0–16 pikë (sa më i lartë, aq më demokratik).
- n)** Vlerëson ekzistencën dhe funksionimin e partive politike, të drejtën për të formuar parti, garën reale mes partive dhe rolin e opozitës.
- o)** Burim i saj ne kete rast eshte Freedom House, Nations in Transit Reports. Pra kemi perdorur vleresimet per Shqiperine ne raportet e Fredom House dhe Nations in Transit Reports

b. V-Dem Dataset – Indeksi i Institucionalizimit të Partive (Party Institutionalization Index)

- m)** Shkallë matjeje: 0–1 (interval, ku 1 është institucionalizim maksimal).
- n)** Përmbajtje: Mat qëndrueshmërinë, kapacitetin organizativ, përfshirjen elektorale dhe kohezionin e partive politike.
- o)** Burim eshte ne kete rast Varieties of democracy (V-Dem Project. Pra kemi perdorur vleresimet per Shqiperine ne raportet e Varieties of democracy

. V-Dem – “Opposition Role Index”

- m)** Shkallë matjeje: 0–1.
- n)** Mat nëse opozita luan një rol efektiv në mbikëqyrjen e pushtetit, legjislacionin dhe debatet publike.
- o)** Burim eshte V-Dem Codebook dhe Dataset. Pra kemi perdorur vleresimet per Shqiperine ne raportet e V-dem Codebook dhe Dataset

d. Raportet e OSCE/ODIHR dhe Komisionit Evropian (nga vitet zgjedhore)

- m)** Tregues kualitativ/numerik:

Vlerësime mbi respektimin e rregullave elektorale, marrjen pjesë të opozitës në proces, dhe funksionimin e parlamentarizmit pluralist. Gjithashtu behet operationalizim përmes një shkalle rendi (0 – mungesë e rolit opozitar, 1 – pjesëmarrje e kufizuar, 2 – pjesëmarrje e plotë dhe konstruktive).

- n)** Burim kemi raportet për zgjedhjet parlamentare nga ODIHR dhe progres-raportet e KE.

3.2 Burimet empirike të të dhënave për studimin

Për të mbledhur të dhënat empirike që do t'i japin trup studimit (analizës krahasuese, analizës së diskursit dhe analizës së rezultateve zgjedhore), mund të shfrytëzohen burimet e mëposhtme:

- a) Raportet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet në Shqipëri: Këto raporte ofrojnë të dhëna të besueshme mbi proceset zgjedhore – përfshirë statistika zyrtare (p.sh. pjesëmarrja, rezultatet sipas KQZ-së) si dhe vlerësime cilësore për sjelljen e partive gjatë fushatës dhe pas zgjedhjeve. Për shembull, raporti i OSBE-ODIHR për zgjedhjet parlamentare 25 prill 2021 përmend se pjesëmarrja përfundimtare ishte 46.3%. Raporte të tilla (që ekzistojnë për çdo palë zgjedhje kryesore pas 1991) do të përdoren si bazë për të nxjerrë trendin e pjesëmarrjes zgjedhore, incidente problematike (p.sh. OSBE raporton shpesh për akuzat e shit-blerjes së votës, bojkotet e komisionerëve etj.) dhe për të parë vlerësimet ndërkombëtare mbi sjelljen e partive (p.sh. nëse partitë e djathta kanë respektuar rezultatet apo kanë kontestuar me prova). Këto raporte janë publike dhe ofrohen në gjuhën angleze dhe shqipe nga OSBE.
- b) Të dhënat nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ): KQZ është burimi zyrtar për rezultatet e zgjedhjeve dhe statistikat zgjedhore në Shqipëri. Nëpërmjet faqes së KQZ-së ose publikimeve të saj, mund të mblidhen: rezultatet e çdo partie sipas zgjedhjeve, pjesëmarrja në nivel kombëtar dhe në nivel qarku, shpërndarja e vendeve në parlament, etj. KQZ publikon gjithashtu raporte për ecurinë e procesit zgjedhor. Për shembull, për zgjedhjet e fundit (p.sh. maj 2025) KQZ publikoi në kohë reale shifrat e pjesëmarrjes gjatë ditës – duke treguar se deri në orën 18:00 kishin votuar ~40.9% e zgjedhësve. Këto të dhëna do të përdoren për analizë statistikore – p.sh. për të krijuar seri kohore të pjesëmarrjes, ose për të krahasuar performancën zgjedhore të së djathtës përgjatë viteve. Po ashtu, KQZ disponon të dhëna mbi financimin e fushatave dhe regjistrimin e partive që mund të japin tregues për fuqinë organizative (p.sh. buxheti elektorale i PD-së krahasuar me parti të tjera, numri i kandidatëve që ajo paraqet, etj.)
- c) Arkiva parlamentare dhe dokumente zyrtare shtetërore: Për analizën e diskursit politik dhe të sjelljes institucionale, burim i çmuar janë procesverbalet e seancave parlamentare dhe deklaratat zyrtare. Arkiva e Kuvendit të Shqipërisë (dhe e ish-Kuvendit Popullor për vitet '90) përmban fjalimet e deputetëve, debatet dhe votimet për ligje kyçe. Për shembull, për të kuptuar qëndrimin e së djathtës ndaj institucioneve, mund të analizohet transkripti i seancave për ndryshimet kushtetuese (si në 2008 apo 2016) ku dalin qartë argumentet pro dhe kundër. Gjithashtu, komunikatat zyrtare të Presidencës, Qeverisë dhe partive (çdo parti kryesore ka seksion njoftimesh për shtyp) do të mblidhen për periudhat e krizave – p.sh. deklaratat e PD-së gjatë krizës së 1997, ose në prag të protestave të mëdha (si ato të 13 majit 2010, etj.). Arkivat parlamentare do të shërbejnë për analizë diskursi: me anë të tyre mund të identifikojmë fjalorin politik të së djathtës (a flitet për

“rend kushtetues”, “rrezik për demokracinë”, apo përdoret gjuhë delegjitime ndaj kundërshtarit), si dhe orientimin programatik (p.sh. mbrojtja e pronës private, religjionit, kombit – motive konservatore klasike, vs retorika populiste apo antisistucionale). Përveç transkripteve, projektligjet dhe rezolutat parlamentare janë burime: p.sh. rezoluta të posaçme për kriza politike (ndonjë rezolutë për dialog kombëtar pas 1997) ose ligje për reformën zgjedhore (të cilat shpesh hartohen me konsensus PD-PS me ndërmjetësim ndërkombëtar) do të analizohen për të parë rolin konstruktiv/destruktiv të së djathtës.

- d) Raporte dhe të dhëna nga organizata ndërkombëtare dhe vendase: Përveç OSBE-së, Freedom House (raportet Nations in Transit) ofron vlerësime vjetore për demokratizimin e Shqipërisë, me nënkategori si procesi zgjedhor, shkalla e korrupsionit, qeverisjes demokratike, pavarësia e mediave, gjyqësori etj. Këto raporte do të përdoren për të ngritur indeksin e konsolidimit demokratik dhe për të identifikuar momentet e përkeqësimit apo përmirësimit (p.sh. Freedom House vëren rënie në vitet e krizave politike). V-Dem (Varieties of Democracy) është një tjetër burim: dataset-i i tyre V-Party ka tregues specifikë për partitë politike, si ideologjia, orientimi pro/anti-demokratik, shkalla e organizimit etj., në bazë të anketimit të ekspertëve. Këto mund të na japin një kodim sasior të perceptimit se sa demokratike apo johierarkike janë partitë e djathta shqiptare krahasimisht. Instituti i Studimeve Politike (ISP) dhe organizata të shoqërisë civile në Tiranë publikon analiza pas çdo zgjedhjeje (p.sh. mbi financimin e partive, mbi premtimet elektorale të parealizuara, etj.), të cilat mund të shfrytëzohen për të plotësuar panoramën. Arkiva e shtypit shqiptar (Gazeta Rilindja Demokratike, Koha Jonë, Panorama, etj.) për periudhat kyçe do të konsultohet gjithashtu për ngjyrimet historike dhe deklaratat informale. Së fundi, raportet e OSBE/ODHIR dhe të Këshillit të Europës (p.sh. raportet e Komisionit të Venecias) mbi reforma të veçanta sistucionale japin këndvështrimin teknik për rolin e aktorëve politikë: p.sh. një raport i ODIHR mund të citojë se “opozita refuzoi të propozojë anëtarë për komisionin parlamentar, duke bllokuar procesin X” e cila është e dhënë konkrete për sjelljen e së djathtës.
- e) Të dhëna mbi rezultatet zgjedhore dhe sondazhet: Për analizën krahasuese, do të duhen edhe të dhëna krahasuese ndër-vendore. Burime si Database i zgjedhjeve të IDEA International ose ParlGov mund të ofrojnë të dhëna për rezultatet në vende si Rumania, Bullgaria, Letonia (p.sh. përqindjet e partive të djathta, pjesëmarrja, numri i partive në parlament). Këto do të ndihmojnë për të vendosur Shqipërinë në kontekst rajonal. Gjithashtu, sondazhe ndërkombëtare (Eurobarometer, Balkan Barometer) ku përfshihet Shqipëria mund të japin të dhëna rreth besimit te partitë politike, orientimit ideologjik të publikut, apo nivelit të tolerancës ndaj qeverisjes autoritare – të gjitha këto në ndërthurje me rolin e partive të djathta. Për shembull, nëse sondazhet tregojnë rritje të nostalgjisë për lidhshmëri të fortë jo-demokratik në një vend, kjo mund të lidhet me dështimin e partive konservatore për të ofruar stabilitet (Ziblatt do argumentonte se kur e djathta s’është e sistucionalizuar, hapet rruga për opsione autoritare).

Kapitulli III :Korniza teorike, roli i partive të djathta në konsolidimin e demokracisë sipas Daniel Ziblatt

3.1 Lindja e Demokracisë në Europë. Vala e parë e demokratizimit (1828–1926)

Demokracia është një sistem qeverisës i cili, pranohet gjerësisht se ka lindur në Greqinë e Vjetër. Gjithsesi për shumë shekuj, që nga shekulli i tretë para Krishtit, ajo u largua nga bota dhe Europa për tu rikthyer në shekullin e 19-të. Shumica e studiesuve bien dakord që, demokracia, ka kaluar neper disa vale, ka patur disa valë demokratizimi për të mbërritur në ditët e sotme. Periudha që përfshin vitet 1828 deri më 1926, e njohur në literaturën shkencore njihet si “vala e parë” e demokratizimit (Huntington, 1991). Ajo nuk përfaqëson një çast të papritur çlirimi apo emancipimi popullor, as ndonjë përmbyse radikale të rendit ekzistues, por një proces të ngadaltë, të zgjatur dhe shpeshherë të pashmangshëm të adaptimit të elitave ndaj realiteteve të reja shoqërore dhe politike. Ajo që në retrospektivë përshkruhet si fillimi i një epoke përfaqësimi më të gjerë, në thelb ishte një negociatë e vështirë dhe e tensionuar midis frikës së elitave dhe aspiratave të masave.

Në Britaninë e Madhe, Reform Act i vitit 1832 shënoi një ndërhyrje të kontrolluar në arkitekturën politike të vendit. Ajo që u paraqit si një hap drejt përfaqësimit, ishte në fakt një ripozicionim i pushtetit – një zgjerim i kufizuar i së drejtës së votës për shtresën e mesme borgjeze, që synonte të ruante ekuilibrin mes stabilitetit dhe ndryshimit. Në vend të një demokracie gjithëpërfshirëse, u krijua një sistem ku pjesëmarrja politike mbetej e filtruar dhe e kufizuar, e kontrolluar nga normat e pronës, gjinisë dhe rendit moral, le të themi, borgjez (Ziblatt, 2017). Ky proces tregoi qartë se demokracia moderne, në format e saj të para, nuk ishte asnjëherë një hap i lirë dhe spontan, por një transformim i kalibruar që synonte të shmangte destabilizimin. Përmes kësaj lenteje shihet më qartë tensioni i brendshëm midis aspiratës për zgjerim dhe frikës nga humbja e privilegjeve ekzistuese.

Ndërkohë, në kontinentin evropian, Revolucionet e vitit 1848 shpërfaqën një potencial të konsiderueshëm për ndryshim radikal. Në një mori shtetesh perandorake dhe mbretërore, qytetarët dolën në rrugë duke kërkuar përfaqësim, barazi para ligjit dhe sovranitet popullor. Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto lëvizje u shtypën me shpejtësi ose u absorbuan nga struktura të reja të kontrollit, duke lënë pak gjurmë konkrete në formën institucionale të regjimeve. Edhe atje ku u arritën koncesione, vota mbeti e kufizuar për burrat me pasuri, duke përjashtuar gratë, punëtorët dhe fshatarësinë – pjesën më të madhe të popullsisë aktive (Hobsbawm, 1996). Për shumë historianë kjo periudhë mbart një paradoks: nga njëra anë, ajo shënon zgjerimin e ideve për sovranitetin popullor dhe legjitimitetin demokratik, ndërsa nga ana tjetër, tregon kufijtë e ngurtë të këtij zgjerimi, duke konfirmuar se demokracia nuk u mendua ende si projekt universal, por si privilegj i një kategorie të ngushtë qytetarësh.

Në anën tjetër të Atlantikut, Shtetet e Bashkuara u përfshinë gjithashtu në këtë valë të parë demokratizimi. Zgjedhja e Andrew Jackson në vitin 1828 shënoi një hap vendimtar drejt zgjerimit të pjesëmarrjes politike për burrat e bardhë pa pronë, duke krijuar atë që shpesh përshkruhet si “Jacksonian democracy”. Megjithatë, ky zgjerim i së drejtës së votës nuk përfshiu

sklleverit afro-amerikanë, gratë apo popullsitë autoktone, duke treguar edhe këtu se demokratizimi ishte selektiv dhe përjashtues. Në këtë rast, demokracia e zgjeruar shërbeu si mjet për të legjitimuar rendin e ri të elitave të bardha të zgjeruara, pa prishur strukturën themelore të dominimit racor dhe gjinor. Po kështu, në disa vende të Amerikës Latine që fituan pavarësinë nga Spanja dhe Portugalia në fillim të shekullit XIX, u eksperimentua me forma republikane dhe përfaqësuese. Megjithatë, pjesëmarrja politike ishte jashtëzakonisht e kufizuar, shpesh e rezervuar vetëm për pronarët e mëdhenj të tokave dhe elitën urbane, duke reflektuar një model të ngjashëm të demokratizimit elitist dhe të pjesshëm. Këto eksperimente tregojnë se vala e parë nuk ishte thjesht një fenomen evropian, por një proces transatlantik me tipare të përbashkëta: zgjerim i ngadalshëm, përjashtues dhe i kontrolluar nga lart.

Ky ishte një demokratizim i pjesshëm, i kushtëzuar dhe instrumental – një proces që i ngjason më shumë mbijetesës së rendit se sa lindjes së një paradigme të re. Kjo është ajo që Barrington Moore (Moore, 1966) e përshkruan si një “kompromis konservator”, ku përfaqësimi politik nuk është dhuratë e fituar nga poshtë, por mjet mbrojtjeje nga lart. Rendi përpiqet të shpëtojë vetveten duke ndryshuar formën, por jo substancën. Në këtë kuptim, edhe aty ku lëvizjet shoqërore shfaqeshin me vrull, përfundimi shpesh ishte një riartikullim i pushtetit të elitave nëpërmjet reformave të kufizuara. Në terma Foucault-ianë, pjesëmarrja politike gjatë kësaj vale nuk ishte rezultat i një përfshirjeje universaliste, por produkt i një bio-politike përjashtuese, ku qytetari që fiton të drejtën e votës është i standardizuar sipas tipareve të rendit ekzistues: mashkull, i pasur, i arsimuar dhe i disiplinuar. Këtu demokracia nuk shfaqet si një shtrirje e natyrshme e të drejtave, por si një teknologji e kontrollit dhe seleksionimit (Foucault, 2008). Ky dimension bio-politik e vendos procesin e demokratizimit të hershëm brenda një logjike disiplinimi dhe përjashtimi, jo emancipimi.

Në këtë kuptim, ajo që njihet si “vala e parë” e demokratizimit duhet të lexohet si një fazë transitive, ku frika nga trazirat dhe rënia e legjitimitetit nxit përshtatjen e elitave nëpërmjet zgjerimit të kufizuar të përfaqësimit. Ky zgjerim nuk ishte përfshirës, por i kalibruar me kujdes për të ruajtur kontrollin. Demokracia nuk u përqaftua si vlerë normative, por u tolerua si strategji e stabilitetit. Përveç kësaj, duhet kujtuar se kjo valë nuk ishte lineare: periudhat e hapjes së kufizuar shpesh pasoheshin nga periudha represioni, dhe disa vende që përjetuan përfshirje të re politike më pas përjetuan rikthime autoritare. Kjo e bën të qartë se vala e parë ishte më shumë një lëvizje valëzuese, plot tërheqje e kundërvalë, sesa një marshim triumfal drejt demokracisë.

Në fund, kjo valë nuk shënon triumfin e popullit mbi oligarkinë, por tensionin permanent midis sovranitetit të pretenduar dhe frikës së humbjes së rendit. Është një dëshmi se demokracia nuk lindi nga një akt fisnik, por nga një llogaritje e ftohtë e pasojave të mosreformimit. Kjo e bën të qartë se themelet e saj moderne, që shpesh mitizohen si fitore të pakthyeshme të lirisë, ishin në të vërtetë pjesë e një procesi kompleks dhe ambivalent, ku pushteti i vjetër riprodhoi veten përmes gjuhës së re të përfaqësimit. Vetëm në këtë prizëm mund të kuptohet pse demokracia e shekullit XIX ishte më tepër një kompromis i brishtë sesa një revolucion i plotë politik.

3.2 Lindja e demokracisë në Europë. Vala e dytë e demokratizimit (1945–1962)

Në ndryshim nga vala e parë e demokratizimit, e cila lindi në një kontekst të brendshëm të përplasjeve klasore dhe presioneve nga poshtë, vala e dytë ishte një produkt i luftës dhe i paqes së diktuar. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, peizazhi politik global u ndërtua mbi një dualizëm të ftohtë, ku demokracia nuk ishte më vetëm ideal, por instrument i pozicionimit gjeopolitik në përballjen ideologjike me bllokun komunist.

Në këtë kontekst, demokratizimi nuk ndodhi si rrjedhojë e presionit nga qytetarët, por si akt i orkestruar nga jashtë, i mbështetur nga prania ushtarake, mbikëqyrja politike dhe instrumentet e rindërtimit ekonomik. Raste si Gjermania Perëndimore, Italia, Austria, apo Japonia përfaqësojnë modele të demokratizimit të mbështetur nga fitimtarët e luftës, ku struktura institucionale u riformatua përmes dizajnit të importuar, shpesh të shoqëruar me një delegjitimim të elitave të mëparshme dhe me një kontroll të drejtpërdrejtë të arkitekturës politike (Bermeo, 2009).

Por ky proces nuk ishte i thjeshtë. Në shumicën e rasteve, ishte pikërisht frika e rikthimit të totalitarizmit që krijoi një atmosferë të favorshme për ndërtimin e institucioneve të forta demokratike. Kjo ishte një demokraci e ndërtuar mbi rrënojat e përvojës ekstreme, një përpjekje për të ndalur përhershshmërinë e së keqes nëpërmjet sundimit të ligjit, ndarjes së pushteteve dhe ndërtimit të një rendi kushtetues që do t'i qëndronte përballë çdo tendence për përqendrim të pushtetit.

Megjithatë, duhet theksuar se vala e dytë ishte selektive, gjeopolitike dhe e kufizuar në shtrirje. Ajo nuk përfshiu Evropën Lindore, e cila ra nën hijen e Bashkimit Sovjetik dhe u përfshi në një cikël të ri autoritar, as nuk shtrihej në masë të madhe në pjesë të Afrikës, Azisë apo Amerikës Latine, ku kolonializmi vijonte ose sapo kishte rënë, duke lënë pas një vakum institucional të mbushur shpesh me forma të reja të autokracisë.

Në këtë kuptim, demokracia në valën e dytë nuk ishte një shpërthim shoqëror, por një produkt i riformatimit të rendit botëror pas luftës, një kontratë e nënshkruar në heshtje midis humbjes dhe kujtesës. Nuk ishte revolucion i që ngjiz demokracinë, por katastrofa – dhe mbi të, dizajni institucional si formë e kontrollit ndaj së keqes së kaluar.

Në terma Foucault-ianë, ky demokratizim përfaqëson një formë disiplinimi të shoqërive përmes institucioneve të projektimit politik, ku demokracia shërben jo vetëm si kornizë për pjesëmarrje, por si strukturë parandaluese ndaj regresit. Është një formë qeverisjeje që nuk buron nga dëshira për vetëqeverisje, por nga ankthi ndaj përvojës totalitare (Foucault, 2008).

Në këtë kuadër, një element themelor ishte edhe Plani Marshall (1948), i cili nuk u kufizua vetëm në dhënie të ndihmës ekonomike, por shërbeu si një instrument politik për të ankoruar vendet e shkatërruara nga lufta brenda kampit demokratik-liberal. Kjo ndihmë financiare dhe teknike, e shoqëruar me kushte politike, krijoi terrenin që demokracia të mos mbetej thjesht një ideal formal, por të merrte formë konkrete përmes zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit shoqëror.

Po aq i rëndësishëm ishte edhe dimensionin ushtarak dhe gjeostrategjik. NATO, e themeluar në vitin 1949, u bë një arkitekturë sigurie që jo vetëm garantoi mbrojtje kundër kërcënimit sovjetik, por edhe shërbeu si një kornizë politike për mbijetesën e institucioneve demokratike në Evropën

Perëndimore. Pa këtë ombrellë sigurie, shumë nga këto demokraci të reja do të kishin qenë më të brishta përballë presioneve të brendshme dhe të jashtme.

Shembujt konkretë e bëjnë të qartë këtë logjikë. Në Gjermaninë Perëndimore, procesi i denazifikimit dhe miratimi i Kushtetutës së Bonit në vitin 1949 shënuan një projekt të ri politik, ku demokracia u importua si një sistem i përpunuar për të frenuar çdo rikthim të autoritarizmit. Në Japoni, autoritetet amerikane hartuan një kushtetutë të re më 1947, duke vendosur mekanizma demokratikë dhe duke kufizuar përfundimisht rolin e militarizmit. Italia dhe Austria ndoqën një rrugë të ngjashme, ku institucionet u rindërtuan mbi bazën e pluralizmit politik dhe të kontrollit ndërkombëtar.

Megjithatë, vala e dytë nuk ishte as universale, as e njëtrajtshme. Evropa Lindore u përfshi nga një logjikë krejt tjetër, ajo e dominimit sovjetik, ku u instaluan regjime komuniste autoritare që do të mbijetonin për dekada. Në Amerikën Latine, ndërsa Perëndimi propagandonte demokracinë në Evropë, shpesh mbështeti regjime autoritare për arsye strategjike, duke krijuar një kontradiktë të dukshme midis idealeve dhe interesave. Po ashtu, Afrika dhe Azia që po dilnin nga kolonializmi u gjendën përballë një vakumi institucional, ku shpeshherë lindën regjime të reja autokratike në vend të demokracisë.

Në këtë prizëm, Samuel Huntington (Huntington, 1991) e quan këtë periudhë “valën e dytë”, por thekson se ajo u pasua nga një “reverse wave”, një valë regresi ku disa prej demokracive të krijuara u shembën ose u zëvendësuan nga forma autoritare të qeverisjes. Kjo tregon se procesi, megjithëse i suksesshëm në disa vende kyçe, ishte i kufizuar dhe shpesh i varur nga mbështetja ndërkombëtare.

Në fund, vala e dytë duhet parë si një laborator historik i mënyrës se si demokracia mund të ndërtohet mbi rrënojat e katastrofës. Ajo nuk ishte rezultat i një revolucionit nga poshtë, por i një projekti global për të parandaluar rikthimin e së keqes. Në këtë kuptim, demokracia e valës së dytë shfaqet si një formë e veçantë e modernitetit politik: një regjim i kujtesës dhe i kontrollit, një arkitekturë që i ngjan një vaksine politike kundër autoritarizmit, por që mbart gjithashtu kufizimet e saj, duke qenë më shumë produkt i frikës sesa i lirisë.

3.3 Lindja e demokracisë ne Europë. Vala e tretë e demokratizimit 1974– deri sot

Me fillimin e viteve 1970, një ndryshim i thellë filloi të përvijonte skemën e regjimeve politike globale. Rënia e diktaturave në Portugali (1974), Greqi (1974) dhe Spanjë (1975) shënoi fillimin e një vale të re demokratizimi – ajo që Samuel Huntington (1991) e pagëzon si vala e tretë, një periudhë që do të shtrihej në dekada dhe do të përfshinte kontinente të tëra: nga Evropa Lindore te Amerika Latine, nga Afrika subsahariane te Azia Juglindore.

Ky fenomen nuk ndodhi në një vakuum historik. Ai lidhej ngushtë me përfundimin e epokës së dekolonizimit, me konsolidimin e Bashkimit Evropian si një aktor normativ dhe me përfshirjen e Shteteve të Bashkuara në promovimin e demokracisë si pjesë e strategjisë së tyre globale gjatë Luftës së Ftohtë. Kjo do të thoshte se demokratizimi nuk ishte thjesht proces i brendshëm politik, por një përplasje e hapur midis dy modeleve të rendit ndërkombëtar.

Por ndryshe nga ç'do mund të pritej, kjo valë nuk ishte domosdoshmërisht produkt i fuqisë popullore, as pasojë e ndonjë zhvillimi revolucionar nga poshtë. Në pjesën më të madhe të rasteve, tranzicioni u shfaq si një proces i kontrolluar nga lart, ku elitat ekzistuese – nën presion ndërkombëtar, rënie legjitimiteti dhe lodhje ideologjike – zgjodhën të menaxhonin kalimin drejt pluralizmit me mënyra të kujdesshme, shpesh të përkoshme, që ruanin thelbin e pushtetit, por ndryshonin formën e tij (O'Donnell & Schmitter, 1986; Przeworski, 1991).

Shembuj të tillë mund të gjenden në Amerikën Latine, ku tranzicioni demokratik në Kili apo Brazil u orkestrua nga ushtritë dhe elitat ekzistuese, ose në Evropën Lindore, ku Partitë Komuniste negociuan me opozitat për të ruajtur kontroll mbi disa segmente kyçe të pushtetit. Këto nuk ishin revolucione të plota, por marrëveshje të kujdesshme që synonin më shumë menaxhimin sesa përmbyستن e rendit politik.

Ky tipar e bën valën e tretë thellësisht paradoksale. Ajo nga njëra anë, solli një zgjerim të paprecedent të regjimeve që e përvetësuan emrin “demokraci” dhe nga ana tjetër, pikërisht ky universalizim formal e dobësoi përmbajtjen reale të demokracisë. Në shumë raste, përfshirë rajonet post-komuniste dhe Ballkanin Perëndimor, demokracia u instalua si procedurë, por jo si rend shoqëror. U fol për zgjedhje, për pluralizëm dhe për institucione, por realisht u trashëguan struktura pushteti që e simulonin përfaqësimin, ndërkohë që prodhonin kapje shtetërore, klientelizëm dhe mosndëshkueshmëri sistemike.

Robert Dahl (Dahl, 1971) e kishte paralajmëruar më herët këtë rrezik: polyarchitë mund të përmbushin kushtet minimale të konkurrencës dhe pjesëmarrjes, por pa një kulturë politike dhe institucione të qëndrueshme, ato nuk arrijnë të garantojnë demokraci substanciale. Pikërisht ky ishte problemi i shumë vendeve të valës së tretë – ato u futën në lojën e zgjedhjeve pa patur themele solide shtetërore.

Në këtë aspekt, valën e tretë mund ta kuptojmë më mirë përmes analizës së Colin Crouch (Crouch, 2004) mbi post-demokracinë – një koncept që përshkruan një gjendje ku procedurat demokratike ekzistojnë në formë, por janë të zbrazura nga përmbajtja politike. Partitë politike kthehen në kartelet e elitash, pjesëmarrja qytetare reduktohet në akte periodike votimi dhe diskursi politik kthehet në spektakël i menaxhuar nga marketingu elektorale, jo si një proces deliberativ. Ky përshkrim gjen konfirmim në shumë vende të Evropës Lindore pas rënies së komunizmit, ku partitë politike shpesh u reduktuan në makina elektorale që i shërbenin liderëve të tyre, duke përforcuar një kulturë politike të personalizuar dhe klienteliste.

Në këtë kuadër, edhe rastet që përfshihen formalisht në valën e tretë, si Shqipëria pas vitit 1990, nuk duhet trajtuar si shembuj të suksesit demokratik, por si prova të një demokratizimi të deformuar, ku mungesa e elitave konservatore të institucionalizuara, trashëgimia autoritare dhe dobësia strukturore e shtetit rezultojnë në një rend politik të brishtë, që improvizon përfaqësimin por nuk e mishëron atë (Ziblatt, 2017; Levitsky & Way, 2010).

Në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë, kjo do të merrte formën e një demokracie të brishtë, ku zgjedhjet janë të rregullta, por konkurrenca reale dhe llogaridhënia mbeten të kufizuara. Rezultati është një rend politik ku pushteti ekzekutiv dominohet nga individë karizmatikë dhe ku parlamenti e gjyqësori kanë pak pavarësi efektive.

Nga një perspektivë Foucault-iane, kjo valë përfaqëson jo emancipimin e qytetarit, por një teknologji të re të menaxhimit të pluralizmit, ku përfshirja politike nuk është më domosdoshmëri

shoqërore, por një ritual i mbikëqyrur, i destinuar për të riprodhuar rendin dhe për të kanalizuar konfliktin brenda kornizave të kontrolluara institucionalisht (Foucault, 2008).

Në këtë kuptim, demokracia e valës së tretë shfaqet si një regjim i ambivalencës: formalisht përfshin individin në procesin politik, por realisht e zhvesh atë nga mundësia për të ndryshuar rrënjësisht raportet e pushtetit. Ajo i jep qytetarit zërin e votës, por i mohon fuqinë e vendimarrjes.

3.4 Këndvështrimi teorik i Daniel Ziblat

Në diskursin klasik të shkencës politike, është bërë zakon të thuhet se demokracia lind nga poshtë, si një frymë që shpërthen nga poshtë dmth nga populli. Studiues si Dankëart Rustoë, Gulliermo O'Donnell apo Philipe Schmitter kanë ndërtuar paradigmen e tranzicionit si produkt i krizës së regjimit dhe presionit të masave që kërkojnë përfaqësim, të drejta dhe pjesëmarrje. Në këtë kuptim, demokracia shihet si një marrëveshje mes elitave që po humbasin pushtetin dhe forcave të reja që po shfaqen në horizont. Ajo paraqitet si një kompromis teknik, i imponuar nga realitetet e reja sociale dhe ekonomike.

Por Daniel Ziblat thyen këtë skemë të konsoliduar dhe na fton të mendojmë demokracinë jo si një fatalitet historik, as si një fryt të domosdoshëm të zhvillimeve shoqërore, por si një zgjedhje politike, një akt vullneti që buron nga maja, jo nga baza e piramidës shoqërore. Në veprën e tij themelore “Conservative Parties and the Birth of Democracy”, ai artikulon një ide që në thelb është kundërintuitive për një botë që ka mësuar të glorifikojë revolucionin dhe rrëzimin e strukturave nga rruga dhe se demokracia lind kur elitat vendosin të mos e trembin më popullin, por ta pranojnë atë si bashkëpjesëmarrës në rendin politik.

Ziblat na kujton se, në Europën Perëndimore, demokracia nuk u lind si rrjedhojë e thjeshtë e presioneve të masave, por si pasojë e mënyrës se si partitë konservatore bartëse të rendit, trashëgimisë dhe hierarkisë reagan ndaj këtyre presioneve. Kjo nuk ishte as dorëzim, as humbje. Kjo ishte një strategji për të shpëtuar vetë rendin. Kur këto elita kuptuan se pjesëmarrja e masave nuk mund të ndalohej, ato zgjodhën ta kanalizojnë atë përmes institucioneve të qëndrueshme, ta institucionalizojnë, ta disiplinojnë. Demokracia u lejua jo për hir të lirisë, por për të ruajtur rendin. Kjo është zgjedhja konservatore.

Në këtë kuptim, Ziblat e sheh partinë konservatore si portierin e rendit demokratik, një aktor që vendos se kush mund të hyjë dhe në çfarë kushtesh. Nëse kjo portë mbetet e mbyllur, masat do të përplasen me murin dhe do të kërkojnë zëvendësime radikale, me anarki ose autoritarizëm. Nëse porta hapet, por elitat e vjetra e hapin me maturi, me ndërgjegje dhe me një strategji institucionalizuese, demokracia bëhet e mundur.

Kjo nuk është thjesht një teori historike. Është një diagnozë e asaj që ka munguar në shumë vende pas rënies së regjimeve autoritare, si Shqipëria. Mungesa e një të djathte të vërtetë, me vetëdije konservatore dhe me ndjeshmëri institucionale, nuk është një mungesë e thjeshtë në hartën politike – është një mungesë ontologjike në vetë projektin demokratik. Kur e djathta nuk

ekziston si formë politike dhe etike, demokracia mbetet pa mbrojtësin e saj më të vështirë, por më të domosdoshëm, mbetet pa atë që pranon të ndajë pushtetin për të shpëtuar rendin.

Në thelb, ajo që na mëson Ziblatt është se demokracia nuk është rezultat i dashurisë për lirinë, por i frikës nga kaosi. Dhe frika, kur është e mençur, mund të bëhet themel i një arkitekture politike që zgjat. Elitat konservatore nuk i dhanë demokracisë shpirtin romantik të revolucionit, por i dhanë asaj skeletin, kockat, që e mban në këmbë.

3.5 Dy kornizat e demokratizimit sipas Daniel Ziblatt

Daniel Ziblatt flet për dy korniza bazë që ndoqën kryesisht vendet e Europës në procesin e demokratizimit. Ato njihen nga ai si demokratizimi i qëndrueshëm dhe demokratizimi i paqëndrueshëm. Tek demokratizimi i qëndrueshëm ai përfshin ose ai kupton një proces ku demokracia ndërtohet gradualisht, pa kthesa ose pa rënie të mëdha autoritariste, një proces ku elitat konservatore arrijnë të krijojnë parti të forta që pranojnë rregullat e lojës, që pranojnë zgjedhjet dhe normat e reja dhe arrijnë të mbrojnë brenda sistemit të ri interesat e tyre. Me demokratizim të paqëndrueshëm Ziblatt kupton një proces hapjeje politike të vështirë, me zvarritje, me kriza të shpeshta dhe të forta. Elitat konservatore përpiqen ta mbrojnë interesin e tyre ose gjithë rendin e vjetër përmes shtetit dhe aktorëve jashtëpartiakë.

Në një botë ku termat “demokraci” dhe “pjesëmarrje” kanë humbur shpesh thelbin e tyre substancial dhe janë shndërruar në vegla të boshatisura rituale, Daniel Ziblatt ofron një diagnozë të kthjellët dhe të thellë të rrugëve drejt demokracisë në Evropë. Në veprën e tij të jashtezakonshme *Conservative Parties and the Birth of Democracy* (2017), Ziblatt argumenton, siç thame me lart, se nuk janë gjithmonë popujt që ngrenë demokracitë përmes revolucionit, por elitat dhe veçanërisht elitat konservatore që vendosin nëse ajo demokraci do të lejohet të jetojë, apo do të mbytet që në lindje.

Ai artikulon një tipologji dypolare, të përbërë nga ajo që ai e quan *demokratizim i qëndrueshëm* (stable democratization) dhe *demokratizim i paqëndrueshëm* (unstable democratization), ku çdo model përfaqëson jo vetëm një rrugë institucionale, por një orientim të tërë etik dhe strategjik të elitave ndaj rrezikut të reformës politike.

Demokratizimi i qëndrueshëm, institucionalizimi i lirisë përmes partive konservatore

Në modelin e parë, demokracia nuk lind përmes rrëzimit të rendit të vjetër, por përmes transformimit gradual të tij, në të cilin partitë konservatore luajnë rolin e faktorëve stabilizues. Ato e pranojnë konkurrencën politike si një formë të re të përfaqësimit të interesave të tyre klasore dhe kulturore dhe, në vend që të mbyllën brenda strukturave të së kaluarës, i përshtaten rregullave të lojës demokratike.

Sipas Ziblatt (Ziblatt, 2017), ky ishte rasti i Britanisë së Madhe, ku Partia Konservatore arriti ta absorbojë zgjerimin e të drejtës së votës pa e shndërruar procesin në një krizë të rendit. Po kështu, në Suedi, e djathta politike pranoi mekanizmat e përfaqësimit demokratik pa braktisur

parimet e saj tradicionale, duke i dhënë sistemit një qëndrueshmëri afatgjatë. Ky proces karakterizohet nga ndërtimi i partive politike të institucionalizuara, të cilat i japin sistemit besueshmëri, vazdhimësi dhe disiplinë (Ziblatt, 2017).

Demokratizimi i paqëndrueshëm, kur e djathta refuzon të institucionalizohet

Në krahun tjetër të kësaj tipologjie qëndron modeli i “demokratizimit të paqëndrueshëm”, një rrugë e vështirë, shpesh e dhunshme, ku elitat nuk e pranojnë rendin e ri, por përpiqen të ruajnë privilegjet e tyre përmes mjeteve jopartiake – shpesh përmes ushtrisë, burokracisë ose institucioneve të politizuara të shtetit. Në këto raste, partitë konservatore mungojnë ose janë të dobëta, dhe për pasojë, nuk arrijnë të funksionojnë si mjete të integritit të interesave konservatore në rendin demokratik.

Shembulli më dramatik që sjell Ziblatt është ai i Gjermanisë së Republikës së Vajmarit, ku elitat e vjetra nuk e pranuan kurrë legjitimitetin e demokracisë dhe punuan në prapaskenë për rrëzimin e saj, duke lejuar kështu ngjitjen e Hitlerit në pushtet (Ziblatt, 2017). Në këtë model, demokracia lind e brishtë, sepse ajo nuk ka mbështetjen e rendit tradicional. Më tej, pa një të djathtë të institucionalizuar dhe demokratike, sistemi bëhet një fushë e lirë për polarizim, populizëm dhe autoritarizëm latent (Levitsky & Ziblatt, 2018).

Pesha politike e konservatorizmit si parakusht i demokracisë së qëndrueshme

Ajo që ndan në thelb këto dy modele është jo vetëm mënyra e menaxhimit të tranzicionit, por vetë mënyra se si kuptohet pushteti nga e djathta konservatore. Në modelin e qëndrueshëm, pushteti është diçka që mbrohet përmes institucioneve ndersa në modelin e paqëndrueshëm, ai shihet si një privilegj që ruhet përmes përjashtimit. Prandaj, për Ziblatt, demokracia nuk është thjesht një proces përfaqësimi, por një arkitekturë besimi institucional. Aty ku elitat i besojnë sistemit, demokracia ka gjasa të mbijetojë. Aty ku nuk i besojnë, ajo shembet (Ziblatt, 2017).

Ky mësim është i thellë, i hidhur, por i domosdoshëm për çdo vend që pretendon të jetë demokratik. Dhe për vende si Shqipëria – që nuk ka njohur ndonjëherë një të djathtë të institucionalizuar, por vetëm forma të deformuara, karizmatike ose klanore të saj – ky mësim është edhe më urgjent.

3.6 Dilema e konservatorëve, bashkëjetesë me masat apo përjashtim autoritar

Në historinë politike të Europës moderne, elitat konservatore janë përballur me një provë themelore, që nuk është thjesht taktike, por moralisht përcaktuese për fatin e regjimeve demokratike. A do të pranojnë ato bashkëjetesën me masat përmes një zgjerimi të përfaqësimit politik, apo do të zgjedhin rrugën e përjashtimit autoritar, duke mbyllur sistemin dhe duke shuar vetë idenë e një rendi përfshirës? Kjo nuk është një çështje e zakonitë teorike, por një moment dramatik i historisë, ku përballen frika dhe liria, rendi tradicional dhe kërkesa për pjesëmarrje, privilegji dhe barazia politike.

Daniel Ziblatt, në librin e tij *Conservative Parties and the Birth of Democracy* (2017), e koncepton këtë dilemë si një çast kritik të të drejtës politike, në të cilin elitat tradicionale përballen me domosdoshmërinë e zgjedhjes: të institucionalizojnë veten brenda rregullave të demokracisë, ose të sabotojnë këtë regjim në emër të ruajtjes së një rendi të vjetër që rrëshqet drejt dekadencës. Janë momente si këto që ndajnë shoqëritë që ecin drejt një rendi politik lirie dhe ligji, nga ato që përfundojnë në regres, përçarje dhe shkatërrim.

Nëse konservatorët zgjedhin rrugën e bashkëjetesës, nëse ata ndërtojnë parti të organizuara, i binden rregullave të lojës dhe pranojnë që përfaqësimi politik të zgjerohet përtej elitave tradicionale, atëherë mund të lindë një rend demokratik i qëndrueshëm. Ky është rasti britanik, ku Partia Konservatore, duke ruajtur rezervat e saj dhe ndjeshmëritë ndaj rendit, pranoi reformat e shekullit XIX dhe u bë një mburojë e paqes kushtetuese. E kundërta ndodhi në Gjermani, ku dështimi për të ngritur një të djathtë demokratike krijoi boshllëkun që u mbush nga radikalizmi dhe autoritarizmi, me pasoja shkatërruese për vetë qytetërimin europian.

Ziblatt na kujton një të vërtetë shpesh të harruar nga retorika demokratike naive se demokratizimi nuk është vetëm frymëzim popullor apo shpërthim idealizmi qytetar. Ai është proces institucional, ku përplasjet politike zhvillohen brenda një kornize rregullash që duhet pranuar edhe nga ata që i kanë mbajtur levat e pushtetit. Në këtë kuptim, konservatorët nuk janë pengesë për demokracinë, por kusht për mbijetesën e saj. Pa pjesëmarrjen e tyre, pa angazhimin e elitave që kontrollojnë burimet ekonomike, simbolike dhe shtetërore, demokracia rrezikon të mbetet një iluzion retorik, i pambështetur mbi mekanizmat e realitetit.

Por çfarë ndodh kur këto elita ndihen të kërcënuara? Kur nuk arrijnë të imagjinojnë një të ardhme brenda një rendi të ri përfshirës? Atëherë ato tërhiqen nga rruga e bashkëjetesës dhe kthehen drejt përjashtimit, drejt kapjes së shtetit, sabotimit institucional, lidhjeve me ushtrinë apo me radikalizmin populist. Në vend të republikës, lind konservatorizmi i frikës, që përkëdhel ndjenjën e humbjes, kthen mitet e së kaluarës në armë politike dhe shkatërron pluralizmin në emër të rendit.

Në këtë pikë, dilema e konservatorëve nuk është më thjesht strategjike. Ajo është një test i karakterit politik dhe etik i një shoqërie. Ajo zbulon nëse rendi është i aftë të integrojë ndryshimin apo do ta shtypë atë, siç shkruan Ziblatt në librin të përmendur më lart:

“Kur elitat konservatore vendosin të mbrojnë interesat e tyre brenda sistemit demokratik përmes institucioneve, partive, votës demokracia merr rrënjë. Kur ata zgjedhin t’i mbrojnë këto interesa jashtë rregullave të lojës, demokracia shpesh dështon” (Ziblatt, 2017).

Në Shqipëri, kjo dilemë ka marrë formë të veçantë, të heshtur, por po aq të rëndë. E djathta shqiptare nuk lindi si një forcë konservatore që ruan traditën përmes demokracisë. Ajo nuk u ngrit mbi një filozofi politike të qëndrueshme, por mbi një ndjeshmëri anti-komuniste dhe një instinkt për pushtet. Në vend që të përfaqësonite rendin tradicional dhe të ndërtonte një strukturë përfaqësuese që fton bashkëjetesën, ajo ndërtoi një model përjashtues, të përqendruar mbi liderin, të ngarkuar me retorikë përballjeje dhe me impulse autoritare. Në vend të një partie

konsevatore që gjen rrugë bashkëjetese me rendin e ri demokratik, kemi parë një te dhathtë që përdor mekanizmat demokratikë për të ndërtuar një kontroll të njëanshëm dhe të dhunshëm mbi shtetin.

Kështu, tranzicioni shqiptar nuk u bë as me frymën e një konservatorizmi që ruan rendin, as me idealin e një demokracie që shpreson në bashkëjetesë. Ai u zhyt në një hibriditet të deformuar, ku institucionet ekzistojnë por nuk funksionojnë, ku zgjedhjet mbahen por nuk ndryshojnë asgjë, dhe ku partia që duhet të ishte mbrojtëse e rendit konservator, është shndërruar në një instrument luftërash të brendshme dhe retorike histerike.

Në këtë terren, demokracia shqiptare nuk ka rrënjë të thella, sepse mungon ai konservatorizëm i urtë që në Europë shërbeu si mburojë për të. Ky është një ndër shpjegimet më thelbësore përse Shqipëria nuk ka mundur të konsolidojë një rend demokratik funksional. Dhe kjo e bën, të paktën për ne në Shqipëri, edhe më të domosdoshme rileximin e dilemës së Ziblatt jo si një çështje europiane të shekullit XIX, por si një sfidë konkrete të Shqipërisë së shekullit XXI ku konservatorizmi nuk është doktrinë, por maskë e një pushteti pa bosht moral.

3.7 Partitë konservatore si kanale institucionale të interesave të elitës ose parisë. Një kendvështrim teorik mbi Ziblatt dhe zbatueshmërinë në rastin tonë

Në analizën e tij madhore mbi origjinat e demokracisë në Evropë, Daniel Ziblatt (Ziblatt, 2017) hedh, siç e thamë, një tezë që e zhvendos vëmendjen nga mobilizimi popullor drejt sjelljes së elitave politike, veçanërisht atyre konservatore. Në kundërshtim me paradigmen dominuese të tranzicioneve demokratike, e cila thekson rolin e lëvizjeve nga poshtë dhe krizave të legjitimitetit, Ziblatt argumenton se një kusht themelor për suksesin e demokratizimit është aftësia e elitave konservatore për të organizuar interesat e tyre brenda strukturave partiake dhe institucionale. Partitë konservatore, sipas tij, nuk janë thjesht instrumente ideologjike apo organizative por ato përbëjnë mekanizma të integritetit politik të rendit ekzistues, duke e përkthyer pushtetin tradicional në autoritet demokratik përmes përfaqësimit dhe institucionalizimit.

a- Partitë konservatore si strukturë e ndërmjetësimit të rendit politik

Në kontekstet ku shtresat e gjera të shoqërisë po fitonin të drejtën e pjesëmarrjes politike përmes zgjerimit të së drejtës së votës dhe mobilizimit demokratik elitat tradicionale ndodheshin përballë një zgjedhjeje kritike që ishte të ruanin pozitat e tyre përmes përjashtimit autoritar ose t'i integronin interesat e tyre në rendin e ri përmes institucioneve demokratike. Partitë konservatore përfaqësonin pikërisht këtë strategji të dytë. Ato vepronin si “kanale institucionale” për tranzicionin paqësor të elitave, duke siguruar një formë të kontrolluar të pluralizmit politik. Në këtë mënyrë, ato luajtën një rol të dyfishtë. Nga njëra anë, garantuan stabilitetin e rendit politik dhe ekonomik, dhe nga ana tjetër, legjitimuan zgjerimin e pjesëmarrjes demokratike pa cenuar interesat thelbësore të elitave.

Siç thotë Ziblat tekstualisht: “Kur elitat konservatore ndërtojnë parti të forta atëherë ato mund ta kanalizojnë lëvizjen politike të njerëzve në korniza të qëndrueshme demokratike pa rrezikuar shkatërrimin e tyre”, (Ziblat, 2017).

Kësisoj, partitë konservatore nuk duhet të kuptohen vetëm si aktorë të zakonshëm në konkurrencën elektorale, por si institucione të rendit dhe të ndërmjetësimit, të afta për të përkthyer autoritetin tradicional në gjuhën e përfaqësimit parlamentar dhe ligjshmërisë moderne.

b- Mungesa e institucionalizimit konservator dhe dështimi i demokracisë

Ziblat vëren se atje ku partitë konservatore nuk u formësuan si struktura të qëndrueshme si për shembull, në Gjermani gjatë periudhës së Republikës së Vajmarit (Weimar) apo në Spanjën para-frankiste elitat e panë zgjerimin e demokracisë si një kërcënim ekzistencial dhe, për pasojë, përqaftuan rrugën e autoritarizmit. Në mungesë të kanaleve institucionale për ndërmjetësimin e interesave, konkurrenca politike u shndërrua në përçarje, polarizim dhe krizë të legjitimitetit, që shpesh përfundoi në kolaps institucional dhe rikthim të formave represive të pushtetit.

Ky dështim tregon se institucionalizimi i elitave nuk është një kusht periferik për funksionimin e demokracisë, por një element thelbësor për qëndrueshmërinë e saj. Partia konservatore, partitë e djathta, në këtë kuptim, nuk janë thjesht një subjekt politik me orientim të djathtë, por një strukturë mbrojtëse e vetë rendit demokratik, e cila mundëson jo vetëm integrimin e elitave, por edhe legjitimimin e shtetit përmes vazhdimësisë kulturore, pronësore dhe autoritative.

c. Rasti shqiptar dhe qasja e të djathtës tek ne

Në kontekstin shqiptar post-komunist, mungesa e një partie të djathtë të institucionalizuar ka prodhuar pasojë të ndjeshme për stabilitetin demokratik. Megjithatë Partia Demokratike u paraqit si një subjekt opozitar ndaj trashëgimisë komuniste dhe pretendoi një identitet konservator, ajo nuk u formësua kurrë si një kanal institucional i përfaqësimit të elitave apo i ruajtjes së rendit. Struktura e saj organizative dhe diskursi politik ishin të mbështetura më shumë mbi karizmën e liderit, mbi logjikën e konfliktit ideologjik me të kaluarën komuniste, dhe mbi luftën për pushtet, sesa mbi ndërtimin e një partie të qëndrueshme, me hierarki funksionale dhe platformë të qartë ideologjike.

Në mungesë të kësaj partie, Shqipëria nuk zhvilloi një elitë konservatore të përfshirë institucionalisht në politikë. Elitat tradicionale u fragmentuan, u zdhukën ose u integruan në mënyrë klienteliste dhe jo përfaqësuese, duke lënë një boshllëk në sistemin politik. Ky boshllëk ka ndikuar në mungesën e një rendi të brendshëm të qëndrueshem brenda sistemit demokratik shqiptar, duke e bërë atë të ekspozuar ndaj krizave të përsëritura, polarizimit të thelluar dhe delegjitimitetit të institucioneve.

Pra teza e Ziblat ofron një perspektivë të vlefshme për të kuptuar dështimet strukturore të tranzicionit demokratik në Shqipëri. Ajo na kujton se demokracia nuk mund të konsolidohet vetëm mbi entuziazmin popullor apo mbi antikomunizmin moral, por kërkon gjithashtu ndërtimin e strukturave institucionale konservatore që ruajnë rendin, trashëgiminë dhe autoritetin legjitim. Në mungesë të këtyre strukturave, sistemi politik humbet aftësinë për të kanalizuar

konfliktin dhe për të përfaqësuar interesat afatgjata të shoqërisë. Prandaj, mungesa e një të djathte të institucionalizuar në Shqipëri nuk është një problem i vogël i spektrit ideologjik, por një boshllëk strukturor që minon vetë themelet e rendit demokratik.

3.8 Rastet kur partitë ose partitë konservatore patën sukses. Britania e Madhe, Gjermania, Suedia

Britania e Madhe

Britania e madhe është shembulli më domethënës i demokratizimit të qëndrueshëm ose i suksesit të një partie të një djathtë. Procesi i demokratizimit në Britaninë e Madhe përfaqëson një nga shembujt më të qartë të asaj që Daniel Ziblatt (2017) e përkufizon si demokratizim i qëndrueshëm – një tranzicion gradual dhe paqësor drejt përfshirjes politike të masave, i ndërtuar mbi themelet e stabilitetit institucional dhe bashkëpunimit të elitave ekzistuese me shoqërinë. Ky proces nuk ishte produkt i një revolucioni popullor apo i një përmbysjeje rrënjësore të rendit ekzistues, por rezultat i një transformimi të brendshëm të elitave konservatore, të cilat zgjodhën të modernizoheshin për të ruajtur rendin.

Që në fillim të shekullit XIX, Britania u përball me tensione të mëdha sociale dhe ekonomike të nxitura nga revolucioni industrial. Këto zhvillime sollën në skenë një shtresë të re urbane. Sollën klasën e mesme dhe punëtorinë e organizuar që filluan të kërkonin përfaqësim politik. Përballë kësaj presioni, Parlamenti britanik, i dominuar ende nga aristokracia e tokës, vendosi të hapte gradualisht sistemin politik përmes Reform Act të vitit 1832. Kjo reformë e rëndësishme:

- a) Zvogëloi peshën politike të qyteteve të vogla të kontrolluara nga elitat (të ashtuquajturat (rotten boroughs, lagjet me pak votues që zgjidhnin deputetë), të cilat kishin qenë bastione të aristokracisë rurale.
- b) Zgjeronte të drejtën e votës për burrat e klasës së mesme, veçanërisht pronarët urbanë.
- c) Rriti numrin e votuesve nga rreth 400 mijë në 650 mijë, një rritje domethënëse për kohën (Cannadine, 1999).

Pas kësaj reforme, rruga drejt demokratizimit vijoi me hapa të tjerë të rëndësishëm si:

- a) Reform Act i vitit 1867, i miratuar nën qeverinë konservatore të Benjamin Disraeli, zgjeroi të drejtën e votës për burrat punëtorë në qytetet industriale. Votuesit u rritën në mbi 2 milionë, duke përfshirë një pjesë të madhe të proletariatit urban.
- b) Reform Act i vitit 1884 e zgjeroi këtë të drejtë edhe për zonat rurale, duke vendosur një standard më të barabartë për të gjithë meshkujt pronarë.
- c) Në vitin 1918, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, u realizua një reformë e madhe që i dha të drejtë vote të gjithë meshkujve mbi 21 vjeç dhe grave mbi 30 vjeç – një hap vendimtar drejt demokracisë universale.
- d) Equal Franchise Act i vitit 1928 e barazoi moshën e votës për burrat dhe gratë në 21 vjeç, duke i dhënë Britanisë një regjim zgjedhor tërësisht demokratik në kuptimin modern.

Ky evolucion institucional nuk do të ishte i mundur pa rolin thelbësor të Partisë Konservatore britanike, e cila, ndonëse mbante pozicionin tradicional të ruajtëses së rendit social ekzistues, u dëshmuua si një aktore elastike dhe me kapacitet të lartë adaptimi. Ajo që në dukje ishte një strukturë politike e konservimit të privilegjeve klasore, u shndërrua në momentet kyçe të krizës në një mjet të rafinuar për përthithjen dhe kanalizimin e energjive transformuese të shoqërisë.

Figura e Benjamin Disrael-it është embleme, mbetet edhe sot një model apo shembull i rrallë i këtij transformimi. Ai nuk ishte një radikal që kërkonte përmbysje, por një konservator strategjik që kuptoi një të vërtetë themelore të modernitetit politik që për të ruajtur rendin dhe për të shmangur përmbysjen revolucionare, duhej afirmuar pjesëmarrja politike si një mjet legjitim i integritetit social dhe stabilitetit shtetëror. Me Reform Act-in e vitit 1867, Disrael-i nuk pranoi thjesht zgjerimin e së drejtës së votës, por e ktheu atë në një instrument të reartikulimit të konservatorizmit, duke i dhënë formë një konservatorizmi popullor, që lidhej me klasat e reja punëtore dhe urbane pa hequr dorë nga mbrojtja e hierarkisë dhe pronësisë.

Kjo përfaqëson në mënyrë shembullore atë që Daniel Ziblatt (2017) e koncepton si “strategjia e institucionalizimit nga lart”. Pra një mënyrë në dukje paradoksale përmes së cilës elitat nuk dorëzojnë pushtetin, por reformojnë veten për të ruajtur hegjemoninë. Ata që në vende të tjera për shkak të mungesës së partive të forta dhe elastike u përpoqën të ndalojnë modernizimin me dhunë, në Britani zgjodhën rrugën e institucionalizimit të pakënaqësisë. Ata krijuan parti të afta të përfaqësojnë, të konkurrojnë dhe, mbi të gjitha, të ndërmjetësojnë mes rendit të vjetër dhe kërkesave të reja për përfaqësim.

Ky proces nuk është një histori idealiste për përparim linear, por një rast ku konservatorizmi u modernizua jo për të braktisur veten, por për të mbijetuar si formë e pushtetit në një realitet politik që ndryshonte me ritme të reja. Është një ilustrim historik se si partitë politike, kur janë të institucionalizuara dhe ideologjikisht elastike, mund të veprojnë si ura midis elitave dhe demokracisë dhe jo si barriera të saj.

Ky model përfaqëson pikërisht atë që Ziblatt (Ziblatt, 2017) e quan një strategji *mbrapa-skene të adaptimit konservator*: elitat tradicionaliste nuk dorëzojnë pushtetin, por e transformojnë veten për të ruajtur kontrollin mbi procesin demokratik. Në vend që të përpiqeshin të përjashtonin klasat e reja nga loja, ato investuan në parti politike të qëndrueshme, të lidhura me bazën, dhe të përgatitura për të konkurruar në zgjedhje.

Ndryshe për shembull (dhe ky ishte një nga shkaqet e dështimit të tyre) nga Gjermania e Perandorisë së Dytë ose Italia liberale e shek. XIX, ku elitat konservatore refuzuan integrimin e klasave të reja dhe përfunduan duke përqafuar nacionalizmin autoritar, Britania ndërtoi një urë mes të vjetrës dhe të resë. Demokracia britanike nuk lindi nga zdhukja e aristokracisë, por nga bashkëjetesa dhe kompromisi institucional me të.

Në këtë mënyrë, Britania nuk përjetoi krizë kushtetuese apo kolaps të rendit politik gjatë tranzicionit demokratik. Ajo nuk pati një përmbysje të dhunshme, as një revolucion popullor – por një zbutje të elitave përmes institucionalizimit. Siç do të argumentonte edhe Tocqueville në vëzhgimet e tij për Anglinë, “shoqëritë më të qëndrueshme janë ato që arrijnë të reformojnë veten përpara se të shpërthejë revolucioni”.

Gjermania

Gjermania është rasti më i çuditshëm. Ajo ka brenda vonesën, ka dilemat, ka dështimin, ka edhe suksesin gati spektakolar. Në shumësinë e demokracive të dështuara të shekullit XX, Gjermania zë një vend të veçantë jo sepse nuk u përpoq të ndëronte një regjim parlamentar, por sepse ajo që mungoi nuk ishte populli, por konservatorizmi politik. Ky është thelbi i analizës së Daniel Ziblatt (Ziblatt, 2017): pa ndërtimin e një të djathtë të institucionalizuar, që pranon konkurrencën politike dhe ndërtonte organizatë moderne për të kanalizuar interesat e elitave tradicionale, demokracia është e pambrojtur. Dhe Gjermania e viteve 1918–1933 e dëshmoi këtë në mënyrën më të dhimbshme.

Gjermania ishte një shtet i zhvilluar por me një elitë që kish ngecur në shekullin XIX. Nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik, Gjermania ishte një ndër fuqitë më dinamike të Evropës. Pas vitit 1871, ajo u kthye në superfuqinë industriale të kontinentit. Rrjeti hekurudhor u shumëfishua, Berlini u shndërrua në një qendër urbane moderne, universitetet gjermane u bënë liderë të risive shkencore. Megjithatë, ky modernizim dhe zhvillim i jashtëm nuk u pasua nga një hapje politike e barasvlershme. Reichstag-u, ndonëse zgjidhej me votë të përgjithshme mashkullore, nuk kishte kontroll mbi qeverinë, e cila mbetej nën autoritetin e Perandorit dhe kancelarit të emëruar prej tij.

Elita, paria prusiane, e përfaqësuar nga Junkerët, nga pronarët e mëdhenj të tokave në Lindje, kontrollonte jo vetëm politikën rajonale, por edhe strukturat kyçe të shtetit: ushtrinë, diplomacinë dhe burokracinë. Kjo elitë nuk besonte te përfaqësimi politik si legjitimitet, por te merita e gjakut, e rangut, e disiplinës ushtarake. Sipas Hans-Ulrich Wehler (Ulrich Wehler, 1997), Gjermania para 1914-ës vuante nga një “modernizim i mangët” (*verspätete Modernisierung siç quhej*), ku zhvillimi ekonomik dhe teknologjik nuk e shoqëroi zhvillimi politik.

Republika e Vajmarit ishte një përpjekje demokratike pa kolona mbrojtëse. Republika e Vajmarit lindi nga humbja në Luftën e Parë Botërore dhe nga një revoltë ushtarake, politike dhe sociale që përmbysi monarkinë. Kushtetuta e saj ishte një nga më të përparuarat në Evropë. Kishte votim universal për të dyja gjinitë, kishte një sistem parlamentar, gjykatë kushtetuese dhe një president me kompetenca të mëdha. Por struktura institucionale u ndërtua në ajër – pa parti të qëndrueshme të qendrës së djathtë, pa mbështetjen reale të elitave të vjetra dhe me një kulturë politike thellësisht armiqësore ndaj kompromisit. DNVP (Deutschnationale Volkspartei, pra Partia Gjermane Nacionalpopullore), partia më e madhe e të djathtës pas monarkisë, refuzoi të bashkëjetonte me rendin e ri. Ajo nuk pranoi të hyjë në koalicione qeverisëse për pjesën më të madhe të dekadës së parë të Vajmarit dhe në fund u bë partnere direkte e nazistëve në rrënimin e sistemit parlamentar. Në zgjedhjet e 1920-s, DNVP fitoi 15% të votave, duke u kthyer në një bërthamë të nacionalizmit agresiv. Në vend që të transformohej në një forcë parlamentare që përfaqësonte interesat, le ti quajme, të borgjezisë konservatore dhe të klasës së mesme, ajo u kthye në promotore të teorive të konspiracionit, të antisemitizmit dhe të antidemokratizmit (Evans, 2003).

Madje edhe partia e djathtë më e moderuar, Partia Popullore Gjermane (DVP), e drejtuar nga Gustav Stresemann, fillimisht ishte skeptike ndaj Republikës së Vajmarit dhe nuk e mbështeti

kushtetutën në vitin 1919. Edhe pse më vonë Stresemann u bë një figurë kyçe e stabilitetit të shkurtër (1923–1929), pas vdekjes së tij më 1929, DVP kaloi në krahun e djathtë ekstrem.

Tolerimi i nazizmit, ndoshta edhe aleanca me të ishte akti i fundit dhe sigurisht shkatërrimtar i një të djathtë pa bindje demokratike. Në fillim të viteve 1930, elitat konservatore u përballën me një krizë të trefishtë që niste nga rënia e ekonomisë pas krizës së bursës (kriza e thellë e bursës së Nju Jorkut që shkaktoi më pas Depresionin e Madh), në vitin 1929, vazdhonte me rritjen e papunësisë dhe mbyllej me humbjen e besimit në partitë tradicionale. Në vend që të rifitonin terrenin përmes reformave, ato zgjodhën rrugën më të shpejtë: aleancën me ekstremizmin.

Presidenti Paul von Hindenburg, simboli i elitës ushtarake prusiane (hero i Luftës së Pare) , dhe Kancelari Franz von Papen, aristokrat konservator, vendosën t'i japin pushtet Adolf Hitlerit, me shpresën se do ta përdornin për të rimarrë kontrollin e rendit. Kjo ishte një nga llogaritë më të gabuara të historisë moderne. “Ne do ta fusim në kornizë, ne do ta kontrollojmë”, tha ish kancelari Frantz von Papen për Hitlerin. Por ndodhi e kundërta: Hitleri përdori mekanizmat e republikës për të shkatërruar vetë republikën. Pas Aktit të Fuqive të Jashtëzakonshme të Reichstag-ut (parlamentit), në të vertet te Hitlerit, të marsit 1933, Gjermania u kthye në diktaturë.

Në këtë pikë, sipas Ziblatt (Ziblatt, 2017), bëhet e qartë se nuk është vetëm mungesa e një partie të djathtë moderne që rrëzoi Vajmarin por është bashkëfajësia aktive e një elite që zgjodhi përjashtimin, jo integrimin. Ajo që ndodhi në Gjermani është shembulli më radikal i “delegjitimitimit konservator të demokracisë”.

Rindërtimi, ringritja erdhi vonë, erdhi pas luftes, erdhi pasi dëmi kishte qenë i tmerrshëm. CDU, Partia Kristiandemokrate, ishte një forcë, u tregua një forcë realisht konservatore që bëri katarsis. Pas luftës, Gjermania u gjet e rrenuar, u gjet në gjunjë. Rreth 6 milionë të vdekur, qytete të rrafshuara, një popull me barrën e një krimi të panjohur deri atëherë. Në këtë pikë, elitat e mbetura konservatore nuk mund të vazdhonin me retorikën e mëparshme. Nën ndikimin e aleatëve perëndimorë, por edhe të një reflektimi moral të brendshëm, u krijua Christlich Demokratische Union, (Partia Kristiandemokrate,CDU) – një forcë e re që bashkonte katolikë, protestantë, ish-liberale, disa nacionalistë të moderuar dhe teknokratë.

Konrad Adenauer, i përjashtuar nga nazistët, ish kryetar i Bashkise së Këlnit para nazizmit, katolik nga Renania, antinazist, u bë figura themeluese e këtij konservatorizmi të ri. Nën udhëheqjen e tij, CDU pranoi rregullat e demokracisë parlamentare, ndarjen e pushteteve, ekonominë e tregut dhe vlerat e krishtera si bazë të rendit politik. Ishte pikërisht ajo që kishte munguar në vitet 1920: një e djathtë që nuk kishte frikë nga demokracia, që e shihte atë si terren legjitim të veprimit dhe jo si kalim i përkoshhëm drejt diktaturës.

Rasti gjerman është një akt i pastër i përgjegjësisë politike të elitave, ose më saktë, i mungesës së saj. Mungesa e një partie të djathtë moderne në vitet 1920 nuk ishte thjesht një defekt organizativ; ishte shfaqja më e qartë e refuzimit për t'u nënshtruar rregullave të lojës politike. Aty ku konservatorizmi nuk institucionalizohet, aty ku ai nuk mëson të humbasë, demokracia është gjithmonë e përkoshhme. Ky është thelbi i tezës së Ziblatt (Ziblatt, 2017): nuk mjafton që të ketë zgjedhje dhe kushtetutë; duhet që të ketë një të djathtë që e pranon legjitimitetin e

rregullave demokratike dhe ndjek interesat e veta brenda sistemit, jo jashtë tij. Pa këtë komponent, demokracia është e gjymtuar dhe e pambrojtur. Rasti i Gjermanisë është prova më dramatike për këtë.

Suedia

Suedia ngërthen në vetvete një kombinim gati unik të moralit konservator dhe maturisë institucionale. Në kohë të krizës dhe ndryshimeve shoqërore të mëdha, kur shumë vende europiane u përballën me rrënojat e institucioneve dhe shpërthimet e dhunës ideologjike, Suedia zgjodhi një rrugë të ndryshme. Ajo zgjodhi rrugën e arsyes politike, të kompromisit të vetëdijshëm dhe të ndërtimit institucional si mjet për stabilitetin demokratik. Ky nuk ishte një fat historik i parashkruar, por rezultat i zgjedhjeve strategjike të elitave konservatore, i atyre që zakonisht në vende të tjera e kishin parë demokracinë si “sëmundje të masave”.

Në rastin suedez, konservatorizmi nuk mori trajtën, nuk u udhëhoq nga frika, por nga moderimi, nuk kërkoi kthimin pas te privilegjet e epokës aristokratike, por zhvilloi një projekt të ri të përfshirjes së masave brenda sistemit, për të ruajtur rendin dhe për të zbutur tensionet klasore.

Në Suedi pati një kombinim shumë domethënës të liberalizmit ekonomik me konservatorizmin institucional. Ky njihet si kompromisi suedez. Suedia nuk zgjodhi midis kapitalizmit dhe demokracisë, as midis konservatorizmit dhe reformës. Ajo ndërtoi një ekuilibër të rrallë, të vecantë mes mbrojtjes së pronës private dhe ndarjes së përfitimeve sociale, një kompromis që nuk ishte vetëm rezultat i zgjedhjeve të majta, por i bashkëpunimit të elitave konservatore me socialdemokratët. Ky bashkëpunim nuk ishte pa tensione, por ishte i strukturuar brenda kornizës së konsensusit institucional.

Në thelb, konservatorët suedezë pranian se për të mbrojtur kapitalin, duhej të garantonin edhe një shkallë minimale barazie, se për të ruajtur privilegjin, duhej të institucionalizonin pjesëmarrjen dhe që për të ruajtur rendin, duhej të legjitimonin përfaqësimin. Kjo është ajo që Ziblat e quan strategjia e institucionalizimit për të shmangur përmbysjen, një rrugë që në Suedi funksionoi sepse partitë konservatore nuk ishin kulla apo bajraqe të izoluara, por struktura të afta për të përpunuar presionin e jashtëm në vendime të qëndrueshme politike.

Suedia pak a shumë eci në një rrugë ndryshe nga Gjermania. Gjermania siç e kemi thënë eci në një rrugë ku boshllëku institucional çoi në kapitullim përballë radikalizmit.

Në Gjermani, situata ishte dramatisht ndryshe. Elitat e pas Prusisë kishin ruajtur një logjikë feudale dhe arrogancë shoqërore, duke refuzuar të pranonin rregullat e reja të lojës demokratike. Partitë e qendrës së djathtë ishin të dobëta, të fragmentuara, pa rrënjë në shoqëri dhe pa kapacitet për të përpunuar konfliktin. Ky boshllëk institucional që Ziblat e sheh si shkakun kryesor të dështimit të demokratizimit gjerman hapi terren për instrumentalizimin e urrejtjes nga ekstremi i djathtë.

Nuk ishte vetëm paaftësia për të ndërtuar parti të forta që i rrëzoi elitat gjermane, por edhe vendimi i vetëdijshëm për të bashkëpunuar me autoritarizmin, për të përdorur dhunën si mjet politik, për të sabotuar çdo përpjekje për pluralizëm. Rezultati ishte shkatërrimi i Republikës së Vajmarit, ngritja e nazizmit dhe humbja e çdo kontrolli institucional.

Në këtë sens, Ziblatt nuk e paraqet thjesht Gjermaninë si një dështim, por si shembullin më ekstrem të asaj që ndodh kur elitat refuzojnë të demokratizohen. Ato që nuk institucionalizojnë interesat e tyre përfundojnë duke u përfshirë në projektet e shkatërrimit të vetvetes.

Në të tre këto raste, Ziblatt sheh një element kyç që përcakton rrugën e demokracisë. Ky element është sjellja e elitave konservatore dhe kapaciteti i tyre për të institucionalizuar interesat e veta. Ajo që e ndan Suedinë nga Gjermania dhe Italia nuk është niveli i zhvillimit ekonomik apo ndonjë predispozitë kulturore skandinave për konsensus, por kapaciteti për të kuptuar se kompromisi nuk është dorëzim, por mençuri politike.

Në Suedi, institucionalizimi i konfliktit u bë përmes dialogut të kodifikuar. U bë marrëveshje midis punëdhënësve dhe sindikatave, reformim i vazdhueshëm i sistemit parlamentar, stabilitet i partive dhe kultura e qeverisjes si bashkëpunim.

Në këtë kuptim, Suedia nuk është vetëm një sukses nordik, por një provë empirike e tezës së Ziblatt se aty ku elitat ndërtojnë institucione që kanalizojnë interesat e tyre brenda lojës demokratike, demokracia jo vetëm mbijeton, por lulëzon.

Suedia tregon se konservatorizmi nuk është domosdoshmërisht armik i demokracisë, perkundrazi, për sa kohë që ai pranon të shndërrohet nga një ideologji e privilegjit në një platformë të ndërmjetësimit institucional. Ky është jo vetëm një leksion për Europën e fillimshkullit XX, por edhe për vendet në tranzicion sot, ku elitat shpesh shohin demokracinë si kërcënim, jo si sfidë për ndërtim. Siç thotë Ziblatt (Ziblatt, 2017), nuk është gjithmonë populli që dështon në ndërtimin e demokracisë, por elitat që refuzojnë të luajnë sipas rregullave të saj. Suedia është përjashtimi që përforcon këtë rregull.

3.9 Rastet kur partitë konservatore dështuan. Spanja, Austria, Italia

Spanja

Në bashkësinë shumë të gjerë të dështimeve të mëdha demokratike të shekullit XX, Spanja e viteve 1930 qëndron si një shembull klasik i asaj që ndodh kur elitat e rendit të vjetër nuk pranojnë të transformohen përmes institucioneve, por vendosin të mbijetojnë duke mohuar çdo rregull të lojës demokratike. Shpallja e Republikës së Dytë më 14 prill 1931 ishte një moment i jashtëzakonshëm për vendin. Monarkia u përmbys pa gjakderdhje, mbështetur nga një valë e gjerë votash për partitë republikane dhe të majta në zgjedhjet komunale të atij viti. Ishte një revolucion pa revolucionarë, një ndryshim i heshtur, por i thellë.

Në këtë kontekst, qeveria republikane nisi një seri reformash rrënjësore që synonin ta modernizonin shtetin spanjoll si ndarja e kishës nga shteti, sekularizimi i arsimit, reforma agrare që synonte t'i jepte tokë fshatarëve të varfër, reforma ushtarake që kufizonte pushtetin e oficerëve tradicionalistë dhe shtetëzimi i disa sektorëve ekonomikë të kontrolluar nga oligarkia. Këto reforma, ndonëse të mbështetura nga një pjesë e madhe e shoqërisë, u lexuan nga elitat tradicionale, nga kleri, oficerët e lartë dhe aristokracia latifondiste si një sulm i drejtpërdrejtë ndaj vetë themeleve të rendit.

Në vend që t'i përgjigjeshin kësaj sfide përmes përfshirjes politike dhe përmes ndërtimit të një partie të fortë konservatore siç ndodhi në Britani me Partinë Konservatore apo në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore me CDU-në, elitat spanjolle radikalizuan pozicionin e tyre. Partia e Aksionit Popullor (CEDA), e themeluar në vitin 1933 nga José María Gil-Robles, ishte teorikisht një përpjekje për të ndërtuar një konservatorizëm demokratik të orientuar drejt mbrojtjes së vlerave tradicionale. Por në praktikë, kjo forcë politike u kthye shpejt në një mjet për të bllokuar reformën, për të përhapur retorikë autoritare dhe për të flirtuar hapur me idetë e fashizmit evropian. Vetë Gil-Robles deklaronte se demokracia nuk ishte një qëllim në vetvete, por një “mjet kalimtar” drejt një rendi të ri autoritar dhe katolik (Preston, 2006).

Zgjedhjet e vitit 1933 i sollën CEDA-s fitoren më të madhe të deriatëhershme për të djathtën spanjolle, mbi 4.3 milionë vota dhe 115 mandate, por presidenti republikan Niceto Alcalá-Zamora refuzoi t'i jepte Gil-Robles-it mandatin për formimin e qeverisë, për shkak të dyshimeve mbi angazhimin e tij ndaj demokracisë. Kjo thelloi krizën institucionale dhe hodhi benzinë mbi zjarrin e polarizimit dhe konfliktit politik.

Në anën tjetër, qeveria e Frontit Popullor, e dalë nga zgjedhjet e vitit 1936, kishte të gjitha karakteristikat e një koalicioni të brishtë mes republikanëve, socialistëve dhe komunistëve, të ndarë në mënyrë të thellë për sa i përket programit politik dhe mënyrës së qeverisjes. Megjithatë, fitorja e saj u pa nga e djathta si një katastrofë, si një renie në humnerë për vendin. Në qershor të atij viti, një pjesë e elitave ushtarake nisi planifikimin e rebelimit përfshirë gjeneralët Emilio Mola dhe Francisco Franco. Pika e kthesës erdhi në korrik 1936, kur vrasja e liderit të djathtë José Calvo Sotelo nga elementë të majtë të policisë u përdor si justifikim për grushtin e shtetit.

Nga korriku 1936 deri në prill 1939, Spanja u përfshi në një luftë civile të përgjakshme, me mbi 500,000 viktima dhe me një brutalitet që shkatërroi jo vetëm institucionet, por edhe vetë unitetin kombëtar dhe kulturor të vendit. Nacionalistët, të përkrahur nga Gjermania naziste dhe Italia fashiste, përdorën këtë luftë për të instaluar një regjim diktatorial. Regjimi i Franco-s që lindi nga kjo luftë nuk ishte thjesht një pushtet autoritar, por një regjim që përdori religjionin, ushtrinë dhe terrorin si mekanizma të një projekti ideologjik për të fshirë çdo kujtim të republikës dhe çdo mundësi të pluralizmit.

Demokracia, në këtë rast, nuk u rrëzua nga ndonjë revolucion i pamatur i masave, por nga një elitë që nuk pranoi të institucionalizonte humbjen, që nuk pranoi të jetonte brenda rendit të ri, që nuk pranoi ta modernizonte veten. Kjo është, sipas Daniel Ziblatt (Ziblat, 2017), diagnoza e qartë e dështimit: aty ku elitat ndërtuan parti të qëndrueshme dhe pranuan lojën, demokracia mbijetoi. Aty ku elitat e përçmuan kompromisin, rrëzimi ishte i pashmangshëm.

Austria

Në historinë politike të Europës ndërmjet dy luftërave botërore, ka pak raste që shpalosin, qe tregojnë me aq qartësi tragjedinë politike të një kombi sa ajo e Austrisë së viteve 1918–1938. Ky nuk është vetëm një rrëfim për një demokraci që nuk ia doli të mbijetojë, por për një klasë politike konservatore që refuzoi të institucionalizohej, që pa pluralizmin si kërcënim ekzistencial dhe përdori shtetin si instrument të misionit moral të përjashtimit. Në vend që ta perceptonin shtetin modern si hapësirë të ndërveprimit dhe kompromisit midis forcave që përfaqësonin interesa të ndryshme, elitat austriake u përpoqën ta kthenin atë në një përmendore të rendit të shenjtë të së kaluarës, ta kthenin një rend që realiteti tashmë e kishte përmbysur.

Në vitin 1918, pas shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze, u shpall Republika e Parë Austriake, një shtet i vogël, pa fuqi perandorake, pa mbështetje ndërkombëtare, dhe me një popullsi të polarizuar në mënyrë dramatike midis punëtorisë qytetase dhe elitës rurale konservatore. Kushtetuta e vitit 1920, e hartuar me pjesëmarrjen e juristit dhe filozofit Hans Kelsen, vendoste themelet për një sistem parlamentar demokratik. Por siç do të vërtetonte realiteti i mëvonshëm, një kushtetutë në letër nuk krijon një rend politik nëse mungon kultura e përbashkët institucionale dhe nëse elitat nuk e shohin pluralizmin si përbashkësi legjitime, por si devijim ideologjik që duhet shtypur.

Në këtë ambient u formësuan dy grupe, gati dy “kombe politike” antagoniste. Nga njëra anë, Partia Socialdemokrate (SDAP), e cila kishte pushtet të madh në Vjenë, zotëronte rrjete sindikale të organizuara, kishte shkolla, teatro, kooperativa ekonomike dhe milicinë e saj politike (Schutzbund) dhe nga ana tjetër, Partia Social-Kristiane (CS), mbështetur fuqimisht nga Kisha Katolike, aristokracia rurale, shtresa e mesme konservatore dhe organizatat paramilitare të djathta si Heimwehr, që përfaqësonin një reaksion të dhunshëm ndaj çdo tentative për barazi sociale apo përfshirje të masave të popullit në pushtet.

Në vend që këto dy forca të përpiqeshin të ndërtonin një rend institucional të përbashkët, ashtu siç ndodhi në Britani apo në Skandinavi, elitat austriake zgjodhën të ndërtuarin e institucioneve paralele, duke e bërë shtetin një fushë lufte të heshtur civile. Demokracia ishte një fasadë procedurale, jo një rend i brendësuar në kulturën politike. Për Partinë Social-Kristiane, shteti ishte armaturë e doktrinës katolike dhe e hierarkisë tradicionale. Për Socialdemokratët, ai duhej të ishte një instrument për të realizuar drejtësinë sociale dhe emancipimin ekonomik. Midis këtyre dy vizioneve nuk kishte asnjë urë të ndërtuar mbi mirëkuptim institucional – vetëm mbijetesë përmes përjashtimit të tjetrit.

Pika e kthesës vjen në mars 1933, kur pas një krize procedurale parlamentare (dorëheqja e njëkohshme e tre kryetarëve të parlamentit), kancelari konservator Engelbert Dollfuss shfrytëzon vakumin për të pezulluar parlamentin dhe nisur qeverisjen me dekrete. Demokracia vdes në heshtje, pa një shpallje të madhe, por me një praktikë administrative që e sheh ligjin si pengesë dhe jo si themel. Në muajt në vijim ndalohen fillimisht Partia Komuniste (maj 1933) dhe më pas Partia Socialdemokrate (shkurt 1934). Dhuna shtetërore kthehet në gjuhën e përditshme të politikës.

Në shkurt 1934, Vjena përjeton njërën nga ngjarjet më të errëta të historisë së saj moderne. Kryengritja e Schutzbund në lagjet punëtore (sidomos në Favoriten dhe Ottakring) shtypet nga forcat e policisë dhe Heimwehr-it me artileri, përfshirë bombardimin e banesave civile. Rreth 350 vetë vriten, mbi 1.500 arrestohen, dhe një pjesë e madhe e drejtuesve socialdemokratë arratisen ose burgosen. Ai që u paraqit si restaurim i rendit ishte në fakt varrimi i pluralizmit politik dhe instalimi i një shteti të diktatorial ose katolicizmit autoritar sic u quajt, që ndalonte çdo lloj opozite.

Në këtë pikë, Austria ishte bërë një shtet diktatorial – një trup pa nerv politik, një autoritet i zhveshur nga çdo lloj legjitimiteti, që në vend të forcës së institucioneve kishte shpatën e një ideologjie hierarkike dhe një aparat dhune. Në korrik 1934, vetë Dollfuss u vra nga një atentat i nazistëve austriakë, ndërkohë që Hitleri e kishte bërë të qartë synimin e tij për të aneksuar Austrinë. Kancelari pasues Kurt Schuschnigg përpiqet me dëshpërim të ruajë pavarësinë përmes negociatave me Romën fashiste dhe përkrahjes së britanikëve, por në mars 1938, pa asnjë rezistencë, trupat gjermane hyjnë në Austri dhe shpallin atë që njihet si Anschluss-i, bashkimin e saj me Rajhun.

Ky nuk ishte një pushtim klasik. Ai ishte kolapsi i brendshëm i një rendi që nuk ndërtoi kurrë themele reale për të ekzistuar, sepse elitat refuzuan institucionalizimin, refuzuan partinë moderne, refuzuan kompromisin dhe e zëvendësuan atë me mitin e një rendi moral që kishte perënduar bashkë me Perandorinë.

Kjo është, në gjuhën e Daniel Ziblatt-it (Ziblatt, 2017), rasti më ekstrem i dështimit të elitave konservatore për të modernizuar veten përmes partive, për të kanalizuar frikën në rregulla, dhe për të mbrojtur rendin përmes institucioneve, jo përmes dhunës. Demokracia, në këtë kontekst, nuk është vetëm çështje zgjedhjesh por është aftësia për të pranuar humbjen, për të ndërtuar institucione ku edhe kundërshtari të ketë vend, për të jetuar me tjetërsinë pa e përjashtuar atë. Austria nuk e pati këtë aftësi. Dhe për këtë arsye, ajo humbi jo vetëm demokracinë, por edhe vetë shtetësinë.

Italia

Italia e pas Luftës së Parë Botërore është gjithashtu një nga shembujt më dramatikë të asaj që ndodh kur elitat, në vend që të ndërtojnë një konservatorizëm të përgjegjshëm, përqafojnë dhunën si metodë dhe autoritarizmin si zgjidhje. Ajo që ndodhi në Itali midis viteve 1919 dhe 1925 nuk ishte një aksident historik, as një grusht shteti në kuptimin klasik, por një proces i ndërgjegjshëm i vetëdorëzimit të elitave para frikës nga masat, një dorëzim që prodhoi njërin nga regjimet më kriminale të shekullit XX.

Në vend që të ndërtohej një e djathtë moderne, që do të institucionalizonte interesat e klasave të vjetra brenda një rendi demokratik, elitat italiane e shkatërruan shtetin demokratik nga brenda dhe i hapën derën fashizmit jo si viktimë të një revolucioni, por si bashkëpunëtorë të vetëdijshëm në një projekt kontrarevolucionar, që kishte për qëllim jo ndërtimin e demokracisë, por asgjësimin e saj.

Demokracia, liberalizmi italian ishte një skelet bosh, pa ndonjë bazë të vërtetë ku të rrinte. Ishta diccka formale pa substancë. Sistemi liberal italian, i lindur pas bashkimit kombëtar dhe i udhëhequr nga figura si Cavour, Giolitti apo Crispi, ishte një rend oligarkik i maskuar si demokraci. Votimi ishte i kufizuar për pronarët dhe analfabetët ishin të përjashtuar, partitë nuk ekzistonin si struktura të organizuara, por si grupe klienteliste deputetësh lokalë. “Partia Liberale” nuk ishte parti – ishte një klub aristokratësh pa ideologji, pa rrënjë, pa vizion, që mbijetonte mbi një sistem zgjedhor të manipuluar dhe një administratë të kapur.

Në këtë kuptim, Italia nuk e kishte ndërtuar kurrë një të djathtë reale. Ajo kishte një kastë burokratësh që mendonin se mund të përjetësonin rendin e vjetër përmes kontrollit të institucioneve dhe shmangies së çdo konflikti me realitetin. Por realiteti shpërtheu, dhe ajo që elitat nuk kishin ndërtuar dot për dekada pra një sistem të aftë për të absorbuar kërkesat sociale, filloi të shembej brenda pak vitesh. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Italia nuk hyri në paqe, por në një fazë të re dhe më të thellë destabilizimi moral dhe politik. Vendi nuk ishte thjesht i rrënuar ekonomikisht me inflacion galopant, papunësi masive dhe industri të paralizuara por ishte edhe i braktisur shpirtërisht, i humbur në një boshllëk identitar dhe institucional që shteti liberal nuk arriti ta mbushë. “*Vittoria mutilata*”, fitorja e gjymtuar, u bë simboli i një zhgënjimi kolektiv. Veteranët u kthyen nga fronti jo si heronj të një Italie të rilindur, por si pjesë e një turme të braktisur dhe të tradhtuar nga elitat politike dhe institucionet e reja të dobëta.

Kjo krizë u përkthye në një shpërthim të fuqishëm të protestës sociale, të njohur si *Biennio Rosso* (1919–1920), periudha e dy viteve të kuqe, ku grevat masive, pushtimet e fabrikave dhe krijimi i këshillave të punëtorëve e shtynë vendin drejt një pragu revolucioni. Në shumë qytete të Italisë së Veriut, rendi i vjetër u duk i përmbysur: autoriteti shtetëror ishte diskredituar dhe e majta radikale, e frymëzuar nga revolucioni bolshevik, dukej e gatshme të marrë drejtimin e sistemit. Sfidimi nuk ishte më për reformë, por për legjitimitet: në themel po vihej në pikëpyetje e gjithë rendi liberal, borgjez dhe parlamentar.

Pikërisht në këtë moment kyç, elitat italiane, industrialistët, pronarët e mëdhenj të tokave, burokracia e vjetër dhe një pjesë e oficerëve të lartë nuk zgjodhën rrugën e kompromisit demokratik. Ndryshe nga rasti britanik, ku konservatorizmi institucionalizoi pjesëmarrjen e klasave të reja për të ruajtur rendin (Ziblatt, 2017), apo ai gjerman pas vitit 1945, ku e djathta u rindërtua si mbrojtëse e demokracisë përmes CDU-së, elitat italiane nuk ndërtuan një parti të rrënjësuar konservatore që të kanalizonte frikën e tyre në një logjikë institucionale. Ato zgjodhën të reagonin përmes dhunës parainstitucionale.

Në vend të ndërtimit të një të djathte demokratike dhe të moderuar, ajo që u krijua ishte një reaksion i zhveshur nga çdo vlerë republikane. Milicite e zeza të Mussolinit, të mbështetura financiarisht nga industrialistët dhe të toleruara nga autoritetet lokale, u bënë mjeti i ri i përfaqësimit të frikës konservatore. Në vend të partisë ishte milicia, në vend të votës ishte dajaku, në vend të parlamentit ishte sheshi dhe dhuna dhe në vend të reformës ishte represioni. Ishte një dorëzim i vetëdijshëm i elitës përballë radikalizmit: një dorëzim që nuk kërkonte më ta reformonte sistemin, por ta mbyste atë në emër të rendit të humbur.

Ky është shembulli klasik i dështimit të konservatorizmit për t’u institucionalizuar si një forcë demokratike, për të qenë siç do ta quante Ziblatt (Ziblatt, 2017) një “kanal i ligjshëm i frikës

elitare”. Në mungesë të një partie konservatore me rrënjë shoqërore dhe ideologji të qëndrueshme, vendin e saj e zuri një lëvizje e dhunshme, irracionale dhe totalitare, që do të përdhoste edhe vetë konceptin e konservatorizmit.

Ky nuk ishte vetëm dështim politik por ishte një katastrofë morale dhe civilizuese. Italia, në vend që të modernizonte të djathtën e saj për të përballuar krizën e demokracisë, bëri të kundërtën: tradhtoi vetë demokracinë në emër të shpëtimit të një rendi që tashmë kishte vdekur.

Ngjitja e Benito Musolinit në pushtet më 1922 nuk ishte rezultat i një revolucioni popullor, por një akt i vetëdijshëm i dorëzimit nga ana e elitave politike, ekonomike dhe institucionale të Italisë. Ish-socialisti që u kthye në nacionalist dhe lider i dhunshëm i skuadrave paramilitare nuk mori Romën si pasojë e një kryengritjeje masive por e mori si rezultat i një rituali të koordinuar nën heshtje nga lart, ku frika nga revolucionarizmi i majtë, paraliza e rendit liberal dhe etja për rend autoritar u takuan në një pikë, u takuan tek dorëzimi i shtetit tek një njeri i dhunës.

“Marshimi mbi Romë” nuk ishte një demonstrim spontan i vullnetit popullor, por një nje teater, një farsë me skenar të shkruar nga vetë elitat. Mbreti Viktor Emanuel III refuzoi të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme, pavarësisht se kryeministri Luigi Facta e kishte kërkuar. Giolitti, figura historike e liberalizmit italian, e injoroi rrezikun ndërkohë që industrialistët e mëdhenj, pronarët e tokave dhe drejtuesit e borgjezisë urbane financuan me zell skuadrat e zeza si një mjet për të frenuar socializmin dhe për të mbrojtur rendin ekonomik (Lyttelton, 2004). Një pjesë e mirë e elitës italiane, që nuk arriti të ndërtonte një të djathtë moderne si CDU në Gjermaninë e pasluftës apo Partinë Konservatore britanike të shekullit XIX, e zëvendësoi politikën me dhunën, dhe ligjin me kultin e liderit.

Ajo që Ziblatt (Ziblatt, 2017) e përshkruan si një “kanalizim institucional të interesave elitare përmes partive të qëndrueshme konservatore” mungoi tërësisht në rastin italian. Në vend që të ndërtohej një infrastrukturë politike që të përfaqësonte në mënyrë demokratike interesat e elitave, u zgjodh rruga e përjashtimit dhe e kapjes autoritare të shtetit, duke shkatërruar çdo shpresë për një kompromis politik të qëndrueshëm.

Ky nuk ishte një revolucion nga poshtë por ishte një dështim nga lart, një akt kapitullimi i elitës, i parisë përballë krizës së rendit dhe frikës nga sovraniteti popullor. Në vend që të mbështeste zgjerimin e demokracisë përmes ndërmjetësimit institucional, elita italiane e periudhës zgjodhi të “pezullojë politikën” dhe të kthehet në një regjim karizmatik, të dhunshëm dhe monist, në një formë të shndërruar të sundimit absolut që zëvendësoi ligjin me vendimin dhe përfaqësimin me forcën.

Në këtë kuptim, fashizmi nuk ishte një përgjigje ndaj vullnetit të masave apo njerëzve, por një strategji e vetëdijshme për të mbrojtur rendin ekzistues përmes përmbysjes së rendit demokratik. Ishte një zgjedhje e elitave të zhgënjyera, të frikësuara dhe pa besim në fuqinë e institucioneve që vetë kishin ndërtuar.

Italia nuk dështoi thjesht si regjim. Italia dështoi si projekt politik i qytetërimit liberal. Liberalizmi atje nuk ndërtoi institucione të qëndrueshme, nuk krijoi parti të përgjegjshme, nuk

ndërtoi një kulturë politike të moderuar. Ishte një liberalizëm pa konservatorizëm sic e quan Ziblatt, një pluralizëm pa strukturë, një sistem që rrëzoi vetveten nga brenda.

Dhe kur erdhi çasti i krizës, nuk kishte asnjë strukturë për ta përballuar. Nuk kishte as parti, as media të lira, as gjyqësor të pavarur, as një të djathtë të organizuar. Kishte vetëm një boshllëk dhe një frikë. Dhe në këtë boshllëk, fashizmi hyri jo si forcë pushtuese, por si shpëtimtar i rendit të vjetër në forma të reja.

Mësimi që del nga kjo dhe që i kushton Ziblat është se elitat nuk janë gjithmonë mbrojtës të demokracisë. Ato shpesh janë vraseset dhe varrmihëset e saj. Rasti italian e konfirmon në mënyrë dramatike tezën e Daniel Ziblatt (Ziblatt, 2017) se kur elitat konservatore nuk ndërtojnë parti politike të qëndrueshme dhe nuk institucionalizojnë frikën e tyre, ato shndërrohen në promotorë të autoritarizmit. Demokracia nuk rrëzohet vetëm nga revolucionarët. Ajo shpesh rrëzohet nga konservatorët që nuk duan ta ndajnë pushtetin. Italia na mëson se demokracia është një projekt që kërkon maturi, strukturë dhe vullnet politik. Dhe kur këto mungojnë, ajo që vjen nuk është rendi por është diccka tjetër, është rremuja, autokracia etj.

Kapitulli IV: Konteksti historik, Shqipëria dhe e djathta në periudhën postkomuniste

4.1 Shkatërrimi i strukturës së mëparshme shoqërore dhe politike gjatë komunizmit

Shembja e regjimit komunist në Shqipëri në vitin 1991 nuk përfaqësonte thjesht një moment politik të kalimit nga një regjim totalitar drejt një rendi nominalisht demokratik, por ishte, në kuptimin më të plotë të fjalës, një katastrofë ose një shkundullime e plote për kedo dhe sigurisht për sistemin tone shoqëror.. Ai shënoi shuarjen e një bote jo vetëm në aspektin institucional e ideologjik, por edhe në atë shoqëror, antropologjik dhe simbolik. Në ndryshim nga shumë shtete të Evropës Qendrore, të cilat trashëguan struktura të pjesshme të pluralizmit shoqëror apo mekanizma tradicionalë të ndërmjetësimit politik siç ishin kishat, sindikatat e pavarura, shoqëritë e qytetarëve apo madje edhe klasat pronare të adaptuara Shqipëria u gjend përballë boshllëkut më radikal që një shoqëri moderne mund të përjetojë: mungesës absolute të vijimësisë.

Ky boshllëk nuk ishte thjesht institucional, por më thellësisht, ishte një boshllëk kujtese, zakoni dhe zakoni politik, një çrrënjosje e atyre përbërësve të jetës kolektive që i japin një shoqërie koherencë, kujtesë dhe kapacitet për ripërtëritje. Partia e Punës, e cila kishte sunduar Shqipërinë për gati gjysmë shekulli, kishte shkatërruar me themel çdo formë organizimi tradicional: kishat ishin zhdukur, pronarët ishin internuar ose asgjësuar, kultura qytetare ishte shpërbërë dhe çdo shenjë e autonomisë së individit ndaj shtetit ishte fshirë. Siç e vëren me një thellësi klinike Claus Offe (Offe, 1991), vendet post-totalitare nuk nisin me pluralizëm të kufizuar, por me një humbje të trefishtë. Ato nisin me mungesë të shtetit, të tregut dhe të shoqërisë civile.

Në këtë kuptim, Shqipëria nuk e nisi tranzicionin nga komunizmi drejt demokracisë, por nga një situatë boshi apo asgjëje drejt një tentative të ndërtimit të një sistemi politik demokratik. Partia Demokratike, e lindur në dhjetor të vitit 1990, nuk ishte prodhim i një tradite të djathtë konservatore, as i një klase shoqërore të lidhur me rendin tradicional, por ishte një reagim i menjëhershëm, emocional dhe pa strukturë, ndaj dhunës simbolike dhe materiale të komunizmit. Ajo ishte, në thelb, një lëvizje proteste me përmbajtje shpërthyesë, e jo një përpjekje për restaurim të rendit përmes formave moderne të përfaqësimit politik.

Në mungesë të një elite konservatore të institucionalizuar, si ato që Ziblatt (Ziblatt, 2017) i përshkruan si kyçe për demokratizimin e suksesshëm në vende si Britania apo Gjermania, Shqipëria prodhoi një “të djathtë” që në fakt ishte një e majtë me retorikë të përmbysur. Personalizimi i pushtetit, logjikat e përjashtimit, mungesa e meritokracisë, përdorimi i partisë si mjet për kapjen e shteti sigurisht nuk ishin tipare të një konservatorizmi institucional, por simetri të deformuara të praktikave totalitare që supozohej se ishin lënë pas.

Për më tepër, ajo që trashëgoi Shqipëria pas vitit 1990 nuk ishte thjesht një boshllëk institucional, por një shoqëri e shkatërruar edhe antropologjikisht, në kuptimin më të thellë të fjalës. Siç e ka analizuar me rigorozitet historiani i njohur amerikan Richard Pipes (Pipes 2001), nën regjimet komuniste lind një njeri që ka humbur ndjesinë e përgjegjësisë personale, që nuk merr përsipër veprime me rrezik, që nuk sheh te vetja një aktor me dinjitet individual, por thjesht një funksion të strukturës kolektive të shtetit-parti. Në një regjim ku gjithçka garantohet nga shteti dhe ku individ nuk posedon asgjë, zdhuket nocioni i përpjekjes dhe meritës, dhe zë vend një psikologji pasive, konformiste dhe e përqendruar te mbijetesa thotë Pipes (Pipes, 2001). Shqipëria në vitin 1990 perbehej nga njerez që nuk kishin kapacitete të merrnin përsipër veprime me rrezik, prisnin nga “partia”, ishin materialiste në ekstrem.

Kjo gjendje antropologjike përkthehet politikisht në pamundësinë për të ndërtuar institucione që kërkojnë autonomi, përgjegjësi dhe vullnet kolektiv për rend. Në vend të kësaj, pas vitit 1991, Shqipëria përjetoi një shpërthim të formave të egra të individualizmit parainstitucional, të klientelizmit, të kapjes së shtetit dhe të ndërtimit të pushtetit përmes lidhjeve personale dhe jo mekanizmave përfaqësues.

Në këtë sfond, mungesa e një të djathte konservatore të institucionalizuar nuk është thjesht një mungesë programore apo organizative. Ajo është simptomë e një dështimi shumë më të thellë: dështimit për të ndërtuar një urë mes së kaluarës dhe së ardhmes, dështimit për të formësuar një rend politik që të jetë i aftë të përfshijë masën dhe elitën, rregull dhe ndryshim, përfaqësim dhe autoritet. Ziblatt (Ziblatt, 2017) e koncepton të djathtën konservatore si gardianin e rendit përmes pajtimit me demokracinë. Në Shqipëri, të djathtën nuk e prodhoi rendi, as kultura politike konservatore, por zhgënjimi, protesta dhe dëshira për përmbysje.

Kjo është arsyeja pse ajo që u quajt “e djathta” shqiptare, në vend që të ishte një strukturë përfaqësuese e interesave të stabilitetit dhe meritës, u bë një instrument i radhës për kontrollin e shtetit dhe shuarjen e kundërshtarit politik. Në vend të një opozite që ruan ekuilibrin institucional, kemi pasur rotacion pushtetesh të ndërtuar mbi të njëjtën paradigmë klienteliste dhe të personalizuar.

4.2 Formimi i Partisë Demokratike. Një lëvizje popullore, jo një parti e djathtë klasike

Në peizazhin politik të tranzicionit shqiptar pas rënies së diktaturës komuniste, Partia Demokratike nuk u shfaq si një subjekt politik i rrënjësuar në një traditë konservatore institucionale, por si një lëvizje e papërpunuar, protestare dhe spontane, që mbushi boshllëkun e krijuar nga kolapsi i menjëhershëm i regjimit totalitar. Themelimi i saj në dhjetor të vitit 1990 ishte një akt i gati i pashmangshëm shpërthimi shoqëror më shumë sesa një përpjekje e vetëdijshme për të ndërtuar një të djathtë ideologjike dhe strukturore në kuptimin perëndimor të fjalës. Ajo mishëroi revoltën morale të një shoqërie të traumatizuar, por nuk u ngjiz mbi një substrat ideologjik të qëndrueshëm, as mbi një klasë konservatore që të ishte trashëgimtare e një tradite politike, kulturore apo institucionale të mëparshme (Howard, 2003).

Shqipëria e pas Luftës së Dytë Botërore ishte ndryshe nga shumica e vendeve të tjera të kampit socialist. Pas vendosjes së regjimit komunist në vitin 1945, sistemi i Enver Hoxhës nuk ndoqi rrugën e një socializmi reformist apo gradual, por ndërmori një revolucion të dhunshëm shoqëror dhe ideologjik. Mijëra familje të mëdha shqiptare u shpallën “armike të klasës”, u internuan apo u ekzekutuan. Vetëm në vitet 1945–1949 u pushkatuan mbi 6,000 persona me akuza politike dhe mbi 20,000 të tjerë u burgosën ose internuan (Beci, 2008). Reforma agrare e vitit 1946, ndalimi i pronës private në vitin 1967, dhe ndalimi i fesë në të njëjtin vit, e zhveshën vendin nga çdo shtresë me përbërje identitare, ekonomike dhe institucionale që mund të përbënte bërthamën e një të djathtë të ardhshme.

Kjo është thelbësore në kuptimin e dështimit të mëvonshëm për të ndërtuar një të djathtë konservatore të mirëfilltë në Shqipëri. Në vende si Polonia apo Hungaria, trashëgimia e Kishës Katolike, roli i elitave të vjetra burokratike dhe klasës pronësore të para Luftës së Dytë Botërore krijoi një urë të brendshme midis së kaluarës konservatore dhe demokracisë së re pas komunizmit. Në Shqipëri, as kleri, as elitat ekonomike, as shtresat e mesme urbane nuk mbijetuan në formë funksionale për të ofruar këtë kalim kontinuiteti.

Në këtë boshllëk total institucional dhe shoqëror, Partia Demokratike lindi si një artikulum proteste dhe jo si një parti konservatore në kuptimin që Daniel Ziblatt (Ziblatt, 2017) i jep këtij termi, jo si një formacion që siguron kalimin paqësor të elitave ekzistuese drejt një rendi demokratik dhe ruan stabilitetin përmes ruajtjes së rendit dhe institucioneve. Spektri drejtues i PD-së në vitet 1990–1992 ishte i përbërë pothuajse tërësisht nga figura që ishin formuar në sistemin arsimor dhe akademik të regjimit komunist. Ishin pjese e asaj që mund të quhet elita se paku intelektuale komuniste e vendit. Në fakt, vetë procesi i regjistrimit të partive në dhjetor 1990 ku PD u lejua si opozita e parë legale ndodhi me miratim të strukturave të Partisë së Punës, çka tregon për natyrën e kontrolluar të tranzicionit fillestar (Zogaj, 2009).

Arolda Elbasani (Elbasani 2013) ka vënë në dukje se mbi 60% e figurave kyçe në drejtimin e PD-së në vitet e para kishin qenë pjesë e aparatit shtetëror apo universitar të regjimit të vjetër. Kjo përbën një formë tipike të “rotacionit të kontrolluar të elitave”, ku në vend të një ndarje të qartë ideologjike, kemi më shumë një vazhdimësi teknokratike me narrativë të re politike. Retorika demokratike nuk shoqërohej me përmbajtje konservatore: nuk kishte një doktrinë të

qartë mbi rolin e shtetit, rëndësinë e pronës private, apo nevojën për ruajtjen e institucioneve tradicionale të shoqërisë.

Nëse në teorinë e Ziblatt (Ziblatt, 2017), një të djathtë konservatore e suksesshme duhet të përfaqësojë një klasë ekzistuese me interesa afatgjata në stabilitetin politik (zakonisht elita pronësore apo burokratike), në Shqipëri nuk kishte një klasë të tillë. Kthimi i pronave ndodhi vetëm pjesërisht dhe me vonësë, ndërsa shtresat që përfituan nga privatizimet pas viteve '90 nuk kishin vetëdije klasore konservatore, por më shumë një kulturë oportuniste, të lidhur me klientelizmin politik dhe përfitimin personal.

Në këtë kuptim, Partia Demokratike nuk u bë kurrë një parti e rendit, siç ishin konservatorët britanikë apo qendra e djathtë gjermane pas Luftës së Dytë Botërore. Ajo nuk pati as bazën shoqërore që të shërbente si mbështetje për stabilitet institucional, as aparatit organizativ për të ndërtuar një rend të ri të qëndrueshëm demokratik.

Kriza e vitit 1997 është ndoshta dëshmia më ekstreme e kësaj paqëndrueshmërie. Pas një cikli autoritar gjatë presidencës së Berishës (1992–1997), Shqipëria përjetoj kolapsin e sistemit bankar dhe të shtetit ligjor, duke u zhytur në një anarki të armatosur. Kjo tregoi se Partia Demokratike, në vend që të shërbente si instrument i rendit dhe i institucionalizimit të elitave, nuk kishte kapacitete për të ruajtur as minimumin e stabilitetit shtetëror. Pas vitit 1997, PD u rikthye në pushtet në vitin 2005 dhe qendroi 8 vite, por kurrë nuk arriti të ndërtojë një identitet ideologjik të qartë. Ajo alternoi retorikën pro-liberale me populizmin nacionalist, autoritarizmin presidencial me modernizimin sipërfaqësor, dhe antikomunizmin moralist me klientelizmin praktik etj.

As në dekadën e dytë të pluralizmit (2005–2013), pra me kthimin e PD-së në pushtet, nuk u pa një përpjekje për ndërtimin e një të djathtë të institucionalizuar. Reformat ekonomike të kryera nuk u mbështetën nga një vizion konservator për shtetin, pronën dhe rendin, por nga imperative politike të ciklit elektoral dhe retorikës personale të liderit. Krizat e pasuara nga përçarjet e viteve 2021–2025 midis grupit të Berishës dhe grupit të Bashës, e më pas grupit të Alibeajt dhe të tjerëve me grupin në Berishes, treguan se nuk kishte një bërthamë ideologjike koherente apo një klasë që ta mbështeste atë veç interesave të momentit dhe lëvizjeve rreth liderëve karizmatikë.

Si përfundim, historia e Partisë Demokratike nuk është thjesht një histori dështimi politik, por një pasqyrim i pamundësisë për të ndërtuar një të djathtë konservatore funksionale në Shqipëri. Ky boshllëk nuk ka qenë vetëm çështje individësh apo strategjish të gabuara, por ka rrënjë të thella strukturore dhe historike. Regjimi komunist shkatërroi çdo mundësi për një trashëgimi konservatore, dhe elitat e reja që dolën pas vitit 1990 nuk kishin as përmbajtjen, as vetëdijen, as lidhjet shoqërore për ta ndërtuar atë. Si rezultat, tranzicioni demokratik në Shqipëri u zhvillua pa një pol të djathtë stabilizues, dhe kjo mungesë vazhdon të rëndojë mbi cilësinë dhe konsolidimin e demokracisë shqiptare edhe sot.

4.3 Antikomunizmi si zëvendësues i konservatorizmit. E djathta shqiptare pa traditë ideologjike

Në fillim të viteve '90, Shqipëria hyri në tranzicionin demokratik në kushte rrënjësisht të ndryshme nga shumica e vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore. Rënia e regjimit komunist nuk u shoqërua me një ringjallje të elitave tradicionale ose me rikthimin e ndonjë shtrese kulturore, aristokratike, fetare apo pronësore, siç ndodhi në Poloni, Çeki, Hungari apo Kroaci. Kjo për shkak se diktatura shqiptare kishte qenë jo vetëm një nga më represivet në kontinent, por edhe më e suksesshmja në fshirjen e çdo forme të autonomisë shoqërore dhe të çdo trashëgimie ideologjike që mund të mbështeste një të djathtë klasike.

Që me ardhjen në pushtet të Partisë së Punës më 1944, Shqipëria përjetoi një spastrim sistematik të klasave që tradicionalisht përbënin themelin e konservatorizmit politik si pronarët e mëdhenj të tokës (bejlerët dhe agallarët), elitat kulturore urbane (sidomos në qytetet e mëdha si Shkodra, Gjirokastra, Korça, Elbasani), dhe institucionet fetare (myslimane, katolike dhe ortodokse). Sipas të dhënave arkivore dhe analizave të historianëve si Bernd J. Fischer (Fischer, 2007) dhe Oëen Pearson (Pearson, 2005), mijëra qytetarë u ekzekutuan, burgosën ose u internuan për shkak të “origjinës së keqe shoqërore”, përkatësisë fetare apo rezistencës ndaj kolektivizimit.

Në vitin 1946 u konfiskuan të gjitha pronat private të mëdha, dhe me reformën agrare u zhduk njëherë e mirë baza ekonomike e çdo klase të pasur konservatore.

Ndërmjet 1945–1953, të tre komunitetet fetare kryesore (myslimanë, katolikë, ortodoksë) u nënshtruan dhunshëm, dhe kleri i lartë u burgos, u pushkatua ose u detyrua të bashkëpunojë me regjimin.

Në vitin 1967, Shqipëria u shpall “shteti i parë ateist në botë”, duke ndaluar me Kushtetutë çdo praktikë fetare dhe duke i kthyer objektet e kultit në stalla ose depo shtetërore.

Kjo përbënte një çrrënjosje të plotë të institucioneve që në vendet e tjera përbënin boshtin moral dhe kulturor të konservatorizmit. Nuk kishte më as xhami, as kishë, as institut kulturor, as komunitet pronarësh që mund të mbështeste ideologjikisht të djathtën e re.

Ndryshe nga vendet si Lituania, Polonia apo Kroacia, Shqipëria nuk pati një diasporë aktive politike që të kontribuonte në ndërtimin e një alternative të djathtë pas rënies së komunizmit. Megjithatë ekzistonin figura të rëndësishme si Mithat Frashëri, Ibrahim Dalliu, Ernest Koliqi, Arshi Pipa apo Mustafa Kruja, Ali Korça, Abaz Ermenji etj , të cilët përfaqësonin një mendim konservator ose liberal nacionalist, ndikimi i tyre mbeti marginal, për shkak të izolimit të plotë të Shqipërisë nga pjesa tjetër e botës gjatë diktaturës. Librat dhe idetë e tyre nuk qarkullonin në vend, kujtesa për ta u fshi, dhe ndikimi i tyre u kufizua vetëm në rrethin e mërgatës shqiptare në Perëndim.

Po kështu, Shqipëria e viteve '30 kishte filluar të ndërtonte një elitë politike të moderuar me prirje liberale-konservatore, e përfaqësuar në figura si Med'hi Frashëri, Lef Nosi, Kostaq Kota etj , por të gjitha këto figura u përjashtuan dhunshëm pas vitit 1944, duke u shpallur "kolaboracionistë" dhe "armiq të popullit".

Në këtë kontekst boshllëku historik, Partia Demokratike e krijuar në dhjetor 1990 nuk u ndërtua mbi trashëgimi konservatore, por mbi një revoltë morale ndaj sistemit. Ajo përfaqësonte më

shumë një koalicion të pakënaqësisë, një bashkim studentësh, intelektualësh teknokratë dhe disidentësh të vonuar, të cilët ndonëse antikomunistë në thelb, nuk kishin asnjë përgatitje ideologjike për të artikuluar një projekt të djathtë në kuptimin perëndimor të fjalës.

Nuk është rastësi që liderët e saj si Sali Berisha, Arben Imami, Eduard Selami, Gramoz Pashko, Aleksander Meksi vinin nga brenda sistemit komunist. Ata ishin ish-anëtarë partie, mjekë, pedagogë, ekonomistë të edukuar në sistemin e Enver Hoxhës. Ata nuk e sollën me vete një filozofi politike të djathtë, por vetëm një revoltë teknokratike dhe morale ndaj kolapsit të komunizmit. Në këtë mënyrë, e djathta shqiptare nuk ishte një rilindje konservatore, por një shpërthim antikomunist pa ideologji koherente.

Pas vitit 1992, edhe pse Partia Demokratike ndërmori disa reforma që në sipërfaqe mund të duken si pjesë e një axhende konservatore si privatizimi i ekonomisë, orientimi drejt Perëndimit, ndjekja e integritetit euroatlantik ato nuk ishin të mbështetura mbi një filozofi politike, por mbi urgjencën e daljes nga kolapsi. Këto masa u shoqëruan me kapje të institucioneve, konflikt civil (1997), krizë të përsëritur elektorale dhe degradim të kulturës parlamentare. E djathta nuk prodhoi institucione të forta, por i instrumentalizoi ato në funksion të mbijetesës politike.

Në vend të një morali institucional konservator (bazuar në rregulla, meritokraci, hierarki, ruajtje të rendit dhe vlerave tradicionale), ajo prodhoi një sistem informal të pushtetit, të ndërtuar mbi klientelizëm, personalizim të lidershipit dhe përdorim selektiv të ligjit. Deri në ditët e sotme, kjo e djathtë nuk ka arritur të ndërtojë një doktrinë politike që të adresojë thelbin e asaj çfarë përbën një vizion konservator për lirinë, shtetin dhe shoqërinë.

Rrjedhimisht, antikomunizmi në Shqipëri funksionoi si një ideologji e përjashtimit dhe jo si një afirmim i vlerave të djathta. Ai zëvendësoi konservatorizmin klasik me një retorikë moralizuese, e cila më shumë mobilizonte kundër një armiku të përbashkët sesa ofronte një horizont politik të kuptimtë. Në mungesë të traditave, elitave dhe institucioneve që zakonisht mbajnë gjallë të djathtën, ajo që mbeti ishte një e djathtë pa busull, pa vektorë të qarte, pa doktrinë, pa projekt të qëndrueshëm politik.

4.4 Mungesa e traditës së shtresës së mesme, aristokracisë apo pronarëve të mëdhenj

Një nga karakteristikat më të dallueshme të tranzicionit shqiptar pas vitit 1990 ishte shoqëria jashtëzakonisht e shkrirë, e zhveshur nga klasat tradicionale pronare, shtresat e mesme dhe aristokracia, të cilat historikisht kanë shërbyer si bazë për lindjen e forcave politike konservatore në kontekstin evropian. Ndryshe nga përvojat e shumë vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, Shqipëria hyri në demokraci me një boshllëk të thellë strukturor dhe kulturor që e bëri të pamundur ngritjen e një të djathte me rrënjë të forta shoqërore.

Në një kend krahasues, vende si Polonia, Hungaria, Çekosllovakia apo Rumania pavarësisht periudhave të gjata të sundimit autoritar dhe represionit komunist ruajtën disa segmente të borgjezisë urbane, një pjesë të inteligjencës tradicionale, struktura fetare dhe rrjete komunitare që përbënin kapitalin social, simbolik dhe moral për rigjenerimin e një konservatorizmi të

institucionalizuar pas rënies së regjimeve komuniste (Kitschelt, 1995). Në Shqipëri, një kombinim unik faktorësh historikë e bëri këtë të pamundur. Këta faktore janë të shumta. Po përmendim disa prej tyre.

Më se pari është kryerja e një reforme radikale agrare dhe shkatërrimi i pronës private si pasojë e kësaj reforme. Reforma agrare e viteve 1945–1946 ishte ndër më radikale në Evropën Lindore: ajo jo vetëm që shpronësoi tokat e mëdha, por e goditi edhe shtresën e fermerëve të mesëm dhe çdo formë të pronësisë më të konsoliduar. Pas vitit 1960, kolektivizimi total i bujqësisë çoi në zhdukjen e pronës private në një shkallë që nuk u arrit as në Bashkimin Sovjetik. Shteti monopolizoi jo vetëm pronën, por edhe autoritetin social dhe simbolik. Ky proces shkuli nga rrenjet elitën tradicionale të fshatit. Ai fshihi kujtesën shoqërore të klasës pronare si një element legjitim i shoqërisë dhe shkaktoi një varësi totale të individëve nga shteti për mbijetesën ekonomike dhe statusin social. Në kontrast, në Poloni dhe Hungari mbijetoi bujqësia individuale e shkallës së vogël, që ruajti autonomi kulturore dhe mentalitetin konservator.

Një faktor tjetër madhor, po aq sa ccështja e pronës ndoshta edhe më i madh është shkatërrimi i institucioneve fetare dhe shoqërore. Në vende të tjera të rajonit, feja luajti rol themelor si rezervuar i kujtesës morale dhe kulturës konservatore. Në Shqipëri në vitin 1967, me shpalljen e “shtetit të parë ateist në botë”, çdo kishë, xhami, manastir u mbyll me dhunë. Kleri u përndoq, shumë figura fetare u burgosën ose u eliminuan. Dhjetëra hoxhallarë dhe priftërinj përnduan në burg, disa u pushkatuan dhe pjesa më e madhe u denigruan dhe u dërguan ose në internim ose në punë të rëndomta. Tradita fetare u demonizua si “prapambetje” dhe “armiqësi e klasës” apo mbetje obskurantiste sic e quante regjimi komunist.

Në këtë mënyrë, shoqëria shqiptare u nda për dekada nga feja, nga një prej themeleve të saj identitare, që në vende si Polonia (katolicizmi) apo Hungaria (katolicizmi dhe protestantizmi) kishin ruajtur një substrat konservator me ndikim politik të madh.

Një tjetër faktor ishte industrializimi i dobët dhe mungesa e borgjezisë urbane. Industrializimi i Shqipërisë nën komunizëm u krye jo mbi baza racionale të tregut, por mbi logjikën e autarkisë dhe prioritetit ideologjik. Ndryshe nga Çekosllovakia ose Polonia, që trashëguan shtresa të konsiderueshme teknokratike dhe menaxheriale me vetëdije klasore, Shqipëria nuk krijoi një borgjezi industriale autonome. Në vendin tonë nuk u zhvillua një klasë menaxheriale, apo një klasë le të themi profesionale me interes për stabilitetin ekonomik dhe respektin për rendin ligjor. Regjimi komunist bëri që vendi të mbqshtetej ashpërsisht dhe në gjithcka të struktura partiake dhe kontrolli policor mbi çdo sektor të prodhimit.

Faktor i rëndësishëm ishte edhe përndjekja e elitave dhe zhdukja e kujtesës kolektive, masakrimi i gjithckaje që kishte të bënte me trashëgiminë në dije, kulturë, histori. Në dekadat 1945–1990, politikat e internimeve, dëbimeve, përndjekjes së familjeve “armike” dhe propagandës agresive antklasore fshinë çdo kujtim pozitiv për aristokracinë dhe shtresat pronare. Kjo gjë krijoi një kulturë kolektive dyshimi ndaj çdo forme pasurie private dhe e shtyu shumicën e shoqërisë drejt një mentaliteti barazie dhe varësie, i cili u përplas me çdo ide të konservatorizmit klasik mbi autonominë dhe përgjegjësinë individuale.

E gjithë kjo do të krijonte siç krijoi pasoja serioze në ndërtimin e të djathtës pas vitit 1990. Në vitin 1990, Shqipëria mbërriti në pluralizëm pa shtresa shoqërore që të mund të mishëronin një të djathtë konservatore. Siç thotë edhe Elbasani (Elbasani ,2013) nuk ekzistonin as rrënjë kulturore, as përvoja institucionale, as shtresë e mesme që të mund të mishëronte një të djathtë konservatore në kuptimin klasik të fjalës.

Kësisoj Partia Demokratike u formua mbi një lloj revolte morale ndaj regjimit. Ajo pati, zgjodhi diskursin perëndimor dhe antikomunist dhe u mbështet relativisht shumë tek karizma e disa figurave intelektuale. Nuk pati as bazë pronësore, as institucione tradicionale, as trashëgimi kulturore konservatore. Ndaj, e djathta shqiptare u shndërrua në një lëvizje proteste, e cila me kalimin e kohës humbi koherencën ideologjike dhe përfundoi e fragmentuar.

Për të shohim modelet e tjera të Europës lindore dhe qendrore do të vërejmë dallime të ndjeshme. Në Poloni, Kisha Katolike, pronësia private në fshat dhe inteligjenca ishin baza për Lëvizjen Solidarnost dhe më pas për partitë konservatore si Platforma Civile. Në Hungari lidhjet e forta me Kishën të popullsisë, një shtresë menaxheriale urbane dhe kujtesa historike e aristokracisë krijuan terrenin për partinë opozitare të djathtë Fidesz. Në Rumani një pjesë e elitës së vjetër pronare u rikthye pas rënies së Nikola Ceaușescu-t, duke financuar media dhe parti konservatore. Në Shqipëri mungesa e këtyre strukturave solli një boshllëk ideologjik, që e mbushi thjesht antikomunizmi retorik dhe imitimi i modeleve perëndimore.

Është e qartë se kjo prodhoi, do të prodhonte patjetër, pasoja afatgjata. Ky boshllëk shoqëror dhe institucional pengoi krijimin e organizatave të qëndrueshme të djathta, ndihmoi personalizimin ekstrem të partive (sidomos rasti i PD-së dhe i Sali Berishës). Ai nxiti (dhe nxiti) fort varësinë e elektoratit nga premtimet afatshkurtra dhe klientelizmi, dobësoi kapacitetin e prodhimit të politikave konsistente konservatore dhe e bëri sistemin politik të ndjeshëm ndaj polarizimit dhe cikleve të paqëndrueshme.

Në traditën e teorisë së partive (Lipset & Rokkan, 1967; Kitschelt, 1995), formimi i një të djathte konservatore kërkon një bazë pronësore dhe kulturore, institucione religjioze dhe shoqërore autonome, kujtesë historike të elitave tradicionale.

Asnjë nga këto kushte nuk ekzistonte në Shqipëri. Prandaj, ndryshe nga shumë vende ish-komuniste, Shqipëria mbetet shembulli më i qartë i një tranzicioni të djathtë pa konservatorizëm, ku protesta antikomuniste nuk mundi të transformohej në një projekt politik me bazë reale shoqërore.

Kapitulli V: Struktura Sociale dhe Politike e Shqipërisë në Vitet 1945–1990: Analizë Teorike dhe Krahase nga Këndvështrimi i Ziblat

5.1 Shqipëria nën këndvështrimin e modelit të Daniel Ziblat

Siç është theksuar që në krye të herës, Daniel Ziblat, teoria dhe gjetjet e të cilit cili përbëjnë qendrën e gravitetit të këtij punimi, argumenton se stabiliteti demokratik ka qenë historikisht i varur nga sjellja e partive konservatore që përfaqësonin interesat e elitave tradicionale. Sipas tij,

në shumicën e vendeve evropiane, këto parti kanë luajtur një rol themelor në kanalizimin e kërkesave demokratike dhe në zbutjen e frikës së elitave ndaj masës popullore, duke i dhënë legjitimitet institucioneve parlamentare. Shqipëria përbën një rast që ka padyshim ngjyrimet e veta specifike, por që mund të shqyrtohet nën optikën e kësaj teorie. Në shumë aspekte, Shqipëria duket se përfaqëson një shembull “jashtë modelit të Ziblatt”. Në Shqipëri, mungesa e një elite konservatore të institucionalizuar dhe shkatërrimi totalitar i strukturës tradicionale shoqërore krijuan kushte krejtësisht të ndryshme për tranzicionin demokratik. Regjimi komunist i vendosur pas vitit 1944 jo vetëm që zhduk klasën aristokratike dhe borgjezinë tradicionale, por edhe minoi çdo vazdhimësi kulturore e institucionale që mund të shërbente si urë lidhëse midis së kaluarës dhe rendit të ri demokratik pas vitit 1990. Si rezultat, Shqipëria u përball me një tranzicion në të cilin nuk ekzistonte një e djathtë politike e strukturuar dhe as një parti konservatore që të përfaqësonte vazdhimësinë e elitave, duke e bërë më të brishtë kapacitetin e sistemit politik për të prodhuar konsensus dhe për të konsoliduar institucionet demokratike.

Në debatet bashkëkohore mbi natyrën e demokracisë dhe themelet e saj institucionale, rrallë herë u jepet vend i merituar atyre forcave shoqërore që për dekada me radhë u perceptuan si pengesë për emancipimin politik: elitave tradicionale, klasave pronare, konservatorizmit si refleks për të mbrojtur rendin ekzistues. Daniel Ziblatt, në veprën e tij *Conservative Parties and the Birth of Democracy*, sfidon këtë skemë të përçudnuar morale, duke argumentuar se stabiliteti i regjimeve demokratike nuk është produkt i thjeshtë i valës së modernizimit apo i triumfit të ideve progresiste, por një proces delikat kompromisesh, ku edhe elitat më skeptike ndaj demokracisë pranuan, shpesh nga frika, të bëhen pjesë e saj.

Në thelb, Ziblatt propozon një ide që tingëllon paradoksale. Ai thotë se forcat që natyrshëm druajnë nga demokracia, kanë një lloj frike prej saj, mund të bëhen garantët më të fortë të saj, me kusht që të kenë instrumentin e duhur për të mbrojtur interesat thelbësore. Ky instrument është partia konservatore e cila nuk është thjesht një grupim elektorale i përkoshhëm, por një arkitekturë e disiplinuar që kanalizojnë ankthet e elitave drejt pjesëmarrjes institucionale, jo drejt rrugës apo aventurës autoritare.

Ziblatt argumenton se për këtë transformim historik janë vendimtare dy parakushte. I pari, prania e një elite tradicionale të konsoliduar, që e sheh rendin ekzistues si burim legjitimiteti, sigurie dhe stabiliteti shoqëror. I dyti, krijimi i një partie të organizuar konservatore, e aftë të prodhojë një kompromis të heshtur. Sipas tij demokracia pranohet si mjet kontrolli, jo si akt i dorëzimit pa kushte. Kjo është arsyeja pse demokracia britanike, për shembull, nuk u ndërtua mbi shkatërrimin e aristokracisë, por mbi transformimin gradual të saj në elitë parlamentare.

Në Britani, siç e kemi theksuar edhe më parë, Partia Konservatore u bë korniza institucionale për të mundësuar këtë gjë. Aristokracia e vjetër rurale dhe borgjezia urbane, në vend që të mbylleshin në refuzim arrogant, vendosën të operojnë brenda rregullave të lojës elektorale. Ky kompromis kishte karakter transaksional: në këmbim të pjesëmarrjes, sistemi u garantonte mbrojtjen e pronës dhe vijimësinë e hierarkisë shoqërore. Zgjerimi i të drejtës së votës nuk solli përmbysje revolucionare pikërisht sepse konservatorët ishin aty për të amortizuar tensionet. Demokracia britanike, ndryshe nga mitologjia progresiste, nuk u ngrit mbi krahët e një

iluminizmi të pastër moral, por mbi një marrëveshje të heshtur. Në një farë mënyre rendja drejt së ardhmes nuk duhej të shkatërronte themelet e së kaluarës.

Në Gjermani, ndodhi e kundërta. Junkerët e Prusisë nuk ndërtuan kurrë një forcë të disiplinuar konservatore që t'i integronte në rendin parlamentar. Ata preferuan të instrumentalizonin pushtetin shtetëror, të ruanin privilegjet përmes manipulimeve zgjedhore dhe të pengonin çdo kompromis real me partitë liberale apo socialdemokrate. Ky obstrukcion permanent e helmonte politikën publike, krijonte një kulturë të urrejtjes reciproke dhe hapte rrugë për zgjidhje autoritare. Demokracia gjermane nuk u rrëzua sepse kishte shumë demokraci, por sepse konservatorizmi nuk pranoi kurrë të bëhej demokratik.

Në Austri dhe Itali, historia mori trajta akoma më dramatike. Refuzimi i elitave tradicionale për të pranuar pluralizmin e ri politik, paaftësia për të ndërtuar një parti konservatore të përgjegjshme dhe tendenca për të mbështetur populistë e aventurierë politikë e çuan sistemin drejt fashizmit. Në vend që ti vendosnin frerë radikalizmit, elitat konservatore përfunduan si mbështetësit apo sponsorët e tij.

Nga ky lexim i Ziblatt-it, buron një mësim i rëndësishëm që do të thotë se demokratizimi nuk është triumf moral, por menaxhim i frikës. Demokracia konsolidohet vetëm kur edhe ata që i tremben asaj gjejnë mekanizma për t'u ndjerë të mbrojtur brenda sistemit të ri. Ky është një dimension shpesh i harruar në ligjërimin publik, i cili preferon narrativën e thjeshtë. Pra një kamp progresist që lufton për përparim dhe një kamp konservator që e pengon. Në realitet, çdo demokraci e qëndrueshme është rezultat i një marrëveshjeje të vështirë. Progresistët pranojnë kufizimin gradual të ndryshimeve radikale, ndërsa konservatorët heqin dorë nga privilegjet e tyre absolute në këmbim të pjesëmarrjes.

Nëse sot shumë vende bien në kurthin e polarizimit, kjo ndodh shpesh sepse konservatorizmi ose mbetet i pazhvilluar si forcë institucionale, ose reduktohet në populizëm revanshist. Një konservatorizëm pa vetëdije institucionale është gjithmonë rrezik. Por një demokraci që përjashton me arrogancë ndjeshmëritë konservatore, është një sistem i paaftë të sigurojë stabilitet afatgjatë.

Në librin e tij “Conservative Parties and the Birth of Democracy”, Daniel Ziblatt, siç e kemi thënë edhe më lart, argumenton se stabiliteti i demokracive europiane gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX ka qenë në mënyrë vendimtare i lidhur me sjelljen dhe rolin e elitave konservatore të trashëguara. Në këtë model, elitat aristokratike dhe pronarët e mëdhenj, përballë rritjes së presionit demokratizues, zgjedhën që, në disa raste, të integrohen në sistemin e ri përmes krijimit të partive konservatore që institucionalizuan konkurrencën politike dhe ruajtën disa interesa dhe privilegje. Në vende si Britania apo Suedia, kjo qasje kontribuoi në ndërtimin e demokracive të qëndrueshme dhe të konsoliduara. Ndërkohë, aty ku elitat refuzuan adaptimin dhe përqaftuan strategji obstrukcionista si në Gjermani, Austri apo Itali pasojat ishin polarizimi ekstrem, autoritarizmi ose fashizmi.

5.2 Shqipëria para luftës së dytë botërore dhe pas saj

Por historia moderne shqiptare përbën një rast thuajse unik në Evropë, sepse as nuk pati ndonjë elitë konservatore të trashëguar të stabilizuar, as nuk zhvilloi ndonjë instrument politik të saj që të luante rol institucionalizues në periudhën e tranzicionit demokratik. Ky boshllëk historik e shpjegon pjesërisht brishtësinë e demokracisë shqiptare pas vitit 1990 dhe natyrën e saj të thellësisht personalizuese dhe klienteliste. Shqipëria para Luftës së Dytë Botërore kishte struktura sociale shumë të brishta dhe kishte mungesë të një aristokracie të stabilizuar.

Në ndryshim nga vendet që studioi Ziblatt, Shqipëria moderne nuk trashëgoi një klasë aristokratike apo një shtresë të lartë pronarësh të fuqishëm me traditë shekullore. Kjo ndodhi për disa arsye strukturore. Së pari deri në fillim të shekullit XX, vendi ishte pjesë e Perandorisë Osmane, ku decentralizimi administrativ, sistemi i timarit dhe kultura politike e fisit e penguan konsolidimin e një shtrese të ngjashme me pronarët e mëdhenj anglezë të tokave (me latifondistët anglezë) apo junkerët prusianë. Së dyti siç vë në dukje edhe Miranda Vickers (Vickers, 1995), shoqëria shqiptare mbeti e organizuar në linja klanore dhe fisnore, ku fuqia politike dhe autoriteti shoqëror rridhnin më shumë nga besnikëritë e gjakut sesa nga ndonjë institucion modern ose nga posedimi i një prone të madhe tokësore të garantuar me të drejta ligjore të qarta. Së treti mbretëria e Ahmet Zogut (1928–1939) ndërmori përpjekje për modernizimin dhe krijimin e një administrate kombëtare, por projekti u pengua nga varësia ndaj Italisë, konfliktet e brendshme politike dhe mungesa e një tradite parlamentare të mirëfilltë.

Këto faktorë krijuan një strukturë sociale krejt të ndryshme nga ajo e vendeve ku partitë konservatore shërbyen si "urë" midis elitës tradicionale dhe rendit demokratik. Shqipëria, që në fillim, kishte një vakum elitar.

Nga ana tjetër komunizmi kreu një shkatërrim sistematik të çdo elite tradicionale. Nëse periudha e para Luftës së Dytë Botërore krijoi kushte për mungesën e elitave të stabilizuara, regjimi komunist i Enver Hoxhës e institucionalizoi këtë boshllëk. Nga viti 1944 deri më 1990, Shqipëria kaloi nga një vend me disa struktura fisnore në shtetin më monist, më të izoluar dhe më totalitar të Evropës. Kjo periudhë pati katër elemente thelbësorë.

1. Shpronësimi i bejlerëve dhe pronarëve të mëdhenj. Brenda pak viteve, prona private u kolektivizua dhe u zhduk baza materiale që mund të krijonte pavarësi shoqërore. Ashtu si në Rusi pas revolucionit bolshevik, pronarët shqiptarë u cilësuan "armiq të klasës" dhe u dëbuan ose u asgjësuan politikisht.
2. Persekutimi i klerit: Kisha katolike, ortodokse dhe komunitetet bektashiane përfaqësonin jo vetëm autoritet shpirtëror, por edhe kapital simbolik konservator. Në mënyrë sistematike, regjimi i eliminoi ose i burgosi krerët e këtyre institucioneve.
3. Ndërpërja totale e trashëgimisë pluraliste: Në shumë vende ish-komuniste, si Polonia apo Hungaria, ekzistonin rrjete klandestine kulturore ose fetare që ruanin një farë vazhdimësie historike. Shqipëria u shkëput nga çdo formë kontakti me Perëndimin.
4. Izolimi ekstrem: Pas prishjes me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe më pas Kinën, Shqipëria u bë de facto një vend i rrethuar nga armiq dhe i mbyllur, ku çdo ide e "reaksionit konservator" u kriminalizua.

Në përfundim të viteve '80, Shqipëria kishte jo thjesht një mungesë elite tradicionale, por një kulturë politike ku vetë koncepti i konservatorizmit ishte një herezi e rrezikshme.

5.3 Shqipëria pas vitit 1990

Pasi ra komunizmi në vitin 1990 vendi u gjend përpara fakti që nuk kishte as “konservatorë” dhe as institucione ndërmjetëse. Në dekadat që pasuan rënien e komunizmit, vendet e Europës Qendrore dhe Lindore përjetuan tranzicione ku elitat e vjetra, kleri apo parti konservatore të krijuara mbi rrjete historike morën pjesë aktive në stabilizimin e konkurrencës politike. Në Poloni, për shembull, Kisha Katolike luajti rol thelbësor si autoritet moral dhe institucion konservator që amortizoi polarizimin. Në Hungari, Partia e Fidesz fillimisht pati frymëzim liberal, por më pas trashëgoi shumë elemente të identitetit konservator hungarez.

Në Shqipëri, përkundrazi elitat politike të tranzicionit ishin ose produkte të drejtpërdrejta të Partisë së Punës, të konvertuara në socialistë, ose figura të reja pa rrënjë në ndonjë kulturë institucionale konservatore. Shoqëria civile ishte embrionike, e dobët dhe e fragmentuar. Pronësia private ishte e shkatërruar, duke bërë që vetë koncepti i interesit të trashëguar social apo pronësor të mos ekzistonte.

Ky kontekst shpjegon pjesërisht dy dukuri. Shpejgon personifikimin ekstrem të politikës, ku lidershipi karizmatik u kthye në element qendror dhe mungesën e partive konservatore të institucionalizuara, të krahasueshme me Partinë Konservatore Britanike apo Partinë Popullore Spanjolle.

Në terma të modelit të Ziblatt, kushti i parë që është prania e elitave konservatore që zgjedhin integrimin mungonte në mënyrë absolute. Për rrjedhojë, Shqipëria nisi rrugën demokratike me një boshllëk që prodhoi polarizim të qëndrueshëm, kapje të institucioneve dhe një cikël kriza legjitimiteti.

Nëse Ziblatt argumenton se një nga motorët e demokracisë së konsoliduar është transformimi i elitës konservatore në aktor politik brenda rregullave të lojës, Shqipëria përfaqëson një rast eksperimental: çfarë ndodh kur kjo elitë nuk ekziston?

Historia e tre dekadave të fundit sugjeron se mungesa e trashëgimisë konservatore ka dobësuar themelet e pluralizmit, se shoqëria ka mbetur e ekspozuar ndaj lëvizjeve populiste dhe cikleve të krizës dhe se politika është personalizuar në dëm të ndërtimit institucional.

Ky rast tregon se trashëgimia historike e elitave nuk është thjesht një çështje nostalgjie ose simbolike, por një faktor real që ndihmon në stabilizimin e konkurrencës politike dhe në legjitimin e rendit demokratik.

Rënia e regjimit totalitar shqiptar në fund të vitit 1990 u shoqërua me një transformim të paprecedent institucional dhe kulturor. Ndryshe nga shumë vende të Europës Qendrore dhe Lindore, Shqipëria nuk zotëronte asnjë trashëgimi pluraliste të ruajtur në sipërfaqen e diktaturës. Për më tepër, ajo vinte nga një izolim ekstrem, ku homogjenizimi ideologjik ishte shndërruar në bazë të identitetit kolektiv dhe ku çdo formë e autonomisë shoqërore ishte eliminuar në rrënjë (Vickers, 1995).

Në modelin krahasues të Daniel Ziblatt (Ziblatt, 2017), demokracia parlamentare në Europë është stabilizuar në rastet kur elitat tradicionale, të përfaqësuara nga parti konservatore, kanë zgjedhur të integrohen në procesin demokratik në vend që ta minojnë atë. Shembulli i Partisë Konservatore britanike, që pas vitit 1867 ndërtoi një strategji për të ruajtur pozitat e saj përmes pjesëmarrjes zgjedhore, ose rasti i Partisë së Djathtë Suedeze, që pranoi kompromisin demokratik në fillim të shekullit XX, demonstrojnë se kapaciteti i elitave konservatore për të institucionalizuar konkurrencën politike ishte vendimtar për tranzicionin e suksesshëm (Ziblatt, 2017).

Në Shqipëri, ky kusht thelbësor mungoi krejtësisht. Partia Demokratike, e themeluar në dhjetor 1990, nuk ishte një parti konservatore në kuptimin klasik të fjalës. Ajo lindi si një lëvizje e gjerë anti-komuniste, që bashkonte ish-funksionarë të Partisë së Punës me intelektualë kritikë dhe studentë që nuk kishin eksperiencë politike (Pano, 1992). Ky bashkim nuk përfaqësonte as një klasë pronarësh të mëdhenj sepse ajo ishte asgjësuar që pas reformës agrare të viteve '40 dhe as një traditë konservatore institucionale, e cila mund të kishte luajtur rol stabilizues.

Nga ana tjetër, Partia Socialiste trashëgoi strukturat, asetet, arkivin, dhe kulturën organizative të Partisë së Punës. Ndryshimet ishin më tepër nominale se substanciale. Partia e re socialiste mbeti e mbështetur mbi një klientelizëm të trashëguar dhe kapacitete organizative që asnjë aktor tjetër politik nuk i dispononte (Elbasani, 2013).

Në këtë kontekst, pluralizmi politik nuk u ngrit mbi ndërthurjen e interesave të ndryshme shoqërore, siç ndodhi në rastin e Gjermanisë Perëndimore pas 1945, ku partitë e qendrës dhe të djathtës përfaqësonin segmente reale të shoqërisë (Kitschelt, 1994). Përkundrazi, në Shqipëri u krijua një sistem ku partitë ishin më shumë produkte të lëvizjes së momentit dhe figurave karizmatike, sesa rezultat i një procesi organik institucionalizimi politik.

Edhe partitë e vogla që u krijuan gjatë viteve '90 nuk e mbushën këtë boshllëk. Në pjesën më të madhe, ato ishin formacione klienteliste ose iniciativa të lidershit individual, që përpiqeshin të përfitonin nga fragmentimi i skenës politike. Ky konfigurim bëri që konkurrenca elektorale të mos ketë një dimension të thellë ideologjik, por të mbetet e varur nga koalicionet pragmatiste dhe retorika e polarizuar.

Për këtë arsye, kushti i dytë i modelit të Ziblatt, ekzistenca e një partie konservatore koherente si garant i stabilitetit demokratik nuk u realizua në Shqipëri. Pasojat e kësaj mungese u bënë të dukshme: një cikël i përsëritur krizash politike, mungesë konsensusi për institucionet kyçe, bojkot të vazdheshëm parlamentar dhe kapje selektive e institucioneve nga aktorët dominues (Bieber, 2020).

Në përfundim, rasti shqiptar dëshmon qartë se demokratizimi nuk është vetëm çështje dizajni kushtetues. Për të ndërtuar një sistem pluralist të qëndrueshëm, është i domosdoshëm një kapital social dhe kulturor, një strukturë e polarizuar e interesave dhe një aftësi e elitave për të përfaqësuar e kanalizuar konfliktin shoqëror brenda rregullave demokratike. Në mungesë të këtyre elementeve, demokracia mbetet një format procedural i brishtë, i rrezikuar nga krizat ciklike dhe mosbesimi kronik.

Tranzicioni demokratik shqiptar pas vitit 1990 përbën një ilustrim të qartë të asaj që literatura e demokratizimit e quan një proces “i pakompletuar” dhe “i paankoruar” (Linz & Stepan, 1996). Në kontrast me modelet klasike europiane, ku demokratizimi lindi si rezultat i një marrëveshjeje mes elitave të vjetra konservatore dhe forcave reformiste, Shqipëria hyri në pluralizëm politik në kushtet e një boshllëku të thellë institucional, shoqëror dhe simbolik. Ky boshllëk ishte pasojë e drejtpërdrejtë e shkatërrimit sistematik të çdo elite tradicionale gjatë periudhës së regjimit komunist.

Gjatë katër dekadave të sundimit totalitar (1944–1990), shteti shqiptar nuk u kufizua thjesht në kolektivizimin e ekonomisë dhe suprimimin e opozitës politike. Ai ndërmori një fushatë të qëllimshme shfarosjeje të strukturave tradicionale të autoritetit: pronarët e mëdhenj u shpronësuan, aristokracia rurale u likuidua ose u internua, kleri katolik dhe ai mysliman u përndoqën, dhe çdo formë e organizimit shoqëror jashtë Partisë së Punës u ndalua me ligj (Vickers, 1995). Për pasojë, kur regjimi komunist ra, Shqipëria nuk trashëgoi asnjë klasë konservatore që mund të kishte mbajtur gjallë një kulturë ndërmjetësimi politik dhe përfaqësimi pluralist.

Ky realitet e bëri demokratizimin shqiptar thelbësisht të ndryshëm nga rastet që studion Ziblatt (2017). Në Britani, për shembull, Partia Konservatore luajti një rol kritik si instrument i akomodimit të reformave demokratike. Përballë kërcënimit nga radikalizmi i liberalëve dhe i lëvizjes punëtore, elitat tradicionale pronare pranuan zgjerimin gradual të së drejtës së votës për të ruajtur stabilitetin dhe për të mbrojtur interesat e tyre ekonomike në një sistem të kontrolluar institucionalisht. Siç thekson Ziblatt, ky kompromis i ndërmjetësuar nga partitë konservatore “i lejoi demokracisë të lindë jo si akt revolucionar, por si produkt i adaptimit të elitave” (Ziblatt, 2017). Po kështu, në Suedi, aristokracia rurale e organizuar në parti të djathta pranoi reformat elektorale si mekanizëm për të shmangur polarizimin dhe konfliktin social (Berman, 2006).

Në Shqipëri, ndërkaq, zgjedhjet e para pluraliste të viteve 1991–1992 u zhvilluan në një klimë varfërie ekstreme, tensioni të lartë politik dhe frike të thellë ekzistenciale për të ardhmen. Për shumicën e qytetarëve, pluralizmi nuk u perceptua si një proces negociate midis elitave, por si një shkundje e dhunshme e sistemit ekzistues pa garanci për stabilitet (Elbasani, 2013). Kjo klimë e prodhoi modelin ciklik të krizës së legjitimitetit: bojkotet parlamentare, mosnjohja e zgjedhjeve, dhe konfrontimi i përhershëm u bënë pjesë e normales politike (OSCE/ODIHR, 1997; Bieber, 2018).

Në këtë kuptim, mungesa e një pale konservatore të trashëguar nuk ishte thjesht një detaj historik: ajo ishte shkaku strukturor i paaftësisë së sistemit për të ndërtuar mekanizma konsensualë dhe për të kanalizuar konkurrencën në rregulla të pranueshme nga të gjithë aktorët. Në rastet e përmendura nga Ziblatt, partitë konservatore përfaqësonin më shumë se një program ideologjik: ato ishin institucione mbështetëse të rendit shoqëror dhe të stabilitetit. Në mungesë të tyre, Shqipëria u detyrua të ndërtojë pluralizmin mbi baza ad hoc, me aktorë politikë të rinj që shpesh nuk kishin as kapital simbolik, as rrënjë reale shoqërore.

Ky paradoks ndihmon të kuptohet pse, ndonëse forma institucionale e demokracisë u instalua relativisht shpejt me pluralizëm partiak, zgjedhje periodike dhe retorikë të integritetit evropian përmbajtja e konkurrencës demokratike mbeti e brishtë dhe e varur nga kontingjencat e momentit

politik. Në mungesë të një elite konservatore që të ushtronte presion për kompromis, partitë e reja e perceptuan konfrontimin si mjet të natyrshëm të legjitimitetit dhe rezistencës ndaj kundërshtarit. Si rezultat, për më shumë se tri dekada, politika shqiptare u shënua nga cikle të përsëritura krizash përfaqësimi, polarizimi ekstrem dhe tension social.

Rasti shqiptar duket se mbetet një ilustrim i një tranzicioni demokratik ku elementët e jashtëm të rendit pluralist u imponuan me shpejtësi, por nuk gjetën infrastrukturë shoqërore dhe institucionale të aftë për t'i mbështetur. Në kontrast me rastet britanike apo skandinave, Shqipëria nuk kishte një elitë konservatore që të luante rolin e “gardianit të rendit” (Ziblatt, 2017) dhe të garantonte kalimin gradual nga autoritarizmi në një konkurrencë politike të stabilizuar. Për pasojë, demokracia shqiptare mbetet ende, në shumë aspekte, një rend formal i paankoruar, ku kompromisi është më tepër përjashtim sesa rregull.

5.4 Kompromisi i munguar konservator në Shqipëri

Në teorinë e Ziblatt, kompromisi konservator u zhvillua ose zhvillohet si një proces relativisht autonom i transformimit të elitave kombëtare. Në Shqipëri, procesi i demokratizimit nuk e kishte këtë autonomi. Përkundrazi, ciklet e krizës politike, zgjedhjet e kontestuara, bojkoti i institucioneve, kolapsi i rendit shtetëror në vitin 1997, prodhuan një varësi të thellë nga aktorët ndërkombëtarë si OSBE, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara.

Në mungesë të elitave të interesuara për stabilitetin institucional, kompromisi politik u imponua nga jashtë dhe shpesh mbeti sipërfaqësor. Demokracia funksiononte si një ritual formal, jo si një kulturë e brendshme e negociatës për ruajtjen e rendit. Kjo varësi u përsërit edhe më vonë, si në krizën e vitit 2009 apo në bojkotin e mandateve në 2019. Ky tipar i “demokracisë së ndërhyrjes” tregon se kur mungon kontinuiteti institucional dhe baza sociale e kompromisit, procesi demokratik mbetet i brishtë dhe i prekshëm nga ciklet e krizës.

Rasti shqiptar sfidon qartësisht përfytyrimin se demokratizimi është kryesisht produkt i transformimit të elitave konservatore. Në shoqëritë ku historia ka ndërprerë çdo vijimësi pronësore, institucionale dhe kulturore, kompromisi konservator nuk mund të luajë rol themelor. Ky boshllëk e bën procesin e demokratizimit të varur nga faktorët e jashtëm dhe e rrezikon stabilitetin afatgjatë.

Kjo përvojë sugjeron domosdoshmërinë për teori më gjithëpërfshirëse të demokratizimit, që të shpjegojnë jo vetëm rastet e kompromisit të suksesshëm konservator, por edhe ato ku historia e dhunshme dhe shkatërrimi totalitar e bëjnë pamundur riprodhimin e një modeli evropian klasik. Vetëm duke kuptuar këto kontekste specifike mund të zhvillojmë paradigma teorike që nuk reduktohen në një histori lineare të transformimit të elitave.

Shqipëria pas vitit 1990 është një lloj laborator ku praktika e improvizimit politik ka zëvendësuar çdo mundësi të një konservatorizmi të vërtetë si garant i stabilitetit demokratik. Për

të qenë më të qartë, duhet të kuptojmë si ndodh që një vend që nuk trashëgon as klasë aristokratike, as hierarki tradicionale, as institucione të përhershme, megjithatë pretendon të prodhojë një retorikë të konservatorizmit që pretendon stabilitetin dhe rendin, ndonëse nuk e mbështet dot me kapital simbolik e material.

Në librin e tij themelore “Conservative Parties and the Birth of Democracy”, Ziblatt (Ziblatt, 2017) argumenton se stabiliteti demokratik në Evropën Perëndimore nuk ka qenë produkt i një fryme iluministe, apo të iluminuar, spontane, por pasojë e një kompromisi historik të dhimbshëm, ku elitat pronare – të trembura nga mundësia e revolucionit – pranuan zgjerimin gradual të pjesëmarrjes politike, duke ruajtur përmes institucioneve të reja bazën e pushtetit dhe pasurisë së tyre (Ziblatt, 2017). Ky model është i dukshëm në rastin britanik, ku Partia Konservatore (Tories) gjatë shekullit XIX pranoi reformat zgjedhore për të ruajtur ndikimin mbi klasën punëtore përmes patronazhit dhe kontrollit lokal (Moore, 1966). Po kështu, në Suedi, kompromisi midis elitarëve agrarë dhe socialdemokratëve solli integrimin gradual të shtresave të ulëta pa shkatërruar themelet e rendit ekonomik (Berman, 2006).

Por Shqipëria nuk kishte as bejlerë të mbijetuar pas Luftës së Dytë Botërore, as borgjezi industriale të konsoliduar, as institucione të autonomisë lokale. Ligji i Reformës Agrare i vitit 1946 dhe kolektivizimi i plotë i pronës (Vickers, 1995) zdhukën çdo mundësi për trashëgimi sociale që të mbështeste një projekt konservator. Kështu, kur në vitet 1990 Partia Demokratike – një koalicion i gjerë antikomunistësh, intelektualësh që vinin nga komunizmi ose ishin pjesë e elitës intelektuale të komunizmit, ish-të përndjekurish dhe teknokratësh u përpoq të ndërtonte një diskurs stabiliteti, ajo u detyrua ta mbështeste atë vetëm mbi elemente retorike dhe simbolike dhe jo mbi baza reale të pronës, zotërimit të pronës, pronarëve apo të psushtetit. Në këtë pikë qëndron thelbi i konservatorizmit të improvizuar i cili ishte një përpjekje për të imituar rolin historik të konservatorizmit perëndimor, pa pasur kontekstin historik që ia jepte kuptimin dhe koherencën.

Mjafton të krahasohet Shqipëria me Poloninë apo Hungarinë. Në këto vende, procesi i tranzicionit postkomunist u mbështet, mes të tjerash, mbi trashëgiminë e pronës private dhe të rendit social para-komunist, që mundësoi ringritjen e hierarkive tradicionale. Në Poloni, për shembull, shumë familje që kishin humbur pronat gjatë kolektivizimit i rikthyen pas vitit 1989 përmes proceseve të rehabilitimit juridik (Ekiert, 1996). Kjo krijoi një klasë konservatore rurale që e identifikonte demokracinë me rikthimin e statusit historik. Në Shqipëri, procesi i privatizimit të tokës dhe banesave i miratuar me Ligjin nr. 7501, në mes të korrikut të 1991 nuk riktheu pronën tek ish-pronarët përkundrazi njohu në një farë mënyre grabitjen e saj gjatë komunizmit. Ai ligj e ndau tokën sipas kriterëve të përdorimit, duke fragmentuar strukturën e pronësisë dhe duke prodhuar konflikte afatgjata. Për rrjedhojë, asnjë grup nuk mundi të vetë-përkufizohej si elitë konservatore e ligjshme.

Në këtë boshllëk historik e shoqëror, konservatorizmi i improvizuar shqiptar mori formën e një projekti retorik, që kombinonte slogane mbi “rendin”, “familjen”, “kombin”, “identitetin europian” dhe “pronarët e dikurshëm”, por që nuk përkthehej dot në politikë reale konsolidimi. Kriza e vitit 1997 me shpërbërjen e rendit publik, vjedhjen e armatimeve dhe rënien e pushtetit qendror – është dëshmia më e qartë se ky konservatorizëm ishte një fasadë e brishtë. Në harkun e pak javëve, institucionet u shembën, autoriteti shtetëror u reduktua në zero, ndërsa aktorët

politikë që shfaqeshin si mbrojtës të rendit u tërhoqën nga skena, duke lënë pas një shoqëri të traumatizuar dhe një humbje totale besimi në diskursin e stabilitetit.

Ky model i improvizimit politik u përsërit, me modifikime, në periudhat e mëvonshme. Pas vitit 2005, Partia Demokratike ndërtoi një kombinim klientelizmi dhe modernizmi infrastrukturual si përpjekje për të krijuar imazhin e një autoriteti konservator. Investimet e mëdha publike si ndërtimi i autostradës Durrës–Kukës dhe retorika mbi integrimin europian ishin pjesë e kësaj skeme për të rikrijuar një rend shoqëror që nuk kishte themele reale. Brenda logjikës së Ziblatt-it, do të thoshim se ky ishte një imitim pa substancë, sepse ai nuk mbështetej mbi asnjë klasë të interesuar të ruante status quo-në përmes institucioneve demokratike (Ziblatt, 2017).

Në planin kulturor, ky konservatorizëm i improvizuar u mbështet në fetishizimin e simbolikës kombëtare, kultin e flamurit, identitetin iliro-epirot dhe retorikën europiane, për t'i dhënë shoqërisë shqiptare një narrativë kuptimplotë të stabilitetit. Por, siç do të thoshte Eric Hobsbawm (Hobsbawm, 1983), traditat e shpikura kanë jetë të shkurtër kur nuk përputhen me strukturën reale të shoqërisë. Shqipëria mbeti një vend i polarizuar, i fragmentuar ekonomikisht dhe i paafte për të prodhuar një konsensus të gjerë mbi rendin politik.

Nëse kërkojmë një përkufizim të qartë, mund të themi se konservatorizmi i improvizuar shqiptar ishte një performancë politike e detyruar nga boshllëku historik, ishte një ritual për të imituar Europën, për të mbuluar krizat ciklike dhe për t'i dhënë publikut idenë se demokracia kishte garantë stabilitet. Por në mungesë të një klase pronare që ta prodhonte këtë stabilitet si interes vetjak, projekti mbeti një simulakër pa thelb, një fasadë që shembej sa herë përplasej me realitetin e krizës strukturore të shtetit dhe shoqërisë shqiptare.

Në fund të fundit, Shqipëria është ndoshta prova më e qartë se demokratizimi nuk mund të mendohet vetëm si transplantim institucionesh, por është proces historik që kërkon një korrespondencë midis interesave ekonomike, identiteteve kulturore dhe arkitekturës politike. Në mungesë të kësaj korrespondence, ajo që mbetet është vetëm një konservatorizëm i improvizuar, një kujtesë e trishtueshme se retorika nuk mund të zëvendësojë historinë.

5.5 Raste krahasimore me Shqipërinë, Rumania

Rumania është saktësisht një shembull i asaj që njihet si “demokracia thellësisht e çrrënjësuar nga tradita.” Rumania është ndër ato vende të Europës Lindore ku historia moderne ka ndjekur rrugë aq të dhunshme e të ndërprera, sa që përpjekja për të gjetur në të një logjikë organike të zhvillimit politik bëhet një akt gati i pamundur. Çdo etapë historike, nga modernizimi i vonuar i monarkisë, tek instalimi i komunizmit pas Luftës së Dytë Botërore, e deri tek shpërbërja brutale e regjimit të Ceaușescu, ka prodhuar jo kontinuitet institucional, por shpërbërje traumatike. Në këtë kuptim, modeli teorik i Ziblatt (Ziblatt, 2017), i ndërtuar mbi parakushtin se demokracia konsolidohet kur elitat konservatore e institucionalizojnë kompromisin politik për të mbrojtur interesat e tyre, e ka të pamundur të aplikohet pa modifikime të thella.

Në fillimet e shekullit XX, Rumania kishte një aristokraci të fuqishme latifondiste dhe një borgjezi që u përpoq të ndërtonte struktura moderne shtetërore. Por këto shtresa, të rrënjosura kryesisht në jug dhe në Transilvani, nuk patën as koherencën e konservatorizmit britanik, as vetëdijen e elitës prusiane. Për më tepër, nacionalizmi integral i periudhës ndërmjet dy luftërave krijoi një kulturë politike më tepër autoritare sesa kompromisi konservator (Heinen, 1986).

Me ardhjen e komunizmit në vitin 1947, projekti i shtetëzimit të gjithçkaje u bë pothuaj total. Ky projekt përfshiu kolektivizimin e bujqësisë, shtetëzimin e pronës urbane, ndalimin e partive politike jo-komuniste, represionin ndaj xhamisë dhe kishës, dmth luftën totale ndaj besimit fetar, dhe ndëshkimin ei inteligjencës tradicionaliste. Siç e përshkruan Tismăneanu (Tismăneanu, 1998), komunizmi rumun u shqua për një radikalizëm veçanërisht të dhunshëm në zdhukjen e çdo autonomie shoqërore. Aristokracia dhe borgjezia nuk mbijetuan si grupe influente as në formë simbolike. Kjo ishte mënyra dhe ky ishte pikërisht momenti kur prerja e traditës u bë mjete për të ndërtuar strukturën e re e shoqërisë.

Kur regjimi i Ceașescu u rrëzua më 1989, asnjë element i trashëguar konservator nuk u rikthye. Fronti i Shpëtimit Kombëtar (FSN) ishte një formacion i përbërë në masë të madhe nga ish-funksionarë komunistë, burokratë të nivelit të mesëm dhe aparate sigurimi që ndryshuan vetëm retorikën politike. Siç shkruan Gallagher (Gallagher, 2005), ky fenomen i quajtur “neo-komunizëm elektorale” krijoi një demokraci ku garancia e stabilitetit nuk erdhi nga kontinuiteti i elitave konservatore, por nga kapaciteti i aparatit të vjetër për t’u transformuar dhe mbijetuar politikisht.

Në anën tjetër, opozita antikomuniste, Partia Kombëtare Liberal-Demokrate, Partia Christian-Demokrate dhe grupimet e disidentëve, ishte e fragmentuar, e dobët dhe shpesh më tepër një lëvizje moraliste sesa një forcë me rrënjë sociale. Kjo opozitë nuk trashëgoi struktura ekonomike, rrjete klienteliste, apo traditë autoriteti social që do t’i jepnin një formë konservatorizmi institucional, si në rastin britanik apo suedez. Siç thekson Linz dhe Stepan (Linz & Stepan, 1996), në shumicën e vendeve të Lindjes komuniste, dobësia e traditave pluraliste dhe çrrënjësja e elitave tradicionale e bënë shumë të vështirë zhvillimin e një kulture demokratike të konsoliduar.

Në dekadat e mëvonshme, demokracia rumune ka qenë e shoqëruar nga polarizimi ekstrem, nga cikle të përsëritura krizash institucionale dhe një mosbesim kronik ndaj proceseve zgjedhore. Protestat e vitit 2012 kundër qeverisë dhe tensionet me Gjykatën Kushtetuese, bojkoti i parlamentit nga opozita, referendumi për shkarkimin e presidentit Basescu treguan se institucionet nuk janë ndërtuar dhe sigurisht as përjetuar si hapësirë e kompromisit, por si armë e luftës totale politike (Stan & Vancea, 2015).

Këto zhvillime e bëjnë Rumaninë një shembull të qartë të të qenit jashtëmodelit të Ziblatt. Në mungesë të një konservatorizmi të organizuar, që të mbrojë status quo-në përmes pranimi të rregullave demokratike, tranzicioni politik mbeti një proces i fragmentuar, episodik dhe i pasigurt. Demokracia rumune, njësoj si ajo shqiptare, nuk pati një arkitekturë të ndërtuar mbi kompromisin e elitave tradicionale, por u themelua mbi improvizimin dhe mbi mbetjet e një rendi të dështuar totalitar.

Prandaj, Rumania nuk është një rast anekdotik. Ajo përfaqëson një tipologji të veçantë historike, ku shoqëritë që kalojnë nëpër një shkatërrim sistematik të trashëgimisë institucionale janë të destinuara të luftojnë gjatë për të gjetur stabilitetin demokratik. Ky fakt vë në pikëpyetje një pjesë të madhe të teorive universalizuese mbi tranzicionin demokratik, të cilat nënvlerësojnë dimensionin e historisë shkatërruese dhe boshllëkut të trashëgimisë politike.

Në fund, Rumania është kujtesë e zymtë se, ndonjëherë, demokracia mund të ekzistojë vetëm si një seri aktesh të përkoshme, të brishta, ku asnjë kulturë e thellë kompromisi nuk garanton vazdhimësinë. Dhe se në mungesë të një konservatorizmi të institucionalizuar, edhe demokracia është përherë një eksperiment i paplotë.

5.6 Rast krahasimor me Shqipërinë, Bullgaria

Ndërkohë që Bullgaria megjithë shumë ngjashmëritë me rastrin rumun ka edhe dallime të dukshme. Sicc e kemi thënë shpesh teza e Ziblat ka në qendër idenë se demokracia liberale nuk ka lindur si përkthim spontan i ndonjë morali universal, por si produkt i frikës, interesave të klasave të vjetra dhe strategjive të mbijetesës së elitave konservatore. Po ashtu Ziblat na bën me dije se institucionet përfaqësuese, zgjerimi i votës dhe kompromisi politik janë shpesh më shumë mjete për të ruajtur status quo-në sesa mjete për ta përmbysur atë.

Por modeli i Ziblat, që mbështetet mbi prirjen e klasave pronare për të kërkuar adaptim institucional në vend të përplasjeve revolucionare, has një kufi radikal kur analizohet historia e vendeve që vijnë nga komunizmi dhe Bullgari nuk bën përjashtim. Ky vend nuk ka qenë kurrë një laborator i evolucionit të butë. Përkundrazi, Bullgaria e shekullit XX është shembulli më i qartë i asaj që mund të quhet histori e këputur, ku çdo traditë e konsoliduar u zhduk me dhunë.

Në fundin e Luftës së Dytë Botërore, mbretëria bullgare, që kishte kaluar disa faza të modernizimit të kujdesshëm dhe të centralizimit shtetëror, u rrëzua pothuaj brenda natës. Më 9 shtator 1944, Fronti i Atdheut, një koalicion i dominuar nga Partia Komuniste Bullgare (BKP), mori pushtetin me mbështetjen e drejtpërdrejtë të ushtrisë komuniste sovjetike. Ajo që pasoi ishte një proces i pashembullt spastrimi. Gjykatat Popullore (1944–1945) dënuan mbi 12,000 njerëz, përfshirë pjesën dërmuese të oficerëve të vjetër të ushtrisë, të ministrave të periudhës mbretërore, të deputetëve të parlamentit, të klerikëve të lartë dhe të elitës intelektuale urbane (Bell, 1977). Ndryshe nga vende si Polonia, ku një pjesë e elitës mbijetoi përmes strukturave të Kishës Katolike, në Bullgari nuk kishte asnjë institucion autonom që të mbante gjallë kujtesën e rendit të vjetër.

Vitet 1946–1950 shënuan kulmin e kolektivizimit dhe të shpronësimit. Nëpërmjet një kombinimi presioni politik, dhune administrative dhe ligjesh për konfiskimin e pronave, 95% e tokës bujqësore u mor nga shteti dhe u organizua në kooperativa (Kalinova & Baeva, 2015). Familjet e mëdha pronare u shpërngulën, u persekutuan ose u shkatërruan ekonomikisht. Ky proces jo vetëm që çrrënjosi klasën e mesme rurale dhe aristokracinë pronare të tokës, por prodhoi një vakum të thellë simbolik. Ish-pronarët u kriminalizuan si “klasë armike”, emrat e tyre u hoqën nga tekstet shkollore, kujtimi i trashëgimisë së tyre u zhduk nga historiografia zyrtare. Ky nivel i

shfarosjes së elitës, shoqëruar me pastrimin ideologjik të Partisë Komuniste pas vitit 1956, shpjegon pse pas vitit 1989 nuk mund të ketë patur një konservatorizëm institucional.

Tranzicioni bullgar ishte një ngjarje që nuk ngjante me rastet e Evropës Qendrore. Bashkimi i Forcave Demokratike (SDS), formuar në dhjetor 1989, përfaqësonte një koalicion qytetar-liberal. Në mesin e themeluesve nuk kishte trashëgimtarë të aristokracisë së para luftës, as struktura borgjeze të organizuara. Liderë si Zheliu Zhelev kishin prejardhje intelektuale dhe disidente, jo pronare. Kur SDS fitoi zgjedhjet e vitit 1991, programi i tij ishte i drejtpërdrejtë: dekomunizim, privatizim, integrim në Bashkimin Europian (Krastev, 2002). Por çfarë nuk kishte ky projekt? Nuk kishte asnjë përfytyrim për restaurimin e rendit tradicional, asnjë koncept të rolit konservator të elitës si garant i stabilitetit.

Kjo shpjegon pse menjëherë pas privatizimit të shpejtë u krijua një oligarki e re që nuk kishte lidhje me trashëgiminë historike. Gjatë viteve 1996–1997, vendi hyri në një krizë të thellë ekonomike dhe politike: hiperinflacioni, protestat masive, falimentimi i bankave private dhe rrëzimi i qeverisë socialiste. Ky episod i krizës dëshmoi dobësinë e institucioneve dhe mungesën e forcave stabilizuese. Në teorinë e Ziblatt, pikërisht një “parti e madhe konservatore” do të mund ta mbante rendin brenda parametrave të lojës institucionale. Në Bullgari, mungesa e saj krijoi hapësirë për polarizim ekstrem.

Në vitin 2001, rikthimi i Simeonit II, mbretit të larguar nga vendi pas ardhjes së komunizmit dhe abrogimit të monarkisë në vitin 1946, dukej sikur mund të sillte një lloj vazdhimësie simbolike. Fitorja e Lëvizjes Kombëtare Simeon II (NDSV) ishte një ngjarje unike. Një ish-mbret që kthehej si kryeministër. Por edhe ky episod tregoi limitet e një konservatorizmi sentimental pa bazë reale shoqërore. Simeoni i II-të, i cili kishte jetuar gjysmën e jetës në Spanjë, nuk kishte rrjet klientelist, nuk kishte organizatë ideologjike, nuk kishte një klasë pronare që ta mbështeste. Brenda katër vitesh, NDSV humbi ndikimin dhe u shndërrua në një parti thuajse të parëndësishme (Ganev, 2007).

Pas vitit 2005, fragmentimi u bë norma e politikës bullgare. Formacionet nacionaliste si Ataka, më pas VMRO dhe GERB e Borisovit, mbushën boshllëkun e përfaqësimit, por jo si forca konservatore tradicionale. GERB ishte një projekt pragmatik i ndërtuar mbi karizmën e liderit dhe klientelizmin administrativ. Në protestat masive të vitit 2013, kur qeveria u rrëzua pas akuzave për korrupsion dhe marrëdhënie me oligarkinë, u bë e qartë se demokracia bullgare kishte mbetur pa një ind të përbashkët të ruajtjes së rendit politik (Stoyanov & Ganev, 2014).

Në këtë kuptim, Bullgaria është rasti i skajshëm ku teoria e Ziblatt nuk mund të aplikohet. Këtu demokracia nuk u përball me refuzimin e elitave konservatore për t’u adaptuar. Përkundrazi, ajo lindi në një truall ku elitat ishin zdhukur si aktorë kolektivë. Dhe ky boshllëk nuk është neutral: ai krijon hapësirë për polarizim të vazdhueshëm, për cikle protestash dhe për një krizë të përhershme legjitimiteti. Në këtë kuptim, Bullgaria është një kujtesë e qartë se historia nuk është një skenë ku të gjithë aktorët mund të hyjnë me të njëjtat instrumente. Aty ku kujtesa shoqërore është djegur, asnjë kompromis konservator nuk mund të prodhohet.

Në fund, Bullgaria tregon një të vërtetë që shpesh harrohet që demokracia nuk është vetëm rezultat i vendimeve racionale, por edhe i vazdhimësisë së klasave dhe institucioneve. Kur ato

zdhukën, vendi mbetet i zbrazur nga ato forca që mund t'i frenojnë krizat. Dhe kjo boshësi është më e rrezikshme se çdo radikalizëm i hapur.

5.7 Rast krahasimor me Shqipërinë, vendet baltike

Vendet baltike ndonëse kulturalisht dallojnë me vednet e Ballkanit, si Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania përsëri e kaluara e gjatë në komunizëm bënë që ato ti qasen teorisë së Ziblat pak a shumë në mënyrë të ngjashme. Ziblat vëren, siç e kemi thënë më sipër, se konsolidimi i demokracisë liberale në Evropë nuk ishte vetëm produkt i mobilizimit popullor dhe presionit nga lëvizjet masive të punëtorëve, por sidomos rezultat “i kapitullimit të elitave konservatore”, të cilat zgjodhën të mbrojnë interesat e tyre duke u integruar brenda një sistemi zgjedhor konkurrues. Kjo qasje i jep rëndësi vednmtare dy aspekteve. Njëra është ekzistenca e një klase pronare ose aristokratike me identitet politik të qartë dhe organizim institucional. Dhe tjetra është kapaciteti i kësaj klase për të transformuar partitë konservatore nga instrumente të mbrojtjes së rendit ekzistues në aktorë që pranojnë gradualisht rregullat e lojës demokratike.

Në vende si Britania, Suedia apo Belgjika, kjo strategji kompromisi parandaloi radikalizimin, frenoi polarizimin ekstrem dhe krijoi themelet e konsensusit pluralist që i dha jetë një demokracie të qëndrueshme. Megjithatë, Ziblat pranon vetë se në kontekste ku elitat konservatore u shkatërruan ose u radikalizuan, rezultati historik ishte polarizim ose autoritarizëm siç ndodhi në Gjermani apo Austri. Pikërisht këtu rasti i vendeve baltike paraqet një sfidë teorike: ato nuk përfunduan në autoritarizëm pas shembjes së elitave tradicionale, por ndërtuan demokraci funksionale mbi themele krejtësisht të tjera.

Një nga veçoritë më të dallueshme të vendeve baltike është shkatërrimi pothuaj total i klasave dhe elitave historike gjatë periudhës sovjetike. Midis viteve 1940–1949, përmes deportimeve, internimeve dhe ekzekutimeve, u zhdukën në masë elitën politike dhe ekonomike që kishte mbështetur pavarësinë midis dy luftërave botërore (Plakans, 2011). Për shembull, vetëm gjatë valës së madhe të internimeve të vitit 1949 në Estoni u përzunë mbi 20,000 njerëz, përfshirë fshatarë të pasur, ish-zyrtarë dhe intelektualë. Kolektivizimi i bujqësisë shkatërroi pronën private si themel ekonomik i autonomisë shoqërore. Edukimi, kultura dhe jeta publike u sovjetizuan. Çdo kujtesë e elitave kombëtare u përdoq me sistem.

Ndryshe nga Polonia ose Hungaria, ku disa shtresa shoqërore mbijetuan brenda aparatit shtetëror, në Baltik pushtimi sovjetik ishte më radikal dhe më i qëllimshëm në asgjësimin e kontinuitetit institucional. Si pasojë, në fillim të viteve '90, këto vende nuk kishin as parti konservatore tradicionale, as një klasë pronare që të mund të shndërrohej në garant të një kompromisi të ri demokratik.

Pavarësisht kësaj shkatërrimi, vendet baltike nuk u zhytën në vakum kaotik institucional. Përkundrazi, legjitimiteti i regjimeve të reja u ndërtua mbi projekti kombëtar i rilindjes shtetërore. Në Lituani, deklarata e pavarësisë e vitit 1990 që njihet si Act of the Re-Establishment of the State of Lithuania, u konceptua si akt vazdhimësie historike me shtetin e periudhës midis dy luftërave, pavarësisht se elitat e vjetra nuk ekzistonin më. Në Estoni dhe

Letoni, qytetaria e re u bazua mbi parimin e shtetësisë së vazhduar (restorative citizenship), duke përjashtuar një pjesë të madhe të popullsisë ruse të ardhur pas vitit 1945. Kjo zgjedhje synonte homogjenizimin kombëtar dhe e shndërroi identitetin kombëtar në themel të rendit demokratik (Smith et al., 1998). Kjo strategji krijoi një bazë të fuqishme mobilizimi, por edhe një tipar të veçantë të demokracisë baltike që është tensioni ivazdhueshëm etnik dhe sfida e përfshirjes së pakicave.

Në këtë kuptim, legjitimiteti nacionalist e zëvendësoi pjesërisht funksionin që Ziblatt i atribuonte partive konservatore, krijimin e një “bërthame stabiliteti” për shoqërinë pas krizës.

Një tjetër shtyllë që e mbajti kohezionin politik ishte perspektiva e integritit në BE dhe NATO. Për vendet baltike, integrimi perëndimor nuk ishte vetëm projekt ekonomik, por edhe garanci ekzistenciale sigurie, veçanërisht pas krizës në Transnistria dhe luftës së parë në Çeçeni. Qeveritë baltike, pavarësisht alternancës politike, krijuan konsensus të gjerë mbi reformat institucionale, kriteret e Kopenhagenit dhe liberalizimin ekonomik. Ky konsensus funksionoi si një ngjithës politik që kompensoi mungesën e elitave konservatore tradicionale.

Përsëri, ky faktor është jashtë modelit të Ziblatt, sepse stabiliteti nuk erdhi nga kompromisi i brendshëm midis klasës aristokratike dhe forcave popullore, por nga shtysa e jashtme dhe frika gjeopolitike.

Partitë kryesore baltike nuk ishin trashëgimtare të konservatorizmit klasik thuasje asfare. Në Estoni, Partia e Reformës (Reformierakond) u krijua më 1994 nga ish-ministra të qeverisë tranzitore, me një program të liberalizmit ekonomik dhe antikomunizmit modernizues (Auers, 2015). Në Lituanë, Unioni i Patriotëve kishte një dimension nacionalist, por jo rrënjë të një aristokracie tradicionale. Në Letoni, partitë e qendrës së djathtë lindi më shumë si koalicionë teknokratësh dhe grupe interesash të reja ekonomike. Ky konfigurim konfirmon se pluralizmi baltik u ngrit mbi identitete moderne teknokratike dhe nacionaliste, jo mbi kompromis të elitave tradicionale.

Rasti i vendeve baltike tregon qartë kufijtë e modelit të Ziblatt për vende të tilla. Në vende ku elitat tradicionale janë zhdukur me dhunë dhe është shkatërruar baza sociale e konservatorizmit, modeli i kompromisit gradual nuk mund të shpjegojë lindjen e një demokracie funksionale pra këto vende nuk mund të kenë rrugëtimin që kishin vende si Britania apo si Suedia.

Gjithshesë në shoqëritë post-totalitare, në shoqëri si ato të ballkanit, të vendeve baltike apo në përgjithësi të Europës Lindore, faktori i jashtëm (integrimi në BE/NATO) dhe projekti identitar kombëtar mund të mbushin boshllëkun e stabilitetit. Sigurisht që teoria e Ziblatt është më e përshtatshme për rastet ku ekziston një vazhdimësi e pjeshme e elitave historike (p.sh., Spanja pas Frankos) sesa për vendet me ndërprerje totale institucionale.

Në përmbledhje, demokracitë baltike janë një rast jashtëmodelit të Ziblatt, sado të ndryshme ngjajnë shumë edhe me Shqipërinë. Ato nuk trashëguan elita konservatore që do të pranonin gradualisht rregullat e konkurrencës demokratike për të ruajtur rendin social. Përkundrazi, ndërtimi i pluralizmit politik u realizua mbi themele të reja identitare, teknokratike dhe gjeopolitike, të nxitura nga projekti kombëtar dhe integrimi perëndimor. Ky përjashtim i

rëndësishëm sugjeron nevojën për teori më elastike mbi tranzicionet demokratike që marrin parasysh rolin e faktorëve të jashtëm dhe shkatërrimin total të elitave.

Kapitulli VI: Sjellja politike e të djathtës në Shqipëri, analizë e periudhave kryesore

6.1 Vitet 1992–1997, shenja të ndërtimit të një pushteti autoritar nga e djathta dhe largim nga parimet e e djathta

Pas zgjedhjeve të marsit 1992, që i dhanë Partisë Demokratike një fitore plebishitare me mbi 60% të votës popullore dhe një shumicë të pakontestueshme parlamentare (Elbasani, 2013), Shqipëria përjetoi një klimë entuziazmi kolektiv, të perceptuar nga një pjesë e madhe e shoqërisë si akti final i ndarjes me të kaluarën totalitare. Retorika politike dhe mediat e kohës e ngjyrosën këtë periudhë me simbolikë ekzaltuese dhe madje biblike. Fitorja e së djathtës interpretohej si një “shkëputje historike” dhe një “fillim nga zeroja”, duke krijuar një narrativë të pastër rature, që shpërfillte vijimësinë strukturore dhe kulturore të periudhës së kaluar (Vickers & Pettifer, 2000).

Presidenti i sapozgjedhur, Sali Berisha, u portretizua nga qarqet politike dhe gazetaria (përgjithësisht por edhe më gjerë) proqeveritare si figura e misionit moral, bartësi i një vullneti historik për të “pastruar” shoqërinë nga mbetjet e komunizmit dhe për të themeluar një rend të ri politik e kulturor. Ky personalizim i pushtetit nuk ishte vetëm një strategji retorike, por një tipar përfaqësues i një kulture politike ende të paçliruar nga logjika e liderit karizmatik dhe e centralizimit ekstrem të vendimmarrjes (Biberaj, 1999).

Në vend që “fillimi i ri” të konceptohej si një proces gradual ndërtimi institucional, me mekanizma kontrolli dhe balancimi, ai u investua me pritshmëri gati utopike për ndryshim të menjëhershëm. Kjo qasje solli dy pasoja strukturore: nga njëra anë, zhvleftësimin e institucioneve pluraliste si mekanizma legjitimues dhe korrektues të pushtetit, dhe nga ana tjetër, krijimin e një klime kulturore që barazonte çdo kritikë me sabotim të transformimit kombëtar (Elbasani, 2013). Ky frymëzim me frymë aspak të djathte apo konservatore, i ndërthurur me diskursin antikomunist radikal, u bë themeli i një politike që në vend të konsolidonte kulturën demokratike, krijoi një pritshmëri të papërmesueshme dhe një lloj shndërrimi të pushtetit politik në projekt moral absolut. Në retrospektivë, ky fenomen kontribuoji ndjeshëm në legjitimin e stilit qeverisës autoritar dhe në dështimin për të ndërtuar kapacitete institucionale reale që do ta bënin demokracinë funksionale dhe të qëndrueshme.

Në fillim të viteve ’90, ideologjia politike e qeverisë së re demokratike në Shqipëri u artikulua mbi një narrativë të fuqishme të imitimit perëndimor, e cila synonte të legjitimonte shpejtësinë e transformimit politik dhe ekonomik. Retorika zyrtare, e përshkroi demokracinë liberale dhe ekonominë e tregut si modele që mund të importoheshin dhe operacionalizoheshin menjëherë, pa kosto të konsiderueshme sociale dhe institucionale. Ky vizion teleologjik i përjashtoi nga diskutimi publik sfidat komplekse të ndërtimit të kapaciteteve administrative, të transformimit të kulturës politike dhe të krijimit të një infrastrukture funksionale të sundimit të ligjit.

Siç thekson Elbasani (Elbasani, 2013), kjo qasje e imitimit formal rezultoi në ngritjen e një sistemi politik dhe institucional që në formë dukej demokratik, por që në përmbytje mbeti i varur nga vullneti dhe arbitrariteti i liderëve politikë. Mungesa e traditës së konsoliduar institucionale dhe e një klase politike të trajnuar për qeverisje demokratike e bëri sistemin të cenueshëm ndaj personalizimit të pushtetit dhe praktikave klienteliste.

Në vitin 1993, qeveria shqiptare ndërmori një program të gjerë privatizimi masiv, duke synuar të transformonte strukturën e ekonomisë brenda një kohe rekord. Megjithatë, ky proces, i cili shpesh u realizua në mungesë të një kuadri ligjor të konsoliduar dhe pa mekanizma të pavarur mbikëqyrjeje, krijoi një mjedis të favorshëm për përvetësimin informal të pronës publike. Siç dokumenton Banka Botërore (1998), zbatimi i reformave ekonomike u karakterizua nga mungesa e transparencës dhe nga një kulturë e klientelizmit, ku përfituesit kryesorë ishin individë dhe grupe me lidhje të ngushta politike me elitat qeverisëse. Ky model i “kapjes” së pasurisë publike përmes marrëdhënieve patron-klient jo vetëm që minoi besimin e qytetarëve te procesi i tranzicionit, por edhe e konsolidoi një ekonomi informale dhe oligarkike, me pasoja afatgjata për zhvillimin demokratik dhe stabilitetin institucional të vendit.

Ndër praktikat më të qarta dhe më të diskutuara të qeverisë shqiptare pas zgjedhjeve të vitit 1992 ishte politika e spastrimeve administrative, e cila u justifikua zyrtarisht si një masë “dekomunistizimi”. Në të vërtetë dekomunistizimi i cili ishte i nevojshëm asnjëherë nuk u bë siç duhet dhe me mënyrën e duhur. Përkundrazi pati një luftë vetëm për qëllime politike ndaj atyre komunisteve që ishin pengesë dhe pati dashamirësi apo vlerësim ndaj komunisteve që ishin ndihmetarë. Në këtë kontekst, qindra drejtues të ndërmarrjeve publike, drejtorë shkollash, kryetarë komunash dhe punonjës të niveleve të ndryshme administrative u larguan nga detyra gjatë viteve 1992 dhe fillimit të vitit 1993 (Biberaj, 1999).

Ky proces nuk u mbështet mbi një kuadër të qartë ligjor dhe nuk pati kritere objektive për të përcaktuar se cilët individë përfaqësonin realisht trashëgiminë e aparatit represiv të diktaturës. Përkundrazi, shpesh herë përjashtimi nga detyra lidhej me përkatësinë politike ose me perceptimin e afërsisë me Partinë e Punës, pavarësisht rolit konkret profesional. Kjo krijoi një administratë thellësisht të politizuar dhe e bëri besnikërinë ndaj partisë në pushtet parakusht për stabilitetin profesional (Elbasani, 2013).

Ky fenomen nuk ishte i izoluar në tranzicionet postkomuniste të Europës Qendrore dhe Lindore. Në Poloni apo Hungari, proceset e “lustracionit”, domethënë të spastrimit të ish-zyrtarëve të lidhur me aparatin e Sigurimit të Shtetit, gjithashtu krijuan tensione të ngjashme, por dallimi kryesor qëndronte te institucionalizimi i procedurave. Në shumicën e këtyre vendeve, u miratuan ligje të posaçme lustracioni, me kritere të mirëpërcaktuara dhe procedura apelimi, duke e mbrojtur procesin nga abuzimi arbitrar (Horne, 2009). Në Shqipëri, përkundrazi, “dekomunistizimi” që nuk u bë kurrë, “u realizua” me vendime administrative dhe vendime politike, pa një infrastrukturë ligjore të konsoliduar.

Në vitin 1994, qeveria ndërmori një tjetër hap me pasoja të rëndësishme institucionale që ishte përpilimi dhe propozimi i një projekti të ri kushtetues që synonte të vendoste një model presidencial me kompetenca të zgjeruara. Projekti parashikonte që Presidenti i Republikës të kishte të drejtë të emëronte krerët e institucioneve të drejtësisë, të propozonte shpërndarjen e

Kuvendit dhe të ushtronte kompetenca të konsiderueshme mbi kabinetin qeveritar (Freedom House, 1995).

Kjo përpjekje për të ndërtuar një ekuilibër të ri institucional ishte ndoshta pjesërisht rezultat i një ndjenje pasigurie dhe frike nga destabiliteti politik, në një shoqëri që kishte dalë nga një regjim totalitar dhe ku fragmentimi i forcave politike rrezikonte të çonte në paralizë institucionale. Megjithatë, për shumë aktorë politikë dhe për një pjesë të gjerë të opinionit publik, projekti u perceptua si një përpjekje për të përqendruar pushtetin ekzekutiv në duart e një individi, duke reduktuar mekanizmat e kontrollit dhe balancës.

Refuzimi i projektit kushtetues në referendumin e nëntorit 1994 përbënte një precedent domethënës. Për herë të parë që nga rënia e diktaturës, shoqëria shqiptare shprehu në mënyrë të qartë një votë mosbesimi ndaj tendencave për centralizimin e skajshëm të pushtetit (Elbasani, 2013). Ky akt tregoi se pavarësisht pasigurisë dhe varfërisë, një kulturë politike e re po fillonte të konturohej. Kishte shenja se po merrte jetë refuzimi i modelit të liderit të fuqishëm dhe po merrnin jetë kërkesa për procedura më gjithëpërfshirëse dhe kontroll demokratik te pushtetit.

Në analizë krahasuese, kjo ngjarje i ngjante dinamikave të vendeve të tjera të ish-bllokut socialist. Për shembull, në Bullgari dhe Rumani pati gjithashtu tentativa të hershme për të përqendruar pushtetin presidencial, por ato u kundërshtuan nga opozita politike dhe nga presioni i aktorëve ndërkombëtarë (Schöpflin, 1993). Në këtë kuptim, referendumi i vitit 1994 i dha Shqipërisë një moment të rëndësishëm për të kuptuar se ndërtimi i institucioneve demokratike nuk mund të imitohet mekanikisht dhe se legjitimiteti kërkon jo vetëm zgjedhje, por edhe konsensus të gjerë politik.

Një nga karakteristikat më të dallueshme të tranzicionit politik shqiptar në vitet pas rënies së komunizmit ishte tendenca e shpejtë për të ndërtuar një pushtet të centralizuar, ku kufijtë midis partisë dhe shtetit u bënë gjithnjë e më të turbullt. Në vend që të konsolidohej një demokraci funksionale, e mbështetur mbi konkurrencën e ndershme politike dhe pavarësinë e institucioneve, Shqipëria hyri në një cikël ku retorika antikomuniste dhe legjitimiteti moral i fituar në zgjedhjet e para pluraliste u përdorën si justifikim për kontrollin e gjithanshëm institucional.

Në këtë kuadër, praktikët e emërimeve të centralizuara në gjykata dhe prokurori krijuan një sistem varësie të drejtpërdrejtë politike. Përzgjedhja e drejtuesve të organeve të drejtësisë u bë shpesh mbi bazën e lojalitetit politik dhe jo të kriterëve meritokratike apo të profesionalizmit të provuar. Në vend që reforma të prodhonte institucione autonome, ajo riprodhoi logjikën klienteliste të sundimit të personalizuar që kishte karakterizuar edhe periudhat e mëparshme. Ky fenomen lidhet drejtpërdrejt me konceptin e demokracisë defektoze që përshkruan Ëlfgang Merkel (Merkel, 2004): një sistem formal demokratik, ku ekzistojnë zgjedhje dhe ndarje pushtetesh në letër, por ku në praktikë kapja politike e institucioneve bën që mekanizmat e kontrollit dhe balancës të jenë vetëm fasadë.

Paralelisht, media publike, veçanërisht Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), u kthye në një mjet propagande qeveritare. Raporti i OSBE-së për zgjedhjet e vitit 1996 e evidenton qartë këtë gjendje. Opozita kishte qasje të kufizuar në transmetimet kombëtare, ndërsa kronikat televizive

dominoheshin nga mbulimi pozitiv i fushatës së Partisë Demokratike (OSCE/ODIHR, 1996). Kjo prodhoi një perceptim të gjerë se konkurrenca politike ishte jo vetëm e pabarabartë, por edhe e instrumentalizuar për të riprodhuar një model të pushtetit të centralizuar.

Raportet ndërkombëtare (Freedom House, 1995) theksonin se ky kontekst kishte pasoja të menjëhershme për cilësinë e demokracisë. Nga njëra anë, zgjedhjet ekzistonin si mekanizëm formal legjitimiteti, nga ana tjetër, konkurrenca e ndershme, liria e informacionit dhe ndarja reale e pushteteve mbeteshin minimale. Ky përputhet me modelin që Colin Crouch (Crouch, 2004) e quan post-demokraci – një fazë ku ritualet demokratike vazdhojnë, por përmbajtja e tyre zbrazet, pasi shteti identifikohet me partinë dhe mediat kthehen në instrument të interesave të pushtetit.

Kështu, periudha 1992–1997 u karakterizua dukshëm nga një drejtësi të politizuar dhe të varur, një media publike të kapur nga qeveria, një administratë të ndërtuar mbi besnikërinë politike dhe nga një sistem zgjedhor ku parimet e konkurrencës së barabartë u cenuan rëndë.

Këto zhvillime kontribuan në delegjitimimin progresiv të institucioneve demokratike, rritjen e mosbesimit publik dhe radikalizimin e opozitës, faktorë që do të kulmonin në krizën dramatike të vitit 1997, kur shteti praktikisht u shpërbë për disa muaj. Ajo që duhej të ishte një periudhë e themelimit të standardeve demokratike u shndërrua në një eksperiment të dështuar të imitimit formal të demokracisë perëndimore, ku narrativat morale dhe antikomuniste maskuan mungesën e sundimit të ligjit dhe të institucioneve të forta.

Zgjedhjet parlamentare të 26 majit 1996 përfaqësojnë kulmin e autoritarizmit latent, në qoftë se mund të përdorim këtë term, në Shqipëri pas rënies së regjimit komunist. Sipas raportit të OSCE/ODIHR (1996), procesi zgjedhor u karakterizua nga një ndërthurje e dhunës institucionale dhe manipulimeve sistematike. Vëzhguesit ndërkombëtarë evidentuan episode të ndërhyrjes së policisë në qendrat e votimit, ushtrimin të presionit fizik mbi komisionerët e opozitës, pengimit të mbikëqyrësve ndërkombëtarë për të hyrë në ambientet e numërimit dhe manipulimit të hapur të rezultateve përfundimtare.

Përballë këtij realiteti, Partia Socialiste dhe disa forca të tjera opozitare morën vendimin për të bojkotuar Kuvendin e ri, duke e zhytur vendin në një krizë të thellë të legjitimitetit institucional dhe duke minuar besimin publik te procesi elektoral si mekanizëm themelor i konkurrencës demokratike. Ky bojkot shënoi për herë të parë në tranzicionin politik shqiptar një distancim të hapur të opozitës nga institucionet përfaqësuese, duke e dobësuar edhe më tej ekuilibrin institucional që ishte ende i brishtë.

Siç argumenton Bieber (Bieber, 2020), kjo periudhë përbën shembullin paradigmatic të një regjimi ku zgjedhjet zhvillohen në mënyrë periodike dhe mbajnë formën procedurale të pluralizmit politik, por realisht garantojnë fitoren e një force dominuese nëpërmjet deformimit të hapur të kushteve të konkurrencës. Kjo dinamikë përforcoi përqendrimin e pushtetit politik në një qendër të vetme vendimmarrjeje dhe krijoi premisa për krizën e mëvonshme të vitit 1997.

Që nga viti 1995, Shqipëria përjetoi një fenomen të shëmtuar ekonomik dhe shoqëror të pashembullt në Evropën postkomuniste, përjetoi përhapjen masive të skemave piramidale, të cilat premtonin fitime të jashtëzakonshme në një kohë kur kapaciteti prodhues i vendit ishte i

dobët dhe sistemet rregullatore ishin te paqena. Kompani si VEFA Holding, Gjallica, Sude, Kamberi, Populli, Xhaferri dhe dhjetëra ndërmarrje të tjera private, u paraqitën si firma investimesh apo shoqëri kursim-kredi, por në thelb funksiononin sipas modelit klasik piramidal: pagesat ndaj depozituesve të hershëm financoheshin nga hyrjet e investitorëve të rinj (Jarvis, 2000).

Edhe pse sinjalet paralajmëruese ishin të shumta, institucionet shtetërore nuk ndërhyjnë në kohë. Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave kishin njohuri mbi natyrën e pasigurt të këtyre kompanive, të cilat nuk kishin licencë bankare dhe nuk ishin subjekt i mbikëqyrjes formale (Jarvis, 2000). Sipas disa analizave, mungesa e ndërhyrjes lidhej me dy arsye kryesore. E para, frika politike se ndalimi i skemave do të shkaktonte pakënaqësi popullore që do të dëmtonte qeverinë dhe e dyta, përfitimi indirekt i disa segmenteve të elitës politike nga kapitali financiar që qarkullonte në to (World Bank, 1998).

Në janar–shkurt të vitit 1997, rënia graduale e disa prej kompanive më të mëdha – fillimisht Sude, më pas Gjallica dhe VEFA, Xhaferri, Populli – shkaktoi panik masiv. Më shumë se 1 milion qytetarë kishin depozituar kursimet e tyre, në shumë raste duke shitur pasuri apo duke marrë borxhe. Humbja e kursimeve solli protesta të përhapura, të cilat u radikalizuan në një kryengritje të hapur kundër qeverisë.

Në mars 1997, strukturat shtetërore filluan të shpërbëheshin. Protestuesit sulmuan institucionet lokale dhe depot e ushtrisë. Sipas raporteve ndërkombëtare, nga depot u grabitën mbi 650 mijë armë zjarri, që u shpërndanë në popullatë dhe në grupe të armatosura (Human Rights Watch, 1997). Në jug të vendit u krijuan “komitete të shpëtimit publik” dhe një formë e pushtetit paralel, ndërsa qeveria humbi kontrollin mbi disa prefektura. Shqipëria hyri në një periudhë kolapsi të rendit publik që në literaturë është cilësuar “shtet i dështuar”.

Ky ishte një rast unikal në Evropë pas vitit 1989 pas perfundimit të Luftës së Ftohtë. Një vend i NATO-s (Greqia) u gjend përballë një fqinj në prag të luftës civile, ku strukturat qeverisëse kishin rënë pothuajse plotësisht. Komuniteti ndërkombëtar ndërhyri me Operacionin Alba, një mision multinacional i udhëhequr nga Italia, për të stabilizuar situatën dhe për të mundësuar mbajtjen e zgjedhjeve të reja në qershor 1997 (World Bank, 1998).

Kriza e skemave piramidale nuk ishte thjesht një dështim ekonomik, por edhe një simptomë e mungesës së kapaciteteve institucionale dhe kulturës minimale të sundimit të ligjit. Ajo ekspozoi brishtësinë e tranzicionit shqiptar, varësinë nga liderët karizmatikë dhe mungesën e mekanizmave të kontrollit demokratik.

E gjithë kjo pati pasoja të rënda më pas, pasoja që vijuan dhe vijnë gjatë në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Një nga këto pasoja është radikalizimi i diskursit politik dhe normalizimi i përjashtimit. Pas krizës së 1997-ës, palët politike hynë në një luftë totale edhe sa i takon diskursit. Denigrimi i kundërshtarit u kthye në një normë. Në vend që të ndërtohej një konsensus minimal mbi “rregullat e lojës”, u thellua logjika e demonizimit reciprok.

Një pasojë tjetër ishte humbja e besimit qytetar ndaj së djathtës. Meqenëse qeverisja e viteve 1992–1997 u identifikua me krizën e skemave piramidale dhe me autoritarizmin, një pjesë e madhe e shoqërisë e barazoi çdo projekt të së djathtës me rrezikun e destabilizimit. Ky perceptim u bë kapital politik për opozitën socialiste e cila bëri gjithçka që ta përdorte poër të fituar në këtë debat.

Gjithashtu u konsolidua, pra ngjarjet e viteve të fundit të periudhës 1992-1997, konsoliduan kulturën e cinizmit ndaj institucioneve. Siç thekson Elbasani (Elbasani, 2013), rënia e rendit institucional gjatë vitit 1997 e ktheu mosbesimin të politika dhe shteti në një tipar shoqëror afatgjatë. Institucionet publike u perceptuan si të kapura ose të paafta për të mbrojtur qytetarët.

Këto zhvillime e ushtruan ndikimin e tyre edhe në periudhën pas 2000-ës, kur, sipas Bieber (Bieber, 2020), Shqipëria u kthye në një demokraci hibride, pra një regjim ku mbahen zgjedhje dhe ekzistojnë procedura demokratike në letër, por praktikat autoritare si kontrolli mbi median, përdorimi politik i institucioneve, klientelizmi elektoral mbeten të thelluara.

Në retrospektivë, periudha 1992–1997 në Shqipëri ofron një ilustrim paradigmatic të asaj që ndodh kur koncepti i konservatorizmit reduktohet në një retorikë moralizuese dhe në kultin e individit. Konservatorizmi i mirëfilltë nuk është thjesht një diskurs i fortë antikomunist apo një projekt për shembjen e simboleve të së kaluarës; ai është përmbajtje institucionale, disiplinë morale dhe respekt për kufijtë e pushtetit. Në thelb, është ndërgjegjja se çdo transformim shoqëror kërkon kohë, ruajtje të balancës midis autoritetit dhe lirisë, si dhe kultivimin e besimit qytetar të institucionet, jo vetëm të figura e liderit.

Kur këto parime u braktisën dhe pushteti u konceptua si autorizim moral për të shpallur “fundin (jo domosdo Fukuyama-ian) e historisë” dhe fillimin e një epoke të re me mjete arbitrare, u hapën plagë të thella politike dhe sociale. Kriza e zgjedhjeve të 1996, kolapsi i skemave piramidale dhe dhuna e vitit 1997 nuk ishin thjesht pasoja të gabimeve administrative apo të paqëndrueshmërisë ekonomike. Ato ishin simptomë e një krize më të thellë: krizës së kulturës politike që i mungonte respekti për kufijtë institucionale, që i mungonte edukata konservatore e përmbajtjes dhe e maturisë.

Pikërisht për këtë arsye, Shqipëria jo vetëm që përjetoi një krizë politike dhe ekonomike, por edhe një krizë morale, pasojat e së cilës janë ndjerë për dekada. Ky është një mësim i dhimbshëm se demokracia liberale dhe konservatorizmi si filozofi politike nuk mund të ndërtohen mbi retorikën e pasionit apo mbi karizmën e një individi, por vetëm mbi themelet e qëndrueshme të kulturës institucionale dhe të kufijve të përgjegjësisë. Vetëm kur këto parime marrin përparësi ndaj ambicies personale dhe manipulimit moralizues, mund të shmangët cikli i krizave që, deri sot, mbetet një plagë e hapur në shoqërinë shqiptare.

Në tërësi për të parë vlerat e variablave të pavarur dhe të varur do të shohim të dhënat mbi këtë periudhë. Sa i takon variablave të pavarur (ai i pari) duhet thënë se partia demokratike kishte në vitin 1992 rreth 150 mijë anëtarë (Biberaj, 1999) ndërsa në vitin 1997 ajo arriti në rreth 80 mijë anëtarë. Partia dmeokratike kishte hapur degë të sajat në të gjithë vendin, në çdo qytet dhe fshat. PD fitoi thellë zgjedhjet e vitit 1992 më 22 mars. Ajo mori një rezultat më të dobët në korrik të atij për zgjedhjet locale por arriti të fitojë bahkinë e Tiranës, atë të Durrësit, të Elbasanit, të

Shkodrës, të Fierit, të Beratit etj. Pra ajo i fitoi zgjedhjet locale duke marrë bashkitë kryesore por i humbi ato në kuptimin që shumë komuna i mori PS-ja dhe numri i votave për PD-në ishte më i vogël se sa në 22 mars. (Biberaj, 1999). Përzgjedhja e kandidatëve ishte e centralizuar por nuk ishte jo dmeokrarike. Pati diktatime dhe vendime të institucioneve. Në refendumin për Kushtetutën në vitin 1994 ajo humbi. Në vitin 1996 zgjedhjet u shkatërruan dhe PD fitoi thellë por në kushte totalisht të dyshimta (OSBE-ODIHR 1996). Gjatë vitit 1997 kemi zgjedhjet të cilat u humbën thekllë nga PD-ja. Kjo sa i takon forcës së partisë.

Variabli i dytë ai i institucionalizimit është gjithashtu në tregues të ngjashëm. Lideri Berisha nuk e dominon partinë në vitin 1991-1992 por më pas e dominon atë fuqimisht. Partia funksionon me struktura komplet të ngurta dhe militanteske (Biberaj, 1999). Ideologjikisht partia është e paqartë.

Në lidhje me variablin e tretë atë të qëndrimit në momente kyçe, hinge of history, partia demokratike rrëzoi qeverinë e stabilitetit të Ylli Bufit në 1991, bojktoi parlamentin pas 31 marsit të vitit 1991. Më pas ajo pati një sjellje shumë problematike në lidhje me institucionet në vitin 1996 dhe 1997 kohë në të cilën gati gjithçka u shemb (Petifer, 2000).

Variabli i katërt ai i rolit në lidhje me institucionet e vendit është thajse asgjësues. Gjykata Kushtetuese, Prokuroria etj janë plotësisht nën kontrollin e PD-së (Petifer, 2000). Gjithçka është gati e politizuar dhe partiake në lidhje me institucionet. E paraqitur me tabelë dhe me variabla të peshuara gjendja në vitet 1992-1997 është si më poshtë.

Vlerësimi i Performancës së PD-së sipas Modelit të Ziblatt (1992–1997). Tabela 1.0

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
Forca dhe organizimi i partive të djathta	Numri i anëtarëve dhe degëve lokale	4
	Përzgjedhja e kandidatëve	4
	Performanca zgjedhore	3
Institucionalizimi i partive të djathta	Rotacioni i lidërshpit	2
	Funksionimi i strukturave statutore	2
	Identiteti ideologjik dhe orientimi programor	2
Sjellja në momente krizash ("Hinge of History")	Qëndrimi në krizat (1997)	1
	Deklaratat publike gjatë krizës	2
	Pjesëmarrja në marrëveshje politike	1
Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike	Qëndrimi ndaj institucioneve të pavarura	2
	Pjesëmarrja në reforma sistematike	1

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike	Diskursi mbi rendin kushtetues dhe ndërkombëtarët	1

Ne qofte do te benim nje llogaritje statistikore do te vinim re se forca dhe organizimi i PD ishte relativisht i lartë me një indeks prej 3.67 ndërsa institucionalizimi, sjellja në kriza dhe roli në ruajtjen e institucioneve ishin dukshëm më të dobëta (rreth ose nën 2.)

Në lidhje me variablin e varur. Siç e thamë edhe më lart institucionet demokratike nuk u konsoliduan përkundrazi patën probleme shumë të mëdha. Raportet e Freedom House, të OSBE-ODIHR-it, të Institutit V-Dem tregojnë dobësi dhe probleme të mëdha. Kështu indeksi i Freedom House për treguesin pjesëmarrje dhe pluralizëm politik në vitin 1992 është 4, në vitin 1993-1996 është 4-4,5 dhe në vitin 1997 është 3. Shkalla 1 është shumë jo pluraliste, shkalla 7 është plotësisht pluraliste. Megjithatë këto vlera ne do ti kthejmë në një shkallë nga 0 në 1. Për këtë përdorim formulën : Vlera e normalizuar (dmth vlera që përdorim tani në shkallën nga 0 në 1) është e barabartë me vlerën në shkallën nga 1 në 7 minus 1 pjesim për 6.

Pra vlera 4-4,5 për vitet 1993-1996 është 0,55-0,58 dhe vlera 3 është dhe vlera 3 për vitin 1997 është 0,33.

Në lidhje me indeksin e pluralizmit këto vlera thonë që kemi pluralizëm por ai është më së shumti formal.

Variabli tjetër ai i Indeksit të Institucionalizimit të Partisë është 0,25-0,35 për periudhën 1992-1997. Kjo do të thotë që kemi paaftësi për të ndërtuar parti me strukturë të qëndrueshme dhe kemi dominim nga lideri (Berisha).

Variabli tjetër i varur ai i Indeksit të Rolit të Partisë në vitet 1992-1994 është 0,4, në vitin 1995-1996 është 0,3 dhe në vitin 1997 është 0,2. Kjo do të thotë që opozita përjashtohet nga proceset, dhunohet dhe zgjedhjet nuk janë të lira.

Në lidhje me variablin që përfaqëson raportet e OSBE-ODIHR dhe raportet e BE-së kemi vlerësime të tilla si manipulim masiv për zgjedhjet e vitit 1996 dhe ato të vitit 1997, kemi përjashtim apo dhunë ndaj opozitës etj. Në vlera që dalim nga kodimi ato janë 1 për vitin 1992-1994 që do të thotë opozitë funksionale por e kufizuar, 0 për vitin 1996 dhe 0 për vitin 1997 që do të thotë se kemi krizë totale dhe ansjë rol të opozitës.

Po i paraqesim të dhënat e sakta të variablave të varur me anë të një tabelë të thjeshtë.

Tabelë 1,1

Viti FH (0–1) V-Dem Parti (0–1) V-Dem Opozitë (0–1) Roli i opozitës (0–2)

1992	0.50	0.30	0.40	1
1993	0.55	0.32	0.35	1
1994	0.58	0.34	0.35	1
1995	0.52	0.30	0.30	1
1996	0.50	0.28	0.25	0
1997	0.33	0.25	0.20	0

Këto të dhëna të periudhës 1992–1997, tregojnë Shqipëria në këto vite nuk përjetoi stabilizim demokratik. Të gjithë indikatorët tregojnë:

- pluralizëm formal, por jo funksional;
- dominim të partisë në pushtet mbi institucionet;
- delegjitimim të opozitës;
- mungesë kontrolli dhe balancesh reale;
- degradim dramatik në vitin 1997.

Kjo mbështet argumentin se Partia Demokratike, ndonëse e djathtë në diskurs, nuk funksionoi si një parti konservatore stabilizuese në kuptimin e Ziblatt.

6.2 Sjellja e PD-së në vitet 1997-2005, opozitë e vështirë dhe me dy pamje

Pas rrëzimit të dhunshëm nga pushteti në vitin 1997 dhe shpërthimit të krizës së piramidave që solli një tronditje të thellë politike dhe shoqërore në Shqipëri, Partia Demokratike (PD) u gjend përballë sfidës ekzistenciale të mbijetesës. Vitet 1997–2005 përbëjnë një periudhë vendimtare për vetëformësimin e PD-së si një forcë opozitare dhe për mënyrën se si ajo e konceptoi raportin me institucionet demokratike, kundërshtarët politikë dhe vetë shoqërinë. Kjo fazë, ndonëse shpeshherë e anashkaluar në analizat historike, është thelbësore për të kuptuar natyrën e partisë si aktor në procesin e demokratizimit të vendit.

E parë nga këndi i Daniel Ziblatt jeta ose sjellja e PD-së në këto vite ka disa ngjyra por së shumti dallohen dy. Dallohet përpjekja për të mbijetuar në stilin e parruive autoritariste dhe pa demokraci, e partis që nuk njeh institucionet dhe që rreket të deligjitimojë qeverisjen dhe e partsë q ëpërpiqet të dnërtojë në nj alternativë, një qasje të re që njeh systemin dhe Lufton të luftojë brenda tij si forcë legjitimuese. Ne e kemi vënë re shpesh gjta ëkërkimit tonë se Ziblatt argumenton se demokracia nuk konsolidohet thjesht si rezultat i mobilizimit nga poshtë, por kërkon edhe vetëpërmbajtjen dhe institucionalizimin e elitave konservatore që zgjedhin të respektojnë rregullat e lojës demokratike për të ruajtur rendin dhe interesat e tyre afatgjata (Ziblatt, 2017).

Duke qenë se modeli i tij ndërtohet mbi katër dimensione analitike që janë forca organizative e partisë, institucionalizimi i strukturës së brendshme, sjellja në momentet e krizës dhe roli në ruajtjen e institucioneve demokratike atëherë ne do të shohims e si këta tregues u shfaqën në këtë periudhë.

Sa i takon treguesit të parë atij të forcas organizative mund të themi se ai ose vetë PD-ja është, ecën midis rindërtimit dhe autoritarizmit të personalizuar. Pas disfatës së vitit 1997, PD përjetoi një shthurje organizative që e la pothuajse të paralizuar për disa muaj. Megjithatë, duke filluar nga viti 1998, nën ndikimin e pandërprerë të Sali Berishës (qoftë edhe si “lider de facto”), partia ndërmori një proces të ngadaltë riorganizimi. Rindërtimi i degëve në rrethe, rikthimi i forumeve rinore dhe përpjekja për të rikuperuar bazën e humbur të elektoratit urban u panë si mjete për të rilindur partinë.

Në aspektin e mobilizimit, PD tregoi njëfarë suksesi – ajo ishte e aftë të organizonte protesta të gjera, të mbante strukturat në funksion, dhe të gjeneronte presion politik mbi mazhorancën socialiste. Megjithatë, forca organizative mbeti e ndërvarur nga struktura të centralizuara, ku vendimmarrja mbizotërohej nga një grup i vogël rreth liderit historik. Organizimi ekziston, por mbështetet në një model karizmatik dhe jo në institucione të qëndrueshme të brendshme.

Në lidhje me treguesin e dytë atë të institucionalizimit të partisë është e qartë dhe do të shihet edhe më poshtë se kemi të bëjmë methuajse një lloj institucionalizimi të personalizimit. Në mënyrë sipërfaqësore, PD gjatë kësaj periudhe u përpoq të zhvillonte rregulla të brendshme, përmes statutit, forumeve dhe Kongreseve. Megjithatë, këto struktura ishin më shumë rituale sesa mekanizma funksionalë. Lideri ishte i pazëvendësueshëm, dhe çdo tentativë për kritikë të brendshme ose garë reale interpretohej si sulm ndaj unitetit të partisë. Partia nuk arriti të ndërtojë një klasë të mesme politike brenda vetes, që të mbartte një kulturë institucionale të brendshme. Në vend të kësaj, shfaqjet e mendimit alternativ u zëvendësuan nga konformizmi dhe rreshtimi rreth liderit. Mungesa e një aparature të qëndrueshme organizative do të kishte pasoja serioze në periudhat e mëvonshme, ku çdo krizë politike kthehej menjëherë në krizë identiteti dhe riorganizimi të partisë.

Sa i takon vlerësimit për sjelljen në momente krize vëmë re se si strategji bazë opozita ka atë të konfrontimit të përhershëm.

Në vend që të kultivonte një opozitë konstruktive, e cila do të ofronte alternativa qeverisëse dhe do të ushtronte kontroll institucional, PD adoptoi një strategji të opozitarizmit të papërmbytur. Ajo e shihte qeverinë jo si kundërshtar legjitim, por si uzurpatore të pushtetit, shpesh duke përdorur një retorikë që e cilësonte atë si të lidhur me krimin, mafien apo “ish-Sigurimin e Shtetit”.

Bojkotet e shpeshta të parlamentit, refuzimi për të marrë pjesë në komisionet hetimore apo në proceset e reformës zgjedhore, si dhe përshkallëzimi i protestave si mjet i vetëm presioni, dëshmojnë një kulturë politike të mungesës së vetëpërmbyajtjes. Kjo sjellje jo vetëm që minoi klimën e konsensusit politik, por përforcoi polarizimin dhe e zbehu më tej besimin e publikut tek demokracia parlamentare. Në vend të vetëpërmbyajtjes, partia reagoi me delegjitimim të kundërshtarit dhe krizë të përhershme.

Treguesi i katër ai i rolit që luan një parti e djathtë në ruajtjen e institucioneve është gjithashtu i mjegullt dhe oportunist.

Në një demokraci funksionale, partitë që nuk janë në pushtet luajnë një rol thelbësor për ruajtjen e integritetit institucional, duke mbështetur reformat dhe duke vepruar brenda kuadrit të rregullave të përbashkëta. Gjatë viteve 1997–2005, PD nuk luajti këtë rol. Në vend që të kontribuonte në procesin e reformave, veçanërisht në drejtësi, zgjedhje apo integrim evropian, ajo shpesh i përdorte institucionet për të frenuar zhvillimet politike dhe për të penguar kundërshtarin.

Në disa raste, PD përdori instrumentet parlamentare për të bllokuar emërime kyçe, për të vonuar reforma të rëndësishme apo për të shkaktuar krizë institucionale. Kjo qasje nuk ishte vetëm opozitare në natyrë, por përfaqësonte një mospërfillje të rolit të institucioneve si garante të stabilitetit demokratik. Roli në ruajtjen e institucioneve ishte i dobët, shpesh i motivuar nga llogaritje politike afatshkurtra.

Tabelë përmbledhëse me vlera numerike për variablin e pavarur për PD-në (1997–2005)

Tabele 1.2

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
Forca dhe organizimi i partive të djathta	Numri i anëtarëve dhe degëve lokale	3
	Përzgjedhja e kandidatëve	2
	Performanca zgjedhore	3
Institucionalizimi i partive të djathta	Rotacioni i lidërshpit	1
	Funksionimi i strukturave statutore	2
	Identiteti ideologjik dhe orientimi programor	2
Sjellja në momente krizash (“Hinge of History”)	Qëndrimi në krizat (1998 – 2001)	1
	Deklaratat publike gjatë krizës	2
	Pjesëmarrja në marrëveshje politike	1
Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike	Qëndrimi ndaj institucioneve të pavarura	2
	Pjesëmarrja në reforma sistemike	1
	Diskursi mbi rendin kushtetues dhe ndërkombëtarët	1

Këto vlera konfirmojnë një nivel të ulët të përputhshmërisë me kriteret që Ziblatt i atribuon partive konservatore që kontribuojnë në konsolidimin demokratik. Me fjalë të tjera, PD gjatë viteve 1997–2005, ndonëse rifitoi pushtetin në vitin 2005, nuk ndërtoi themelet e një partie konservatore të institucionalizuar, por mbeti një formacion opozitar populist, me organizim vertikal, mungesë kulture vetëpërmbytjeje dhe përdorim taktik të institucioneve.

Në vend të përfaqësonte një konservatorizëm demokratik si në rastet që Ziblatt përshkruan në Evropën Perëndimore, PD në këtë fazë veçoi si një formacion hibrid, i cili shfaqte trajta të jashtme të organizimit formal, por që në thelb funksiononte përmes besnikërisë personale ndaj liderit dhe përmes retorikës konfliktuale. Ky model i sjelljes jo vetëm që nuk kontribuoi në konsolidimin e rendit demokratik, por në fakt ushqeui një kulturë politike të polarizuar, që do të përshkruante edhe dekadën pasuese të tranzicionit shqiptar.

Në perspektivën e një teorie normative për ndërtimin e demokracisë, kjo periudhë për PD-në nuk duhet parë thjesht si opozitë e natyrshme, por si dëshmi e mungesës së një konservatorizmi të strukturuar që respekton rregullin institucional dhe përgjegjshmërinë demokratike.

Sa i takon variablit të varur, atij që mat konsolidimin e demokracisë ai ecën paralelisht ose në proporcion të drejtë me vlerat e variablit të pavarur. Këtu kemi tabelën me të dhënat e sakta të vlerave të secilit indikator të variablit tonë të varur.

Tabele 1.3

Viti	FH (0–1)	V-Dem Parti (0–1)	V-Dem Opozitë (0–1)	Roli i opozitës (0–2)
1997	0.33	0.25	0.20	0
1998	0.38	0.28	0.22	1
1999	0.42	0.30	0.25	1
2000	0.45	0.33	0.30	1
2001	0.48	0.36	0.32	1
2002	0.50	0.38	0.34	2
2003	0.52	0.40	0.36	2
2004	0.55	0.43	0.38	2
2005	0.58	0.45	0.40	2

Duhet thënë se për indeksin FH (0–1) të dhënat janë normalizuar nga Freedom House (1 = më e lirë, 0 = jo e lirë)., për indeksin V-Dem Parti/Opozitë është përdorur vlerësim i V-Dem për funksionimin e partive politike (ruling dhe opposition).

Për indeksin e fundit roli i opozitës (0–2) është përdorur vlerësim ordinal (dmth rendor) ku 0 = bojkot i institucioneve dhe mungesë konstruktiviteti, 1 = pjesëmarrje e pjesshme dhe konfrontim i lartë dhe 2 = pjesëmarrje aktive, rol konstruktiv dhe negociata institucionale.

Siç shihet, pas krizës së vitit 1997 dhe bojkotit të plotë opozitar, ka një rritje graduale në të gjithë treguesit:

- Freedom House tregon një përmirësim të vazhdueshëm të lirisë politike.
- V-Dem raporton rritje si për kapacitetin e partive në pushtet, ashtu edhe për opozitën.
- Roli i opozitës kalon nga mosfunksionimi i plotë (0) drejt një sjelljeje më konstruktive (2) pas vitit 2002, kur PD rikthehet në Parlament dhe merr pjesë aktive në reformat institucionale.

Ky trend tregon një normalizim të pjesëmarrjes politike dhe një konsolidim të pjesshëm të institucioneve demokratike, ndonëse mbeten sfida strukturore në përfaqësim dhe llogaridhënie gjë që duhet thënë se çoi në fakt në një parti demokratike më të fortë dhe që fitoi zgjedhjet e vitit 2005.

6.3 Qeverisja 2005–2013, konsolidimi institucional shoqëruar dhe tensionet e brendshme

Zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 u shenjua nga një përmbysje e balancës së pushtetit, duke rikthyer Partinë Demokratike në qeverisje pas tetë vitesh opozitë. Fitorja e PD-së dhe krijimi i një shumice parlamentare me aleatë të vegjël u përshkrua si provë se alternanca politike po kthehej në një tipar normal të sistemit (OSCE/ODIHR, 2005). Për herë të parë pas vitit 1997, rrotacioni, ndryshimi i pushtetit, u realizua pa krizë të menjëhershme legjitimiteti.

Megjithatë, raportet e monitorimit vlerësuan se procesi zgjedhor mbeti larg standardeve evropiane, për shkak të listave të papërditësuara të zgjedhësve, presionit mbi administratën publike, manipulimeve gjatë numërimit (OSCE/ODIHR, 2005). Qeveria e re e PD-së ndërtoi një axhendë të qartë: luftën ndaj korrupsionit, përmirësimin e infrastrukturës dhe avancimin e integritimit euroatlantik. Gjatë mandatit qeverisës 2005–2009, një nga prioritetet kryesore u shënua nga ndërmarrja e reformave administrative dhe realizimi i projekteve të mëdha infrastrukturore me karakter strategjik. Përpjekjet reformuese u fokusuan në dixhitalizimin e regjistrave civilë, modernizimin e administratës tatimore dhe përmirësimin e transparencës në shërbimet publike. Krahës tyre, investimet kapitale në infrastrukturë u shndërruan në simbol të axhendës zhvillimore.

Projekti më emblematic i kësaj periudhe ishte ndërtimi i *Rrugës së Kombit*, me një kosto të përgjithshme që tejkaloi 1 miliard euro, i konceptuar si një korridor strategjik për të lidhur Shqipërinë me Kosovën dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik rajonal (Bankëatch, 2012). Ky projekt kontribuoi në lehtësimin e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, si dhe krijoi një dimension të ri simbolik të afrimit ndër-shqiptar. Megjithatë, procesi i realizimit të tij u shoqërua me kritika të ashpra lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së kontraktorëve dhe transparencën e procedurave të tenderimit. Sipas raportit të Bankës Botërore (2011), kontratat për ndërtimin e këtij segmenti u lidhën pa garë ndërkombëtare të hapur, duke e bërë procesin të prekshëm nga praktika klienteliste dhe duke rritur rrezikun e abuzimeve financiare. Për më tepër, financimi i projektit kontribuoi ndjeshëm në rritjen e borxhit publik, duke shtuar presionin mbi stabilitetin fiskal në një periudhë kur ekonomia globale po përballlej me sfida të mëdha.

Ky rast ilustron tensionin midis nevojës për investime infrastrukturore afatgjata dhe domosdoshmërisë për të respektuar standardet e qeverisjes së mirë, konkurrencës së ndershme dhe përgjegjshmërisë fiskale. Në planin ndërkombëtar, Shqipëria gjatë dekadës së parë të shekullit XXI shënoi dy objektiva historike që simbolizuan përfundimisht kthesën strategjike drejt integritit euroatlantik.

Së pari, më 1 prill 2009, vendi u bë anëtar i plotë i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), duke finalizuar një proces të nisur menjëherë pas rënies së regjimit komunist dhe që kishte si qëllim sigurimin e një arkitekture të qëndrueshme sigurie dhe forcimin e lidhjeve me Perëndimin (Ministria e Punëve të Jashtme, 2009). Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO u konsiderua një moment i rëndësishëm jo vetëm nga pikëpamja gjeopolitike, por edhe si konfirmim i përparimeve të arritura në modernizimin e forcave të armatosura dhe përafrimin e standardeve institucionale me praktikatat euroatlantike (Ministria e Punëve të Jashtme, 2009).

Së dyti, në dhjetor 2010, qytetarët shqiptarë përfituan liberalizimin e vizave për zonën Schengen, pas një procesi të gjatë verifikimi teknik dhe politik që zgjati disa vite dhe kërkoi plotësimin e kritereve të ashpra në fushat e kontrollit kufitar, menaxhimit të migracionit, sigurisë së dokumenteve dhe luftës kundër korrupsionit (European Commission, 2010). Liberalizimi i vizave u përjetua si një hap simbolik drejt normalizimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian dhe si një njohje e përparimeve në procesin e reformave.

Këto dy arritje të rëndësishme – anëtarësimi në NATO dhe liberalizimi i lëvizjes së lirë – kontribuan në konsolidimin e perceptimit të identitetit euroatlantik të shtetit shqiptar dhe në forcimin e legjitimitetit të projekteve të integritit evropian (Elbasani, 2013). Megjithatë, pavarësisht suksesit diplomatik, raportet periodike të Komisionit Evropian theksonin në mënyrë të përsëritur se Shqipëria mbetej e brishtë në planin e brendshëm institucional. Sipas Komisionit Evropian (2010), vendi nuk kishte arritur konsensus politik mbi reformat madhore kushtetuese dhe administrative, ndërsa fenomeni i kapjes së institucioneve nga interesat partiake dhe klienteliste vazdhonte të minonte funksionimin e shtetit të së drejtës dhe procesin e konsolidimit demokratik.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 u zhvilluan në një klimë të ngarkuar politike, ku trashëgimia e konfliktit PD–PS që nga viti 1997 kishte prodhuar një kulturë të konfliktit kronik. Pas humbjes së zgjedhjeve të vitit 2005 Partia Socialiste hyri në një fazë të vështirë. Kryetari i saj Fatos Nano dha dorëheqjen dhe në në vend të tij u zgjodh kryetari i PS-së Edi Rama. Partia Socialiste pati vështirësi në gjetjen e një ekuilibri brenda gjithë opozitës dhe veprimt të saj politik. Një vit më parë nga PS-ja ishte shkëputur ish kryeministri Ilir Meta me një grup drejtuesish të sja dhe kishin formuar partinë Lëvizja Socialiste për Integritim. LSI e kishte pozicionuar veten si forcë e tretë, që pretendonte të përfaqësonte një model më pragmatik të socialdemokracisë, i distancuar nga personalizimi ekstrem i PS-së dhe nga konfliktualiteti i vazdhueshëm PD–PS (Elbasani, 2013). LSI pretendonte se përfaqësonte më mirë dhe më drejt të majtën. Ajo madje kërkoi të krijohte një lidhje me trashëgiminë enveriste duke përfshirë në drejtim të saj figura politike që kishin një lidhje funksionale me Partrinë e Punës ose me trashëgimin e saj. Gjithashtu ajo përdorte një gjuhë më afër Luftës Nacional çlirimtare, (Luftës Partizane) dhe veteranëve me qëllim që të krijonte një lidhje të shkurtër me elektoratin bazë të PS-së. Gjithsesi konflikti PS-

LSI përkohësisht përfundoi dhe në zgjedhjet lokale të vitit 2007 ato fituan qartë dhe thellë ndaj PD-së.

Nga ana tjetër, qeverisja e PD-së (2005–2009) synoi të paraqitej si më efikase dhe më e orientuar drejt reformave integruese. Ndër iniciativat më të rëndësishme të kësaj periudhe ishin miratimi i ligjit të dekriminalizimit të zgjedhjeve, nisja e reformës administrative-territoriale dhe intensifikimi i negociatave për liberalizimin e vizave me BE (European Commission, 2009). Megjithatë, kritikët për kapjen e institucioneve, kontrollin e medias publike dhe përdorimin e pushtetit për qëllime elektorale ishin të pranishme dhe krijuan një terren mosbesimi.

Zgjedhjet e 28 qershorit 2009 u zhvilluan nën një kuadër të reformuar ligjor dhe me mbikëqyrje të gjerë ndërkombëtare. Pati një ndryshim të rëndësishëm të Kushtetutës në një marrëveshje jo transparente mes PS-së dhe PD-së në të cilën kompetencat e kryeministrit u rritën dhe u ndryshua ligji zgjedhor duke u bërë proporcional dhe duke i dhënë fuqi të madhe kryetarëve të partive në hartimin e listës së kandidatëve. Në zgjedhjet e vitit 2009 gjithësi problemet nuk munguan. Sipas OSBE/ODIHR (2009), administrimi teknik ishte më i përmirësuar krahasuar me ciklin e vitit 2005, veçanërisht për shkak të përdorimit të listave të reja zgjedhore dhe trajnimit të komisionerëve. Pavarësisht këtyre përparimeve, procesi nuk arriti të evitojë pretendimet për parregullsi. Raporti i OSBE tha se dokumentoi raste presionesh mbi administratën publike, se fushata u karakterizua nga retorikë polarizuese dhe numërimi i votave zgjati javë të tëra, duke krijuar dyshime mbi integritetin e rezultatit.

Përfundimisht, shpërndarja e mandateve ishte tepër e ngushtë. PD mori 68 mandate, PS mori 65 dhe LSI mori 4 mandate. Në një kënd më të gjerë koalicioni i PS-së mori 66 mandate, ai i PD-së 70 mandate dhe LSI-ja mori 4 mandate. Pra PD-ja nuk mund të formonte një qeveri dhe PS bashkë me LSI-në nuk mund të formonte dot një qeveri. Marrëveshja për koalicion mes PD-së dhe LSI-së u firmos më 4 shtator 2009. Në planin formal, ky bashkëpunim synonte të sigurojë një shumicë të qëndrueshme për reformat europiane dhe miratimin e ligjeve të rëndësishme që kërkonin shumicë të cilësuar. Elbasani (2013) e ka interpretuar këtë lëvizje si një shenjë të “maturimit pragmatik” të sistemit politik shqiptar, ku për herë të parë ndarjet klasike mes së majtës dhe së djathtës relativizoheshin në funksion të qeverisjes.

Por një pjesë e madhe e opinionit publik dhe analistëve ndërkombëtarë e panë marrëveshjen si shembull të oportunitetit politik. Bieber (Bieber, 2015) thekson se LSI, që deri atëherë kishte denoncuar PD-në si forcë autokratike, brenda natës ndryshoi kurs për interesa pushteti. Kjo sjellje e kontribuoi më tej në normalizimin e kulturës politike klienteliste, ku koherenca programore humbte rëndësinë përballë përfitimeve të pushtetit ekzekutiv (Bieber, 2015). Pas shpalljes së rezultatit, Partia Socialiste refuzoi të pranonte legjitimitetin e zgjedhjeve, duke pretenduar manipulim sistematik të numërimit. Për më shumë se gjashtë muaj, PS bojkotoi Kuvendin, duke e zhvendosur betejën politike në rrugë përmes tubimeve dhe protestave masive. Ky bojkot paralizoi pjesërisht procesin e ligjbërjes dhe krijoi një krizë legjitimiteti institucional që ndikoi negativisht perceptimin ndërkombëtar për stabilitetin politik të Shqipërisë (Freedom House, 2010). Në retrospektivë, ngjarjet e 2009–2010 dëshmuar dy tendenca kontradiktore: nga njëra anë, përpjekjet për të ndërtuar një sistem më teknik dhe të konsoliduar zgjedhor; nga ana tjetër, instrumentalizimin e institucioneve për përfitime politike dhe mungesën e etikës së kompromisit demokratik.

Në raport me zgjedhjet e vitit 2005, ku rotacioni i pushtetit ndodhi me një shumicë të qartë të PD-së, procesi i 2009 ishte më kompetitiv por edhe më konfliktual. Nëse 2005 simbolizonte një moment të shpresës për depolarizim dhe konsolidim të procedurave demokratike, 2009 konfirmoi se Shqipëria mbetej një demokraci e brishtë me deficit besimi, pra me mosbesim të thellë, midis aktorëve politikë.

Në krahasim me zgjedhjet e vitit 2013, ku PS–LSI përmbysën qeverinë e PD-së me një fitore të thellë, rezultati i 2009 tregon qartë se stabiliteti politik varej më shumë nga kalkulime afatshkurtra sesa nga rregullat e qëndrueshme të lojës demokratike. Ndërkohë, lëvizja e LSI me kalimin nga një koalicion me të djathtën në një koalicion me të majtën vetëm katër vjet më vonë e vulosi perceptimin e saj si forcë oportuniste. Patiu shuëm zëra që e quajtën madje klienteliste (Bieber, 2015).

Këto ngjarje kanë pasur disa pasoja strukturore serioze. Ato normalizuan kulturën e “koalicioneve të interesit”, duke dobësuar ndarjet ideologjike dhe konsoliduan modelin e partive klienteliste që kontrollojnë burimet shtetërore si mjet legjitimimi. Kriza e besimit qytetar ndaj institucioneve dhe procesit zgjedhor u thellua. Siç ka theksuar Bieber (Bieber, 2015), Shqipëria në këtë periudhë përfaqëson modelin e “demokracisë hibride”, ku procedurat zgjedhore bashkëjetojnë me praktika autoritare dhe konflikt të vazdheshëm institucional.

Gjatë këtij mandati qeverisës ndodhën edhe ngjarjet e rënda të 21 janarit. Protesta e 21 janarit të vitit 2011 përfaqëson një nga momentet më dramatike të përplasjes midis pushtetit ekzekutiv dhe opozitës në periudhën postkomuniste të Shqipërisë, duke bërë të dukshme brishtësinë e institucioneve demokratike dhe polarizimin ekstrem politik. Shkaku i drejtpërdrejtë i tensioneve ishte publikimi i një video-regjistrimi nga televizioni Top Channel, ku zëvendëskryeministri i atëhershëm Ilir Meta dyshohej se negocionte përfitime financiare në lidhje me kontratat publike të hidrocentraleve (Balkan Insight, 2011). Ky skandal ushqeu indinjatën qytetare dhe i ofroi opozitës së drejtuar nga Partia Socialiste një motiv mobilizues për të sfiduar legjitimitetin moral të qeverisë së kryeministrit Sali Berisha dhe për ti dhënë gjithashtu një mjet më të madh në dorë opozitës të legjitimonte veten pas humbjes së vitit 2009 dhe vështirësive politike në opozitë.

Më 21 janar 2011, mijëra qytetarë u mbledhën në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” përpara godinës së Kryeministrit. Protesta, e cila fillimisht u paraqit si manifestim paqësor kundër korrupsionit dhe mungesës së transparencës, degjeneroi në përplasje të dhunshme mes demonstruesve dhe forcave të Gardës së Republikës. Në këtë përballje, pjesëtarë të Gardës përdorën armë zjarri kundër turmës, duke vrarë katër protestues: Ziver Veizi, Aleks Nika, Hekuran Deda dhe Faik Myrtaj. Pamjet televizive, ku shihej një protestues i plagosur nga goditja direkte e një plumbi, tronditën opinionin publik dhe shkaktuan një krizë legjitimiteti të paprecedentë (OSCE/ODIHR, 2011).

Organizata të njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si Human Rights Watch (Human Rights Watch, 2011), theksuan se autoritetet shqiptare nuk realizuan një hetim të pavarur, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm mbi përdorimin e forcës vdekjeprurëse. Në vend të transparencës dhe përgjegjësisë, procesi gjyqësor që pasoi u perceptua gjerësisht si i politizuar dhe i orientuar për të mbrojtur strukturat e ekzekutivit. Raporti i Komisionit Evropian (2011) vlerësoi se ngjarja e 21 janarit nxori në pah dobësinë e sistemit të drejtësisë për të garantuar

ndarjen e pushteteve dhe llogaridhënien. Ambasada amerikane në Tiranë tha se me anë të një deklarate se “ata ishin të tronditur” nga vendimi i Gjykatës së Tiranës e cila nuk dha fajësi për vrasje.

Përtej aspektit penal dhe ligjor, 21 janari u shndërrua në një simbol të krizës së thellë të besimit politik dhe qytetar në Shqipëri. Polarizimi i diskursit publik, demonizimi i kundërshtarit politik dhe retorika përjashtuese u bënë pjesë e përditshmërisë politike, duke e minuar më tej konsensusin institucional që kishte nisur të konsolidohej pas viteve të trazuara 1997–2001 (Elbasani, 2013). Për opozitën, viktimat e protestës u kthyen në emblemë të represionit shtetëror dhe të padrejtësisë, ndërsa për qeverinë, episodi u interpretuar si një përpjekje për destabilizim politik, si një grusht shteti i cili dështoi.

Në retrospektivë, 21 janari dëshmoi jo vetëm për mungesën e një kulture demokratike të dialogut dhe kompromisit, por edhe për kapjen e institucioneve të drejtësisë nga pushteti ekzekutiv, një fenomen që ka penguar sistematikisht konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri (Freedom House, 2012). Ky moment përbën një nga ato pika kthese ku historia politike e vendit u nda edhe më shumë në dy kampe antagonistë, dhe ku retorika e hakmarrjes politike u ngulit si pjesë e natyrshme e konkurrencës elektorale.

Deri në prag të krizës financiare globale të vitit 2008, Shqipëria shënonte nivele të larta të rritjes ekonomike, me norma që tejkalonin mesatarisht 6% në vit, të mbështetura nga remitancat, investimet e huaja direkte dhe një politikë aktive infrastrukturore (Eorl Bank, 2010). Kjo periudhë ishte karakterizuar nga një atmosferë optimizmi të fortë makroekonomik dhe një diskurs politik që e lidhte rritjen e shpejtë me suksesin e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut dhe integrimit euroatlantik.

Kriza globale financiare ndikoi ndjeshëm në ekonominë shqiptare duke shkaktuar një ngadalësim të menjëhershëm të rritjes. Në vitin 2009, ritmi i rritjes ekonomike ra në 3.3%, ndërsa deri në vitin 2012 arriti nivelin më të ulët, vetëm 1.3% (INSTAT, 2013). Ky ngadalësim u reflektua në disa indikatorë kyç. Pati ulje të ndjeshme të remitancave të cilat në vitin 2008 përbënin mbi 9% të PBB-së (Bank of Albania, 2009), pati rënie të investimeve private dhe konsumit, si dhe dobësim të aftësisë së sektorit bankar për të kredituar ekonominë.

Përballë kësaj krize, qeveria ndoqi një strategji të dyfishtë. Nga njëra anë, ajo ruajti retorikën zhvillimore, duke promovuar vazhdimin e investimeve të mëdha publike në infrastrukturë si element të legjitimitetit politik dhe mjet për të zbutur pasojat e krizës (Beqiraj, 2015). Nga ana tjetër, niveli i deficitit buxhetor u rrit, duke e çuar borxhin publik nga 54% e PBB-së në vitin 2008 në mbi 62% në vitin 2013 (IMF, 2014). Ky zgjerim fiskal, në një klimë të ngadalësimit ekonomik, e rriti ekspozimin e financave publike ndaj riskut të qëndrueshmërisë afatgjatë.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2014), shpenzimet kapitale që ishin rreth 8% e PBB-së në vitin 2009 mbetën të larta, ndërkohë që të ardhurat fiskale nuk i ndoqën ritmet e shpenzimeve. Në këtë kontekst, autorë të ndryshëm argumentojnë se zgjedhja për të ruajtur një profil të lartë të investimeve publike ishte e lidhur jo vetëm me konsiderata ekonomike, por edhe me një logjikë politike të ruajtjes së mbështetjes elektorale dhe të krijimit të

imazhit të zhvillimit, veçanërisht përmes projekteve simbolike infrastrukturore si Rruga e Kombit (Bankëatch, 2012; Elbasani, 2013).

Kriza ekonomike solli gjithashtu rritje të papunësisë dhe rënie të ndjeshme të besimit të konsumatorëve, duke ekspozuar dobësitë strukturore të modelit ekonomik të bazuar te remitancat dhe konsumi privat. Përballë këtyre sfidave, reformat fiskale mbetën pjesërisht të papërfunduara, ndërsa përpjekjet për konsolidim fiskal pas vitit 2013 u shoqëruan me debate të forta politike dhe sociale mbi kostot e tyre afatshkurtra (European Commission, 2014).

Pavarësisht konsolidimit të një forme institucionale demokratike, Shqipëria mbeti e karakterizuar nga një polarizim ekstrem politik, i cili minoi në mënyrë të përsëritur besimin publik te institucionet. Raportet ndërkombëtare të Freedom House (2012) vlerësuan se vendi kishte zhvilluar një “strukturë formale të demokracisë pluraliste”, por se mungesa e konsensusit politik për reformat madhore, kapja e institucioneve publike dhe politizimi i skajshëm i medias vazdhonin ta kufizonin funksionimin e saj real. Kjo situatë ishte veçanërisht e evidente gjatë periudhës pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009, kur raportet e OSBE-së dhe të Komisionit Evropian evidentuan tensione të larta politike, bllokim të procesit legjislativ dhe bojkot të Kuvendit nga opozita.

Një episod kritik që pasqyroi dobësinë e institucioneve dhe krizën e besueshmërisë demokratike ishte procesi i numërimit të votave për Bashkinë e Tiranës në zgjedhjet lokale të majit 2011. Fillimisht, rezultati paraprak shpallte fitues kandidatin e opozitës, Edi Rama, me një diferencë të ngushtë prej 10 votash. Megjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas interpretimit të votave të kontestuara – përfshirë zarfe që ishin hedhur gabimisht në kutitë e tjera (vota për kryetar bashkie ishte hedhur gabimisht nga votuesi në kutinë e caktuar për votat për anëtarë të Këshillit Bashkiak)– ndryshoi rezultatin në favor të kandidatit të mazhorancës, Lulzim Basha (OSCE/ODIHR, 2011). Ky vendim u shoqërua me polemika të forta ligjore dhe politike, protesta publike dhe një përkeqësim të mëtejshëm të perceptimit për pavarësinë e KQZ-së dhe gjyqësorit. Raporti final i OSBE-së konkludoi se ky rast ekspozoi “mangësi serioze në kuadrin ligjor dhe praktikën zgjedhore” dhe theksoi se procesi i apelit ishte i ndikuar nga përplasjet politike.

Për më tepër, sipas Bieber (Bieber, 2015), Shqipëria pas viteve 2000 krijoi një model që në pamje të parë i ngjante një demokracie funksionale, por në thelb mbetej i brishtë, pasi aktorët politikë shfrytëzonin çdo vakum ligjor dhe institucionet e pavarura për qëllime strategjike.

Në këtë klimë, edhe reformat e drejtësisë apo proceset e integrimit evropian shpesh perceptoheshin nga publiku si instrumente të luftës politike. Kapja e medias publike dhe përdorimi selektiv i Prokurorisë së Përgjithshme për të hetuar eksponentë të opozitës shtuan ndjesinë e mungesës së garës së ndershme dhe të barazisë para ligjit thoshte raporti i progresit i Bashkimit Evropian (European Commission, 2011).

Ky kontekst i tensionuar polarizoi më tej shoqërinë dhe prodhoi një kulturë politike të mosbesimit të ndërsjellë, ku legjitimiteti i zgjedhjeve dhe autoriteti i institucioneve interpretoheshin kryesisht si funksion i forcës relative të palëve në konflikt.

Periudha 2005–2013 përbën një fazë paradoksale të tranzicionit politik shqiptar, e cila mund të përshkruhet si një tranzicion me dy fytyra. Nga njëra anë, Shqipëria njohu arritje të padiskutueshme simbolike dhe integruese, ndër më të rëndësishmet në historinë e saj moderne. Në prill 2009, vendi u anëtarësua në NATO, duke finalizuar një aspiratë të gjatë për sigurinë kolektive dhe rikthimin në hapësirën euroatlantike (Ministria e Jashtme, 2009). Në dhjetor 2010, qytetarët shqiptarë fituan të drejtën e lëvizjes pa viza në zonën Schengen, një moment që përjetohej si dëshmi e pjekurisë institucionale dhe përmbushjes së standardeve evropiane (European Commission, 2010). Po gjatë kësaj periudhe, qeveria nisi projekte të mëdha infrastrukturore, si ndërtimi i Rrugës së Kombit dhe modernizimi i rrjeteve energjetike dhe rrugore. Këto investime u paraqitën si bazë materiale e modernizimit dhe forcimit të kohezionit kombëtar.

Nga ana tjetër, pas fasadës së përparimit simbolik, mbijetuan dhe u thelluan tensionet kronike të sistemit politik shqiptar. Raportet ndërkombëtare vërenin përkeqësimin e cilësisë së demokracisë procedurale dhe konsolidimit institucional. Polarizimi ekstrem mes forcave kryesore politike shndërrohej në pengesë strukturore për dialogun dhe kompromisin. Një nga episodet më të qarta ishte kriza pas zgjedhjeve lokale të Tiranës më 2011, ku rezultati i ngushtë ndryshoi pas interpretimit të kontestuar të votave të pavlefshme, duke tronditur më tej besimin te integriteti zgjedhor (OSCE/ODIHR, 2011). Ngjarjet e 21 janarit 2011, me vrasjen e katër protestuesve gjatë demonstratës kundër qeverisë, zbuluan dobësinë e kulturës demokratike dhe dështimin e institucioneve të drejtësisë për të garantuar llogaridhënie dhe hetim të paanshëm (Human Rights Watch, 2011).

Një element tjetër kritik i kësaj periudhe ishte përhapja e perceptimit për kapjen e institucioneve. Raportet e progresit të Komisionit Evropian nënvizonin vazdhimisht ndërhyrjen politike në administratë dhe mungesën e ndarjes reale të pushteteve. Ndërkohë, media publike dhe një pjesë e madhe e mediave private mbetën të politizuara dhe të varura nga interesa ekonomike të lidhura me qeverinë (European Commission, 2012).

Si rezultat, procesi i konsolidimit demokratik, megjithëse i shoqëruar nga retorikë e vazhdueshme integruese dhe reforma ligjore, mbeti më shumë formal sesa funksional. Institucionet demokratike ekzistojnë në letër dhe në simbolikë, por në praktikë funksionimi i tyre varej nga vullneti i liderëve politikë dhe marrëdhëniet e tyre të tensionuara. Ky dualitet e shndërroi tranzicionin e Shqipërisë në një proces ku progresi i jashtëm bashkëjetonte me dobësi të brendshme strukturore, duke krijuar një regjim që studiues të ndryshëm e kanë përshkruar si “demokraci hibride” (Bieber, 2015).

Në këtë kuptim, periudha 2005–2013 ishte një kohë e arritjeve të rëndësishme, por edhe e dështimit për të ndërtuar një kulturë politike të bazuar mbi kompromisin, llogaridhënien dhe funksionimin e pandikuar institucional.

Gjatë periudhës së qeverisjes së dytë të PD-së 2005-2013 variablat e pavarur dhe indikatorët e tyre matës kishin ndryshuar qartë krahasuar me periudhën 1992-1997 por ndryshuan gjithashtu edhe gjatë viteve. Në lidhje me variablin e parë të pavarur atë të forcës dhe organizmit të partisë mund të themi se ajo në vitin 2005 ishte relativisht e madhe. Ajo kishte një numër anëtarësh që shkonte deri në 120-130 mijë anëtarë (Rilindja demokratike, 2005). PD-ja ishte e organizuar në

gjithë vedin me degë që funksiononin në çdo qytet dhe çdo fshat. PD-ja arriti të fitonte në zgjedhjet e vitit 2005 pas një fushate të mirë, humbi në zgjedhjet lokale të vitit 2007 për shkak të krizës energjettike dhe për shkak të koalicionit PS-LSI. PD arriti të formojë një qeveri në vitin 2009 por nuk i fitoi dot zgjedhjet e vetme. Mori, siç e thamë më lart, 70 mandate. Në vitin 2011 fitoi bashkinë e Tiranës por me shumë vështirësi dhe humbi në bashkitë kryesore të vendit. Humbi rëndë zgjedhjet e vitit 2013 dhe ra në opozitë. Sa i takon indikatorit që mat centralizmin në përzgjedhjen e kandidatëve mund të thuhet se ato në vitin 2005 ajo u bë në mënyrë institucionale dhe më pas u bë nga kryeministri Berisha dhe grupet e tjera të pushtetit (Elbasani, 2020).

Variabli i institucionalizmit të PD-së ndryshoi shumë nga koha në kohë gjatë kësaj periudhe por dominimi i berishës ishte i qartë. Nuk pati rotacion të brendshëm dhe institucionet e partisë ishin formale. Përcaktimi ideologjik ishte kaotik dhe varësia nga një figurë karizmatike ishte shumë e lartë. Zgjedhjet e brendshme funksionuan pak dhe formalisht.

Variabli i tretë ai sjellejs në momente krizash është gjithashtu i lëvizshëm. PD dhe qeveria e saj nuk patën përgjigjen e duhur ndaj ngjarjes së Gerdecit, ndaj ngjarjes së 11 janarit të vitit 2011 madje në 11 janar patiu një sjellje plotësisht antiinstitucionale. Deklarat kanë qenë të gjitha jo parimore dhe PD-ja nuk arriti që në moment kyç të asaj periudhe të sillej si parriu institucionale e modleit ziblatian.

Variabli i katërt gjithashtu ai i qëndrimit ndaj institucioneve kushteuese si KQZ, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria etj është ai i ndjekjes së interesit politik të momentit (Elbasani, 2020). Kqz në përgjithësi u mbrojt fort. Prokurroia qoftë nën drejtimin Sollakut, qoftë nën drejtimin e Ina Ramës u sulmua. Gjykata Kushtetuese u sulmua në disa raste.

Tabela e Zgjeruar për Periudhën 2005–2013

Tabela 1.4

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
Forca dhe organizimi i partive të djathta	Numri i anëtarëve dhe degëve lokale	4
	Përzgjedhja e kandidatëve	3
	Performanca zgjedhore	4
Institucionalizimi i partive të djathta	Rotacioni i lidërshpit	3
	Funksionimi i strukturave statutore	4
	Identiteti ideologjik dhe orientimi programor	4
Sjellja në momente krizash	Qëndrimi në krizat (2008, 2011)	4
	Deklaratat publike gjatë krizave	3
	Pjesëmarrja në marrëveshje politike	4

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike	Qëndrimi ndaj institucioneve të pavarura	4
	Pjesëmarrja në reforma sistemike	4
	Diskursi mbi rendin kushtetues dhe ndërkombëtarët	4

Nga gjithë këto të dhëna vëmë re se gjatë periudhës 2005–2013, Partia Demokratike e Shqipërisë shënoi një përmirësim të ndjeshëm në raport me standardet e institucionalizimit dhe angazhimit demokratik, në krahasim me periudhën 1992–1997. Kjo periudhë përkon me një qeverisje më të qëndrueshme, rindërtim të strukturave dhe një ripozicionim më institucional në arenën politike. Kësisoj forca dhe organizimi i partisë u shfaq nëpërmjet një rrjeti të konsoliduar degësh lokale dhe një baze elektorale të mobilizuar (vlerësimi: 4), ndonëse përzgjedhja e kandidatëve mbeti e centralizuar (3), duke reflektuar mungesën e plotë të hapjes.

Institucionalizimi i partisë tregoi përparime të konsiderueshme. Strukturat statutore funksionuan më mirë dhe identiteti programor mori formë më të qarta ideologjike të qendrës së djathtë (vlerësim 4), megjithëse mungesa e garës së brendshme për lidërsipin reflektonte një mungesë të rotacionit real (3).

Sjellja në momente krizash ishte më konstruktive se në të kaluarën. Në krizat politike të 2008 dhe 2011 (Gërdeci dhe 21 janari), PD ruajti qëndrime më të moderuara ndonëse nuk u soll në mënyrë institucionale dhe mori pjesë në procese kompromisi (vlerësime mes 3–4), duke reflektuar një rol më të përgjegjshëm.

Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike ishte ndoshta aspekti më i fortë i PD në këtë periudhë. Ajo mbështeti reforma të rëndësishme, bashkëpunoi me aktorët ndërkombëtarë dhe mbajti një diskurs pro-europian (vlerësim 4 në të tre indikatorët), duke e pozicionuar veten si një mbështetëse e rendit kushtetues dhe integritit euroatlantik.

Pra në kuadrin e modelit të Ziblatt, periudha 2005–2013 paraqet fazën më të afërt të Partisë Demokratike me funksionin që një parti konservatore duhet të luajë në konsolidimin e demokracisë. Megjithatë, disa dobësi strukturore si mungesa e konkurrencës së brendshme dhe centralizimi i pushtetit e kufizuan plotësisht institucionalizimin.

Variablat e varur dhe indikatorët që i masin ato reflektojnë plotësisht vlerat e variablave të pavarura. Më poshtë po paraqesim të dhënat e sakta të kësaj regjistrimi.

Treguesit e Stabilizimit Demokratik në Shqipëri (2005–2013)

Tabela 1.5

Viti	FH (0–1)	V-Dem Parti (0–1)	V-Dem Opozitë (0–1)	Roli i opozitës (0–2)
2005	0.67	0.42	0.50	2
2006	0.70	0.45	0.52	2
2007	0.72	0.47	0.50	2
2008	0.72	0.50	0.52	2
2009	0.68	0.48	0.45	1
2010	0.65	0.45	0.42	1
2011	0.62	0.43	0.40	1
2012	0.60	0.42	0.42	1
2013	0.65	0.44	0.45	2

Ajo që vihet re nga të dhënat është se gjatë periudhës 2005–2013, Shqipëria përjetoi një nivel mesatar të stabilizimit demokratik, dukshëm më i lartë se në vitet 1992–1997, por me tensione ciklike që ekspozuan brishtësinë institucionale të demokracisë.

Në lidhje me variablin e varur të pluralizmi politik ose indeksit të Freedom House vihet re që shkalla e pluralizmit politik ishte më e lartë se në dekadën e parë postkomuniste, me vlera që variojnë nga 0.60 deri në 0.72, duke reflektuar një mjedis relativisht kompetitiv, me alternim pushteti në vitin 2013 dhe pjesëmarrje të gjerë të partive në zgjedhje. Megjithatë, raportet e Freedom House theksojnë probleme me presionet ndaj medias dhe përdorimin e burimeve shtetërore për avantazh elektoral.

Variabli tjetër ai i institucionalizimi të partive politike (V-Dem Index) tregon se niveli i institucionalizimit të partive u përmirësua krahasuar me vitet '90, me një vlerë mesatare rreth 0.45–0.50. Kjo tregon se PD dhe PS kishin arritur një strukturë më të konsoliduar organizative, megjithatë të dyja mbetën thellësisht të centralizuara dhe të orientuara rreth liderëve (Berisha dhe Rama). Mungesa e demokracisë së brendshme dhe dominimi i figurave karizmatike kufizuan më tej institucionalizimin real.

Roli i opozitës ishte relativisht funksional gjatë viteve të para të qeverisjes së PD-së (2005–2008), por pas zgjedhjeve të diskutueshme të vitit 2009, opozita socialiste hyri në një cikël bojkotesh, krizash dhe përplasje politike, duke e ulur ndjeshëm efektivitetin e saj institucional (vlerësime rreth 0.40–0.45 në indeksin V-Dem). Vetëm pas rotacionit të vitit 2013 u rikthye një klimë më konstruktive.

Pavarësisht se pluralizmi dhe rotacioni ekzistonin formalisht, në praktikë, shpesh mungonte bashkëpunimi ndërpartiak, rregullat e lojës politike ishin të kontestuara dhe institucione si KQZ, gjykatat dhe Kuvendi nuk perceptoheshin si neutralë. Kjo tregon një demokraci elektorale me tipare të deformuara, ku mbijetesa në pushtet ishte shpesh më e rëndësishme se vetë procesi demokratik.

Kështu periudha 2005–2013 paraqet një fazë kalimtare drejt konsolidimit demokratik, me përparime strukturore, por me një elitë politike që vazhdimisht minonte institucionet për përfitime afatshkurtra. Në krahasim me vitet 1992–1997, ka përmirësim të dukshëm, por mungesa e rregullave të pranuar reciprokisht nga palët mbeti një pengesë kyçe për stabilizimin e plotë të demokracisë.

6.4 Gjendja dhe sjellja e PD-së pas vitit 2013. Dobësim, bojkot dhe delegjitimim i proceseve

Humbja në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, ku koalicioni i majtë i përbërë nga Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim fitoi 83 mandate përballë 57 mandateve të Partisë Demokratike, përfaqësoi një moment kritik në historinë e pastranzicionit të të djathtës shqiptare. Ky rrotacion politik, ndonëse formal në kuptimin e demokracisë konkurruese, në realitet shënoi fillimin e një krize strukturore dhe sistemike që do të përcaktonte trajektoren e Partisë Demokratike për dekadën në vijim ndoshta edhe më gjatë.

Studiuesja Arolda Elbasani (Elbasani, 2013), thote se një nga tiparet që karakterizuan qeverisjen e gjatë të PD-së (2005–2013) ishte ndërtimi i një kulture pushteti të përqendruar, ku identifikimi mes partisë dhe institucioneve shtetërore u bë gjithnjë e më i ngushtë. Në këtë kontekst, pushteti ekzekutiv dhe kontrolli mbi administratën publike nuk ishin vetëm instrumente politikash publike, por edhe burime legjitimiteti dhe mjet për të ruajtur kohezionin e brendshëm partiak. Rënia nga pushteti zbuloi një dobësi të thellë të infrastrukturës organizative. Kjo dobësi kishte të bente me faktin që pjesa më e madhe e strukturës territoriale dhe organizatave bazë nuk mbështetej mbi një kulturë të konsoliduar vullnetarizmi dhe angazhimi ideologjik, por mbi mekanizmat e shpërndarjes së burimeve shtetërore dhe ndikimit klientelist.

Në mënyrë ilustrative, një raport i OSBE-së për zgjedhjet e 2013 konstatonte se Partia Demokratike hyri në fushatë duke mbajtur ende një retorikë të fortë suksesesh infrastrukturore dhe integrimi euroatlantik, por kishte humbur aftësinë për të krijuar një narrativë mobilizuese të përshtatur me krizën sociale dhe kërkesën për ndryshim (OSCE/ODIHR, 2013). Ky hendek mes diskursit të qeverisë dhe realitetit shoqëror e thelloi hendekun me pjesë të mëdha të elektoratit, sidomos në zonat urbane dhe tek votuesit e rinj.

Në aspektin organizativ, humbja e pushtetit e zhveshi partinë nga një pjesë e madhe e kapaciteteve të saj mobilizuese, të lidhura me varësinë ekonomike të strukturave lokale nga fondet dhe punësimet publike. Kjo u reflektua në fragmentimin e lidhshërit lokal, i cili në disa raste kaloi në opozitë pasive ose migroi drejt forcave të tjera politike, në dobësimin e kanaleve të financimit të aktivitetit partiak, që deri atëherë kishin qenë të ndërruar me mundësinë e qeverisjes, mungesën e një plani strategjik të riorganizimit ideologjik dhe strukturor, që do ta shndërronte humbjen elektorale në mundësi për rinovim.

Në vend të një procesi të brendshëm reflektimi dhe hapjeje ndaj ideve të reja, Partia Demokratike mbeti për disa vite e bllokuar në një diskurs delegjitimues ndaj kundërshtarit dhe në një klimë rivaliteti personal brenda elitës drejtuese. Kjo mungesë e kapacitetit për të ndërtuar një opozitë koherente e ndihmoi Partinë Socialiste të konsolidonte pozicionin e saj dominant.

Siç thekson Bieber (Bieber, 2015), kultura e patronazhit që karakterizoi qeverisjen e gjatë të PD-së e kishte kthyer partinë në një strukturë ku lojaliteti personal dhe përfitimi afatshkurtër mbizotëronin ndaj angazhimit ideologjik dhe kapaciteteve institucionale. Pas 2013-ës, ky model u shpërbë me shpejtësi dhe zbuloi dobësinë latente organizative, që do ta shoqëronte Partinë Demokratike në krizën e mëvonshme.

Rënia e Partisë Demokratike pas vitit 2013 është e dukshme dhe vështirësisht e kthyeshme. Ajo nisi të marrë rrugën ose kahjen e ecjes nga nga forcë qendrore në periferinë politike të vendit. Pas vitit 2013, Partia Demokratike hyri në një cikël të gjatë humbesh dhe ç'organizimi, i cili gradualisht e zhveshi atë nga atributet e një force politike me kapacitet përfaqësues dhe konkurrues real. Zgjedhjet lokale të vitit 2015 ishin një pikë kthese e qartë. Reforma territoriale që konsolidoi 373 njësi vendore në 61 bashki e gjeti PD-në të papërgatitur organizativisht dhe të fragmentuar në nivel lokal. Veç kësaj ajo vuajti shumë faktin që vinte nga një humbje e madhe në vitin 2013 dhe nuk kishte gjetur forcë të reflektonte për shkaqet e kësaj humbjeje. Humbja e shumicës dërrmuese të bashkive, përveç goditjes simbolike ekspozoi një varësi kronike nga pushteti shtetëror si mekanizëm kontrolli mbi elektoratin. Vetëm disa bastione tradicionale si Shkodra, Kukësi, Lezha dhe disa bashki periferike mbetën si ishuj simbolikë të mbijetesës politike.

Kjo rënie nuk u përmbys as në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, ku Partia Demokratike regjistroi rezultatin më të dobët në historinë e saj. Ajo mori vetëm 43 mandate. Edhe pse formalisht ruajti një front opozitar me aleatët e vegjël, kjo aleancë nuk i dha as përmasë morale e as besueshmëri programore. Përkundrazi, bojkoti i reformës në drejtësi dhe retorika sistematike e delegjitimitit të proceseve e ngjizën perceptimin se PD ishte një subjekt i bllokadës dhe i konfrontimit retorik, jo një alternativë qeverisëse e disiplinuar.

Këtu duhet thënë se reforma në drejtësi e cila kishte nisur si proces që në gusht të vitit 2015 ishte kthyer në çështjen kryesore politike të vendit por sidomos ishte kthyer në çështjen kryesore që drejtronte mënyrën se si PD-ja vepronte apo sillej politikisht. PD e kudnërshtoi që në fillim reformën si diccka që bëhej nga qeveria dhe kryeministri Rama për qëllime politike dhe për të sulmuar opozitën. Kishte zëra të shumtë që thonin se PD dhe sidomos ish kryetari Berisha kishin drojë se reforma në drejtësi mund të prekte ata drejtpërdrejt. Ishte e qartë se PD pavarësisht gjuhës që thoshte se ishte dakord me reformën në drejtësi por thjesht luftonte që ajo të kontrohej nga Rama ishte kundër reformës në drejtësi. Reforma në drejtësi ishte një projekt ndrkombëtar sidomos i qeverisë amerikane sic ishte shprehur vetë ambasadori Lu apo edhe raportet e BE-së (Komisioni Europian, 2016). PD dukej se do ta radikalizonte veprimin e saj në kundërshtim të reformës në drejtësi. Edhe protesta e vitit 2017 nga shkurti në maj para zgjedhjeve lokale ishte në thelb pjesë e radikalizmit të veprimit politik kundër reformës në drejtësi.

Në këtë sfond, zgjedhjet lokale të vitit 2019 përbëjnë ndoshta kapitullin më të errët të krizës opozitare. Ato u bojkotuan si pasojë e kësaj logjike politike ku kishte hyrë PD-ja. Vendimi për bojkot total të procesit elektoral e dorëzoi pushtetin vendor pothuajse në mënyrë të pakushtëzuar në duart e Partisë Socialiste. Për herë të parë në tranzicionin shqiptar, një parti e vetme kontrollonte praktikisht të gjitha bashkitë e vendit. Ajo që në diskursin opozitar u paraqit si akt

proteste dhe refuzimi, në praktikë përkthehet në zdhukjen e kapilaritetit institucional, në shuarjen e kontaktit organik me shoqërinë dhe në krijimin e një boshllëku të thellë përfaqësimi.

Këtyre humbjeve të njëpasnjëshme iu shtuan pasoja të natyrës strukturore si largimi i figurave historike e influente, përçarja e grupit parlamentar dhe fragmentimi i hierarkisë së drejtimit politik, që deri atëherë kishte mbajtur një kohezion minimal. Besimi brenda vetë PD-së dobësohej vazhdimisht. Reflektimi vazhdimisht bëhej më i dobët ose nuk ishte fare.

Në retrospektivë, dekada pas vitit 2013 është fotografia më e qartë e kalimit të Partisë Demokratike nga një forcë qendrore e sistemit politik në një subjekt që, për shkak të humbjeve të përsëritura, përçarjes së brendshme dhe konsumit simbolik, pafuqisë për të reflektuar dhe ndryshuar e gjeti veten në periferi të skenës politike shqiptare. Në vend të ripërtëritjes programore dhe ideologjike, ajo u ngatërrua në një logjikë bojkoti dhe konfrontimi që, me kalimin e viteve, shndërroi krizën e zakonshme të rotacionit në një krizë të thellë legjitimiteti dhe identiteti.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, në të cilat Partia Socialiste dhe aleanca e saj fituan një shumicë të gjerë (83 mandate nga 140), Partia Demokratike hyri në një fazë të gjatë të dobësimit elektoral dhe krizës së brendshme. Duke mos qenë në gjendje të përballej me konsolidimin e pushtetit të mazhorancës socialiste përmes instrumenteve të zakonshme parlamentare dhe duke mos artikuluar një projekt të qartë alternativ politik, opozita e re pas 2013 zgjodhi gjithnjë e më shumë bojkotin dhe denoncimin publik, zgjodhi radikalizimin si mjet kryesor të aksionit politik (Elbasani, 2018).

Që në vitin 2014, PD ndërmoi disa bojkotime të pjesshme dhe seanca parlamentare u shndërruan shpesh në arenë konfrontimi simbolik. Akuza kryesore ndaj mazhorancës konsistonte në pretendimin për kapjen e shtetit dhe kriminalizimin e politikës, retorikë që u radikalizua pas zgjedhjeve lokale të 2015, ku opozita humbi shumicën e bashkive dhe u gjend më e margjinalizuar institucionalisht. Koha pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015, gushti i atij viti është peridua kur doli në pah ideja dhe nisi procesi i reformës në drejtësi.

Në shkurt 2017, siç e përmendëm pak më lart Partia Demokratike organizoi një protestë të zgjatur, të njohur si “Çadra e Lirisë”, duke ngritur një kamp simbolik përpara Kryeministrit. Kjo protestë nuk ishte vetëm një formë presioni politik, por edhe një performancë publike e pretendimit moral për përfaqësimin e “popullit të vërtetë” kundër një qeverie që akuzohej për illegjitimitet.

Protesta kishte disa dimensione të veçanta. Ajo ishte e paracaktuar për të zgjatur me javë të tëra, duke e shndërruar protestën nga një ngjarje politike në një ritual të përditshëm të rezistencës. Protesta u ndërtua mbi simbolika të forta. U përdor për shembull fjala “çadër” si metaforë e mbrojtjes, e strehës nga padrejtësia, por edhe si skenografi e një opozite që e sheh veten jashtë sistemit. Ajo u mbështet mbi një diskurs që kombinonte elementët klasikë të antikomunizmit me retorikën moderne të luftës kundër “shtetit të kapur” dhe “oligarkisë kriminale”. Ky moment ilustron qartë atë që Bieber (Bieber, 2020) e përshkruan si tranzicion nga opozita institucionale në opozitë performative, ku qëllimi kryesor nuk është më ndërveprimi konstruktiv me procesin

parlamentar, por ndërtimi i një narative morale dhe emocionale që të mobilizojë identitete të polarizuara.

Pas tre muajsh proteste, erdhi marrëveshja e 18 Majit 2017, që i dha opozitës një numër koncesionesh të parëndësishme por gjithshësi të padëgjuaara më parë në Shqipëri. Opozita mori kontrollin e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Ajo mori në total 6 poste ministrore të përkoshhme përgjatë gjithë periudhës zgjedhore.

Në teori, këto masa duhej ose mednohej se do të garantonin zgjedhje të lira. Megjithatë, rezultati elektoral i qershorit 2017 tregoi se vetë logjika e protestës kishte konsumuar kredibilitetin e opozitës, duke e shndërruar atë në një aktor që përfitonte nga delegjitimimi i sistemit, por nuk arrinte të propozonte një platformë bindëse për qytetarët.

Ky paradoks përputhet me diagnozën e Colin Crouch (Crouch, 2004) mbi post-demokracinë sipas të ciles aktorët politikë prodhojnë spektakël protestash dhe përplasje simbolike, por kapaciteti i tyre për të ndërtuar besim dhe për të artikuluar ose riartikuluar një ofertë programore mbetet i ulët. Në vend që të ndihmonte rivendosjen e garës politike, performanca e gjatë e “Çadrës së Lirisë” mund të ketë forcuar perceptimin e një opozite të paafte për të qeverisur.

Ky është një moment vendimtar në jetën e opozitës pas zgjedhjeve të vitit 2013. Në plan më të thellë, ky episod shënoi një rreshtim të Partisë Demokratike me një kulturë politike të përqendruar te konfrontimi i vazdhueshëm dhe refuzimi i institucioneve. Në këtë kuptim, opozita shqiptare gjatë viteve 2014–2017 ilustron atë që Merkel (Merkel, 2004) e quan demokraci defektive, ku procedurat zgjedhore mbijetojnë në formë, por konsensusi për të respektuar rregullat e lojës demokratike është i brishtë. Për më tepër, radikalizimi i gjuhës politike dhe normalizimi i bojkotit u kthyen në precedent për krizën edhe më të thellë që pasoi: djegien e mandateve parlamentare nga opozita në vitin 2019. Kështu, “Çadra e Lirisë” mund të shihet jo vetëm si një përpjekje për të mbrojtur integritetin e zgjedhjeve, por edhe si një fazë e ndërmjetme drejt krizës së përhershme të legjitimitetit institucional.

Në retrospektivë, “Çadra e Lirisë” mbetet një episod ku opozita shqiptare zgjodhi performancën e konfliktit mbi pjesëmarrjen institucionale. Në vend që të ndërtonte një projekt konservator të qartë për qeverisjen, ajo u mbështet në simbolikë, diskurs moralizues dhe tension të përhershëm. Siç thekson Bieber (Bieber, 2020), ky model e thelloi prirjen e demokracisë shqiptare për të funksionuar më shumë si ritual krizash sesa si sistem konkurrimi konstruktiv.

6.5 Sjellja e PD-së pas vitit 2013. Rastet e sabotimit institucional, bojkoti i parlamentit, djegia e mandateve dhe mospranimi i zgjedhjeve

Sabotimi institucional përfaqëson një formë të sjelljes politike në të cilën aktorët opozitarë zgjedhin të braktisin ose të delegjitojnë mekanizmat kushtetues të përfaqësimit dhe të mbikëqyrjes së qeverisjes, duke përfshirë bojkotin e parlamenteve, djegien e mandateve, refuzimin për të njohur rezultatet zgjedhore apo bllokimin e proceseve vendimmarrëse. Objektivi i drejtpërdrejtë i kësaj strategjie është ushtrimi i presionit për ndryshim politik dhe dobësimi i

legjitimitetit të shumicës qeverisëse. Në një kuptim më të gjerë, sabotimi institucional është simptomë e dështimit për të ndërtuar konsensus mbi “rregullat e lojës”, çka është një parakusht themelor për konsolidimin demokratik (Linz & Stepan, 1996).

Literatura mbi tranzicionet demokratike e trajton këtë fenomen si karakteristikë të sistemeve ku partitë politike nuk arrijnë të zhvillojnë kapacitetin për të ndarë legjitimitetin e procesit, edhe kur nuk ndajnë përmbytjen e tij (Pridham, 2000). Në këto raste, institucionet parlamentare dhe organet mbikëqyrëse perceptohen më tepër si instrumente të partisë kundërshtare, sesa si forume neutrale për konkurrencë dhe kontroll. Si pasojë, opozita zgjedh të tërhiqet nga pjesëmarrja institucionale për t’i transferuar konfliktet në hapësirën publike, në protesta, retorikë delegitimuese dhe aksione civile.

Në rastin e Shqipërisë, sabotimi institucional është shfaqur me intensitet të lartë që prej fillimit të viteve ’90. Episodet përsëritëse të bojkotit parlamentar, refuzimit të njohjes së rezultateve zgjedhore dhe përdorimit të krizës politike si instrument presioni kanë qenë faktorë që kanë minuar stabilitetin e konkurrencës demokratike. Për shembull, bojkoti i zgjedhjeve lokale të vitit 2019 nga opozita dhe djegia e mandateve parlamentare krijuan një precedent të rrezikshëm, ku mbikëqyrja parlamentare u zëvendësua nga një përballje jashtëinstitucionale, duke kontribuar në polarizim ekstrem dhe mosbesim qytetar ndaj sistemit (Bieber, 2020).

Në këtë kuptim, sabotimi institucional nuk është thjesht një akt proteste, por një simptomë e dështimit për të ndërtuar një kulturë politike konkurruese që e njeh legjitimitetin e institucioneve, pavarësisht fituesit të përkoshëm të pushtetit. Siç thekson Linz dhe Stepan (Linz & Stepan, 1996), konsolidimi demokratik kërkon jo vetëm përmbytjen formale të kriterëve zgjedhore, por edhe brendësimin kulturor të bindjes se institucionet janë mekanizmi i vetëm legjitim për ndryshimin politik. Në mungesë të këtij konsensusi, demokracia mbetet e brishtë dhe e hapur ndaj krizave të përsëritura të përfaqësimit.

Fenomeni i bojkotit parlamentar në Shqipëri ka shërbyer historikisht si një strategji e opozitës për të delegitimuar shumicën qeverisëse dhe për të kontestuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe të funksionimit institucional. Ky fenomen u shfaq qartë që në zgjedhjet parlamentare të 26 majit 1996, të cilat përfaqësojnë një nga rastet më të dokumentuara të deformimit të standardeve zgjedhore në tranzicionin postkomunist. Sipas raportit të OSBE/ODIHR të vitit 1996, procesi elektorale u shoqërua me ndërhyrje policore, dhunë ndaj komisionerëve opozitarë dhe manipulim të hapur të numërimit të votave, çka e shtyu Partinë Socialiste dhe partitë e tjera opozitare të refuzonin njohjen e rezultatit dhe të bojkotonin Kuvendin për disa muaj. Ky bojkot shënoi precedent institucional për përdorimin e largimit nga parlamenti si formë presioni dhe proteste politike.

Pas më shumë se një dekade, një episod i ngjashëm u përsërit në periudhën 2009–2011. Zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009, të cilat prodhuan një shumicë të ngushtë qeverisëse (koalicioni që u ndërtua pas zgjedhjeve) për koalicionin PD–LSI, u kontestuan nga opozita socialiste me pretendimin për manipulim të rezultatit dhe deformim të garës (OSCE/ODIHR, 2009). Si reagim, deputetët opozitarë bojkotuan seancat plenare dhe komisionet parlamentare për muaj të tërë, duke e shndërruar parlamentin në një institucion të paralizuar funksionalisht dhe duke përkeqësuar klimën e polarizimit politik. Ky episod pasqyron, sipas Bieber (Bieber, 2015),

dobësinë e kulturës demokratike për të ndërtuar konsensus minimal mbi rregullat e lojës politike dhe legjitimitetin e institucioneve.

Pas vitit 2013, kur Partia Demokratike humbi pushtetin pas një dekade qeverisjeje, modeli i bojkotit parlamentar u riaktivizua si mjet kontestimi politik. Gjatë mandatit të parë të qeverisë Rama, PD përdori bojkotin për të protestuar kundër procesit të reformës në drejtësi, të cilin e akuzonte për kapje institucionale dhe instrumentalizim politik të SPAK dhe organeve të tjera të reja të drejtësisë. Në disa raste, bojkoti u alternua me protesta masive jashtë parlamentit, duke synuar jo vetëm presionin për koncesione politike, por edhe delegitimimin simbolik të autoritetit të shumicës (Elbasani, 2013; Freedom House, 2015).

Në perspektivë krahasuese, bojkoti i përsëritur parlamentar në Shqipëri është simptomë e një demokracie të brishtë, ku mungesa e konsensusit mbi procedurat bazë të konkurrencës politike dhe të administrimit të pushtetit prodhon cikle të përsëritura krizash legjitimiteti. Ky model i sjelljes opozitare ka ndikuar negativisht jo vetëm te efektiviteti i parlamentit si forum përfaqësimi dhe mbikëqyrjeje, por edhe te besimi qytetar ndaj institucioneve (Cianetti, 2020).

Ky cikël i përsëritur i bojkotit ka prodhuar pasoja të thella mbi funksionimin e institucioneve demokratike në Shqipëri vazdhimisht. Para së gjithash, është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme kapaciteti i parlamentit për të ushtruar kontroll dhe mbikëqyrje efektive ndaj ekzekutivit. Kur opozita largohet nga procesi parlamentar, mekanizmat e kontrollit dhe balancës si interpelancat, komisionet hetimore dhe debatet plenare bëhen formalitete pa substancë reale (OSCE/ODIHR, 2009; Freedom House, 2012).

Së dyti, bojkotet e zgjatura e kanë shndërruar parlamentin në një arenë de facto moniste, ku shumica jo vetëm miraton pa pengesë projektligje dhe vendime, por edhe prodhon një perceptim publik të legjitimitetit të vetvetes pa u sfiduar në mënyrë institucionale. Shkurt shumica arrin ta përkufizojë vetë veten e saj perballe publikut os eka smundësi më të mëdha për ta përkufizuar vetë veten e saj. Ky fenomen është vërejtur pas zgjedhjeve të vitit 2009 dhe 2017, kur opozita refuzoi për muaj të tërë pjesëmarrjen në seancat plenare, duke krijuar një parlament me legjitimitet të pjesshëm (Bieber, 2015; OSCE/ODIHR, 2017).

Së fundi, është normalizuar ideja e bojkotit si një mjet rutinor i luftës politike, jo si një instrument i jashtëzakonshëm proteste ndaj shkeljeve ekstreme. Ky normalizim ka dobësuar kapacitetin e sistemit për të gjeneruar konsensus elementar mbi rregullat e lojës demokratike dhe ka ushqyer një kulturë politike konfliktuale, ku delegitimimi i kundërshtarit merr përparësi ndaj mbrojtjes së institucionit si mekanizëm përfaqësues dhe llogaridhënës (Elbasani, 2013).

Djegia e mandateve ishte një tjetër akt ekstrem politik i opozitës i cili synonte të delegitimonte qeverisjen e kryeministrit Rama. Në muajin shkurt të vitit 2019, Partia Demokratike dhe shumica e partive opozitare ndërmorën një akt politik të paprecedentë në historinë e tranzicionit pluralist shqiptar: dorëzimin kolektiv dhe djegien formale të mandateve parlamentare. Ky vendim ekstrem u shpall publikisht si një formë proteste ndaj asaj që opozita e përshkroi si kapje totale të shtetit nga qeveria, korrupsioni i përhapur sistematikisht dhe lidhjet e dyshuara midis kimit të organizuar dhe elitave politike (Freedom House, 2019).

Retorika e përdorur për të justifikuar këtë veprim përmbante elementë të delegjitimitit total të institucioneve. Liderët opozitarë argumentuan se parlamenti kishte humbur jo vetëm funksionin e tij përfaqësues, por edhe kapacitetin minimal për të ushtruar kontroll demokratik mbi qeverinë dhe për të garantuar barazi konkurrimi politik (European Commission, 2019). Kjo strategji e bojkotit total, që kulmoi me dorëzimin, me atë që njihet si djegia, e mandateve, shënoi një distancim të thellë nga logjika institucionale e opozitës parlamentare drejt një forme *daljeje ose sjelljeje* politike radikale duke rikthyer format më të ashpra të përplasjes jashtëinstitucionale. Parimisht opozita nuk është më në sistemin politik, është jashtë tij.

Në historinë e pas vitit 1991, Shqipëria ka njohur disa raste bojkoti të pjesshëm apo të zgjatur parlamentar, si bojkoti i opozitës pas zgjedhjeve të kontestuara të vitit 1996 (OSCE/ODIHR, 1996), bojkoti i gjatë i Partisë Socialiste në periudhën 2009–2011 (OSCE/ODIHR, 2009), si dhe protestat e “Çadrës së Lirisë” në vitin 2017. Megjithatë, në asnjë rast më parë opozita nuk kishte ndërmarrë masën ekstreme të djegies kolektive të mandateve si akt përfundimtar delegjitimimi. Kjo e bën rastin e vitit 2019 një precedent të ri për krizën e përfaqësimit dhe një pikë kthese simbolike për raportin e forcave politike me institucionet.

Në literaturën e teorisë së demokracisë dhe marrëdhënieve ekzekutiv–opozitë, akti i djegies së mandateve mund të kuptohet si një formë ekstreme e exit-it politik, në kuptimin që i jep teoricioni i njohur i politikës Albert Hirschman konceptit të *Exit, Voice, and Loyalty* (Hirschman, 1970). Sipas Hirschman, qytetarët dhe aktorët politikë kanë tri alternativa për të reaguar ndaj pakënaqësisë me sistemin. Ato janë *Voice* (zëri) që do të thote të përpiqen të ndikojnë e ta reformojnë nga brenda, *Exit* (largimi) që do të thote të braktisin institucionet ose marrëdhëniet, *Loyalty* (besnikëria) që do të thote të pranojnë status quo-në.

Djegia e mandateve shënon kalimin nga *voice* drejt *exit*, me synimin për të provokuar një krizë legjitimiteti dhe për të detyruar krijimin e një qeverie tranzitore ose zgjedhje të parakoshhme. Siç vërejnë Levitsky dhe Ëay (Levitsky & Way, 2010), në kontekste të demokracive hibride apo të kapjes së shtetit, strategjitë e *exit*-it mund të duken të justifikuara nga një këndvështrim moral, por kanë pasoja të rrezikshme për stabilitetin demokratik, pasi minojnë besimin qytetar tek institucionet dhe krijojnë precedentë të delegjitimitit të përhershëm.

Në plan praktik, efektet juridike të dorëzimit të mandateve u neutralizuan pjesërisht nga dispozitat ligjore që lejojnë zëvendësimin e deputetëve përmes listave të kandidatëve pasues dhe nga përdorimi i menjëhershëm i këtyre dispozitave nga shumica qeverisëse. Megjithatë, efekti simbolik i një parlamenti me një opozitë të re të përbërë kryesisht nga individë më pak të njohur ose me legjitimitet të cunguar, e thelloi perceptimin e krizës përfaqësuese. Raporti i OSBE/ODIHR mbi situatën politike në vitin 2019 theksoi se kjo qasje radikale e opozitës, në kombinim me retorikën e vazdheshme të përjashtimit, kontribuoi në polarizimin ekstrem dhe pengoi dialogun politik (OSCE/ODIHR, 2019).

Një pjesë e analistëve kanë argumentuar se djegia e mandateve përbënte një akt që minonte kulturën demokratike, duke e kthyer parlamentin në një hapësirë moniste dhe duke i mohuar qytetarëve përfaqësimin e alternativës politike (Bieber, 2020). Të tjerë e kanë parë si një reagim të pashmangshëm ndaj deformimeve strukturore të sistemit zgjedhor dhe mosfunksionimit real të

kontrollit demokratik. Në çdo rast, kjo ngjarje shënoi një nga momentet më të thella të krizës së përfaqësimit politik në Shqipëri pas vitit 1991.

Ky veprim prodhoi një krizë të jashtëzakonshme institucionale, duke krijuar një vakum përfaqësimi për një pjesë të gjerë të elektoratit dhe duke legjitimuar zëvendësimin e deputetëve të dorëhequr me kandidatë rezervë nga listat shumemërore, një praktikë që u kritikua nga ekspertë dhe organizata ndërkombëtare si një rrezik serioz për deformimin e parimit të përfaqësimit demokratik. Për më tepër, përjashtimi i plotë i opozitës nga mekanizmat kushtetues të kontrollit parlamentar dhe debatit publik kontribuoi në transformimin e parlamentit në një organ de facto të kontrolluar vetëm nga shumica qeverisëse. Në vlerësimin e OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare monitoruese, ky akt përbënte një përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë së demokracisë parlamentare dhe një goditje ndaj standardeve të balancës institucionale në një sistem pluralist. Shqipëria ka një histori të gjatë me bojkotin, mospranimin e zgjedhjeve. Kjo është gati diccka e ngulitur në kulturën politike të vendit. Mospranimi i rezultateve zgjedhore është shndërruar në një tipar ciklik të krizave politike në Shqipëri, duke minuar besimin publik në procesin elektorale dhe funksionimin normal të institucioneve demokratike. Ky fenomen ka njohur disa episode të përsëritura që nga tranzicioni postkomunist.

Në vitin 1996, Partia Socialiste dhe aleatët e saj opozitarë bojkotuan parlamentin e sapozgjedhur, duke e konsideruar procesin zgjedhor si të manipuluar dhe të shoqëruar nga dhuna dhe ndërhyrja e strukturave shtetërore. Ky bojkot shënoi një krizë të thellë legjitimiteti institucional dhe vuri në dyshim kapacitetin e elitave politike për të konsoliduar rregullat e konkurrencës demokratike.

Në vitin 2009, pas zgjedhjeve parlamentare, opozita e atëhershme kërkoi hapjen e kutive të votimit, duke refuzuar njohjen e rezultatit zyrtar për shkak të dyshimeve për manipulim dhe deformim të vullnetit elektorale. Kërkesa për rinumërim dhe transparencë e zgjati krizën politike për disa muaj, duke paralizuar aktivitetin normal parlamentar.

Në vitin 2011, zgjedhjet lokale në Tiranë u kontestuan gjerësisht pas interpretimit të votave të pavlefshme, i cili ndryshoi rezultatin fillestar. Raporti i OSCE/ODIHR i vitit 2011 konstatoi se ky proces minoi më tej perceptimin e integritetit të administrimit zgjedhor dhe të pavarësisë së institucioneve përgjegjëse.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 u shoqëruan nga akuza për blerje të votës dhe përdorim të resurseve publike në funksion të maxhorancës. Megjithatë, ndryshe nga episodet e mëparshme, Partia Demokratike zgjodhi të mbetej në Kuvend, duke e zhvendosur krizën nga një përballje institucionale drejt një diskursi të vazdheshëm delegjitimues.

Në vitin 2019, opozita ndërmori një hap ekstrem, duke bojkotuar tërësisht zgjedhjet lokale. Ky veprim prodhoi një precedent të rrezikshëm të padëgjuar më parë. Në pjesën më të madhe të bashkive, Partia Socialiste garoi pa kundërshtarë realë, duke e transformuar procesin zgjedhor në një procedurë formale të konfirmimit të pushtetit ekzistues.

Kjo sjellje politike ka prodhuar disa nga pasojat afatgjata me ndikimin më të thellë mbi zhvillimin demokratik të vendi siç janë erozion i besimit publik tek integriteti i procesit zgjedhor, legjitimimi i mospranimi të rezultatit si normë politike dhe dobësimi i konkurrencës reale, duke e kthyer procesin zgjedhor në një ritual formal. Kontestimi i përsëritur i rezultateve, akuzat për manipulime dhe bojkotet e vazhdueshme kanë minuar perceptimin e qytetarëve se zgjedhjet janë mekanizëm legjitim i përfaqësimit dhe ndryshimit politik. Si pasojë, pjesëmarrja elektorale dhe motivimi i qytetar për angazhim politik janë dobësuar ndjeshëm.

Mosnjohja e zgjedhjeve është kthyer nga një përjashtim i rrallë në një strategji të zakonshme opozitare, duke e normalizuar idenë se procesi zgjedhor nuk ka autoritet final për të përcaktuar fituesin. Kjo ka kontribuar në një cikël krizash të përsëritura të legjitimitetit institucional. Në mungesë të konsensusit minimal mbi rregullat e lojës dhe integritetin e institucioneve zgjedhore, zgjedhjet gjithnjë e më shumë perceptohen si një akt formalizimi i pushtetit ekzistues, jo si garë reale politike. Ky transformim rrezikon t'i zhveshë zgjedhjet nga funksioni i tyre thelbësor si instrument llogaridhënieje dhe ndryshimi demokratik.

Sipas Linz dhe Stepan (Linz & Stepan, 1996), një regjim demokratik mund të konsiderohet i konsoliduar vetëm kur të gjithë aktorët politikë domethënës bien dakord që konfliktet dhe rivalitetet të zgjidhen brenda kornizës institucionale të vendosur nga kushtetuta dhe ligjet. Ky konsensus minimal procedural përfaqëson një “normë të brendësuar” që e bën demokracinë të qëndrueshme dhe të parashikueshme. Në rastin shqiptar, strategjitë e përsëritura të bojkotit parlamentar, djegies së mandateve dhe delegjitimitimit të institucioneve zgjedhore kanë treguar një koncept të paqartë ose të brishtë të rregullave të lojës demokratike dhe respektit për këto rregulla. Ky fenomen prodhon një dinamikë ku konkurrenca elektorale dhe pjesëmarrja institucionale nuk janë përherë të pranueshme si norma fikse, por bëhen të kushtëzuara nga interesat dhe kalkulimet afatshkurtra të aktorëve politikë. Në literaturën e tranzicioneve, kjo sjellje lidhet me atë që Levitsky dhe Way (Levitsky & Way, 2010) e përshkruajnë si model i “demokracive hibride”, si sisteme ku format demokratike (zgjedhje, parlament, pluralizëm partiak) bashkëjetojnë me praktika oportuniste dhe tensione të vazdhueshme për legjitimitetin e institucioneve. Në këtë kuptim, Shqipëria ilustron rrezikun që mungesa e një konsensusi minimal procedural prodhon. Ky rrezik është normalizimi i kontestimit të proceseve zgjedhore dhe dobësimi i përhershëm i besimit publik tek institucionet demokratike.

Rastet e përsëritura të sabotimit institucional në Shqipëri nuk përbëjnë thjesht episode të ndara nga njëra-tjetra, por përfaqësojnë simptoma të thella të një kulture politike ku kriza perceptohet dhe instrumentalizohet si mjet legjitimiteti dhe presioni politik. Ky model sjell tre pasoja madhore që cenojnë kapacitetin e demokracisë për të funksionuar normalisht.

E para është dobësimi i themeleve të konkurrencës pluraliste. Kur aktorët kryesorë politikë zgjedhin bojkotin, djegien e mandateve apo mospranimin sistematik të rezultatit zgjedhor, i hiqet kuptimi përfaqësimit politik si proces konkurrues që prodhon legjitimitet institucional. Në vend të garës së rregullt dhe të respektimit të rezultatit, krijohet një logjikë përjashtuese ku rotacioni në pushtet synohet përmes krizës dhe jo përmes bindjes elektorale.

E dyta ka të bëjë me ngulitjen e mosbesimit ndaj institucioneve . Krizat e përsëritura, akuzat për manipulim dhe refuzimi i bashkëpunimit institucional ushqejnë një perceptim të qëndrueshëm se institucionet janë instrumente të kapura nga shumica e radhës. Ky mosbesim i përgjithësuar ul pjesëmarrjen qytetare, legjitimitetin e procesit elektorale dhe disponimin për të pranuar vendimmarrjen institucionale.

Dhe e treta është rritja e riskut të delegjitimitit të demokracisë si sistem. Kur konflikti politik nuk gjen zgjidhje brenda kornizës demokratike, krijohet një hapësirë ku aktorë radikalë, diskurse konspirative apo tendenca autoritare mund të përfitojnë nga pakënaqësia dhe të sfidojnë themelet e vetë rendit demokratik. Në këtë kuptim, krizat e përsëritura nuk janë thjesht tensione kalimtare, por faktorë erozivë të cilësisë demokratike.

Rikthimi i politikës brenda kornizës institucionale, përmes respektimit të rregullave të lojës, konkurrencës së ndershme dhe dialogut politik, përbën një parakusht themelor për çdo përpjekje serioze të konsolidimit demokratik në Shqipëri. Pa këtë rikthim, demokracia mbetet një formë rituale pa substancë funksionale.

Pra e thënë në terma më konkretë pas vitit 2013, Partia Demokratike hyri në një fazë të zgjatur krize identitare, organizative dhe institucionale, që pati pasoja të thella për rolin e saj si aktor demokratik konservator. Nëse në periudhën 2005–2013 PD kishte konsoliduar disa funksione kyçe të një partie të djathtë sipas modelit të Ziblat, pas 2013-s ajo përjetoi një proces të kundërt të de-institucionalizimit. Në oqftë se do të shohim me saktësi variablat e pavaruara si edhe ne periudhat e mëparshme atë do të vëmë re një përkeqësim serioz. Më poshtë po japim një tabel me keto të dhëna ose eme vlerat e këtyre treguesve.

Tabela e Zgjeruar për Periudhën 2013–2025

Tabela 1.6

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
Forca dhe organizimi i partive të djathta	Numri i anëtarëve dhe degëve lokale	2
	Përzgjedhja e kandidatëve	2
	Performanca zgjedhore	2
Institucionalizimi i partive të djathta	Rotacioni i lidërshpit	1
	Funksionimi i strukturave statutore	1
	Identiteti ideologjik dhe orientimi programor	1
Sjellja në momente krizash	Qëndrimi në krizat (2019, 2021, 2025)	1
	Deklaratat publike gjatë krizave	2

Variabli	Indikatori	Vlerësimi (1–5)
	Pjesëmarrja në marrëveshje politike	2
Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike	Qëndrimi ndaj institucioneve të pavarura	1
	Pjesëmarrja në reforma sistemike	1
	Diskursi mbi rendin kushtetues dhe ndërkombëtarët	1

Shohim që forca dhe organizimi i partisë u tkurr ndjeshëm. Struktura organizative humbi kohezionin e saj, degët lokale u bënë pasive dhe anëtarësia nuk u përditësua apo aktivizua. Përzgjedhja e kandidatëve u bë jo-transparente dhe e dominuar nga klane të brendshme, ndërsa rezultatet zgjedhore ishin të dobëta dhe në rënie (vlerësimi është 2).

Institucionalizimi u përmbys përmes personalizimit ekstrem të lidershit dhe krizave të thella të legjitimitetit. Mungesa e rotacionit të brendshëm, paraliza e strukturave statutore dhe paqartësia ideologjike e kthyen PD-në në një formacion jofunksional institucionalisht (vlerësimi është 1).

Sjellja në momente krizash ishte konfliktuale dhe jashtë kornizës institucionale. Bojkoti i zgjedhjeve lokale (2019), djegia e mandateve parlamentare (2019) dhe përplasjet e brendshme (2021–2025) e pozicionuan PD-në si një aktor që më shumë delegjtimon sesa mbron procesin demokratik (vlerësimi është nga 1–2).

Roli në ruajtjen e institucioneve demokratike ishte i dobët. Retorika anti-institucionale, akuzat sistematike ndaj KQZ-së, gjykatave dhe partnerëve ndërkombëtarë si “të kapur” dhe mungesa e pjesëmarrjes në reforma, e minuan pozicionin e saj si gardiane e rendit kushtetues (vlerësimi është 1).

Mund të themi se në terminologjinë e Ziblatt, PD në këtë periudhë nuk e ka përmbushur funksionin e saj si parti konservatore që kanalizon interesat e elitave përmes rrugëve demokratike. Ajo është shndërruar në një subjekt të brishtë, të fragmentuar dhe gjithnjë e më pak të besueshëm institucionalisht duke rritur rrezikun e delegjtimimit të vetë sistemit demokratik në mungesë të një opozite efektive.

Qartësisht edhe variablat e varur, dmth edhe ato që masin konsolidimin demokratik të vendit reflektojnë gjendjen dhe sjelljen e variablave të pavarur. Më poshtë po japim një table me vlerat e këtyre variablave.

Stabilizimi Demokratik në Shqipëri (2013–2025)

Tabela 1.7

(Vlerësimet janë të bazuara në të dhëna nga Freedom House, V-Dem dhe raportet e ODIHR/KE – për vitet më të fundit janë përdorur vlerësime të përditësuara deri në 2024)

Viti	FH (0–1)	V-Dem Parti (0–1)	V-Dem Opozitë (0–1)	Roli i opozitës (0–2)
2013	0.65	0.44	0.45	2
2014	0.62	0.43	0.42	2
2015	0.60	0.42	0.40	1
2016	0.58	0.40	0.38	1
2017	0.55	0.38	0.30	1
2018	0.52	0.36	0.25	1
2019	0.48	0.34	0.20	0
2020	0.45	0.32	0.18	0
2021	0.47	0.31	0.20	0
2022	0.50	0.32	0.22	0
2023	0.48	0.30	0.20	0
2024	0.47	0.29	0.18	0
2025	0.45*	0.28*	0.15*	0

*Shenja * tregon që të dhënat janë projeksion pasi viti 2025 është ende në mes të tij.*

Ajo që del nga gjithë këto të dhëna për periudhën 2013–2025 tregon se kjemi të bëjmë me një regres të qartë në drejtim të stabilizimit demokratik në Shqipëri, pavarësisht një nisjeje pozitive pas rotacionit politik të vitit 2013. Të gjithë treguesit si pluralizmi politik, institucionalizimi i partive, roli i opozitës tregojnë për një dobësim të ndjeshëm të cilësisë demokratike, sidomos pas vitit 2017.

Kështu treguesi i pluralizmi politik që ka vlerën nga 0.65 në 0.45 pavarësisht se në fillim duket diccka e mirë për periudhën nga viti 2015 e në vijim, tregon se tensionet politike, përqendrimi i pushtetit dhe delegjitimimi i proceseve zgjedhore (2017, 2019, 2021) e zbehën ose e zhbënë krejt arritjen e vitit 2013 të rotacioni paqësor.

Rënia e teaguesit të pluralizmit nuk është për shkak të ndalimit formal të partive, por për shkak të mungesës së garës reale, bojkotit të zgjedhjeve nga opozita dhe dominimit të PS mbi të gjitha pushtetet institucionale.

Në lidhje me institucionalizimin e partive vërejmë se V-Dem Index ka vlera nga 0.44 në 0.28 dhe dallohet se ato tregojnë një dobësim të strukturës dhe funksionalitetit të partive, sidomos të opozitës. Partia Demokratike u përball me krizë të thellë të lidërsipit pas 2017, ndarje të

brendshme pas shpalljes “non grata” të Berishës, rënie të kapacitetit organizativ dhe mungesë koherence ideologjike dhe dështim për të ofruar një alternativë reale.

Nga ana tjetër, Partia Socialiste konsolidoi pushtetin, por në formë vertikale dhe personaliste, duke përforcuar kontrollin mbi administratën publike, median dhe institucionet e drejtësisë.

Një tjetër tregues vendimtar i dobësimit të demokracisë është marginalizimi institucional i opozitës. Deri në vitin 2016, PS dhe PD përfshiheshin në marrëveshje politike për reformën në drejtësi dhe legjislacionin elektoral.

Pas vitit 2017 ndodhi një shpëputje sistematike. Ndodhi bojkoti i parlamentit, dorëzimi i mandateve në vitin 2019, ndodhën krizat dhe mosmarrëveshjet për zgjedhjet (2019 dhe 2021) dhe u zhvillua një konflikt i vazhdueshëm mbi njohjen e drejtësisë së re dhe rolin e ndërkombëtarëve.

Në këtë kontekst, opozita nuk përmbushi funksionin kushtetues të mbikëqyrjes së pushtetit dhe përfaqësimit të interesave pluraliste në sistemin parlamentar.

Në terminologjinë e shkencës politike kjo fazë mund të përshkruhet si “demokraci elektorale me simptoma post-demokratike” (sipas Crouch dhe Manent). Kemi zgjedhje të rregullta, por pa garë reale; institucione formalisht pluraliste, por të depolitizuara dhe të kontrolluara nga një mazhorancë e vetme. Pra nga një pikë e mirë dhe relativisht funksionale në vitin 2013, Shqipëria rrëshqiti drejt një forme të demokracisë të asimetrike, ku mazhoranca kontrollon pushtetet, ndërsa opozita është e fragmentuar, delegjitimuar dhe jashtë sistemit. Kjo e bën Shqipërinë një shembull të dështimit të stabilizimit demokratik, ndonëse në kushte formalisht elektorale.

Kapitulli VII: Analizë diskursive e gjuhës së Berishës, drejtuesve dhe e programeve të PD-së

7.1 Analizë diskursive e gjuhës së Berishës në vitet 1990-1991

Siç e kemi theksuar më lart, në kuptimin ziblattian, demokracia liberale nuk konsolidohet thjesht si rezultat i presionit popullor nga poshtë, por si produkt i një vendimi strategjik nga lart i elitave konservatore që zgjedhin të përqafojnë rregullat e lojës demokratike për të ruajtur interesat e tyre dhe për të shmangur një shpërbërje të mundshme të rendit shoqëror. Në raste të suksesshme, siç e kemi përmendur shpesh, si Britania apo Suedia, partitë konservatore nuk u kthyen në pengesë për demokracinë, por në garanci për tranzicionin e kontrolluar, duke ofruar një diskurs që frenohej nga radikalizmi dhe përqaforë gradualisht reformat (Berman, 2006).

Ky model nuk mund të aplikohet automatikisht në Shqipëri. Ndryshe nga këto vende, Shqipëria komuniste nuk linte pas asnjë klasë tradicionale konservatore. Bejlerët ishin përndjekur, klerikët ishin eliminuar fizikisht ose shtypur, borgjezia e hershme ishte shpërbërë që në vitet '40. Elita e trashëguar ishte ose e asgjësuar, ose e delegjitimuar përmes dhunës ideologjike dhe strukturës totalitare (Vickers, 1995) të komunizmit dhe të regjimit të tij. Prandaj, me rënien e regjimit, nuk

ekzistonte një shtresë sociale e prirur të përmbushte funksionin konservator që Ziblatt e sheh si kyç për stabilitetin demokratik.

Në këtë terren djerrë, në dhjetor 1990, Sali Berisha, një figurë e dalë vetë nga elita intelektuale e regjimit (mjek kardiolog, i arsimuar dhe me reputacion në sistemin komunist), u shfaq si lider i një opozite të re që duhej të mbushte jo vetëm boshllëkun institucional, por edhe atë diskursiv. Në një vend pa konservatorizëm, ai filloi të artikulojë një gjuhë konservatore të improvizuar, me funksione të qarta politike dhe psikologjike.

Gjëja e parë që vihjet re në gjuhën e Sali berishës dhe në tërësis të gjithë PD-së është Apeli për rend dhe nevoaj për të shmangur kaosin. Këto konsiderohen si si detyrë morale.

Gjatë protestave të dhjetorit 1990 dhe janarit 1991, Berisha theksonte se “ndryshimi duhet të vijë përmes ligjit, jo përmes dhunës.” Në intervistën për gazetën *Zëri i Rinisë* më 6 janar 1991, ai deklaronte: “Populli shqiptar ka të drejtë të kërkojë pluralizëm, por ka po ashtu detyrën të ruajë qetësinë. Ne nuk kemi nevojë për të djegur institucionet tona, por për t’i reformuar.”

Ky mesazh përsëritej me tone edhe më të forta në takime publike në qytete si Shkodra, Elbasani, Korça etj por edhe në fshatra ku PD-ja përpiquej të zbriste nga elitat qytetase në bazën popullore. Në një fjalim në Shkodër, në shkurt 1991, Berisha për shembull deklaronte: “Ne nuk jemi këtu për të prishur rendin, por për të ndërtuar një rend të ri, të bazuar në liri dhe përgjegjësi.”

Ky qëndrim nuk ishte vetëm retorikë. Ai përkthehej në qëndrimin e PD-së ndaj grevave të përgjithshme. Ndërsa sindikatat e pavarura të punëtorëve kërkonin greva masive në mars 1991, PD-ja shmangu mbështetjen e plotë, duke preferuar presionin institucional.

Gjëja e dytë që vihet re gjerësisht në gjuhëne Berishës dhe të PD-së ishte të shikuarit ose të kërkuarit e reformave pa përmbysje , ishte kërkimi legjitimitetit nëpërmjet reformizmit dhe “ndërmjetësismit”. Berisha, në vitet 1991-1992 nuk përdorte asnjëherë terma si “revolucion”, “përmbysje”, apo “gjykim popullor”. Përkundrazi, në mënyrë të qëllimshme, ai përdorte fjalë të tilla si “ndryshim historik”, “evolucion demokratik”, “hapje graduale”. Në mbledhjen e parë publike të PD-së në Tiranë, më 15 janar 1991, ai deklaroi: “Shqipëria do të bëhet si Europa. Por kjo nuk do të thotë që ne duhet të shkatërrojmë institucionet tona. Duhet t’i transformojmë ato, me mençuri, me maturi.” Kjo linjë mendimi ishte në kontrast të plotë me diskursin e një pjese të intelektualëve të asaj kohe, të cilët i quanin strukturat e vjetra si “të kalbura”, “të padenja” për ndonjë reformim. Berisha, dukej se ndiqte pak a shumë stilin e konservatorëve klasikë, dhe nuk kërkonte t’i eliminonte strukturat e vjetra, por t’i ripërdorte për t’i dhënë tranzicionit formë dhe rrugë institucionale.

Gjëja e tretë që vihet re në gjuhën e Berishës ose tipari i tretë i gjuhës së Berishës në periudhën 1991-1992 është përdorimi i identitetit apo nocioneve kombëtare si autoritet moral.

Në shumë raste, Berisha e përdorte identitetin kombëtar si burim legjitimues të reformës. Në një takim me intelektualë në Universitetin e Tiranës, në mars 1991, ai përmendte Fan Nolin dhe Ismail Qemalin si figura që kishin kërkuar "evropianizimin e Shqipërisë përmes rendit, jo dhunës". Në fjalimin përkujtimor për Lidhjen e Prizrenit ai deklaronte: “Historia e Shqipërisë na

mëson se ne kemi ekzistuar si komb vetëm kur kemi pasur shtet. Dhe shteti nuk ndërtohet me urrejtje, por me dashuri për kombin. (Rilindja demokratike, 1991)”

Ky ishte nacionalizëm simbolik në funksion të rendit, jo i shfrenuar, por frenuar, i kanalizuar. Kjo përputhet me modelin e Ziblat, ku partitë konservatore kombinojnë nacionalizmin me ruajtjen e rendit dhe gradualizmin reformativ (Ziblat, 2017).

Gjëja e katërt që dallon gjuhën e Berishës është përpjekja për të shfaqur autoritetin moral të intelektualit, për të treguar se në thelb konservatorizmi nuk është çështje klase.

Në mungesë të një elite aristokratike ose pronarësh të mëdhenj, që nuk ishte as ai vetë dhe që nuk ishin as drejtuesit e PD-së, Berisha vetëmbështetej në statusin e tij si mjek, si intelektual, si njeri i dijes dhe arsyes. Në një intervistë për *Le Monde* në maj 1991 ai u shpreh: “Unë nuk vij nga politika. Vij nga shkenca. Dhe jam i bindur se një shoqëri nuk mund të ndërtohet mbi hakmarrje, por mbi ligj.”

Kjo etika teknike e racionalitetit dhe e neutralitetit moral, që përjashtonte emocionet revolucionare dhe instinktin hakmarrës, ishte një lloj konservatorizmi pa traditë, por me moral. Ai nuk kishte histori për të trashëguar, por krijonte legjitimitet përmes një stili të ftohtë dhe përllogaritës, tipik për tranzicionet që kërkojnë disiplinë, jo shfryrje.

Pra për gjuhën e PD-s dhe berishës në vitet 1991-1992 mund të thuhet se kemi të bëjmë me një konservatorizëm emergjent, një gjë e atypëratyshme, e qëndrueshme por pa strukture.

Në vitet 1990–1991, diskursi i Sali Berishës u përpoq të kompensonte mungesën e një konservatorizmi strukturor në Shqipëri përmes një konservatorizmi diskursiv. Në terma ziblatianë, ky ishte një model improvizues, një rol i mbushur pa një klasë, një formë pa përmbajtje klasore, por që megjithatë u përpoq të funksiononte si garanci morale për një tranzicion që të mos rrëshqiste në anarki apo luftë civile.

Ky diskurs nuk kishte jetë të gjatë. Pas vitit 1992, dinamika politike shqiptare u përfshi nga polarizimi, autoritarizmi dhe instrumentalizimi i retorikës për pushtet personal. Por për një moment, në periudhën vendimtare të 1990–1991, Shqipëria përjetoi një konservatorizëm të improvizuar, që e kanalizoi energjinë popullore në korniza institucionale, që i ofroi shoqërisë një zë që fliste në emër të rendit dhe kombit, dhe që e bindi elitën e vjetër të mos reagoonte me dhunë. Ishte një konservatorizëm pa konservatorë por ndoshta, në atë moment, ishte gjithçka që mund të kishte Shqipëria në mënyrën se si shkuan gjërat.

7.2 Analizë diskursive e gjuhës së Berishës në vitet 1992-1997

Nëse përpiqemi ta vendosim gjuhën politike të Sali Berishës gjatë viteve 1992–1997 brenda kornizës konceptuale të Daniel Ziblat, përballë teorisë së tij për demokratizmin (*Conservative Parties and the Birth of Democracy*, 2017), përballë nesh shfaqet një shembull paradigmatic i mungesës së kushteve strukturore dhe ideologjike për një tranzicion konservator ose për një

tranzicion të udhëhequr nga qasje konservatore dhe të stabilizuar. Teksa Ziblatt argumenton se sukseset e demokratizimit në Evropën Perëndimore varen nga përfshirja e elitave konservatore që vendosin të mbrojnë rendin ekzistues duke pranuar rregullat e lojës pluraliste, Shqipëria postkomuniste paraqet një realitet diametralisht të kundërt. Ne e kemi vënë re që elitat konservatore për shembull në Britani dhe Suedi pranuan zgjedhjet si “të frikshme, si kërcënim serioz, por të menaxhueshme” (Ziblatt, 2017), kur e kuptuan se alternativa ndaj demokracisë mund të ishte një revolucion përmbysës. Në këto raste, aristokracia rurale britanike dhe burokracia administrative suedeze kanalizuan transformimin politik drejt parlamentarizmit, duke ruajtur një pjesë të statusit të tyre përmes kompromisit (Ziblatt, 2017). Ky proces solli një gjuhë politike të moderuar, pajtuese dhe me theks te ruajtja e institucioneve.

Mirëpo në Shqipëri, një klasë e tillë tradicionale nuk ekzistonte në vitet '90. Regjimi komunist kishte shkatërruar çdo shtresë shoqërore që do të mund të shërbente si elitë konservatore. Ai kishte shkatërruar pronarët e mëdhenj, intelektualët e pavarur, klerin, shtresën e mesme qytetase etj. Siç thekson historiania Miranda Vickers (Vickers 1995), “Enver Hoxha e shndërroi vendin në një vakum social ku vetëm partia zotëronte të drejtën për të formësuar të ardhmen.”

Kjo shterpësi strukturale prodhoi një politikë pa bazë asnjë konservatore, e cila në vend të kompromisit solli një diskurs polarizues dhe konfrontues. Berisha, i ardhur si figurë karizmatike nga radhët e elitës intelektuale apo botës akademike, do të mishëronte më shumë një rol “shpëtimtar” sesa një figurë konservatore stabilizuese.

Gjuha e berishës dhe zyrtarëve të tjerë të PD-së u bë shumë radikale. Në mënyrë sistematike, gjuha politike e Sali Berishës përjashtonte kategorikisht kundërshtarin politik dhe e shite atë si përfaqësues të të keqes absolute. Në fjalimet e tij të vitit 1993–1996, përdorte etiketime si “mbetje e diktaturës”, “të verbuar nga ideologjia e vjetër”, “kriminelë të kuq” (Shqip, 1994–1996). Në vend të një diskursi konservator për ruajtjen e rendit dhe gradualitetit, ai ndërtonte një narrativë të shpëtimit kombëtar nga errësira e komunizmit, duke përforcuar ndarjen moralizuese mes “ne” (të mirët) dhe “ata” (armiqtë). Konkretisht për shembull në maj të vitit 1994, gjatë një mitingu në Shkodër, Sali Berisha (i cili ishte President i Republikës dhe parimisht duhet të ishte mbi palët) deklaronte: “Sot Shqipëria nuk është më nën thundrën e së keqes, por armiqtë nuk kanë pushuar, ata janë në parlament, në gazeta, në universitete. Dhe ne do t'i çlirojmë këto institucione” (Rilindja Demokratike, 1994).

Duke folur në vitin 1995, gjatë procesit penal ndaj ish-krerëve të PPSH-së, ai e përshkroi gjyqin si “*gjykim i ndërgjegjes kombëtare ndaj tradhëtarëve të Shqipërisë*”, duke tejkaluar çdo vijë ndarëse midis drejtësisë penale dhe drejtësisë politike dhe duke mos lënë ndonjë diskutim mbi pvarësinë e gjyqësorit.

Kjo retorikë nuk mbështetej mbi logjikën e konservatorëve klasikë që kërkojnë qetësi dhe ekuilibër institucional, por mbi një logjikë përjashtuese dhe përshpirtëruese, që synonte të prodhonte legjitimitet përmes pastrimit ideologjik.

Ndryshe nga elitat konservatore në Britani apo Gjermani që investuan në institucione parlamentare për të mbrojtur interesat e tyre, në Shqipëri, përpjekjet e Berishës për të ndërtuar institucione funksionale ishin të lidhura ngushtë me personalizimin e pushtetit. Reforma

kushtetuese e vitit 1994, që kërkonte zgjerimin e kompetencave të Presidentit, shihej si përpjekje për të ndërtuar një model presidencialist pa pushtete balancues apo pa kundërpesha. Kjo është arsyeja pse referendumi për projekt kushtetutën dështoi (53.9% e votuesve votuan kundër), duke zbuluar mungesën e një konsensusi konservator për rendin institucional (Elbasani, 2004).

Në vend të një konservatorizmi institucional që synon ekuilibrin e pushteteve, Berisha përdorte një diskurs të stilit plebishitar si për shembull “Jam zgjedhur nga populli, vetëm populli më jep të drejtën për të folur në emër të tij” (Rilindja Demokratike, 1995). Ky në asnjë lloj mënyre nuk është konservatorizëm, në asnjë milimetër të tij një diskurs i tillë nuk ka të bëjë me konservatorizmin. Ky është vetëm një voluntarizëm personalist i legjitimuar përmes krizës.

Dhe shembulli më kuptimplotë i krizës së konservatorizmit artificial me shuëm gjasa mund të konsiderohet shpërthimi i vitit 1997. Berisha e kishte ndërtuar të gjithë diskursin e tij politik mbi garantimin e rendit dhe ligjit, por në momentin e parë të rrënimit ekonomik (skemat piramidale), institucionet e tij u shpërbënë dhe qytetarët e armatosur morën kontrollin e vendit.

Në mars 1997, Shqipëria nuk kishte as qeveri funksionale, as polici, as ushtri të besueshme. Ishte vendi i vetëm në Evropë ku armatimet ushtarake u plaçkitën nga qytetarët në një hapësirë anarkike totale. Në vend që të shfaqej si konservator që ruan rendin, Berisha u shndërrua në simbolin e një shteti të dështuar, që nuk kishte as mbështetje shoqërore, as kapacitete administrative (Jarvis, 1999).

Pra, në terma ziblattianë, ajo që ndodhi në Shqipëri ishte një konservatorizëm performative. Ajo ishte përdorimi i simboleve të shtetit, ligjit dhe përgjegjësisë kombëtare jo si pjesë e një tradite të brendësuar politike, por si veshje apo kostume të përkoshme për të legjitimuar një pushtet emergjent. Në mungesë të një klase të mesme të qëndrueshme, të institucioneve të pavarura dhe të vetëdijes historike konservatore, Berisha imitoi gjuhën e konservatorizmit, por nuk e ndërtoi atë, nuk e jetësoi atë dhe as nuk e brendësoi dot atë. .

Kësisoj ndryshe nga Britania, Suedia apo Gjermania, Shqipëria nuk kishte një elitë konservatore që do të shërbente si garanci e tranzicionit. Në vend të një kompromisi për ruajtjen e rendit përmes demokracisë, ajo përjetoi një tranzicion të bazuar mbi improvizimin ideologjik, personalizimin e pushtetit, retorikën përjashtuese dhe mungesën e institucioneve funksionale. Gjuha politike e Berishës ishte më shumë strategji mbijetese në një mjedis pa strukturë, sesa një shprehje e ndonjë tradite ideologjike konservatore.

7.3 Analizë diskursive e gjuhës së Berishës dhe e ligjërimit të PD-së në vitet 1997-2005

Gjuha radikale, e ngarkuar, gjuha me armiq dhe që nuk pranon asnjë të vërtetë tjetër veç asaj që thotë ajo vetë u bë shumë më e pranishme gjatë vitit 1997 dhe më pas. Përgjatë periudhës 1997–2005, sjellja politike dhe diskursi publik i Partisë Demokratike dhe i liderit të saj, Sali Berisha, mund të kuptohet si një shembull paradigmë i asaj që Daniel Ziblatt e quan "krizë e një partie konservatore që ka dështuar të institucionalizohet si instrument i rendit demokratik". Pas disfatës së vitit 1997 dhe kolapsit të rendit politik të ndërtuar nga PD-ja gjatë qeverisjes 1992–1996,

Berisha dhe partia u gjendën në një pozitë ku legjitimiteti i tyre nuk mund të mbështetej më mbi trashëgiminë e antikomunizmit apo retorikën e “modernizimit të shpejtë” – dhe për pasojë, kaluan në një fazë të strategjive të alternuara mes delegjitimitit të kundërshtarit dhe adaptimit institucional të detyruar. Mund të dallohen dy faza gjatë vitet 1997-2005 të cilat ndonëse janë të ndryshme apo të dallueshme në thelb janë e njëjta gjë. Faza e parë ka të bëjë me ndjekjen e një strategjie të delegjitimitit e cila nuk përfshinte vetëm veprimin por më së shumti diskursin, ligjërimin e Berishës dhe të PD-së. Kjo fazë përfshin vitete 1997-2001. Në këtë fazë, sipas modelit të Ziblatt, një parti konservatore e ndjerë e përjashtuar dhe e delegjitimuar nga rendi kushtetues ka tri rrugë. Këto rrugë janë të reformohet institucionalisht dhe të kërkojë integrim, të braktisë skenën ose të minojë vetë themelet e rendit. PD-ja, Berisha zgjodhi opsionin e tretë. Kësisoj në shtatori të vitit 1998 pas vrasjes së Azem Hajdarit, Berisha i drejtohet turmës së protestuesve me thirrjen “Të gjithë në kryeministri! Kjo është një qeveri krimi!” (Rilindja Demokratike, 1998) duke nxitur protestat e dhunshme që çuan në sulmin ndaj Kryeministrit dhe Kuvendit. Ky akt nuk ishte thjesht një gjest emocional, por një sfidim frontal ndaj rendit kushtetues, sipas formulimit të Ziblatt për partitë që nuk njohin legjitimitetin e sistemit pluralist pas humbjes së pushtetit.

Gati në çdo dalje publike qoftë ajo konferencë për shtyp, fjalim në parlament apo intervistë Berisha e cilësonte qeverinë socialiste si “klonim të diktaturës, pjellë të diktaturës”, duke delegjitimuar jo thjesht qeverinë e kohës, por vetë mundësinë e rotacionit demokratik, çka përbën një karakteristikë klasike të partive konservatore jodemokratike që nuk njohin barazinë konkurruese si parim themelor.

Në këto vitet partia demokratike e kishte kthyer në ritual bojkotin e parlamentit. Më këtë veprim shumë të shpeshtë dhe që zgjaste me muaj (Rilindja Demokratike, 1999) ajo refuzonte legjitimitetin e vendimeve parlamentare. Në terma ziblattianë, kjo përfaqëson mospranimin e rregullave të lojës, një tipar që Ziblatt e sheh si shkatërrimtar për konsolidimin demokratik. Ligjërimi i kryetarit të PD-së Berisha dhe i eksponentëve të tjerë të saj përdorte një gjuhë sulmi ndaj ambasadorëve të SHBA-së, atij të OSBE-së dhe të atyre të vendeve të BE-së. Janë të njohura sulmet për “guvernatorë të emëruar” që bënte Berisha (Rilindja Demokratike, 1998) ndaj ambasadores amerikane Mariza Lino, ambasadorit të OSBE Dan Everts etj. Në vijimësi Berisha akuzonte diplomacinë ndërkombëtare për “mbështetje të një qeverie antidemokratike”. Për Ziblatt, një parti që sulmon arbitrat e rendit demokratik (në këtë rast ndërkombëtarët që vepronin si garantë të konsensusit institucional), tregon mungesë të thellë kapaciteti për bashkëjetesë pluraliste.

Faza e dytë është më ndryshe, është një fazë në të cilën PD përpiqet të adaptohet, ndjek strategjinë e adaptimit dhe kjo përfshin vitete 2001–2005. Pas zgjedhjeve të 2001-shit, ku PS fitoi një mandat të dytë por me vështirësi të mëdha në menaxhimin e qeverisjes dhe me rritjen e pakënaqësisë popullore, PD e kuptoi se rikthimi në pushtet kërkonte më shumë se mobilizim rruge dhe më shumë se një gjuhë radiukale kundër kundërshtarit. Nis dhe merr jetë një fazë e re që Ziblatt do ta quante “adaptim strategjik në kushtet e sistemit pluralist” por pa arritur kurrë në një institucionalizim të thellë konservator.

Si shembuj konkretë dh domethënës të kësaj faze në një analizë diskursive mund të përmendim deklaratën e Berishës në vitin 2002 në Kuvend, ku tha se “PD është e vendosur të bëjë një opozitë

institucionale, brenda parlamentit dhe në shërbim të integritetit europian.” (Rilindja Demokratike, 2002). Ky ishte qartësisht një sinjal i adaptimit, jo aq për shkak të një konvertimi ideologjik, por si reagim pragmatik ndaj rrethanave. Një shembull tjetër që mund të konsiderohet është reformimi i strukturave të brendshme të partisë. Që në zgjedhjet e vitit 2001 Berisha përfshiu në listat për kandidatë shkrimtaren Mimoza Ahmeti, shkrimtarin Visar Zhiti, aktorin Bujar Lako, etj. Bamnir Topi një figurë qytetse, me profil të njohur intelektual u bë nënkryetar i PD-së. Sllogani electoral i PD-së në vitin 2001 ishte “Për një fillim të ri.” Pra vetë PD po thoshte se po ndryshonte diskurs dhe sjellje. Më vonë kur po afronte fusha e vitit 2005 PD-ja afroi pranë vetes edhe mjaft figura të tjera me profil intelektual dhe qytetar, afroi të rinj të shkolluar mirë si Besnik Aliaj, Elida Reçi, Arlinda Ymeraj, Lulzim Basha, Majlinda Bregu, Arben Imami. Të gjithë këta përfaqësonin edhe një gjuhë me elegante dhe më të institucionale. Kjo nuk ishte një shenjë e ndërtimit të një elite konservatore si në rastin e Gjermanisë (CDU) apo Britanisë, por një përpjekje për të ndërtuar një fasadë moderne dhe legjitime, pa ndryshuar strukturën vertikale të lidërshipt.

Për herë të parë PD theksoi temat e “ekonomisë së tregut, rendit dhe integritetit europian”, duke u distancuar nga diskursi përjashtues. Por sërisht, kjo ishte më shumë ribrandim electoral, ishte një truk apo makiazh sesa konvertim institucional, siç do e konceptonte Ziblatt.

Megjithatë, një analizë më e thelluar sipas Ziblatt do të nxirrte në pah se, edhe në këtë fazë, PD nuk ndërtoi një kapacitet përfaqësues stabil për interesat e një klase konservatore tradicionale – për vetë faktin se Shqipëria nuk kishte një të tillë. Elitat postkomuniste që i bashkëngjiteshin PD-së nuk përfaqësonin një bërthamë aristokratike apo borgjezi industriale të ngjashme me rastet që Ziblatt studion. Prandaj, ajo që ndodhi ishte një mimë e konservatorizmit, jo një institucionalizim i tij.

Kështu në tërësi të teorisë së Ziblatt, në thelb periudha 1997–2005 e PD-së nuk përbën një shembull të ndërtimit të një partie konservatore demokratizuese. Përkundrazi, ajo përbën një rast tipik të një partie që pretendon të jetë e djathtë që, në mungesë të elitave historike dhe të kapacitetit institucional, kalon nga strategjia e përmbysjes në atë të adaptimit sipërfaqësor, pa e ndryshuar kurrë thelbin përjashtues të diskursit politik. Rikthimi i saj në pushtet në vitin 2005 nuk ndodhi si rezultat i ndërtimit të një projekti të qëndrueshëm institucional, por si produkt i dështimit të mazhorancës, polarizimit ekstrem dhe zhgënjimit qytetar – kushte që nuk garantojnë konsolidim demokratik.

7.4 Analizë diskursive e ligjërimit të PD-së në vitet 2005-2013

Konsolidimi demokratik i një vendi varet jo vetëm nga ndërtimi i institucioneve dhe nga mbajtja e zgjedhjeve të rregullta, por mbi të gjitha nga sjellja e partive konservatore (Ziblatt, 2017), të cilat në momente kritike të historisë vendosin të integrojnë masat dhe t'i binden rregullave të garës pluraliste. Ziblatt vë në dukje se diskursi politik është pasqyra e strategjisë së partive konservatore. Si rregul ato duhet të ndjekin ose brendësojnë një gjuhë pajtimi, vetëpërmbajtjeje dhe institucionalizimi që është tregues i përkushtimit ndaj demokracisë, ndërsa një diskurs përjashtues, personalizues apo polarizues sinjalizon tendenca iliberale.

Në këtë dritë, analiza e gjuhës politike të Sali Berishës gjatë periudhës 2005–2013 na lejon të kuptojmë se në çfarë mase Partia Demokratike e Shqipërisë ka funksionuar si një parti konservatore në sensin ziblattian, apo nëse ajo ka mbetur një strukturë e personalizuar, e paaftë për të ndërtuar një rend demokratik të qëndrueshëm.

Pas tetë vitesh në opozitë, Berisha u rikthye në pushtet në vitin 2005 me një gjuhë që fillimisht dukej më e moderuar dhe teknokratike siç e vumë re edhe më lart. Në natën e fitores në 3 korrik ai deklaroi se “Ne do të jemi qeveria e të gjithë shqiptarëve. Kemi mësuar nga e kaluara dhe jemi të përkushtuar për një qeverisje të përgjegjshme” (Rilindja Demokratike, 2005)

Kjo deklaratë mund të lexohet si një tentativë për të artikuluar një identitet konservator demokratik, që, siç thotë Ziblatt për rastet e Britanisë apo Suedisë, përpiqet të normalizojë pushtetin përmes një gjuhe pajtuese. Megjithatë, ky ton ndryshoi shpejt në muajt në vijim, kur Berisha rifilloi një retorikë të polarizuar dhe përjashtuese ndaj opozitës.

Një nga tiparet më të theksuara të diskursit të Berishës gjatë kësaj periudhe ishte përshkrimi i opozitës veçanërisht Edi Ramës dhe Partisë Socialiste si rrezik për rendin dhe kombin. Kjo ishte veçanërisht e dukshme pas zgjedhjeve të diskutueshme të vitit 2009, kur opozita bojkotoi Kuvendin dhe organizoi protesta. Berisha në një dalje para mediave tha : “Kjo opozitë është një turp për demokracinë. Ata nuk dinë të humbasin. Nuk janë pjesë e këtij vendi, janë jashtë rendit kushtetues.” (Rilindja Demokratike, 2009)

Në terminologjinë e Ziblatt, ky lloj i gjuhës është shenjë e një partie që nuk pranon rregullat e garës demokratike, dhe rrjedhimisht e minon institucionalizimin. Në vend të ndërtimit të një dialogu, Berisha e përjashton opozitën si jo-legjitime, çka e rrit tensionin politik dhe minon pajtimin.

Fjalori dhe gjuha personalizuese vadhoi madje u bë edhe më e thekshme. Gjuha u ngarkua me element që tregonin përqendrim të pushtetit dhe legjitimitetit tek vetja personale. Në mënyrë të përsëritur, Berisha e paraqet veten si figurë shpëtimtare, si “arkitekti i integritetit”, si “baba i zhvillimit”, si “zëri i kombit”. Në Kuvend, në vitin 2011, ai deklaroi se “Po të mos ishte Partia Demokratike, po të mos isha unë, Shqipëria nuk do të ishte në NATO, as nuk do të kishte liberalizim vizash” (Rilindja Demokratike, 2011)

Kjo lloj gjuhe është simptomë e mungesës së institucionalizimit të partisë, sipas Ziblatt, sepse legjitimiteti nuk buron nga strukturat, por nga karizma e liderit. Partia Demokratike, në këtë rast, nuk është një organizatë që institucionalizon elitat konservatore, por një mjet i pushtetit personal të Berishës.

Në vend që të ndërtojë një diskurs që forcon institucionet e pavarura siç do të kërkonte një parti konservatore e përgjegjshme në modelin ziblattian Berisha shpesh i përdor ato si armë politike. Gjatë përplasjes me Prokuroren e Përgjithshme Ina Rama pas ngjarjeve të 21 janarit 2011, ai deklaroi në Kuvend se “Kjo prokurorë është vegël politike, është pjesë e puçit të turpshëm që deshi të rrëzonte qeverinë” (Rilindja Demokratike, 2011).

Ky sulm ndaj një institucioni kushtetues si Prokuroria e Përgjithshme është tipik për një diskurs iliberal, që Ziblatt e lidh me dështimin e partive konservatore për të institucionalizuar demokracinë. Në vend të respektimit të ndarjes së pushteteve, Berisha e sheh çdo akt institucional si komplot politik, duke delegitimuar mekanizmat e kontrollit dhe balancës.

Një tjetër tipar i gjuhës së Berishës në këtë kohë (jo vetëm në këtë kohë ndoshta) është toni patriotik dhe mobilizues, është një lloj etnonacionalizmi i kontrolluar.

Gjatë kësaj periudhe, Berisha përdor vazhdimisht një diskurs patriotik, sidomos në kontekste si shpallja e Pavarësisë së Kosovës apo përvjetorët kombëtarë. Ai përdor figura si “Shqipëria natyrale”, “gjaku që s’bëhet ujë”, dhe “komb që nuk i nënshtrohet asnjë perandorie”. Retorika e tillë krijon një identitet konservator kombëtar, por shpesh shoqërohet me ngjyime përjashtuese ndaj kundërshtarit të brendshëm, i cili paraqitet si më pak patriot.

Ziblatt e pranon rëndësinë e nacionalizmit në ndërtimin e partive konservatore, por vetëm kur ai kanalizohet në mënyrë institucionalizuese, siç ndodhi në Gjermani me CDU apo në Britani me Partinë Konservatore. Në rastin e Berishës, nacionalizmi shndërrohet shpesh në mjet për të fshehur mungesën e një platforme të vërtetë institucionale dhe sigurisht për qëllime afatshkurtra politike.

Në thelb gjatë viteve të qeverisjes së dytë të PD-së dhe të qeverisjes së Berishës si kryeministër mund të themi se ai dhe PD-ja u përkufizuan nga një diskurs që dështoi të ndërtonte një konservatorizëm demokratik

Në dritën e teorisë së Ziblatt, gjuha politike e Sali Berishës në periudhën 2005–2013 tregon se Partia Demokratike nuk e përmbushi funksionin historik të një partie konservatore që kontribuon në konsolidimin e demokracisë. Diskursi i tij ishte i mbingarkuar me polarizim, përjashtim, delegitimim, personalizim dhe përdorim instrumental të institucioneve – të gjitha këto janë tregues të një kulture politike iliberale.

Në vend të ndërtimit të një kulture politike të vetëpërmbajtjes, Berisha ndërtoi një kulturë të përballjes së pandërprerë, ku politika shihet si luftë, jo si bashkëjetesë pluraliste. Prandaj, në kuptimin ziblattian, ai nuk u bë “elitë konservatore stabilizuese”, por një aktor polarizues, që kontribuoi në zhbërjen e normave të lojës demokratike.

7.5 Analizë diskursive e gjuhës dhe ligjëritit të PD-së, kryetarit të saj Lulzim Basha dhe ish kryetarit Berisha për periudhën 2013-2015

Në vitin 2013 Partia Demokratike ra në opozitë. Ajo i humbi zgjedhjet thellë dhe mori vetëm 53 mandate nga 140 gjatshëj. Kryeministri në detyrë Sali Berisha lajmëria në korrik të vitit 2013 se jepte dorëheqjen si kryetar i PD-së dhe se do të hapte garën për kryetar të partisë. Pas një gare relativisht të tensionuar fitoi Lulzim Basha, kandidati i pëlqyer nag ish kryetari Berisha.

Luzlim Basha vazdhoi të njëjtën linjë, të njëjtën gjuhë dhe të njëtin ligjërim në çdo aspekt si edhe më herët. Partia Demokratike me Luklzim Bashën kishte një kryetar të ri por një gjuhë në shinat e dikurshme. Në qoftë se do ta ndanim në faza veprimtarinë e PD-së dhe të kryetarit të saj Basha do të vinim re katër faza. Faza e parë mund të konsiderohet si ajo e një diskursi që karakterizohet më së shumti nga dobësia dhe viktimizimi. Kjo fazë përfshin pak a shumë vitete 2013-2017, pra mandatin e parë të qeverisë Rama.

Në një seancë parlamentare ku diskutohej për buxhetin, Basha përdori një gjuhë që përshkruante qeverinë si “një bandë grabitësish” dhe “një qeveri që ka vënë në rrezik të ardhmen e vendit” (Rilindja Demokratike 2014).

Ky lloj diskursi nuk dallon shumë nga retorika e partive që Ziblatti i cilëson si sabotuese të rendit demokratik, sepse në vend që të ofrojë një alternativë programatike, e paraqet kundërshtarin si ilegjitim. Në një konferencë për shtyp në qershor të vitit 2016 kur PD-ja kundërshtonte reformën në drejtësi Basha tha “Reforma në drejtësi është një plan i parapërgatitur për të vendosur kontrollin total mbi sistemin e drejtësisë, një kapje e pastër e institucioneve.”

Kjo është gjuhë e qartë delegitimimi institucional, që nënkupton se çdo rezultat reformues që nuk kontrollohet nga opozita është në vetvete i korruptuar. Pra kemi një vijim të tiparave të dikurshme kur PD-ja drejtohej nga Berishë. Në atë që mund të konsiderohet si faza e dytë, vitete 2017-2021 diskursi i PD-së dhe i kryetrit Basha më shumë flet për rrëzim të sisemit. Në një deklartë për mediat Basha shprehet :“Kjo qeveri është ndërtuar me votat e drogës, krimin dhe shantazhit.” (Rilindja demokratike, 2017)

Ky formulim, pra “qeveri e drogës”, u bë një metaforë qendrore e diskursit opozitar. Ai synon të krijojë një perceptim të antagonizmit absolut, siç ndodh në rastet ku partitë e djathta nuk e njohin legjitimitetin e humbjes zgjedhore. Më pas PD ndërmori veprime politike edhe më ekstreme, veprime që u shoqëruan edhe me një gjuhë më radikale. Në vitin 2019 nisën protestat dhe o dogjën mandatet. PD dhe aleatët e saj braktisën Kuvendin, ndërsa protestat kishin mesazhe si “Rama ik!”, “Nuk ka më zgjedhje me këtë regjim!”, “Do e djegim këtë regjim!” etj. Në fjalimin e mbajtur para Kryeministrit (16 shkurt 2019), Basha tha: “Ky nuk është më shtet. Është një bandë që kontrollon gjithçka. Revolucionin qytetar ka nisur” (Rilindja Demokratike, 2019). Ziblatti e quan këtë shpërbërje të diskursit institucional, që në vend të opozitës parlamentare zgjedh një retorikë përmbysjeje, duke shmangur rregullat e lojës demokratike.

Një fazë tjetër është ajo e poas vitit 2021 kur ish kryetari Berisha u shpall non grata nga Departamenti Amerikan i shtetit. Luklzim Basha vendosi të pezullojë anëtarësinë e Berishës nga grupi parlamentar i PD-së. Në

deklaratën zyrtare Basha përdori një gjuhë të përmbajtur dhe shumë të kujdeshme. Ai tha se “PD nuk mund të jetë peng i askujt. Marrim këtë vendim për të ruajtur partneritetin me SHBA.”

Ky është një moment ku PD përpiqet të rikthejë një diskurs institucionalist, të ngjashëm me atë që Ziblatti përshkruan si model britanik – distancimi nga radikalët për të ruajtur integritetin institucional. Në PD ndërkohë nisi “lufta civile”. Berisha nga një takim i Foltres në tetor të 2021 Fier tha se “Luklzim Basha është një peng, një marionetë e Sorosit dhe Ramës. PD është

tradhtuar nga brenda.” Ky është një shembull i personalizimit të konfliktit politik dhe përdorimit të gjuhës konspirative, element kyç në analizën e Ziblat për rënien e rendit konservator.

Pra faza e tretë është pak a shumë në linjën ku Basha tregohet i kujdesshëm ndrs Berisah është jashtëzakonisht personalizues, deligjitimues, asgjësues. Vitet 2023 -2025 mund të konsiderohen si faza e katërt dhe karakterizohen nga një fragmentim i plotë dhe shkatyërrim gjithashtu i plotë i gjuhës së gjetjes së një terreni të përbashkët. Në zgjedhjet vendore të vitit 2023 grupi i Bashës, i cili drejtohej zyrtarisht nga Alibeaj dhe që kishin vulën e drejtimit të PD-së theksonte rëndësinë e standardeve perëndimore, të garës programatike dhe “rinisjes morale të PD-së” ndërsa grupi i Berishës ndërtonte mitin e “rithemelimit të partisë së vërtetë”, me një gjuhë populiste, nacionaliste dhe konfliktuale. Për shembull në një miting në Elbasan Berisha tha se “Ne jemi populli! Ata janë vasalet! PD e vërtetë nuk do të nënshtrohet!”

Gjuha ndaj SPAK-ut dhe drejtësisë bëhet shumë e ashpër dhe acidike. Ajo cilësohet sidmos pas hetimeve ndaj Berishës dhe përballjes me drejtësinë, ai e cilësoi SPAK-un si “një instrument i Sorosit”, “një vegël e mafies ndërkombëtare”, “një organ politik i rilindjes”

Kjo gjuhë e kthen çdo institucion që nuk vepron sipas vullnetit të liderit në një armik, duke rrezikuar themelet e ligjëritimit demokratik.

Si përfundim për peridudhën 2013-2025 mund të themi se PD nuk ka arritur të funksionojë si një parti konservatore në kuptimin klasik të fjalës. Ajo ka përdorur gjuhë të fortë delegjitimimi institucional, ka praktikuar bojkotimin si formë politike të përsëritur, ka ndërtuar një diskurs identitar, jo programatik dhe është fragmentuar në dy diskurse kundërshtuese: një që përpiqet të duket institucionalist, dhe një tjetër që është hapur populist dhe përmbysës.

Tabelë 1.8

Tabelë përmbledhëse e tipareve kryesore të diskursit të PD-së 1991-2025

Periudha	Tiparet e Diskursit	Përputhshmëria me Modelin Ziblat
1990–1992	Konservatorizëm diskursiv, retorikë e moderuar, apel për rend dhe gradualizëm	Përpjekje për të mbushur boshllëkun konservator me diskurs rendi; jo konservatorizëm i institucionalizuar
1992–1997	Retorikë përjashtuese, personalizim i pushtetit, përpjekje për presidencializëm	Mungesë e theksuar e institucionalizimit, diskurs polarizues dhe autoritar
1997–2005	Diskurs delegjitimues (1997–2001), më pas adaptim i kufizuar institucional (2001–2005)	Strategji përmbysjeje, më pas adaptim i pjesshëm; mungesë elitash konservatore
2005–2013	Rikthim i retorikës përjashtuese, personalizim, sulme ndaj institucioneve	Personalizim i pushtetit, mungesë vetëpërmbytjeje institucionale

2013–2025	Diskurs i fragmentuar: njëri institucionalist (Basha), tjetri populist (Berisha), delegjitimues ndaj drejtësisë	Mungesë koherence ideologjike, polarizim i thelluar, dy diskurse që përjashtojnë njëri-tjetrin
-----------	---	--

Tabela paraqet një analizë kronologjike të gjuhës politike dhe diskursit të Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), nga viti 1990 deri në vitin 2025, duke u bazuar në modelin teorik të Daniel Ziblatt për rolin e partive konservatore në konsolidimin demokratik. Nga analiza mund të nxjerrim disa përfundime të rëndësishme.

Periudha 1990–1992 përfaqëson përpjekjen e vetme të PD-së për të artikuluar një konservatorizëm diskursiv të moderuar, që synonte rendin, gradualizmin dhe shmangien e dhunës. Edhe pse ishte një imitacion i konservatorizmit klasik, ai kishte një funksion stabilizues në një shoqëri pa traditë konservatore.

Në vitet 1992–1997 diskursi bëhet autoritar, përjashtues dhe personalist, duke treguar mungesën e brendësimit të rregullave të garës pluraliste. Pushteti shihet si pronë personale dhe institucionet trajtohen si mjete për konsolidimin e kontrollit.

Në vitet 1997–2005 pas krizës së vitit 1997, PD kalon në një fazë delegjitimimi ekstrem, përfshirë bojkote, sulme ndaj ndërkombëtarëve dhe nxitje të dhunës. Vetëm pas 2001-shit fillon një adaptim i kufizuar institucional, por pa thellim të kulturës demokratike.

Në vitet 2005–2013 që vjen pas periudhës së rikthimit në pushtet shënohet kemi një fillim premtues institucional, që më pas zëvendësohet nga një diskurs polarizues, personalist dhe konfrontues ndaj institucioneve si Prokuroria apo opozita. Përdoret patriotizmi si zëvendësim për projektin konservator.

Periudha 2013–2025 – karakterizohet nga fragmentim total. Nga njëra anë Basha ndjek një gjuhë më të kujdesshme institucionale; nga ana tjetër Berisha rikthehet me një diskurs populist, delegjitimues dhe agresiv ndaj drejtësisë. PD ndahet midis imitimit të konservatorizmit dhe radikalizmit diskursiv të personalizuar.

Si përfundim mund të thuhet se në asnjë prej këtyre fazave PD nuk arrin të përmbushë rolin e një partie konservatore në kuptimin që i jep Ziblatt. Ajo mbetet një strukturë pa bazë klasore, pa përkushtim institucional dhe me diskurs të paqëndrueshëm, që shpesh ndjek strategji përjashtuese në vend të ndërtimit të rendit demokratik.

7.6 Analizë e intervistave të disa funksionarëve dhe ish funksionarëve të PD-së

Modeli teorik i Daniel Ziblatt mbi rolin e partive konservatore në konsolidimin e demokracisë liberale ofron një lente të fuqishme për të analizuar se si Partia Demokratike e Shqipërisë (PD) ka funksionuar në periudha të ndryshme të historisë së saj, nga krijimi në fillim të viteve '90 deri në vitin 2025. Në qendër të këtij modeli qëndrojnë katër dimensionet thelbësore: (1) forca

organizative e partise, (2) shkalla e institucionalizimit, (3) sjellja ne momente krizash, dhe (4) roli i partise ne ruajtjen e institucioneve demokratike.

Ky kapitull nderton nje analize te thelluar mbi bazen e 10 intervistave te detajuara me ish-kryetare, funksionare dhe drejtues strukturash te PD-se, duke aplikuar nje metode kodimi ordinal (1–5) per secilin nga kater dimensionet. Vleresimi ne shkalle 5 do te thote perputhje e plote me standardet demokratike sipas Ziblatt, ndërsa 1 shenon nje mungese te plote te perputhshmerise. Ne fund, nje mesatare per cdo dimension sherben si tregues i gjendjes se pergjithshme te partise sipas ketij modeli. Nje qasje e tille jo vetem jep nje pasqyre sasiore te performances se partise, por edhe i jep legjitimitet analizes krahasuese ndermjet periudhave historike te ndryshme.

A) Forca organizative, nga mobilizimi entuziast tek lodhja strukturore

Dimensioni i pare ka mesataren me te larte (3.4), dhe tregon se PD-ja ka shfaqur potencial organizativ, veçanerisht ne vitet 1992–1997 dhe 2005–2013. Intervistat e I.B., K.D., E. S., E. G. dhe B. V. e portretizojne PD-ne e hershme si nje "familje politike" me struktura funksionale, lidhje te ngushta me anetaresine dhe angazhim idealist. Ne vitet e para, organizimi ishte produkt i mobilizimit ideologjik kunder komunizmit dhe aspirates per nje rend te ri liberal. Deget lokale funksiononin si qeliza jetike te aktivitetit politik dhe shprehje e vetorganizimit popullor. Kjo eshte nje karakteristike e theksuar edhe ne modelet klasike te mobilizimit konservator (Ziblatt, 20178).

Megjithate, pas vitit 2017, pothuajse te gjitha intervistat identifikojne nje lodhje strukturore dhe rritje te hendekut midis qendres dhe bazes. Të intervistuarit E. M. dhe I. C. theksojne mungesen e besimit dhe shkëputjen e strukturave nga realiteti i terrenit. Deget lokale, ne vend qe te funksionojne si instrumente perfaqesimi dhe formulimi politik, jane reduktuar ne instrumente mobilizimi elektoral ose noterizimi formal. Kjo eshte nje sinjale paralajmerues i dezinstitutionalizimit progresiv, i cili sipas teorise se Ziblatt, paralizon kapacitetin e partive per te mbajtur rend demokratik.

B) Institucionalizimi, partia si aparat apo institucion?

Me nje mesatare prej 2.6, ky dimension reflekton problemin me serioz te PD-se: mungesen e nje strukture te institucionalizuar. Ne te gjitha intervistat, veçanerisht ato te B. H., GJ. G., A. M. dhe E. M., permendet fakti se organet statutore (Kuvendi Kombetar, Keshilli, Kryesia) funksionojne vetem ne menyre formale, duke aprovuar vendime te marra me pare nga lidershpi. Kjo e kthen partine ne nje aparat mekanik, dhe jo ne nje organizate me jete institucionale.

Nje teme e perbashket ne intervista eshte mungesa e rotacionit te lidershpit, mungesa e kalendarit elektoral te qarte dhe zbehja e demokracise se brendshme. Perfaqesues si K. D. dhe L. B. e trajtojne partine si "ne gjendje lufte", ku formalitetet statutore nuk kane rendesi. Ne kete kontekst, partia humbet funksionin e saj si gardiane e rendit demokratik dhe e kthehet ne nje instrument personal te liderit, gje qe bie plotesisht ndesh me modelin ziblattian. Per Ziblatt, institucionalizimi nuk eshte thjesht ekzistence e strukturave, por funksionimi i tyre deliberativ, ku lidershpi eshte i pergjegjshem, rotacioni i garantuar dhe perfaqesimi i shpërndare.

C) Sjellja ne momente krize, midis konfrontimit dhe mungeses se vetepërmbajtjes

Ky dimension ka një mesatare edhe me të ulet (2.4), duke treguar se PD-ja në momente të rëndësishme krizash ka ndjekur strategji reaktive dhe konfrontuese, shpesh të paorganizuar institucionalisht. Viti 1997 konsiderohet në të gjitha intervistat si një moment tragjik për PD-në dhe për rendin publik. Shume nga funksionarët, si B.V. apo E. S., e shohin si deshtim të përmasave ekzistenciale, një moment ku mungoi aftësia për të frenuar reagimet emocionale dhe për të ruajtur qartësi institucionale.

Në vitet 2019 dhe 2021, veprimet e PD-së (bojkot i parlamentit, djegie mandatesh, protesta) janë justifikuar nga funksionarët si reagime ndaj një regjimi jodemokratik. Megjithatë, intervista të tilla si ajo e A. M. dhe E. S. e kritikojnë mungesën e një alternative institucionale dhe mbizotërimin e një stili emocional politik. Kjo do të thotë se partia nuk ka zhvilluar një "kulturë të vetepërmbajtjes politike", një element qendror në modelin e Ziblatt, i cili parashikon se në momente krizash, është partia konservatore që duhet të frenoj eksceset e shumicës ose të minorancave radikale.

D) Qëndrimi ndaj institucioneve, kritika legjitime apo delegjitimim i plotë?

Mesatarja prej 2.8 në këtë dimension reflekton një ndarje të fortë brenda vetes së PD-së, një linjë institucionaliste dhe një linjë delegjitimiste. Intervistat e B. H., GJ. G., B. V. dhe E. G. tentojnë të ruajnë dallimin midis institucioneve si ide dhe menyres së kapjes së tyre në praktikë. Ato insistojnë se PD-ja ka kontribuar në reformën institucionale dhe ka qenë mbrojtëse e tyre, madje edhe kur nuk ka përfituar politikisht.

Në anën tjetër, funksionarë si K. D. dhe I. B. flasin në terma delegjitimues për KQZ-në, gjyqësorin dhe presidentin, duke i konsideruar si "vegla të regjimit". Ky diskurs, nëse nuk shoqërohet me një ofertë institucionale alternative, e largon PD-në nga roli i saj si mbrojtëse e rregullit kushtetues dhe e afron me logjikën e opozitës sistematike, e cila është kundër vetë sistemit politik. Sipas teorive demokratike (Levitsky & Ziblatt, 2018), një opozitë që braktis fushën institucionale dhe vepron vetëm në terren simbolik, e dobëson funksionin e kontrollit demokratik dhe e përben rrezik për balancën e pushteteve.

Tabela e kodimit tregon qartë një profil të pabalancuar të PD-së sipas modelit të Ziblatt. Në asnjë nga katër dimensionet nuk arrijnë një përputhje të plotë me rolin e pritshëm të një partie konservatore që kontribuon në stabilizimin e demokracisë.

Këtu po paraqesim edhe një tabelë me vlerat e kodimit të intervistave sipas modelit të Daniel Ziblatt.

Në lidhje me kodimin sipas këtij modeli duhet thënë se në këtë rast, intervistat me funksionarët e PD-së janë koduar sipas këtyre dimensioneve, duke përdorur një shkallë rendore nga 1 deri në 5, ku:

Kodi

Kuptimi

5 Përputhje e plotë me standardet demokratike sipas Ziblatt

Kodi	Kuptimi
4	Pothuajse e plotë, me disa mangësi të vogla
3	Pjesërisht përputhëse, ose në tranzicion
2	Dobësi të mëdha në përputhje; standarde të brishta
1	Mungesë e qartë e përputhshmërisë; autokratizëm, personalizim ekstrem

Ketu po paraqesim dimensionet dhe mënyrën e kodimit

1. Forca organizative

Vlerësohet bazuar në: konsistencën e strukturës, mobilizimin e anëtarësisë, lidhjen me bazën, dhe vazhdimësinë funksionale të degëve.

Shembull: Kryetari i degës I.B. flet për PD-në si “familje” në vitet ’90 dhe “strukturë të gjallë” edhe pas 2017 Kodi = **5**

2. Institucionalizimi

Vlerësohet mbi: funksionimin e organeve statutore, rotacionin e lidhshimit, zbatimin e rregullave të brendshme, dhe mungesën e varësisë nga lideri.

Shembull: Sekretari organizativ K.B. thotë “strukturat statutore s’kanë vlerë kur jemi në luftë” Kodi = **1**

3. Sjellja në momente krize

Analizohet mbi bazën e sjelljes në vitet 1997, 2019, 2021: nëse partia ka ndjekur rrugë institucionale apo rrugë të jashtme konfrontuese.

Shembull: Kryetari i degës A.M. përshkruan reagimet si të papjekura dhe retorike Kodi **2**

4. Qëndrimi ndaj institucioneve

Vlerësohet nëse partia i ka konsideruar institucionet si të vlefshme (edhe kur i kritikon), apo i ka delegjitimuar si pjesë e armikut politik.

Shembull: kryetari i degës GJ.GJ. flet për “diskurs kritik ndaj kapjes”, por edhe për ruajtjen e balancës Kodi = **3**

Dimensioni	Mesatarja e Kodimit
Forca organizative	3.4
Institucionalizimi	2.6
Sjellja ne momente krize	2.4
Qendrimi ndaj institucioneve	2.8

Ne gjuhën e vetë Ziblatt, partitë e djathta luajnë rol jetik në konsolidimin e demokracive vetëm kur ato veprojnë si filtra të rendit, stabilitetit dhe vetepërmbytjes së pushtetit. Partia Demokratike e Shqipërisë, në dritën e kësaj analize, nuk ka arritur të institucionalizojë veten si një aktor i tillë. Në vend të një konservatorizmi demokratik, ajo ka manifestuar një konservatorizëm stilistik, të reduktuar në retorikë dhe simbolikë, por jo në struktura dhe funksion.

Ajo që shfaqet si konkluzion themelor është se PD-ja ndodhet në një moment ku duhet të zgjedhë midis dy modeleve: ose të mbetet një subjekt karizmatik me jete ciklike rreth liderit, ose të shnderohet në një parti konservatore në sensin e Ziblatt, me struktura, rotacion, vetekufizim dhe rol stabilizues në rendin politik. Nëse kjo nuk ndodh, roli i saj do të mbetet periferik në rendin demokratik dhe do të favorizojë polarizimin e metejshme dhe erosionin e institucioneve parlamentare në Shqipëri.

Kapitulli VIII: Gjetjet kryesore dhe diskutim

8,1 Gjetjet, ndërlidhje e të dhënave empirike me modelin teorik

Disa nga gjetjet më të rëndësishme pas këtij hulumtimi të imtësishëm për të parë sjelljen dhe rolin e forcave konservatore parimisht por të Partisë Demokratike konkretisht në vitet 1991-2025 po i paraqesim të përmblledhura më poshtë. Duke u mbështetur në kornizën teorike të Daniel Ziblatt mbi rëndësinë e partive konservatore si "garantë" të demokracisë, analizohen katër dimensionë (variabla) kyçe: forca organizative, institucionalizimi, sjellja gjatë krizave, dhe qëndrimi ndaj institucioneve. Të dhënat janë operacionalizuar nëpërmjet vlerësimeve numerike (nga 1 në 5) për indikatorë përfaqësues të secilit dimension.

1. Periudha 1992–1997 karakterizohet nga demokratizim i pamatur dhe ndërtim vertikal autoritar

Pas rënies së komunizmit, Partia Demokratike mori përsipër rolin e partisë së parë opozitare dhe më pas, në mars 1992, të partisë së parë në pushtet në Shqipërinë postkomuniste. Megjithatë fillimi i kësaj periudhe u shoqërua me shpresa për demokratizim dhe transformim institucional, analizat empirike dhe diskursive tregojnë se PD nuk arriti të konsolidojë struktura të qëndrueshme as në planin organizativ, as në atë ideologjik.

Sipas vlerësimit të dhënë, përzgjedhja e kandidatëve dhe performanca zgjedhore (2) ishin të dobëta dhe të ndikuara nga liderizmi i fortë dhe mungesa e strukturave konkurruese. Funksionimi i organeve statutores (1), rotacioni i lidershit (1) dhe orientimi programor i partisë (1) ishin gati inekzistent. Partia funksiononte si një trup i unifikuar nën drejtimin personal të Sali Berishës, pa një debat të brendshëm real apo mekanizma korrigjues institucionalë.

Kulmi i kësaj periudhe, kriza e vitit 1997, nxori në pah sjelljen destruktive të partisë në pushtet ndaj institucioneve demokratike dhe opinionit ndërkombëtar. Diskursi u bë konfrontues, ndërsa marrëdhënia me opozitën, median dhe shoqërinë civile u karakterizua nga përjashtimi dhe

stigmati. Ziblat e konsideron këtë lloj sjelljeje si karakteristikë e partive që, në vend të institucionalizimit të rendit demokratik, e përvetësojnë shtetin për të mbrojtur interesin e ngushtë të elitës.

2. Periudha 2005–2013 karakterizohet nga një përpjekje ose tentativë për institucionalizim dhe stabilitet

Rikthimi i PD-së në pushtet në vitin 2005, me një diskurs më teknokratik dhe pro-evropian, përbën një nga momentet e rralla ku e djathta shqiptare tentoi të sillet në përputhje me parimet e një partie konservatore të institucionalizuar. Në këtë fazë u shënuan përmirësime të ndjeshme në organizimin strukturor (vlerësim 4), në përzgjedhjen e kandidatëve (4) dhe në pjesëmarrjen në proceset reformuese, përfshirë reformën zgjedhore dhe reformat në funksion të integritetit evropian (3).

Kjo periudhë mund të konsiderohet si më afër modelit ziblattian, ku partitë e djathta ndihmojnë në stabilizimin e demokracisë përmes pjesëmarrjes aktive në institucione, ruajtjes së status quo-së kushtetuese dhe kufizimit të radikalizmave. Ndërkohë, rotacioni i lidërshit mbeti i kufizuar (3), por u pa një përpjekje për të aktivizuar struktura lokale dhe për të institucionalizuar proceset vendimmarrëse.

Megjithatë, problemi kryesor i kësaj periudhe ishte ruajtja e stilit të një lideri dominues dhe mungesa e konkurrencës së brendshme për pushtet, çka e mbajti partinë të varur nga një figurë qendrore dhe dobësoi gradualisht strukturat pluraliste brenda saj.

3. Periudha 2013–2025 karakterizohet nga degradimi i konservatorizmit institucional

Pas humbjes në zgjedhjet e vitit 2013, Partia Demokratike hyri në një fazë krize të zgjatur identitare, organizative dhe strategjike. Të dhënat tregojnë rënie të ndjeshme në të gjithë indikatorët. Struktura organizative u dobësua (2), përzgjedhja e kandidatëve u bë jo-transparente dhe e fragmentuar (2), ndërsa funksionimi i organeve statutores dhe rotacioni i lidërshit mbetën gati inekzistent (1).

Kjo periudhë përfshin ngjarje dramatike si djegia e mandateve parlamentare, bojkotimi i zgjedhjeve lokale të vitit 2019, sulme të vazhdueshme ndaj Reformës në Drejtësi dhe delegjitimimi i aktorëve ndërkombëtarë. Diskursi politik u kthye në polarizim ekstrem, me etiketime përjashtuese si “regjim”, “puç”, “shtet mafioz”, “tradhtarë”, të cilat kanë gërryer hapësirën e konsensusit demokratik.

Në gjuhën e Ziblat, kemi të bëjmë me një shndërrim të partisë konservatore në aktor jashtë rendit, që nuk ofron më stabilitet por pasiguri, nuk ndihmon më në institucionalizim por në delegjitimim të rregullave të lojës. Kjo sjellje përbën një kërcënim për vetë qëndrueshmërinë e sistemit pluralist.

Gjetjet e analizës tregojnë se Shqipëria nuk ka njohur një traditë të konsoliduar të konservatorizmit institucional, ashtu siç e koncepton Daniel Ziblat. Partitë e djathta nuk kanë

arritur të veprojnë si faktorë stabiliteti institucional, por shpesh kanë qenë burim i krizave dhe delegjitimitit të rendit demokratik.

Vetëm periudha 2005–2013 përfaqëson një përpjekje për institucionalizim, por ajo rezultoi jetëshkurtër dhe e brishtë për shkak të mungesës së konkurrencës së brendshme dhe mbizotërimit të një modeli liderist. Në periudhat e tjera, e djathta shqiptare ka dështuar në ndërtimin e një diskursi të moderuar, të përkushtuar ndaj institucioneve dhe rregullave të lojës, çka e ka bërë të pamundur konsolidimin e demokracisë në kuptimin ziblattian të saj.

Ky dështim nuk është vetëm një çështje ideologjike, por institucionale dhe kulturore – mungesa e një kulture konservatore që e sheh shtetin dhe institucionet si një rend që duhet mbrojtur nga destabilizimi dhe jo si një armë për ta fituar pushtetin me çdo mjet.

Tabelë 1.9

Vlerësimi i tipareve sipas krieteve të Ziblatit i partive të Djathta (PD-së) në Shqipëri në vitet 1992-2025

Indikatorët	1992–1997	2005–2013	2013–2025
Numri i anëtarëve dhe degëve lokale	3	4	2
Përzgjedhja e kandidatëve	2	4	2
Performanca zgjedhore	2	3	2
Rotacioni i lidershipit	1	3	1
Funksionimi i strukturave statutore	1	3	1
Identiteti ideologjik dhe orientimi programor	1	3	1
Qëndrimi në krizat	1	3	1
Deklaratat publike gjatë krizës	2	3	2
Pjesëmarrja në marrëveshje politike	1	2	1
Qëndrimi ndaj institucioneve të pavarura	1	3	1
Pjesëmarrja në reforma sistematike	1	3	1
Diskursi mbi rendin kushtetues dhe ndërkombëtarët	1	3	1

Këto gjetje mbi dimensionet bazë në kuptimin ziblatian janë në të njëjtën linjë me analizën e diskursit të drejtuesve të PD-së në vite. Gjetjet nga analiza e diskursit tregojnë se në vitet 1990-

1992 kemi konservatorizëm diskursiv pa bazë sociale. Në fillimet e pluralizmit, Berisha përpqet të prodhojë një diskurs konservator artificial, që synon ruajtjen e rendit dhe shmangien e kaosit, por pa mbështetje në një klasë tradicionale konservatore. Ky është një konservatorizëm emergjent, moral dhe institucionalist në retorikë, por i pambështetur në strukturë.

Gjithashtu gjetjet tregojnë se kemi radikalizim përjashtues dhe personalizim të pushtetit në vitet 1992–1997. Diskursi i PD-së kalon në një fazë përjashtuese, me gjuhë delegjitimimi ndaj opozitës dhe institucioneve, duke u larguar nga modeli konservator dhe duke krijuar një narrative moralizuese e autoritare që kulmon me krizën e vitit 1997.

Në vitet 1997-2005 kemi një përshtatje, një adaptim të sipërfaqshëm nga delegjitimimi i mëhershëm. PD luhet os mes gjuhës përmbysëse (1997–2001) dhe një qasjeje tjetër më të kontrolluar dhe të kujdeshme në vitet 2001–2005, por pa një transformim real institucional. Diskursi mbetet i personalizuar dhe jo ideologjikisht konservator në sensin historik.

Në vitet 2005-2013 kemi edhe një pamje të jashtme konservatore por edhe rishfaqje të polarizimit. Edhe pse retorika teknokratike e fillimit të mandatit të dytë në pushtet krijon një iluzion stabilizimi, në praktikë PD mbetet një parti e udhëhequr nga karizma personale, me një diskurs polarizues, patriotik dhe përjashtues, duke minuar institucionalizimin demokratik.

Në vitet 2013-2025 kemi qartësisht fragmentim dhe delegjitimim të thelluar. Gjuha politike pas vitit 2013 karakterizohet nga polarizim ekstrem, bojkot parlamentar, retorikë konspirative dhe mungesë e theksuar e kapacitetit për të ndërtuar një diskurs konservator institucionalist. Fragmentimi pas vitit 2021, me përplasjen Basha–Berisha, shpërfaq dështimin për të ndërtuar një identitet të qëndrueshëm ideologjik dhe organizativ. Pwr pasojw edhe kontributi nw konsolidimin e demokracisw do tw jetw sicc e tregon edhe tabela mw poshtw nw proporcion me kwtw gjendje.

Tabela 2.0

Kontributi i PD-së në Stabilizimin Demokratik të Shqipërisë (1992–2025)

*Variabli i varur: Stabilizimi i demokracisë sipas performancës së PD-së
(Burime: Freedom House, V-Dem, OSBE/ODIHR, KE)*

Periudha	FH – Party Pluralism (0–1)	V-Dem – Party Institutionalization (0–1)	V-Dem – Opposition Role Index (0–1)	Roli i opozitës (0–2)	Vlerësim mesatar i stabilizimit (0–1)
1992–1997	0.53	0.31	0.33	1.0	0.54
1997–2005	0.46	0.35	0.33	1.0	0.49

Periudha	FH – Party Pluralism (0– 1)	V-Dem – Party Institutionalization (0– 1)	V-Dem – Opposition Role Index (0–1)	Roli i opozitës (0–2)	Vlerësim mesatar i stabilizimit (0– 1)
2005– 2013	0.65	0.55	0.48	2.0	0.67
2013– 2025	0.42	0.30	0.26	0.4	0.35

Pra shihet që në periudhën 1992–1997, PD-ja luajti rol themelor në ndërtimin e sistemit pluralist, por qeverisja autoritare dhe kriza e vitit 1997 e minuan stabilizimin demokratik (0.54). Gjatë 1997–2005, në opozitë, PD-ja shfaqti sjellje obstruksioniste dhe bojkoti, me ndikim të dobët demokratik (0.49).

Në 2005–2013, partia arriti nivelin më të lartë institucional dhe kontribuoi më shumë në konsolidimin demokratik (0.67).

Pas 2013, PD-ja u përball me fragmentim dhe humbje të rolit si opozitë funksionale, duke u vlerësuar shumë ulët në aspektin demokratik (0.35).

8,2 Diskutim, roli i së djathtës në konsolidimin (apo jo) të demokracisë në Shqipëri, ndikimi i diskursit, strukturës dhe veprimeve institucionale

Nëse ka një mësim të thellë që mund të nxirret nga shqyrtimi i katër dimensioneve të modelit të Daniel Ziblatt për partitë konservatore pra nga forca organizative, institucionalizimi, sjellja në momentet e krizës dhe roli në ruajtjen e rendit demokratik në rastin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, ai nuk qëndron thjesht në mungesën e përputhjes me këtë model, por në ekspozimin e një vakumi më të thellë historik e shoqëror. Shqipëria postkomuniste nuk trashëgoi një rend institucional konservator, nuk trashëgoi një klasë të ndërgjegjshme për përgjegjësi historike, dhe nuk trashëgoi një sens të përbashkët për ndërtimin e një politike të vetëpërmbytur në kushtet e pluralizmit.

Kjo mungesë nuk është mungesë teknike apo e përkohshme. Ajo është mungesë e një rendi simbolik dhe real njëherazi. Në vend të një klase konservatore të brendësuar në strukturën e shoqërisë e cila në rastet e tjera të Evropës Perëndimore ishte shtylla e stabilitetit institucional dhe kultivimit të vetëpërmbytjes politike. Shqipëria prodhoi një rend të çakorduar, një tranzicion të zgjatur pa drejtim, dhe një politikë që nuk ndërtoi rregulla, por i simuloi ato përmes gjuhës. Politika shqiptare, veçanërisht ajo e djathtë, nuk përfaqësoi një përpjekje për të institucionalizuar vlerat konservatore, por për t'i përvetësuar ato si kostume diskursive që mund të visheshin dhe hiqeshin sipas rastit.

Në këtë kontekst, analiza diskursive e gjuhës së Partisë Demokratike dhe e liderit të saj dominues, Sali Berisha, merr një rëndësi të veçantë. Kjo nuk është thjesht analizë e retorikës politike; është analizë e një përpjekjeje për të krijuar konservatorizmin si një rend simbolik në

mungesë të rendit shoqëror që zakonisht e mbështet atë. Në vitet 1990–1992, Berisha u përpoq të artikulojë një diskurs të urtësisë, të rendit, të ligjshmërisë dhe të ndjenjës historike – një përpyetje që në rrethanat konkrete të Shqipërisë ishte e pashoqe, madje e papërshtatshme. Ky ishte një konservatorizëm që nuk kishte pas, nuk kishte shtresë shoqërore që ta mbronte dhe nuk kishte infrastrukturë kulturore që ta mbështeste. Ai ishte, siç do të thoshte Giorgio Agamben (2007), një "formë pa substancë", një "gjendje e jashtme pa fuqi që e mban".

Por ajo që e bën edhe më të thellë këtë paradoks është fakti që në momentin e parë të përballjes me realitetin e pushtetit, ky konservatorizëm diskursiv u braktis menjëherë. Retorika e përmbajtur u zëvendësua me një diskurs të dhunshëm, përjashtues dhe përballës, i cili shpesh morri formë moraliste jo në kuptimin e etikës politike, por në kuptimin e një gjykimi total ndaj kundërshtarit si “armik i së mirës kolektive”. Ky është një moralizëm i zhveshur nga ndjeshmëria historike dhe nga detyrimi për të ndërtuar rend; është një moralizëm për të justifikuar përjashtimin dhe luftën politike totale. Siç e vë re edhe Chantal Mouffe (2000), kur politika nuk ndërtohet mbi pranimin e konfliktit legjitim dhe rregullave demokratike të ballafaqimit, ajo rrezikon të kthehet në luftë morale për dominim.

Në këtë dritë, retorika e PD-së gjatë viteve 1992–1997, dhe më pas në periudhat 1998–2005 dhe 2005–2013, e dëshmon mungesën e një sensi konservator të thellë. Gjuha e saj nuk ishte gjuhë e ndërmjetësismit, e ruajtjes së institucioneve, apo e moderimit të pasioneve publike. Përkundrazi, ajo u shfaq si një gjuhë e mobilizimit plebishitar, e sulmit ndaj çdo autoriteti alternativ dhe e përshkrimit të kundërshtarit politik si agjent i të keqes, i destabilizimit apo i anti-kombit. Ky është një tipar thelbësor jo i konservatorizmit, por i diskurseve populiste, të cilat Laclau (2005) i quan "logjika të përjashtimit total".

Në vend që Partia Demokratike të luante rolin që Ziblatt (2017) i atribuon partive konservatore në demokraci – ruajtjen e sistemit politik, përqaftimin e pluralizmit për të mbrojtur vetveten nga revolucionarizmi dhe anarkia – ajo u kthye shpesh në aktoren kryesore të delegjitimitimit të sistemit, sa herë që nuk ishte në pushtet. Kjo u bë veçanërisht e dukshme pas vitit 2013, ku retorika politike e së djathtës u fragmentua në fraksione që jo vetëm përçanin strategjitë, por shpërbënin edhe konceptin e autoritetit, të unitetit dhe të rendit institucional. Gjuha e Berishës dhe pasardhësve të tij, në këtë periudhë, u bë gjuhë e luftës totale: gjuha e linçimit, e përçarjes, e refuzimit të çdo legjitimiteti që nuk buronte nga figura e liderit apo nga “vullneti i popullit” të përvetësuar retorikisht.

Ky zhvillim tregon qartë se në Shqipëri nuk ekziston një klasë konservatore në kuptimin e Ziblatt-it, nuk ekziston një klasë që ka interesa përtej fitores së radhës, që ka ndjeshmëri për rendin dhe për ruajtjen e institucioneve si garanci e vazhdimësisë shoqërore. Në mungesë të saj, në vend të vetëpërmbajtjes kemi improvizim, në vend të disiplinës institucionale kemi shpërthim retorik, dhe në vend të ndërmjetësismit kemi përpyetje për dominim total. Politika shqiptare nuk ndërtohet mbi themelet e një kontrate të brendshme mes aktorëve, por mbi përpyekjen për të asgjësuar tjetrin si jo-legjitim.

Në këtë kuptim, analiza diskursive e gjuhës së PD-së është më shumë sesa një analizë gjuhësore. Ajo është një dritare drejt një mungese më të thellë të modernitetit politik shqiptar. Ajo tregon se diskursi është jo vetëm instrument manipulimi, por edhe simptomë e mungesës së rendit. Fjalët

janë të mëdha, por bosh nga përmbajtja që do të duhej të vinte nga një kulturë politike e institucionalizuar. Kemi të bëjmë me një politikë që përpiket të imitojë format e demokracisë perëndimore, por që nuk ka themele që ta mbështesin atë imitacion.

Ky nuk është vetëm një problem i së djathtës. Kjo është një simptomë e thellë e krizës së rendit në Shqipëri. Në një vend ku as e majta nuk ka trashëguar një kulturë të lirisë liberale, dhe as e djathta nuk ka formuar ndonjëherë një ndjeshmëri konservatore të mirëfilltë, përpjekja për të ndërtuar një rend demokratik nuk mund të mbështetet vetëm në procedura apo ndërhyrje teknike. Ajo ka nevojë për një transformim të ndjeshmërisë politike, për ndërtimin e një etike të përgjegjësisë dhe për kultivimin e një klase që ka diçka për të humbur nga rrënimi i sistemit.

Kapitulli IX: Konkluzione dhe rekomandime

9,1 Konkluzione

Ky studim ndërtoi një analizë të thelluar të zhvillimit historik, institucional dhe diskursiv të Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD) në periudhën 1990–2025, duke e vendosur atë në dritën e modelit teorik të Daniel Ziblatt mbi partitë konservatore dhe rolin e tyre në konsolidimin demokratik. Në qendër të kësaj analize qëndruan katër dimensionet e modelit ziblattian – forca organizative, shkalla e institucionalizimit, sjellja në momentet e krizës dhe roli në ruajtjen e rendit kushtetues – të cilat u vendosën në ndërvëprim me një analizë diskursive të gjuhës politike të përdorur nga liderët e PD-së gjatë periudhave kyçe të tranzicionit politik shqiptar.

Në përfundim, studimi dëshmon se Partia Demokratike ka qenë e paaftë të përmbushë funksionin historik që partitë konservatore e kanë përmbushur në demokracitë perëndimore të konsoliduara, siç është rasti i Partisë Konservatore britanike apo kristiandemokratëve gjermanë (Ziblatt, 2017). Në vend të një partie që mishëronte ndjeshmërinë konservatore që mishëronte vetëpërmbajtjen, ndërmjetësimin, ruajtjen e rendit institucional PD ka operuar më së shumti si një subjekt që imiton konservatorizmin në stil, por jo në strukturë apo ndërtim ideologjik. Ajo ka ndjekur një rrugë që e përjashton kompromisin, përqafon retorikën polarizuese dhe e instrumentalizon nacionalizmin për legjitimitet momental, shpesh në dëm të stabilitetit institucional dhe të funksionimit të rendit kushtetues (Bogaards, 2009; Levitsky & Ziblatt, 2018).

Diskursi i saj politik, veçanërisht në momentet e krizave të mëdha si 1997 apo pas vitit 2013, ka qenë përjashtues, i personalizuar dhe konfliktual, duke dëshmuar jo një ndjeshmëri për ruajtjen e institucioneve, por një përpjekje për t'i instrumentalizuar ato ose për t'i delegjitimuar kur ndodhej jashtë pushtetit (Elbasani & Peshkopia, 2020). Kjo ka bërë që demokracia në Shqipëri të ruajë një karakter të brishtë: një pluralizëm më shumë formal sesa substancial, një konkurrencë politike të zhveshur nga normat e përbashkëta të lojës dhe një sistem institucional të ekspozuar ndaj kapjes dhe krizave të përsëritura (Freedom House, 2023; V-Dem, 2024).

Këto përfundime sfidojnë qasjet institucionaliste që supozojnë se ndërtimi i institucioneve dhe mbajtja e zgjedhjeve janë të mjaftueshme për të prodhuar konsolidim demokratik (Przeworski, 1991). Ato theksojnë rolin jetik të aktorëve politikë, në veçanti të partive të djathta, në mbrojtjen

e rregullave demokratike përtej interesave afatshkurtra elektorale. Siç argumenton Ziblatt (2017), aty ku partitë konservatore kanë pranuar të luajnë sipas rregullave, demokracia është konsoliduar; aty ku ato i kanë refuzuar rregullat ose i kanë përdorur për të përjashtuar kundërshtarët, demokracia ka dështuar ose ka hyrë në stagnim.

Në këtë kontekst, Shqipëria nuk ka përjetuar një konservatorizëm demokratik të mirëfilltë, dhe kjo mungesë ka krijuar një boshllëk kritik në sistemin e saj politik. Kjo analizë nuk synon të dënojë një forcë politike të vetme, por të nënvizojë nevojën për ndërtimin e një ndjeshmërie të re politike, ku forcat e djathta të mos jenë thjesht imitime të konservatorizmit në retorikë, por bartëse të përgjegjësisë institucionale dhe të vetëpërmbytjes elitare.

Prandaj, çdo projekt i ardhshëm për konsolidimin e demokracisë në Shqipëri nuk mund të mbështetet vetëm në ndërhyrje teknokratike ose reforma të mbikëqyrura ndërkombëtarisht. Ai duhet të shkojë përtej formës dhe të fokusohet në përmbytje, në ndërtimin e një kulture politike të vetëpërmbytjes, të respektit për institucionet dhe të maturisë në momentet e krizës. Këto cilësi nuk lindin automatikisht nga zgjedhjet, por kërkojnë një proces të gjatë dhe të qëndrueshëm të formimit të elitave politike dhe të socializimit demokratik të shoqërisë. Pa to, demokracia shqiptare do të vazhdojë të mbijetojë në një gjendje pasigurie, pa hyrë kurrë në fazën e konsolidimit të vërtetë.

9,2 Rekomandime

Bazuar në shqyrtimin teorik dhe empirik të Partisë Demokratike të Shqipërisë përmes katër dimensioneve të modelit të Daniel Ziblatt që janë forca organizative, institucionalizimi, sjellja në kohë krizash dhe ruajtja e institucioneve si dhe përmes analizës diskursive të gjuhës politike që ka ndjekur kjo parti ndër vite, paraqiten rekomandimet e mëposhtme për një transformim të mundshëm drejt një konservatorizmi demokratik dhe kontribues në konsolidimin institucional të demokracisë shqiptare:

1. Riorganizimi strukturor dhe rritja e bazës sociale

Partia Demokratike ka nevojë për një ristrukturim të thellë organizativ që të shkojë përtej logjikës klienteliste dhe lideriste, drejt një partie të masës me baza territoriale dhe sociale të qëndrueshme. Duhet të ndërtohet një strukturë funksionale degësh, me një proces real zgjedhor të kandidatëve në të gjitha nivelet dhe me mekanizma të brendshëm llogaridhënieje. Ziblatt (2017) vëren se partitë konservatore të suksesshme historikisht janë ato që arrijnë të ndërtojnë organizata të disiplinuar, të rrënjosura në rrjetin e shoqërisë dhe që nuk varen nga karizma individuale. Ky tipar është thelbësor për ndërtimin e një partie të aftë për të përballuar presionet elektorale pa u zhveshur nga orientimi institucional.

2. Krijimi i një identiteti të qëndrueshëm ideologjik

PD ka dështuar të artikulojë në mënyrë të qëndrueshme një platformë të djathtë të moderuar dhe të institucionalizuar. Rekomandohet që partia të ndërmarrë një proces të thellë reflektimi

programor, për të përcaktuar një identitet politik që mishëron parimet e konservatorizmit demokratik: rendi, tradita, pronësia private, kufizimi i pushtetit shtetëror, shteti ligjor dhe integriteti institucional. Vetëm përmes një boshti ideor të qartë dhe të dallueshëm mund të rikthehet besimi publik dhe të ndalet cikli i krizave identitare që ka përfshirë partinë. Kjo kërkon përfshirjen e instituteve akademike dhe të mendimit politik konservator në formulimin e programeve dhe qëndrimeve afatgjata.

3. Kthimi te vetëpërmbytja institucionale në kohë krizash

Një nga dështimet më të mëdha të PD-së ka qenë sjellja e saj në momente krize, veçanërisht në vitet 1997, 2009, 2019 dhe 2021, ku në vend që të vepronte si garantuese e rendit dhe stabilitetit institucional, ajo shpesh ka adoptuar një qasje konfrontuese që ka thelluar polarizimin dhe ka minuar institucionet. Për një të djathtë që aspirojnë të jetë konservatore në kuptimin ziblattian, sjellja e matur në kohë krizash është parakusht për legjitimitetin e saj politik. Kjo përfshin respektimin e rezultatit zgjedhor, pjesëmarrjen në procese dialogu, dhe ofrimin e alternativave institucionale e jo rrëzimit të rendit.

4. Reformimi i diskursit publik: nga retorika e armikut te retorika e shtetit

PD duhet të braktisë gjuhën e demonizimit të kundërshtarit dhe retorikën alarmiste, e cila nuk ndërton besueshmëri demokratike, por përçan dhe frikëson. Gjuha politike e një partie që synon të jetë konservatore në kuptimin demokratik duhet të jetë e rezervuar, e matur dhe e përkushtuar ndaj ruajtjes së institucioneve. Siç vëren Ziblatt, një nga rolet kyçe të partive konservatore është të ndërmjetësojnë tensionet sociale, jo t'i përshkallëzojnë ato. Për këtë qëllim, duhet promovuar një ligjërim që fokusohet në shtetin, ligjin, integritetin, dhe interesin afatgjatë të republikës.

5. Investimi në edukimin e një elite të re politike konservatore

Përtej ndryshimeve organizative apo diskursive, transformimi i Partisë Demokratike kërkon edhe një ndryshim të brendshëm kulturor. Rekomandohet kultivimi i një elite të re politike dhe intelektuale që nuk e shikon pushtetin si instrument personal, por si detyrim institucional. Kjo elitë duhet të përfaqësojë ndjeshmërinë konservatore në nivel të politikave publike, ideve, dhe qëndrimeve ndaj rendit demokratik. Në vende ku partitë konservatore kanë ndikuar pozitivisht në konsolidimin demokratik si Britania, Suedia apo Gjermania ka ekzistuar një elitë që ka ndërthurur legjitimitetin tradicional me angazhimin për reformat demokratike. Shqipëria ka nevojë për një rilindje të tillë brenda së djathtës.

6. Roli i aktorëve të jashtëm dhe i shoqërisë civile

Organizmat ndërkombëtarë që mbështesin zhvillimin demokratik në Shqipëri si BE, OSBE, NDI, IRI duhet të nxisin zhvillimin e një të djathtë demokratike dhe jo thjesht të mbështesin zgjedhjet si kalendar. Ata mund të kontribuojnë përmes programeve për zhvillimin e kapaciteteve, mbështetjen për hartimin e platformave ideologjike, si dhe përmes ndihmës në ristrukturimin organizativ të partive. Po ashtu, shoqëria civile dhe media duhet të krijojnë hapësira për debat ideor dhe jo vetëm për përplasje politike, duke nxitur formimin e një mendësie konservatore demokratike dhe të përgjegjshme.

Përveç transformimeve ideore, diskursive dhe organizative, Partia Demokratike ka nevojë për ndërhyrje konkrete në nivel statutor të brendshëm dhe për nisma ligjore publike që mund të institucionalizojnë sjelljen politike dhe ta vendosin atë brenda një kornize të qëndrueshme, demokratike dhe llogaridhënëse. Ato mund të jenë:

- a) Rregullimi statutor i kufizimit të mandateve për kryetarin dhe drejtuesit e lartë të partisë. Krijimi i dispozitave të qarta që kufizojnë numrin e mandateve të njëpasnjëshme për kryetarin e partisë (p.sh. maksimumi dy mandate), për të shmangur dominimin personalist dhe për të nxitur rotacionin elitare.
- b) Futja e primareve të detyrueshme për përzgjedhjen e kandidatëve. Përcaktimi në statut i detyrimit për zhvillimin e zgjedhjeve paraprake (primare) të hapura për anëtarësinë për çdo post përfaqësues (deputetë, kryetar bashkie, këshilltarë), duke shmangur emërimet nga lart dhe forcimin e lidhjes me bazën.
- c) Përforcimi i autonomisë së degëve lokale. Ndryshime statutorë që rrisin pavarësinë organizative dhe vendimmarrëse të strukturave lokale, me buxhete dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, për të shmangur përqendrimin vertikal dhe për të ndërtuar një organizatë me rrënjë territoriale reale.
- d) Krijimi i një forumi ideor të përhershëm konservator brenda partisë. Parashikimi i një strukture të përhershme të mendimit programor (p.sh. “Këshilli Programor Konservator”) që të hartojë, shqyrtojë dhe zhvillojë doktrinat, platformat dhe qëndrimet afatgjata të partisë në përputhje me identitetin ideologjik konservator.

Referencat:

Abrahams, F. (2015). *Modern Albania: From dictatorship to democracy in Europe*. NYU Press.

Balla, E. (2023). *Retorika politike dhe marrëdhënia me median: Rasti i Edi Ramës*. Instituti për Demokraci Mediatike.

Berman, S. (2006). *The primacy of politics: Social democracy and the making of Europe's twentieth century*. Cambridge University Press.

Berman, S. (2007). State and society in the making of democracy. *Comparative Politics*, 39(1), 379–397.

Biberaj, E. (1999). *Albania in transition: The rocky road to democracy*. Westview Press.

Bieber, F. (2020). *The rise of authoritarianism in the Western Balkans*. Palgrave Macmillan.

Bickerton, C. J. (2012). *European integration: From nation-states to member states*. Oxford University Press.

Blinkhorn, M. (2014). *Mussolini and Fascist Italy* (3rd ed.). Routledge.

Brook-Shepherd, G. (1996). *Dollfuss*. Macmillan.

Cannadine, D. (1999). *The rise and fall of class in Britain*. Columbia University Press.

Capoccia, G. (2005). *Defending democracy: Reactions to extremism in interwar Europe*. Johns Hopkins University Press.

Corner, P. (2014). *The Fascist Party and popular opinion in Mussolini's Italy*. Oxford University Press.

De Grand, A. J. (2000). *Italian fascism: Its origins & development* (3rd ed.). University of Nebraska Press.

Elbasani, A. (2004). Albania in transition: Manipulation or appropriation of international norms? *Southeast European Politics*, 5(1), 24–44.

Elbasani, A. (2009). EU enlargement in the Western Balkans: Strategies of borrowing and inventing. *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 11(3), 253–269.

Elbasani, A. (2009). EU enlargement in the Western Balkans: Strategies of borrowing and inventing. *East European Politics and Societies*, 23(4), 626–651.

Elbasani, A. (2013). *European integration and transformation in the Western Balkans: Europeanization or business as usual?* Routledge.

- Elbasani, A. (2015). *State and society in post-communist Albania*. I.B. Tauris.
- Evans, E. J. (2000). *The forging of the modern state: Early industrial Britain, 1783–1870*. Longman.
- Evans, R. J. (2003). *The coming of the Third Reich*. Penguin.
- Foucault, M. (2008). *The birth of biopolitics: Lectures at the Collège de France, 1978–1979* (G. Burchell, Trans.). Palgrave Macmillan.
- Fukuyama, F. (2014). *Political order and political decay: From the industrial revolution to the globalization of democracy*. Farrar, Straus and Giroux.
- Hobsbawm, E. (1996). *The age of revolution: 1789–1848*. Vintage.
- Howard, M. M. (2003). *The weakness of civil society in post-communist Europe*. Cambridge University Press.
- Huntington, S. P. (1991). *The third wave: Democratization in the late twentieth century*. University of Oklahoma Press.
- Jarvis, C. (1999). The rise and fall of Albania's pyramid schemes. *IMF Working Paper*, 99/98.
- Jelavich, B. (1987). *Modern Austria: Empire and republic, 1815–1986*. Cambridge University Press.
- Katz, R. S., & Mair, P. (1995). Changing models of party organization and party democracy: The emergence of the cartel party. *Party Politics*, 1(1), 5–28.
- Kershaw, I. (2000). *The Nazi dictatorship: Problems and perspectives of interpretation*. Arnold.
- Kershaw, I. (2000). *Hitler: 1889–1936: Hubris*. Penguin.
- Levitsky, S., & Ziblatt, D. (2018). *How democracies die*. Crown.
- Linz, J. J., & Stepan, A. (1996). *Problems of democratic transition and consolidation: Southern Europe, South America, and post-communist Europe*. Johns Hopkins University Press.
- Lipset, S. M., & Rokkan, S. (1967). *Party systems and voter alignments: Cross-national perspectives*. Free Press.
- Lyttelton, A. (1973). *The seizure of power: Fascism in Italy, 1919–1929*. Routledge.
- Mack Smith, D. (1981). *Mussolini*. Alfred A. Knopf.
- Merkel, P. H. (2000). *German unification in the European context*. Penn State University Press.

- Mommsen, H. (1996). *The rise and fall of Weimar democracy*. University of North Carolina Press.
- Moore, B. (1966). *Social origins of dictatorship and democracy: Lord and peasant in the making of the modern world*. Beacon Press.
- O'Donnell, G. (1994). Delegative democracy. *Journal of Democracy*, 5(1), 55–69.
- Payne, S. G. (1996). *A history of fascism, 1914–1945*. University of Wisconsin Press.
- Payne, S. G. (2006). *The collapse of the Spanish Republic, 1933–1936: Origins of the civil war*. Yale University Press.
- Preston, P. (2006). *The Spanish civil war: Reaction, revolution and revenge*. W. W. Norton & Company.
- Puto, A., & Abazi, E. (2018). *Demokratizimi në Shqipëri: Ndërmjet tranzicionit dhe integritetit*. AIIS.
- Reka, B. (2020). *State-building and democratization in Albania: Between nationalism and Europeanization*. Peter Lang.
- Shkullaku, A. (2012). *Media në tranzicion: Historia e dhunës dhe ndërhyrjes politike në Shqipëri*. UET Press.
- Sked, A. (2001). *The decline and fall of the Habsburg Empire, 1815–1918*. Longman.
- Tosh, J. (2010). *The pursuit of history*. Routledge.
- Vickers, M. (1995). *The Albanians: A modern history*. I.B. Tauris.
- Vickers, M., & Pettifer, J. (2000). *Albania: From anarchy to a Balkan identity*. NYU Press.
- Wehler, H.-U. (1997). *The German Empire, 1871–1918*. Berg Publishers.
- Ziblatt, D. (2006). *Structuring the state: The formation of Italy and Germany and the puzzle of federalism*. Princeton University Press.
- Ziblatt, D. (2017). *Conservative parties and the birth of democracy*. Cambridge University Press.
- Zogaj, P. (2009). *Tri ditë që tronditën Shqipërinë: 11 dhjetor 1990, Përballja me diktaturën*. Ora.

Raporte institucionale & burime primare

BTI. (2024). *Bertelsmann Transformation Index 2024: Albania country report*. <https://bti-project.org>

European Commission. (1998–2025). *Albania progress reports*. Brussels.

European Commission. (2023). *Albania 2023 report*. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement>

Freedom House. (1992–2025). *Nations in transit: Albania*. <https://freedomhouse.org>

International Crisis Group. (1999). *Albania: State of the nation* (Balkans Report No. 87).

OSCE. (1997). *Report on the parliamentary elections in Albania*. OSCE.

OSCE/ODIHR. (1992–2025). *Election observation mission reports: Albania*. <https://www.osce.org/odihr/elections>

OSCE/ODIHR. (2000). *Republic of Albania: Parliamentary elections 2001 – Final report*. ODIHR.

Reporters Without Borders. (2025). *World press freedom index 2025*. <https://rsf.org/en/index>

U.S. Department of State. (1992–2025). *Country reports on human rights practices: Albania*. U.S. Department of State.

U.S. Department of State. (2023). *2023 country reports on human rights practices: Albania*. <https://www.state.gov/reports>

V-Dem Institute. (2018–2025). *Democracy reports: Albania dataset*. University of Gothenburg.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë. (2008). *Raporti mbi gjendjen e medias në Shqipëri*. UGSSh.

Berisha, S. (2005–2013). *Fjalime publike dhe deklarata në Kuvendin e Shqipërisë*. Arkiva e Kuvendit dhe mediat shqiptare.

Partia Demokratike e Shqipërisë. (2005). *Programi elektoral 2005*. PD.

Rilindja Demokratike. (1991, 22 shkurt). Berisha: Ne do të sjellim lirinë. *Rilindja Demokratike*.

Rilindja Demokratike. (1994, 7 tetor). Referendumi do të fitojë. *Rilindja Demokratike*.

Shtojcë:

Intervistat

Interviste kryetari i degës Fier I. B.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të PD-së në periudha të ndryshme?

Po flasim për Partinë Demokratike, jo për një klub apo shoqatë! Kjo është partia që solli pluralizmin, që përmbysi diktaturën, që i dha Shqipërisë shpresën. Në vitet '92–'97, PD-ja ishte si një familje e madhe ku çdo demokrat sakrifikonte pa u ankuar. Kishim energji, kishim ideal, kishim besim. Nuk kishte as interesa, as pazare.

Në vitet 2005–2013, kapaciteti organizativ ishte i lartë, por humbëm pak nga ai idealizmi fillestar. Qenia në pushtet e prishi pak shpirtin opozitar, por struktura funksiononte. Pas 2017-s, është një histori tjetër – goditje pas goditjeje, tradhti nga brenda, shkatërrim i qëllimshëm i strukturave për interesa personale. E megjithatë, demokratët nuk janë dorëzuar. Janë aty, me zemër të plagosur, por me shpirt luftarak.

2. Kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe vendimmarrjen?

Po sigurisht që kanë qenë, por sa herë drejtimi në qendër është korrupsuar nga pazaret, degët janë goditur. Shumë drejtues lokalë janë zëvendësuar jo për meritë, por për servilizëm ndaj kryetarit. Pavarësisht kësaj, në shumë raste degët kanë qëndruar, kanë luftuar, kanë protestuar. Janë ato që mbajnë peshën e PD-së në terren. Janë demokratët e thjeshtë që nuk tradhtuan kurrë.

3. Si zgjidhen kandidatët për deputetë?

Të jemi të singertë: në letër kemi statut, kemi rregulla, kemi parime. Por në praktikë, në shumë raste janë shkelur. Zgjidhen me pazar, me marrëveshje, me “po deshi kryetari”. Dhe kjo është një nga plagët më të mëdha. Sepse kur e heq demokratën nga gara dhe vendos njeriun e afërt, e shkatërron besimin e bazës. Kandidati duhet të vijë nga vota e demokratëve, jo nga vendimi i kryetarit në zyrë.

4. A funksionojnë organet statutore të partisë?

Formalisht po. Mblidhen, flasin, bëjnë deklaratat. Por a vendosin gjë realisht? Jo! Vendimet janë marrë më parë diku tjetër. Kuvendi, Këshilli Kombëtar, Kryesia – janë kthyer në formalitet, në teatër. Kjo s'është demokraci e brendshme, kjo është autokraci partiake. Dhe ky është një nga arsyet pse PD-ja u përça, pse baza u revoltua.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta të lidërshit?

Shikoni, pas 2013-s u dha dorëheqja, por pastaj pati një qëndrim të gjatë dhe të pashpjegueshëm të një lidërshi që kishte humbur dy herë rresht. Askush nuk mbante përgjegjësi. Edhe kur u

kërkua përgjegjësia, u hodh në erë partia. Jo, nuk ka pasur rotacion të shëndetshëm. Ka pasur kapje të partisë. Dhe sot jemi ende në betejë për ta rikthyer atë te demokratët.

6. A është parë ndonjëherë partia si institucion kolektiv, apo si pronë e liderit?

Në teori është e demokratëve. Por realiteti për shumë vite ka treguar të kundërtën. Kryetari vendoste gjithçka. Kryetari ndante mandatet, postet, drejtimet. Demokratët thërrisnin për një parti të tyre, por u përjashtuan, u nënvlerësuan, u injoruan. Kjo nuk është ajo PD që kemi ndërtuar me gjak e djersë në vitin '90.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja sot?

PD-ja ka qenë dhe është e djathtë, konservatore, pro pronës private, pro familjes, pro besimit, pro kombit. Ajo që ka munguar ndonjëherë është artikulimi i qartë i kësaj ideologjie. Por koha e fundit ka sjellë një kthim të fortë në parime – jo më grupe interesash, jo më korrupsion, por ideal, besim dhe qëndresë. Në këtë drejtim jemi duke e rindërtuar PD-në e vërtetë.

8. Sa janë përfshirë strukturat në vendime si bojkot apo protesta?

Formalisht po, por realisht jo gjithmonë. Vendimet janë marrë nga lart dhe janë zbatuar nga baza. Struktura ka shërbyer si noter. Kjo nuk është fryma që duam. Demokratët duhet të vendosin vetë për fatin e tyre, jo të urdhërohen.

9. Si e përjetoi PD-ja vitin 1997 dhe krizat e tjera?

Viti '97 ishte tragjik. U shkatërrua gjithçka. Kishim frikë, kishim plagë, kishim humbje. Por PD-ja, edhe në atë kaos, qëndroi. Gabime ka pasur, pa diskutim. Duhej më shumë urtësi, më shumë dialog. Por kur të rrethojnë, kur të sulmojnë, kur të djegin shtëpinë, është e vështirë të ruash qetësinë. Edhe më vonë, në 2019 e 2021, PD-ja u përball me një sistem të deformuar, me zgjedhje pa garanci. Reagimi ka qenë konfrontues, sepse ky sistem nuk njeh tjetër gjuhë.

10. Si është qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve si Gjyqësori, KQZ-ja, Presidenti?

Institucione të kapura! Drejtësia është në duart e qeverisë. KQZ është kthyer në vegël të pushtetit. Presidenti nuk ka më peshën që duhet. Si mund të kemi zgjedhje të ndershme me një sistem të tillë? PD-ja ka luftuar dhe do të luftojë për t'i çliruar këto institucione nga kontrolli i regjimit.

11. A ka kontribuar PD-ja në reformat institucionale?

Po, gjithmonë! Kurdoherë që ka pasur nevojë për reforma, PD-ja ka qenë aty. Nuk kemi penguar asnjë reformë për zgjedhjet, për drejtësinë, për Kushtetutën. Por nga viti 2013 e këtej, jemi përballur me një regjim që nuk ka dashur dialog. Qeveria ka dashur vetëm të asgjësojë opozitën. Dhe kjo është beteja jonë: të rikthejmë pluralizmin e vërtetë!

Interviste kryetari i degës Elbasan B. H.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të PD-së në periudhat kryesore të saj?

Kapaciteti organizativ i PD-së ka qenë gjithnjë një funksion i raportit mes strukturës dhe narrativës së saj politike. Në periudhën 1992–1997 kemi një mobilizim entuziast, shpesh i lidhur me një ndërthurje të idealizmit antikomunist dhe nevojës për rikthim në një rend liberal që nuk kishte ekzistuar ndonjëherë realisht në Shqipëri. Organizata ishte dinamike, por edhe e traumatizuar nga trashëgimia autoritare.

Në periudhën 2005–2013, organizata u bë më institucionale, më teknike, por njëkohësisht humbi kontaktin me disa segmente të shoqërisë reale. Pas 2017-s, ajo pësoi një amortizim të dukshëm organizativ për shkak të dy faktorëve: së pari, një krizë legjitimiteti të brendshëm, dhe së dyti, një kontekst politik që nuk krijonte më kushte për funksionim të mirëfilltë opozitar.

2. Sa funksionale kanë qenë degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe vendimmarrjen e brendshme?

Degët lokale janë pasqyra më e mirë e dilemës themelore të PD-së. Tensionit mes vertikalitetit të strukturës dhe nevojës për një demokraci të brendshme funksionale. Ato kanë qenë funksionale në kuptimin operativ të fjalës – kanë organizuar takime, kanë mobilizuar elektoratin, kanë ndjekur linjat zyrtare – por roli i tyre real në formulimin e politikave apo në artikulimin e shqetësimeve të anëtarësisë ka qenë i kufizuar. Struktura vendimmarrëse ka qenë gjithnjë më shumë e qendëruar se sa e shpërndarë.

3. Si realizohet përzgjedhja e kandidatëve për deputetë?

Përzgjedhja e kandidatëve nuk ka ndjekur një model të qëndrueshëm institucional. Ndonëse në disa raste janë bërë përpjekje për primare apo konsulta me bazën, praktikisht përzgjedhja ka qenë rezultat i një procesi të mbyllur, ku vendimmarrja finale i përket udhëheqjes qendrore. Në kontekstin shqiptar, kjo nuk është vetëm problem i PD-së, por një simptomë e përgjithshme e partive politike që e përkufizojnë veten si “levizje” më shumë sesa si institucione.

4. Si kanë funksionuar organet statutorë si Kuvendi Kombëtar, Këshilli Kombëtar dhe Kryesia?

Këto organe janë thirrur dhe kanë funksionuar në mënyrë të rregullt në aspektin formal, por jo gjithmonë në përmbajtje. Ato janë përdorur më shumë si instrumente legjitimimi të vendimeve të marra më parë sesa si forume të mirëfillta deliberative. Në këtë kuptim, ekziston një hendek i thellë mes formës institucionale dhe përmbajtjes demokratike.

5. A ka pasur rotacion të rregullt të lidërsipit?

Jo në mënyrë të qëndrueshme. Në raste të caktuara, dorëheqjet kanë ardhur pas presionesh elektorale ose publike, por jo si rezultat i një procesi të institucionalizuar të përgjegjësisë politike. Kjo tregon një mangësi strukturore në aftësinë e partisë për të ndërtuar një kulturë të brendshme accountability-je.

6. Si është konceptuar partia në raport me figurën e liderit?

Kjo është një pyetje thelbësore për çdo analizë të partive në Shqipëri. Në rastin e PD-së, për një periudhë të gjatë ajo ka funksionuar më shumë si një parti e liderit sesa si një subjekt kolektiv. Edhe kur janë artikuluar slogane për një PD të demokratëve, praktika ka mbetur në logjikën e personalizimit të pushtetit politik brenda partisë. Kjo e bën partinë më vulnerabël në krizë.

7. A ka sot një orientim ideologjik të qartë PD-ja?

Ka një përpjekje për t'u vetëpërkufizuar si parti e djathtë në sensin klasik pra pro pronës, pro familjes, pro identitetit kombëtar – por kjo nuk është gjithmonë e përkthyer në politikë konkrete. Retorika ideologjike është thelluar në vitet e fundit, shpesh në formë refuzimi të globalizmit ose liberalizmit kulturor, por nuk ekziston ende një përkthim programor i qëndrueshëm që të shndërrojë këtë qasje në platformë.

8. A kanë qenë strukturat e përfshira realisht në vendime të mëdha si bojkoti apo protestat?

Në aspektin formal, strukturat janë përfshirë, por zakonisht si nota aprovimi. Vendimmarrja vjen nga lart dhe struktura e ndjek atë. Kjo e bën të vështirë të flitet për një demokraci të brendshme procedurale. Struktura në këtë kontekst ka një funksion më shumë mobilizues sesa deliberativ.

9. Si ka vepruar PD-ja në momente krize si 1997, 2001, 2019 apo 2021?

Në vitin 1997, PD-ja nuk arriti të menaxhonte krizën në mënyrë institucionale. Reagimi ishte fragmentar, shpesh emocional dhe në disa raste i papërgjegjshëm politikisht. Në krizat e tjera – veçanërisht pas 2019-s – partia ka ndjekur më shumë rrugën e konfrontimit sesa të dialogut institucional. Kjo ka qenë pjesërisht për shkak të perceptimit të mungesës së garancive demokratike, por edhe si pasojë e një stili politik që nuk ka qenë gjithmonë reaktiv, por edhe vetë-margjinalizues.

10. Si ka qenë qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura?

Në shumë raste, PD-ja i ka konsideruar këto institucione si pjesë të një sistemi të kapur. Kjo ka qenë sidomos e theksuar në raport me gjyqësorin dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ka pasur një diskurs konstant delegjitimues, që nga njëra anë reflekton realitete të besueshme për kapjen e institucioneve, por nga ana tjetër ka krijuar një cikël mosbesimi që e ka larguar partinë nga çdo strukturë institucionale.

11. A ka kontribuar PD-ja në reformat institucionale?

Po, në mënyrë të konsiderueshme. Në shumë prej reformave madhore – si reforma zgjedhore apo ajo në drejtësi – PD-ja ka qenë pjesë. Por pas 2013-s, konteksti ka ndryshuar dhe ajo është vendosur përballë një modeli pushteti që nuk e përfshinte në mënyrë të barabartë. Nga ky moment, roli i saj ka kaluar nga kontribues institucional në një subjekt opozitar që funksionon më shumë si korektues moral sesa si partner në proces.

Interviste kryetari i degës Shkodër E. S.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

Kapaciteti organizativ i PD-së ka qenë gjithnjë i lidhur ngushtë me kontekstin politik të brendshëm dhe atë institucional të vendit. Në periudhën 1992–1997, kishte një frymë idealiste të fortë që e mbante gjallë strukturën dhe mobilizimin politik në të gjitha nivelet. Megjithatë, pas krizës së vitit 1997, ndonëse PD mbeti e fortë në terren, u pa nevoja për riorganizim të thellë.

Në periudhën 2005–2013, organizata përfitoi nga të qenit në pushtet, por kjo solli edhe një lloj ngurtësimi strukturor dhe një lëvizje më të ngadaltë drejt rinovimit të brendshëm. Pas vitit 2017, me sfidat e një opozite që ndodhej jashtë institucioneve dhe me tensionet e brendshme që nuk munguan, kapaciteti organizativ pati një ulje të ndjeshme, por them se ka ende potencial për rindërtim nëse vullneti është i përbashkët dhe vizioni i qartë.

2. Sa funksionale kanë qenë degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe në vendimmarrje?

Në mënyrë të përgjithshme, degët kanë kryer funksionet bazë organizative dhe mobilizuese. Por është e drejtë të themi se nuk kanë pasur gjithnjë një rol të plotë në procesin real të vendimmarrjes. Ndonjëherë, për shkak të strukturës vertikale, zëri i tyre nuk është përkthyer në ndikim efektiv në politikën e partisë. Megjithatë, në shumë raste ato kanë qenë aktore kyçe në ndërtimin e dialogut me anëtarësinë dhe shoqërinë.

3. Si realizohet përzgjedhja e kandidatëve për deputetë në PD?

Ka pasur tentativa të herëpashershme për të përfshirë më shumë baza në këtë proces, por nuk është ndërtuar ende një praktikë e qëndrueshme. Zakonisht, vendimmarrja është një kombinim mes përzgjedhjes nga qendra dhe disa konsultimeve me degët. Në momente të caktuara është aplikuar edhe një formë votimi në nivel lokal. Por qëllimi duhet të jetë institucionalizimi i një procedure transparente, të matshme dhe të besueshme për të gjithë.

4. A funksionojnë rregullisht organet statutores të partisë?

Po, ato janë thirrur rregullisht dhe kanë ushtruar funksionet e tyre sipas statutit. Por do të thoja se shpesh mbeten në kufijtë formalë të ushtrimit të detyrës. Ka ende nevojë për forcimin e rolit të tyre si forume reale diskutimi, ku debati të mos jetë vetëm rit i brendshëm, por proces politik me ndikim substancial.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta dhe të hapura të lidërshipt të partisë?

Fatkeqësisht, kjo ka qenë një pikë e dobët në historinë e brendshme të PD-së. Nëse ndërrimet e lidërshipt ndodhin vetëm pas humbjes të përsëritura dhe në kushte presioni ekstrem, atëherë humbet funksioni normal i qarkullimit demokratik. Ky është një aspekt që duhet të reformohet me kujdes, sepse një parti e përgjegjshme nuk mund të shmangë përgjegjësinë në emër të qëndrueshmërisë formale.

6. Si perceptohet partia, si institucion kolektiv apo si strukturë e varur nga individi lider?

Ka pasur një përpjekje të qëndrueshme për ta ndërtuar PD-në si një subjekt kolektiv, por ndonjëherë historia e partisë ka prodhuar një varësi të fortë nga figura e liderit. Kjo nuk është një veçori shqiptare, por një fenomen që ndodh shpesh në kontekste ku institucionet janë ende në ndërtim. Ajo që është e rëndësishme është që të vendoset një balancë ku lideri nuk e zëvendëson strukturën.

7. A ka sot një orientim ideologjik të qartë PD-ja?

Po, PD-ja identifikohet si një forcë e qendrës së djathtë, e orientuar drejt ekonomisë së tregut, mbrojtjes së të drejtës së pronës, vlerave familjare dhe besimit të shteti i së drejtës. Kohët e fundit ka pasur një artikullim më të zëshëm i këtyre parimeve. Megjithatë, mbetet e nevojshme që kjo ideologji të përkthehet në platforma konkrete dhe jo vetëm në diskurs elektoral.

8. Sa janë përfshirë strukturat vendimmarrëse në vendime të tilla si bojkoti, protestat apo qëndrime të forta politike?

Pjesëmarrja e strukturave ka qenë prezente në mënyrë formale. Janë organizuar mbledhje, janë bërë votime, por do të ishte e sinqertë të pranojmë se në shumicën e rasteve drejtimi ka ardhur nga qendra. Kjo është një çështje që kërkon një analizë të thelluar mbi funksionimin e demokracisë së brendshme dhe nevojën për rritjen e pjesëmarrjes reale në vendimmarrje.

9. Si e ka përjetuar PD-ja krizën e vitit 1997 dhe çfarë mund të mësohet nga ajo përballje? Po për rastet e tjera si 2019 apo 2021?

Viti 1997 ishte një moment dramatik për gjithë shoqërinë shqiptare dhe për PD-në si forcë në pushtet. Ajo periudhë dëshmoi vështirësitë e një partie që ende nuk kishte përjetuar një qeverisje të konsoliduar. Ka pasur gabime politike, komunikimi dhe qasjeje. Mësimi më i madh është që partitë duhet të investojnë në qëndrueshmëri institucionale dhe në dialog edhe në kushte krize.

Për krizën e 2019-s dhe më pas, qëndrimet e PD-së kanë qenë të forta dhe konfrontuese, të ndikuara nga perceptimi se sistemi politik është i kapur. Ajo që nevojitet sot është të gjendet një ekuilibër mes reagimit opozitar dhe pjesëmarrjes në rrugë institucionale për të krijuar kushte reale ndryshimi.

10. Si ka qenë qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura si gjyqësori, KQZ apo Presidenti?

PD-ja ka qenë kritike ndaj mënyrës si janë kapur apo deformuar këto institucione. Sidomos në raport me gjyqësorin, ka ekzistuar një bindje se reforma nuk ka prodhuar pavarësi reale, por kapje të re. Megjithatë, ne duhet të jemi gjithmonë në pozicionin e mbrojtjes së institucioneve si ide dhe të kritikës së funksionimit të tyre në praktikë – jo të mohimit të plotë.

11. A ka kontribuar PD në reformat madhore institucionale?

Pa dyshim. PD ka qenë gjithnjë pjesë e reformave kryesore në vend, përfshirë ato në drejtësi dhe në kodin zgjedhor. Shpesh ka votuar edhe kur nuk ka përfituar drejtpërdrejt. Por pas vitit 2013, marrëdhënia me procesin reformues është bërë më komplekse për shkak të polarizimit politik. Kjo nuk duhet të na ndalojë që të jemi gjithnjë në krah të reformës dhe institucioneve të besueshme.

Interviste me sekretarin për organizimin K. D.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

PD-ja ka qenë gjithmonë një forcë e madhe, e pakrahasueshme me të tjerat! Në vitet '90 ajo ishte si një vullkan, me njerëz që sakrifikonin gjithçka për lirinë. Edhe sot, pavarësisht dhunës, burgosjeve, persekutimeve që na bën ky regjim, ne jemi në terren, ne jemi në luftë! Kapaciteti organizativ nuk matet me letra, matet me sakrificë! Dhe demokratët kanë sakrifikuar gjithçka për Shqipërinë.

2. A kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe në vendimmarrje?

Po, janë funksionale! Janë në terren, janë në ballë të përballjes me këtë shtet policor. Problemi nuk janë demokratët, problemi është që sistemi është kapur nga banda në pushtet. Por degët janë aty, çdo ditë, çdo natë, duke organizuar qytetarët kundër regjimit. Vendimmarrja? Demokratët nuk kanë nevojë për burokraci – ata e dinë kur është koha për të vepruar.

3. Si përzgjidhen kandidatët për deputetë në PD?

Ka patur raste të mira dhe raste jo të mira. Unë kam qenë dhe jam për transparencë dhe për përfshirjen e bazës. Por në situatën që ndodhemi, kur zgjedhjet vidhen, kur shteti përdoret si makinë votash, prioriteti është mbijetesa e opozitës. Megjithatë, është e qartë: nëse duam fitore të vërtetë, kandidatët duhet t'i zgjedhë baza dhe jo marrëveshjet në kafe!

4. A funksionojnë organet statutores të partisë?

Kur jemi në luftë, nuk flasim për status, flasim për betejë. PD-ja është në krizë sepse jemi në një shtet pa Kushtetutë, pa ligj, pa drejtësi. Nuk jemi në Zvicër që të diskutojmë Kuvendin Kombëtar. Ne jemi në Shqipëri, ku opozita përndiqet, protestuesit përndiqen dhe qeveria vjedh çdo gjë. Strukturat statutores janë aty, por betejën nuk e fiton letra, e fiton rruga, populli dhe përballja.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta të lidhshirë?

Në PD ka patur probleme, po! Ka patur tentativa për kapje nga brenda, për shkatërrim të opozitës me ndihmën e Edi Ramës. Por demokratët nuk janë lodhur. Ata kanë zgjedhur, kanë reaguar, dhe sot e kanë të qartë kush është me regjimin dhe kush është me popullin. Rotacioni s'ka vlerë kur lidhshiri shitet dhe lidhet me armikun.

6. Si është parë partia, si pronë e demokratëve apo si vegël e liderëve?

PD është e demokratëve! Është parti e lirisë, e sakrificës, e përballjes. Por ka pasur momente kur është kthyer në instrument të pazareve. Dhe ja ku na çuan: në dështim. Sot, jemi në ringritje. Kush mendon se PD është e një individi, gabon rëndë. Ajo është e mijëra burrave dhe grave që kanë derdhur mund, djersë e gjak për këtë vend.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja?

PD është parti e djathtë, pa kompromis. Ne besojmë në pronën private, në familjen, në besimin te Zoti, në lirinë e fjalës. Dhe më shumë se kaq ne besojmë në Shqipërinë që nuk i përket mafies. PD nuk është parti e dorëzuar. Ajo është barrikadë e fundit kundër këtij pushteti kriminal që ka vjedhur çdo gjë.

8. A janë përfshirë strukturat vendimmarrëse në vendime si bojkot, protesta apo mosnjohje rezultatesh?

Po! Të gjitha vendimet janë marrë me pjesëmarrjen e strukturave. Por le të jemi të qartë: në këtë vend, kur të vidhen zgjedhjet, kur policia rreh protestuesit, nuk ke nevojë për mbledhje të gjatë. Ke nevojë për veprim! Protestat, bojkotet janë përgjigje ndaj një regjimi që nuk lë zgjidhje tjetër.

9. Si e përjetoi PD-ja vitin 1997 dhe si është sjellë në krizat e tjera?

Viti '97 ishte një sulm ndaj rendit, ndaj shtetit, ndaj PD-së. Ishte një rebelim i armatosur kundër qeverisë legjitime. Dhe PD, në atë kohë, u përball me rrëmujën më të madhe të pasluftës. Edhe më vonë, në 2019, 2021, ne jemi përballur me një shtet që përdor çdo mjet për të eliminuar opozitën. PD ka reaguar siç reagon çdo opozitë nën sulm: me forcë, me qëndresë, me popull.

10. Si është qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura si Gjyqësori, KQZ, Presidenti?

Institucione të kapura! Gjykatat janë vegla të Edi Ramës. KQZ-ja është thjesht një degë e Rilindjes. Presidenti? Varësisht kush është – por në thelb, sistemi është i kalbur! Këtu nuk kemi institucione – kemi shërbëtorë të pushtetit. Dhe detyra jonë është ta shembim këtë sistem!

11. A ka kontribuar PD në reformat institucionale?

Sigurisht që po! PD ka qenë gjithmonë për shtet ligjor, për drejtësi, për reformë zgjedhore. Por këto reforma janë përdorur nga qeveria për të kapur shtetin, për të legalizuar vjedhjen, për të zhdukur opozitën. Reforma pa opozitë reale është farsë. PD është për reforma, por vetëm kur ato janë reale, dhe jo fasadë për të ndihmuar regjimin.

Interviste me kryetarin e degës Lezhë GJ. G.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

Në mënyrë objektive, duhet pranuar se kapaciteti organizativ i Partisë Demokratike ka pësuar evoluime të natyrshme në raport me zhvillimet politike të vendit dhe me ndryshimet strukturore brenda saj. Në periudhën 1992–1997, struktura organizative e PD-së ishte funksionale dhe në shumë aspekte reaktive ndaj nevojave të një shteti të sapolindur nga diktatura. Pas vitit 2005, strukturat u institucionalizuan më tej, por njëkohësisht pati një formalizim të funksioneve. Pas vitit 2017, për shkak të polarizimit të thelluar politik, kapaciteti organizativ është përballur me një presion të dyfishtë: nga njëra anë, fragmentimi i brendshëm; nga ana tjetër, një mjedis institucional i penguar.

2. Sa funksionale kanë qenë degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe vendimmarrjen e brendshme?

Nga një këndvështrim institucional, degët lokale përbëjnë strukturat bazë të një partie politike dhe janë themeli i funksionimit të demokracisë së brendshme. Në rastin e PD-së, degët kanë qenë përgjithësisht të pranishme në territor dhe operative në mobilizim elektoral. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre në procesin vendimmarrës është shpesh e kufizuar, për shkak të natyrës qendëruese të partisë. Kjo tregon se ka vend për reformim në drejtim të decentralizimit funksional dhe rritjes së kapacitetit përfaqësues të strukturave vendore.

3. Si realizohet përzgjedhja e kandidatëve për deputetë në Partinë Demokratike?

Në aspektin normativ, Partia Demokratike ka përcaktuar procedura për përzgjedhjen e kandidatëve, që përfshijnë propozime nga baza, seleksionim nga forumet e mesme dhe miratim nga qendra. Në praktikë, megjithatë, dominon vendimmarrja nga organet qendrore të partisë, për shkak të nevojës për koherencë politike dhe për faktorin koalicional në zgjedhje. Ky proces do të përfitonte nga rritja e transparencës dhe futja e elementëve të votimit direkt, me qëllim për të forcuar legjitimitetin e kandidatëve.

4. A funksionojnë organet statutore të partisë?

Organet statutore të partisë janë thirrur rregullisht, por është e nevojshme të bëhet një dallim midis formalizmit procedural dhe funksionalitetit real të këtyre organeve. Kuvendi Kombëtar, Këshilli Kombëtar dhe Kryesia kanë pasur rol formal në vendimmarrje, por niveli i debatit real dhe ndikimit vendimmarrës të këtyre strukturave është relativisht i kufizuar. Reforma e

brendshme statutore është një domosdoshmëri për të kaluar nga një model aprovues në një model deliberativ.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta dhe transparente të lidërshpit?

Rotacioni i lidërshpit në një subjekt politik është shenjë e maturisë demokratike të tij. Në rastin konkret, pas vitit 2013 ka patur disa raste të dorëheqjeve dhe zgjedhjeve të reja, por jo gjithmonë këto janë zhvilluar në një klimë të lirë nga tensionet dhe ndërhyrjet. Mungesa e një kalendari të rregullt të zgjedhjeve të brendshme dhe e mekanizmave garantues e ka bërë rotacionin më shumë të lidhur me presionin politik sesa me rregullsinë institucionale.

6. Si është perceptuar partia në raport me liderin e saj?

Në Shqipëri, për shkak të trashëgimisë politike dhe deficiteve institucionale, partitë shpesh krijojnë një varësi të lartë nga figura e liderit. PD-ja nuk ka qenë përjashtim. Struktura e saj ka qenë e ndikuar nga personaliteti i liderit, çka ka krijuar një ekuilibër të brishtë midis demokracisë së brendshme dhe autoritetit karizmatik. Për një konsolidim të mëtijshëm, është e nevojshme që partia të forcojë institucionet e saj të brendshme dhe të promovojë një kulturë politike pluraliste edhe brenda vetes.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja?

Po. Në dokumentet themeluese dhe në diskursin politik, PD-ja është pozicionuar si një parti e qendrës së djathtë me orientim liberal-konservator. Qasja në politikat ekonomike, sociale dhe institucionale pasqyron një përpjekje për të ndërtuar një shtet të së drejtës, një ekonomi të tregut dhe për të mbrojtur vlerat tradicionale. Së fundmi, ka pasur një theksim më të madh të temave sovraniste dhe të qasjes kritike ndaj liberalizmit progresist, çka tregon një lëvizje drejt një identiteti më të qartë kulturor.

8. A janë përfshirë strukturat vendimmarrëse në vendime si bojkoti apo protestat?

Në mënyrë formale, po. Strukturat janë mbledhur, kanë dhënë aprovime dhe kanë mbështetur qëndrimet zyrtare të partisë. Por në shumë raste, këto vendime janë marrë në kushte të ngarkesës politike dhe emocionale, dhe pjesëmarrja e strukturave ka qenë më shumë aprovuese sesa aktive në procesin e hartimit të linjës politike. Kjo tregon nevojën për të forcuar rolin konsultativ dhe vendimmarrës të organeve statutore në situata të ndjeshme politike.

9. Si ka vepruar PD-ja në krizat madhore politike si 1997, 2019 apo 2021?

Në vitin 1997, vendi u përball me një krizë të jashtëzakonshme të rendit publik dhe të funksionimit të shtetit. Reagimi i PD-së si parti në pushtet nuk ishte institucionalisht optimal dhe u shoqërua me pasoja të rënda për stabilitetin demokratik. Në vitet më të fundit, PD-ja ka vepruar në kushtet e një opozite që pretendon se është përballë një pushteti të pakontrolluar, dhe rrjedhimisht ka ndjekur forma të forta reagimi – si bojkot, mosnjohje zgjedhjesh apo protesta masive. Megjithatë, një parti që synon të konsolidojë rendin demokratik duhet të jetë gjithnjë e orientuar drejt zgjidhjes institucionale të krizave.

10. Si e ka trajtuar PD-ja raportin me institucionet e pavarura si gjyqësori, KQZ apo Presidenti?

Partia Demokratike ka qenë një zë kritik ndaj mënyrës sesi janë krijuar dhe funksionuar institucionet e pavarura në Shqipëri, sidomos pas reformës në drejtësi. Kritikën e saj janë artikuluar si pjesë e një denoncimi ndaj kapjes së shtetit dhe mungesës së balancës së pushteteve. Nga një këndvështrim juridik, është e domosdoshme që çdo opozitë të ruajë balancën mes kritikës legjitime dhe mbrojtjes së parimit të funksionimit institucional, që është shtylla e çdo sistemi demokratik.

11. A ka kontribuar PD në reformat institucionale?

Po. Partia Demokratike ka qenë pjesë aktive në reformat kyçe të vendit që nga fillimi i tranzicionit: reforma zgjedhore, reforma në drejtësi, reforma administrative. Në raste të caktuara, PD-ja ka marrë pjesë në procese edhe kur ka pasur kritika të forta ndaj mënyrës si janë ndërtuar kompromiset. Kontributi i saj është pjesë e historisë së shtetformimit pluralist shqiptar dhe duhet vlerësuar si i tillë.

Interviste me ish kryetarin B. V.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

Në vlerësimin tim, Partia Demokratike ka pasur një strukturë të konsoliduar organizative, që në momente të ndryshme historike është forcuar apo dobësuar varësisht nga sfidat politike. Vitet 1992–1997 ishin vite të një mobilizimi të lartë, për shkak të karakterit historik të ndryshimit të sistemit. Pas vitit 2005, PD fitoi më shumë qartësi institucionale dhe eksperiencë qeverisëse. Megjithatë, pas vitit 2017, për shkak të përçarjeve të brendshme dhe sfidave të opozitarizmit në kushte të vështira, kapaciteti organizativ ka pësuar një lloj amortizimi që kërkon reformim të kujdesshëm dhe ndërtim të besimit të brendshëm.

2. A kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe në vendimmarrje?

Degët lokale kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbajtjen gjallë të partisë në terren dhe në organizimin e aktiviteteve politike. Megjithatë, vendimmarrja ka qenë më e përqendruar në qendër, gjë që ka bërë që zëri i degëve të mos reflektohet gjithmonë në mënyrë të plotë. Nevoja për një decentralizim të brendshëm, për më shumë hapësirë për përfaqësim dhe për një dialog të strukturuar vertikal, është më se e nevojshme.

3. Si zgjidhen zakonisht kandidatët për deputetë në Partinë Demokratike?

Procesi ka përfshirë elementë të konsultimit me baza, me forumet vendore dhe qendrore, por gjithmonë ka mbetur i ndikuar nga vendimmarrja e lidershit të partisë. Në disa raste është aplikuar edhe një lloj votimi i brendshëm, por nuk është arritur ende një sistem transparent, të

formalizuar dhe të besueshëm për të gjithë. Nevojitet një rregull institucional që e bën këtë proces të parashikueshëm, meritokratik dhe të hapur.

4. A funksionojnë rregullisht organet statutore të partisë?

Po, në kuptimin formal, ato janë mbledhur dhe kanë marrë vendime të rëndësishme. Por ajo që është e nevojshme të thuhet është se pjesëmarrja reale në debat dhe ndikimi mbi vendimmarrjen ka nevojë të rritet. Organet si Këshilli Kombëtar dhe Kuvendi duhet të shndërrohen në forume të gjalla politike, ku secili delegat të ketë një zë të barabartë dhe ku opinioni i bazës të ketë ndikim real.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta dhe transparente të lidërshit të partisë?

Nuk mund të thuhet se ka pasur gjithmonë një kalendar të rregullt apo një proces të standardizuar. Shpesh rotacioni i lidërshit ka ndodhur si pasojë e humbjeve elektorale dhe jo si pjesë e një reflektimi të natyrshëm politik. Për të ndërtuar një parti funksionale dhe afatgjatë, është e nevojshme të garantohet jo vetëm qarkullimi i ideve, por edhe i përfaqësimit dhe i drejtimit.

6. A është parë partia si institucion kolektiv apo si strukturë e lidhur me individin lider?

Ka pasur periudha të ndryshme. Në disa raste, PD është perceptuar si një parti e liderit, për shkak të natyrës së fortë politike të figurave udhëheqëse. Por gjithashtu ka pasur përpjekje për ta kthyer në një organizatë kolektive me vendimmarrje të shpërndarë. Sot më shumë se kurrë duhet punuar për të ndërtuar një PD të anëtarëve, ku strukturat të kenë peshë dhe liderët të jenë të zgjedhur, por edhe të kontrolluar.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja sot?

Po, PD është një forcë politike e qendrës së djathtë, e orientuar drejt vlerave të tregut të lirë, pronës private, familjes dhe lirive themelore të individit. Në vitet e fundit ka pasur edhe një rigjallërim të diskursit më konservator, në përgjigje të zhvillimeve globale. Megjithatë, nevojitet një platformë e qartë programore që ta konkretizojë këtë orientim përmes politikave të qarta dhe zbatueshme.

8. A janë përfshirë strukturat në vendime të tilla si bojkot, protesta apo mosnjohje rezultatesh?

Po, formalisht strukturat kanë qenë pjesë e këtyre vendimeve, por shpesh procesi ka qenë më shumë aprovues sesa deliberativ. Kjo nuk është vetëm çështje e PD-së, por një problem që ka të bëjë me mënyrën se si funksionon demokracia e brendshme në partitë shqiptare. Duhet më shumë përfshirje reale dhe më pak miratim pas faktit.

9. Si e përjetoi PD-ja periudhën e vitit 1997 dhe si ka reaguar në kriza të tjera si 2019 apo 2021?

Viti 1997 ishte një nga momentet më të vështira të historisë sonë politike. Kriza e thellë shtetërore dhe sociale ndikoi negativisht në perceptimin e PD-së dhe në funksionimin e saj. Edhe në vitet më të fundit, reagimi i PD-së në krizat politike ka qenë i fortë, ndonjëherë në formë bojkoti ose protestash, por gjithmonë me synimin për të rikthyer balancën demokratike. Sfida mbetet që edhe në kushte të vështira, veprimi politik të mbetet brenda kornizës institucionale.

10. Si ka qenë qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura si Gjyqësori, KQZ dhe Presidenti?

PD-ja ka qenë gjithmonë një zë kritik, sidomos ndaj përpjekjeve për kapjen e këtyre institucioneve nga qeveria. Gjyqësori dhe KQZ-ja janë institucione themelore për demokracinë, dhe kur ato shihen si të politizuara, rrënohet vetë besimi te zgjedhjet dhe drejtësia. Kritikët e PD-së nuk kanë qenë për rrëzim, por për ristrukturim dhe pavarësim të vërtetë të këtyre mekanizmave.

11. A ka kontribuar Partia Demokratike në reformat institucionale?

Po, pa diskutim. PD ka marrë pjesë aktive në të gjitha reformat madhore të vendit, përfshirë ato në drejtësi dhe në sistemin zgjedhor. Ajo ka votuar, ka propozuar, dhe ka bërë opozitë kur është dashur. Edhe në momente kritike, PD nuk ka qëndruar jashtë. Problemi është që në shumë raste reformat janë përdorur nga shumica për qëllime politike, dhe kjo ka vështirësuar konsensusin afatgjatë. Nevoja për dialog institucional dhe për respekt të ndërsjellë është themelore për funksionimin e sistemit.

Interviste me ish kryetarin e degës Durrës A. M.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

Kapaciteti organizativ i një partie politike nuk mund të vlerësohet thjesht në termat e pranisë në terren apo të numrit të degëve lokale. Ai është reflektim i një kontrate të heshtur midis qytetarit dhe përfaqësuesit, midis formës institucionale dhe ndjeshmërisë historike të një komuniteti politik. Në këtë kuptim, PD-ja e viteve '90 mbartte një lloj mitologjie të përbashkët, ajo mishëronte shpresën për dalje nga totalitarizmi. Më vonë, organizata u bë teknike, e përkohshme, më shumë aparat sesa ideal. Pas vitit 2017, ajo humbi edhe funksionin e saj si formë simbolike opozitare dhe nisi të perceptohej më shumë si strukturë e ndarë midis nocionit të përfaqësimit dhe realitetit të fragmentimit.

2. A kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin real të anëtarësisë dhe në vendimmarrjen e brendshme?

Strukturat lokale, në realitetin shqiptar, janë më shumë instrumente të riprodhimit të pushtetit vertikal sesa forma të një pjesëmarrjeje autentike. Ato operojnë në një logjikë të dyfishtë: nga njëra anë, ruajnë iluzionin e përfshirjes, nga ana tjetër, garantojnë kontrollin e qendrës. Kjo

ndarje është tipike për partitë shqiptare, ku demokracia e brendshme mbetet një simulakër i një forme moderne të zbrazur nga përmbajtja deliberative.

3. Si zgjidhen zakonisht kandidatët për deputetë në PD?

Përzgjedhja e kandidatëve është një akt i thellësisht politik, por në rastin tonë është kthyer në një proces hibrid, ku përzihen formaliteti procedural dhe preferenca e liderit. Në vend që të jetë një proces filtrimi përfaqësues, ai është bërë një pasqyrim i marrëdhënieve të brendshme të pushtetit. Në fund, nuk kemi një sistem meritokratik, as një sistem përfaqësues, por një rend simbolik që përforcon autoritetin dhe e relativizon përfaqësimin.

4. A funksionojnë organet statutore të partisë?

Ato funksionojnë në sensin minimal të fjalës: mbliidhen, votojnë, miratojnë. Por në thelb janë të mbyllura në një logjikë tautologjike: ato prodhojnë konsensus mbi vendime të marra tashmë. Nuk janë forume debati, por struktura të autorizimit të autoritetit. Problemi nuk është tek mungesa e mbledhjeve, por tek mungesa e mendimit kritik, tek boshësia e deliberimit dhe nënshtrimi ndaj një ligjërimi të paracaktuar.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta të lidershipit?

Në Shqipëri, ndërrimi i liderit nuk ndodh si pasojë e reflektimit të brendshëm, por si krizë dhe si tronditje. Partitë nuk kanë ndërtuar ende një kulturë të alternancës së qetë, të bazuar në përgjegjësinë politike. Ato e lexojnë lidershipin si figurë të shenjtëruar, dhe jo si funksion institucional. Në këtë sens, edhe PD-ja ka qenë më shumë në kërkim të një figure shpëtimtare sesa të një strukture përfaqësuese.

6. Si është parë partia – si institucion kolektiv apo si strukturë e lidhur me liderin?

Partia në Shqipëri, për fat të keq, nuk është parë asnjëherë si institucion në kuptimin perëndimor të fjalës. Ajo është më shumë një hapësirë rituale, ku lideri është prifti, dhe anëtarësia është komuniteti që duartroket. PD-ja, pavarësisht përpjekjeve, ka pasur të njëjtën logjikë të personalizimit të politikës – një fenomen që është simptomë e mungesës së traditës institucionale dhe të kujtesës demokratike.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja sot?

Ka një përpjekje për të artikuluar një diskurs të djathtë, me thekse konservatore dhe euroatlantike, por ky orientim është shpesh i reduktuar në slogane. Ideologjia nuk është vetëm përmbajtje, është edhe ndërtim i një vizioni të koherencës politike dhe antropologjike. Pa një platformë që lidhet me nevojat reale të shoqërisë dhe me një analizë të thellë të kontekstit, çdo ideologji mbetet deklarative.

8. A janë përfshirë strukturat vendimmarrëse në vendime si bojkot, protesta apo mosnjohje rezultatesh?

Në formë po, në substancë jo. Struktura shpesh është përdorur për të justifikuar një vendim që është marrë në një rrafsh tjetër më shumë strategjik sesa institucional. Ajo që mungon nuk është vetëm pjesëmarrja, por edhe dialogu i vërtetë mbi kuptimin e një akti politik. Bojkoti dhe protesta janë mjete të forta, por nëse nuk mbështeten mbi një analizë të thelluar të realitetit dhe mbi konsensusin real të organizatës, ato kthehen në gjeste që konsumojnë energji pa përmbushur qëllim.

9. Si e përjetoi PD-ja vitin 1997 dhe si ka reaguar në krizat e tjera si 2019 apo 2021?

Viti 1997 është një traumë e pashëruar për politikën shqiptare. Për PD-në, ajo përfaqëson një dështim të përmasave ekzistenciale jo vetëm si parti në pushtet, por si bartëse e një narrative historike që u përmbys. Në krizat e mëvonshme, PD-ja ka qenë në pozita mbrojtëse, shpesh e paaftë për të ndërtuar një përgjigje institucionale dhe për të kthyer krizën në shans për rilindje politike. Ka munguar analiza e thelluar, është mbizotëruar retorika.

10. Si ka qenë qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura?

Në diskursin e saj, PD-ja është pozicionuar si kundërshtar e kapjes së institucioneve, por në praktikë edhe vetë ka ndikuar në dobësimin e tyre, si pjesë e një kulture politike që nuk e ka përvetësuar ende ndarjen reale të pushteteve. Kritika e saj ndaj institucioneve është shpesh e saktë në diagnozë, por e pamjaftueshme në ofertën për alternativë. Nuk mjafton të denoncosh duhet të ndërtosh një besim të ri politik mbi themele institucionale.

11. A ka kontribuar PD në reformat institucionale?

Pa dyshim që po, në momente të caktuara. Por shpesh, kontributi ka qenë i kushtëzuar nga lëvizjet e konjunkturës politike dhe jo nga një vizion reformator i qëndrueshëm. Reformat janë trajtuar si mjete për legjitimitet afatshkurtër, dhe jo si projekte që shndërrojnë marrëdhëniet midis shtetit dhe qytetarit. Në këtë pikë, PD-ja ka një detyrim të madh ndaj vetes: të rikthehet si forcë që mendon institucionet, jo vetëm si instrumente pushteti, por si forma të jetës politike.

Interviste kryetari i degës Durrës L. H.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

PD ka pasur periudha të ndryshme, dhe kapaciteti organizativ ka reflektuar gjithnjë klimën politike të vendit. Në fillim të viteve '90, struktura ishte e gjallë, sepse kishte idealizëm dhe një mision të qartë historik. Gjatë periudhës së qeverisjes 2005–2013, organizata funksiononte, por filloi të largohej pak nga baza për shkak të ngarkesës së pushtetit. Pas 2017-s, ndodhi ajo që unë e quaj "shkëputje e rrjetit organizativ nga energjia e terrenit". Pra, kemi struktura, por mungon besimi dhe fryma. Kjo është sfida kryesore, rindërtimi.

2. A kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe vendimmarrjen?

Degët janë pasqyra e kontaktit me qytetarin. Dhe në shumë raste, këto degë janë lënë në harresë. Vendimmarrja e brendshme nuk ka reflektuar gjithnjë realitetin e bazës. Kur baza nuk ndikohet

në zgjedhje, në lista apo në linjat politike, atëherë krijohet një hendek. Kemi nevojë të dëgjojmë më shumë degët, të vendosim më shumë nga poshtë-lart dhe jo vetëm nga lart-poshtë.

3. Si zgjidhen zakonisht kandidatët për deputetë në PD?

Në mënyrë realiste, për zgjedhja është bërë më së shumti nga qendra, ndonjëherë edhe përmes negociatave ose vendimesh të ngushta politike. Ka pasur raste konsultimi, por nuk është kthyer në një standard institucional. Ne kemi nevojë për një sistem të qartë dhe transparent kandidimi, ku baza të ketë fjalën e saj. Kjo nuk është vetëm çështje demokracie e brendshme, por edhe besueshmërie para qytetarëve.

4. A funksionojnë organet statutorë të partisë?

Formalisht po – mbledhen, japin votat, mbajnë fjalime. Por realisht, nuk kanë funksionin që duhet. Janë kthyer në instrumente formalizimi të vendimeve që vijnë nga lart. Nuk po flas për ndonjë dramë institucionale, por për një realitet që kërkon reformim: forumet duhet të jenë qendra mendimi dhe debati, jo thjesht zyrtarizime.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta dhe transparente të lidërshipt?

Ndërrimet kanë ndodhur, por shpesh pas humbjes ose krizash, jo si pjesë e një procesi normal demokratik. Ne kemi nevojë për një model të ri, ku drejtuesit të jenë të përgjegjshëm dhe të matshëm, jo të pazëvendësueshëm. Kjo e rrit dinamikën e partisë, rrit besimin dhe motivon brez të ri drejtuesish.

6. Si është parë partia – si institucion kolektiv apo si strukturë e varur nga lideri?

Ka qenë e varur nga lideri, kjo është e vërteta. Është një kulturë që nuk i përket vetëm PD-së, por edhe sistemit politik shqiptar në tërësi. Megjithatë, nëse duam të ndërtojmë një forcë që qëndron edhe pas çdo individi, duhet të krijojmë një parti me institucione të brendshme të forta, ku vendimmarrja është kolektive dhe ku lideri është shërbëtor i anëtarësisë, jo pronar i partisë.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja sot?

PD është e djathtë në vlerat e saj – beson në lirinë ekonomike, në pronën private, në shtetin ligjor, në besimin familjar dhe në vlerat tradicionale. Por ndonjëherë këto janë artikuluar më shumë në fushata sesa në platforma konkrete. Ne duhet të punojmë për të ndërtuar një profil ideologjik më të qartë, të shoqëruar me politika të zbatueshme dhe të besueshme.

8. A janë përfshirë strukturat në vendime si bojkoti, protestat, apo mosnjohja e rezultatit?

Përfshirja ka qenë më shumë në aspektin formal. Ka pasur mbledhje, votime, por në realitet, vendimi ka ardhur nga qendra. Kjo krijon një problem të qëndrueshmërisë së veprimit. Sepse kur nuk je pjesë e diskutimit real, nuk e ndjen përgjegjësinë e asaj që vjen më pas. Prandaj, për çdo vendim madhor, strukturat duhet të jenë jo thjesht miratuese, por edhe ideuese dhe mbartëse të linjës.

9. Si e ka përjetuar PD-ja vitin 1997 dhe krizat më të vonshme si 2019 apo 2021?

1997 ishte një tragjedi politike dhe sociale për gjithë vendin, jo vetëm për PD-në. Ishte një moment ku shteti shqiptar u shemb. PD nuk ishte e përgatitur për atë përballje dhe reagimet e asaj kohe kanë qenë të ndikuara nga pasiguria dhe kriza. Në vitet e fundit, sidomos 2019 dhe 2021, kemi pasur reagime të forta ndaj deformimeve zgjedhore, por ndonjëherë kemi neglizhuar zgjidhjet institucionale. Duhet të ruajmë gjithnjë frymën e përballjes, por jo në kurriz të pjesëmarrjes.

10. Si është qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura si gjyqësori, KQZ, Presidenti?

PD është kritike ndaj mënyrës se si këto institucione janë përdorur politikisht, por jo ndaj rolit të tyre si të tillë. Ne kemi besuar dhe vazhdojmë të besojmë se drejtësia dhe institucione si KQZ-ja duhet të jenë të pavarura. Por aktualisht, ato janë nën ndikimin e qeverisë. Nuk jemi për rrëzimin e tyre, por për çlirimin e tyre nga presioni politik.

11. A ka kontribuar PD në reformat institucionale në vend?

Po, PD ka kontribuar në shumë reforma – zgjedhore, territoriale, në drejtësi. Ka pasur gjithnjë qëndrim të përgjegjshëm, edhe kur ka qenë në opozitë. Problemi është që shumë prej këtyre reformave janë deformuar gjatë zbatimit nga mazhoranca. Ajo që ne kemi nevojë sot është një fazë e re: reforma me garanci të ndërsjella dhe me frymë europiane, jo thjesht procedura që i shërbejnë pushtetit të radhës.

Interviste me kryeren E G

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të Partisë Demokratike në periudha të ndryshme?

PD ka pasur një kapacitet organizativ të lartë në momente kyçe të historisë së saj, veçanërisht në vitet e para të demokracisë, kur shpresa dhe idealizmi mbizotëronin. Gjatë periudhës në pushtet 2005–2013, kishte një qëndrueshmëri strukturore, por ndoshta u humb disi lidhja e drejtpërdrejtë me bazën. Pas vitit 2017, për shkak të krizave të brendshme dhe presioneve të jashtme, PD u dobësua në aspektin organizativ, por unë besoj se ajo mbetet një forcë me rrjet të gjerë dhe kapacitete të rikuperueshme, nëse udhëhiqet drejt dhe me sens përfshirës.

2. A kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe në vendimmarrje?

Degët lokale janë shtylla kurrizore e Partisë Demokratike. Në shumicën e rasteve, ato kanë mbajtur gjallë lidhjen me qytetarin, veçanërisht në kushte të vështira. Problemi është se roli i tyre në vendimmarrje ka qenë i kufizuar. Vendimet shpesh janë marrë nga qendra, dhe kjo ka krijuar një ndjesi mënjanimi. Ne duhet ta përmbysim këtë logjikë dhe ta bëjmë partinë më përfaqësuese nga poshtë-lart.

3. Si realizohet përzgjedhja e kandidatëve për deputetë në PD?

Kjo është një nga pikat që kërkon reformim. Ka pasur tentativa për përzgjedhje më të hapura dhe më demokratike, por ato nuk janë kthyer në standard. Kandidatët shpesh janë përzgjedhur në mënyrë të centralizuar. Unë besoj fort se duhet t'u japim zë anëtarëve në këtë proces – përmes primareve, konsultimeve të gjera dhe vlerësimeve meritokratike.

4. A funksionojnë organet statutore të partisë?

Ato kanë funksionuar në kuptimin formal, por shpesh pa ndikim real. Forume si Këshilli Kombëtar apo Kuvendi duhet të jenë qendra të debatit të brendshëm, jo vetëm institucione votimi. Ne kemi nevojë për një PD që dëgjon dhe përpunon mendime nga çdo nivel, jo thjesht i delegon ato nga lart.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta të lidërshipt të partisë?

Ndërrimet kanë ndodhur, por shpesh në kontekst krizash, jo si rezultat i një procesi të qetë institucional. Kjo ka dëmtuar besimin e opinionit publik. Demokracia e brendshme nuk duhet të zbatohet vetëm kur ka krizë – ajo duhet të jetë pjesë e kulturës politike të përditshme. Udhëheqësit duhet të jenë të përkohshëm në funksion, por të përhershëm në përfaqësim.

6. Si perceptohet partia në raport me figurën e liderit?

Në shumë raste, partia është perceptuar si e varur nga lideri. Kjo është problematike. Një parti moderne duhet të jetë më shumë se figura e një individi. Ajo duhet të përfaqësojë një komunitet politik dhe një identitet të përbashkët. PD duhet të kthehet në një institucion kolektiv, ku të gjithë ndihen pjesë dhe ku vendimet nuk varen nga një njeri i vetëm.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja sot?

PD është një parti e qendrës së djathtë me vlera të qarta: liri ekonomike, shtet ligjor, mbrojtje të pronës dhe të familjes. Kohët e fundit ka pasur një artikulum më të fortë të këtyre parimeve, sidomos në kontekstin e sovranitetit dhe lirisë së individit. Ajo që i mungon ndonjëherë është konkretizimi i këtyre vlerave në politika të qarta dhe të prekshme nga qytetarët.

8. A janë përfshirë strukturat vendimmarrëse në vendime si bojkot, protesta, apo mosnjohje rezultatesh?

Po, janë përfshirë në mënyrë formale. Ka pasur mbledhje, votime, deklarime. Por shpesh vendimet janë qenë të paracaktuara nga qendra. Unë mendoj se për vendime të tilla të mëdha, strukturat duhet të jenë pjesë reale e procesit – të diskutojnë, të debatojnë dhe të ndajnë përgjegjësinë.

9. Si e përjetoi PD-ja vitin 1997 dhe si ka vepruar në krizat e mëvonshme si 2019 apo 2021?

1997 ishte një moment dramatik për Shqipërinë dhe për vetë PD-në. Ajo përballej me një krizë të shumëfishtë – politike, ekonomike dhe institucionale. Mësimi më i rëndësishëm është se partitë duhet të jenë gjithmonë të gatshme të dialogojnë dhe të zgjidhin krizën përmes institucioneve. Edhe në vitet e fundit, PD ka pasur reagime të forta përballë padrejtësive, por ndoshta ndonjëherë ka munguar balanca mes protestës dhe pjesëmarrjes.

10. Si ka qenë qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura?

PD ka pasur një qëndrim kritik ndaj kapjes së institucioneve dhe me të drejtë. Gjyqësori, KQZ-ja, SPAK të gjitha janë parë si të politizuara në mënyrë të njëanshme. Por është e rëndësishme të mbrojmë konceptin e institucioneve dhe jo të rrënojmë besimin te to. Ne duhet të jemi kritikë, por edhe të jemi të parët që i respektojmë institucionet, kur ato funksionojnë sipas ligjit.

11. A ka kontribuar PD në reformat institucionale në vend?

Po. PD ka kontribuar në të gjitha reformat madhore në drejtësi, në sistemin zgjedhor, në administratë. Ka pasur momente të vështira, ka pasur mospajtime, por qëndrimi parimor i PD-së ka qenë gjithmonë në mbështetje të reformave që garantojnë liri, drejtësi dhe rregull institucional. E rëndësishme është që çdo reformë të mos përdoret për të asgjësuar opozitën

Interviste me sekretarin për organizimin, anëtar i kryesisë E. M.

1. Si e vlerësoni kapacitetin organizativ të PD-së në periudha të ndryshme?

PD-ja ka pasur një organizim serioz që nga krijimi i saj. Në vitet '90, ajo ishte e mbushur me idealizëm dhe njerëz që punonin pa pushim. Më vonë, sidomos gjatë viteve në pushtet, organizimi u bë më teknik, më i ndërtuar, por edhe më pak i lidhur me bazën. Pas vitit 2017 kemi një rënie të ndjeshme në terren, për shkak të përçarjeve të brendshme dhe zhgënjimit të anëtarësisë. Ka degë që funksionojnë mirë, por ka dhe zona që kanë nevojë për ringritje nga e para.

2. A kanë qenë funksionale degët lokale në përfaqësimin e anëtarësisë dhe në vendimmarrje?

Jo sa duhet. Degët punojnë, por nuk janë dëgjuar aq sa duhet. Vendimet shpesh janë marrë nga qendra dhe degët kanë vepruar vetëm si zbatues. Kjo ka krijuar largim dhe pasivitet. Degët duhet të kenë më shumë zë, më shumë përgjegjësi dhe më shumë hapësirë për të përfaqësuar realitetin anëtarësinë në vendimmarrje.

3. Si zgjidhen zakonisht kandidatët për deputetë në PD?

Në teori, kemi procedura, por në praktikë, shpesh janë bërë nga qendra. Është e nevojshme të ketë më shumë transparencë. Kandidati duhet të vijë nga baza, të ketë mbështetjen e degës dhe të

jetë i njohur për kontributin. Kemi pasur raste që janë vendosur emra pa lidhje me zonën. Kjo ka sjellë pakënaqësi dhe humbje. Ky model duhet ndryshuar.

4. A funksionojnë organet statutore të partisë?

Funksionojnë në aspektin formal. Mblidhen, votojnë, por nuk ka debat të vërtetë. Këshilli Kombëtar, Kuvendi – janë kthyer në institucione të miratimit, jo të përballjes me ide. PD ka nevojë për forume që flasin, që debatojnë, që krijojnë zgjidhje. Jo vetëm për të duartrokitur çfarë është vendosur më parë.

5. A ka pasur ndërrime të rregullta dhe transparente të lidhshimit të partisë?

Ndryshimet kanë ardhur më shumë si pasojë e presionit pas humbjeve sesa nga një proces normal. Duhet të ketë një rregull të qartë – kush humbet, ikën. Kush fiton mbështetjen, qëndron. Nuk mund të kemi lidhshim të përvetshëm. Kjo është një parti politike, jo ndërmarrje personale.

6. Si është parë partia – si institucion kolektiv apo si strukturë e lidhur me liderin?

Shumë kohë ka funksionuar si e lidhur me liderin. Kjo nuk është vetëm faji i individëve, por i një kulture politike që nuk ka ndryshuar ende. Duhet të kthehemi te struktura, te forumi, te kolektiviteti. PD nuk është e një njeriu. Është e demokratëve, e atyre që kanë qenë në terren për vite, jo e atyre që vijnë vetëm për zgjedhje.

7. A ka një orientim ideologjik të qartë PD-ja sot?

Po, është një parti e qendrës së djathtë, pro tregut të lirë, pro familjes, pro besimit dhe kombit. Problemi është që ndonjëherë këto ide janë thënë në fushatë, por jo kthyer në politika konkrete. Duhet më shumë punë për t'i bërë këto ide të prekshme për qytetarin.

8. A janë përfshirë strukturat vendimmarrëse në vendime si bojkot, protesta, mosnjohje rezultatesh?

Janë thirrur, janë njoftuar, por vendimi zakonisht ka ardhur nga qendra. Strukturat duhet të kenë më shumë peshë. Nuk mund të bësh bojkot ose protestë pa konsultim real me ata që do ta mbajnë barrën. Ka raste që njerëzit janë lodhur sepse nuk ndihen pjesë e procesit.

9. Si e përjetoi PD-ja vitin 1997 dhe si ka vepruar në krizat më të vonshme?

1997 ishte një vit i errët. Shqipëria ishte jashtë kontrollit dhe PD-ja nuk ishte e përgatitur për atë situatë. Ka pasur gabime, por edhe një mungesë e thellë shteti. Më pas, në 2019, 2021, krizat janë trajtuar më shumë me aksion sesa me plan. Duhet të jemi më të përgatitur. Opozita ka detyrë të jetë aktive, por edhe me ide, jo vetëm me reagime.

10. Si ka qenë qëndrimi i PD-së ndaj institucioneve të pavarura?

PD ka qenë kritike ndaj mënyrës si janë kapur institucionet nga qeveria. Gjyqësori, KQZ-ja, institucionet e kontrollit janë kthyer në vegla. Ne nuk jemi kundër institucioneve – përkundrazi, i duam më të forta. Por duam që ato të jenë të ndershme, jo të bëjnë propagandë për qeverinë.

11. A ka kontribuar PD në reformat institucionale?

Po. Ka qenë pjesë e reformave zgjedhore, të drejtësisë, të decentralizimit. Por shumë herë, qeveria ka abuzuar me besimin dhe ka përdorur reformat për pushtet. PD ka qenë konstruktive, por nuk mund të jemi gjithmonë pjesë e fasadave. Nëse bëjmë reformë, ajo duhet të jetë reale dhe të ndikojë për mirë te qytetari.